



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS 2025



WWW.KLSH.ORG.AL

© Kontrolli i Lartë i Shtetit

Materiali i paraqitur në këtë dokument i nënshtrohet të drejtës së autorit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Materiali mund të kopjohet ose riprodhohet vetëm për qëllime jokomerciale, përkatësisht riprodhim për kërkime, studime private ose për qarkullim të brendshëm të kufizuar brenda një organizate për qëllime studimore dhe analitike. Kopjimi për qëllime jokomerciale duhet të shoqërohet me një njohje të mjaftueshme, të riprodhohet me saktësi dhe të mos përdoret në një kontekst tjetër.



Përmbajtja

| | |
|---------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| MESAZHI I KRYETARIT TË KLSH-SË | 04 |
| <hr/> | |
| 1. MISIONI, VIZIONI DHE OBJEKTIVAT | 06 |
| <hr/> | |
| 2. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE | 10 |
| <hr/> | |
| 3. AKTIVITETI AUDITUES | 30 |
| 3.1 Auditime të Përputhshmërisë | 31 |
| 3.2 Auditime të kombinuara | 61 |
| 3.3 Auditime financiare | 88 |
| 3.4 Auditime tematike | 112 |
| 3.5 Auditime të performancës | 120 |
| 3.6 Auditime të Teknologjisë së Informacionit | 134 |
| 3.6 Auditime të zbatimit të rekomandimeve | 139 |
| <hr/> | |
| 4. MENAXHIMI INSTITUCIONAL DHE ZHVILLIMI STRATEGJIK | 143 |
| 4.1 Monitorimi vjetor i "Strategjisë së zhvillimit Institucional 2023-2027" | 144 |
| 4.2 Mbi menaxhimin e Burimeve Njerëzore | 148 |
| 4.3 Zhvillimi i vazhdueshëm profesional | 152 |
| 4.4 Vetëvlerësimi vjetor sipas kornizës INTOSAI | 154 |
| <hr/> | |
| 5. KOMUNIKIMI DHE BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL | 157 |
| 5.1 KLSH dhe Kuvendi | 159 |
| 5.2 KLSH dhe Media | 164 |
| 5.3 KLSH dhe partnerët strategjikë | 167 |
| 5.4 Vlerësime nga institucione ndërkombëtare | 181 |
| 5.5 Programi i transparencës dhe e drejta për informim | 185 |
| <hr/> | |
| 6. TREGUESIT BUXHETORË DHE FINANCIARË TË KLSH-SË DHE OPINIONI I AUDITIT TË BRENDSHËM | 187 |
| 6.1 Treguesit buxhetorë dhe financiarë të KLSH-së | 188 |
| 6.2 Opinioni i auditit të brendshëm mbi pasqyrat financiare | 191 |
| <hr/> | |
| 7. ANEKSE | 192 |
| <hr/> | |



MESAZHI I KRYETARIT TË KLSH-SË, Z. ARBEN SHEHU

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përmbushje të mandatit të tij kushtetues dhe ligjor, paraqet Raportin e Performancës për vitin 2025, si një dokument që pasqyron veprimtarinë audituese, zhvillimin institucional dhe kontributin e dhënë në forcimin e llogaridhënies, transparencës dhe mirëqeverisjes në sektorin publik.

Gjatë vitit 2025, KLSH ka vijuar ushtrimin e funksioneve të tij me profesionalizëm, pavarësi dhe përkushtim, duke synuar që përdorimi i fondeve publike dhe administrimi i pasurisë shtetërore të zhvillohen në përputhje me ligjin, me parimet e economicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, si dhe në funksion të interesit publik. Nëpërmjet auditimeve të kryera në nivele të ndryshme të qeverisjes dhe në institucione të natyrave të ndryshme, KLSH ka kontribuar në evidentimin e problematikave, dobësive sistematike dhe risqeve që cenojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe administrativ të sektorit publik.

Puna audituese është mbështetur në standardet ndërkombëtare të auditimit publik, në kuadrin metodologjik të institucionit dhe në një qasje të orientuar drejt cilësisë dhe objektivitetit. Gjetjet dhe rekomandimet e adresuara kanë synuar jo vetëm evidentimin e shkeljeve dhe parregullsive, por mbi të gjitha nxitjen e përmirësimeve të qëndrueshme në sistemet e kontrollit të brendshëm, planifikimit, ekzekutimit buxhetor, prokurimeve publike, administrimit të të ardhurave dhe menaxhimit të aseteve publike.

Auditimet financiare kanë nxjerrë në pah mangësi në saktësinë dhe plotësinë e raportimit financiar, në pasqyrimin e aktiveve dhe detyrimeve, si dhe në rakordimin dhe klasifikimin e zërave kontabël. Auditimet e përputhshmërisë kanë evidentuar dobësi të vazhdueshme në zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator, veçanërisht në fushën e prokurimeve publike, administrimit të pasurisë, menaxhimit të kontratave dhe disiplinës buxhetore. Nga auditimet e performancës është konstatuar se, në një sërë rastesh, orientimi drejt rezultateve të matshme dhe ndikimit konkret mbetet ende i pamjaftueshëm, ndërsa auditimet e teknologjisë së informacionit kanë evidentuar nevojën për forcimin e sigurisë së sistemeve dhe të kapaciteteve menaxhuese në këtë fushë.

Një rëndësi e veçantë gjatë vitit 2025 i është kushtuar ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve, si një tregues thelbësor i ndikimit të punës së KLSH-së. Pranimi i lartë i rekomandimeve konfirmon vlerësimin institucional të punës sonë, ndërsa ritmi dhe cilësia e zbatimit të tyre mbeten ende një sfidë që kërkon angazhim më të madh nga institucionet publike. Në këtë drejtim, KLSH do të vijojë të forcojë monitorimin dhe dialogun institucional, me qëllim që rekomandimet e dhëna të mos mbeten vetëm në nivel pranimi, por të përkthehen në ndryshime konkrete dhe të matshme.

Gjatë këtij viti, KLSH ka vijuar gjithashtu përpjekjet për forcimin e kapaciteteve të veta profesionale dhe institucionale, nëpërmjet trajnimeve të specializuara, përmirësimit të metodologjive audituese dhe bashkëpunimit me institucione homologe dhe partnerë ndërkombëtarë. Kjo qasje ka synuar rritjen e cilësisë së auditimit dhe përshtatjen e vazhdueshme të institucionit me kërkesat e zhvillimit të administrimit publik dhe të standardeve bashkëkohore të auditimit.

KLSH ka vijuar të mbetet një institucion i hapur ndaj Kuvendit, qytetarëve, medias dhe palëve të tjera të interesit, duke konsideruar transparencën dhe komunikimin publik si pjesë të rëndësishme të misionit të tij. Besimi i publikut ndaj institucioneve të auditimit ndërtohet



mbi profesionalizmin, paanshmërinë, integritetin dhe qëndrueshmërinë e punës së tyre, ndaj këto vlera kanë udhëhequr veprimtarinë tonë edhe gjatë vitit 2025.

Viti 2025 përbën një moment të rëndësishëm për KLSH-në, pasi shënoi 100-vjetorin e themelimit të këtij institucioni kyç në fushën e auditimit të jashtëm publik në Republikën e Shqipërisë. Ky përvjetor përfaqëson një moment reflektimi mbi rrugëtimin shekullor të institucionit dhe njëkohësisht një vlerësim të rolit të tij në forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe mirëmenaxhimit të financave publike.

I nderuar lexues,

Raporti i Performancës për vitin 2025 është një pasqyrë e angazhimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për të qenë një institucion i besueshëm dhe në shërbim të interesit publik. Në një mjedis ku kërkesat për llogaridhënie, transparencë dhe përdorim të përgjegjshëm të burimeve publike bëhen gjithnjë e më të larta, roli i KLSH-së mbetet thelbësor për mbështetjen e mirëqeverisjes dhe forcimin e besimit të qytetarëve tek institucionet publike.

KLSH do të vijojë të përmbushë misionin e tij me objektivitet, profesionalizëm dhe pavarësi, duke mbetur një mekanizëm i rëndësishëm mbikëqyrës, një partner institucional për përmirësim dhe një zë i qëndrueshëm në mbrojtje të interesit publik.

Arben SHEHU







01

MISIONI,
VIZIONI DHE
OBJEKTIVAT

1. MISIONI, VIZIONI & OBJEKTIVAT



Misioni

Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucion i pavarur, kushtetues, i cili nëpërmjet ekspertizës dhe auditimeve cilësore, mbështet Kuvendin dhe informon publikun dhe palët e interesit në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në menaxhimin e parasë së taksapaguesve, me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike.

Vizioni

KLSH është një institucion model që udhëheq nëpërmjet shembullit, nxit rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës, dhe përmirësimin e shërbimeve publike, nëpërmjet auditimeve cilësore dhe luftës kundër korrupsionit, duke forcuar integritetin dhe besimin e publikut tek institucioni.

Objektivat

Përcaktuar në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2023-2027, objektivat e KLSH-së edhe për vitin 2025 janë:

- Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH-së, si mbështetës i Kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të enteve publike.
- Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë, nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve.
- Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese.

Në linjë me INTOSAI P-12 “Vlerat dhe përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditimit - Një ndryshim në jetën e qytetarëve”, KLSH ka adoptuar parimet që përcaktojnë mënyrën se si institucioni duhet të përmbushë mandatin për të forcuar përgjegjshmërinë, transparencën dhe integritetin e qeverisë dhe njësisë të sektorit publik, duke ruajtur vlerat që lidhen me: forcimin e llogaridhënies, transparencës dhe integritetit të qeverisë në njësitë e sektorit publik; demonstrimin e rëndësisë dhe konsideratës së duhur ndaj qytetarëve, Parlamentit dhe grupeve të tjera të interesit; dhe shndërrimin në një organizatë model, duke udhëhequr nëpërmjet shembullit.







02

PËRMBLEDHJA
EKZEKUTIVE

TREGUESIT KRYESORË, VITI 2025

**190** AUDITIME

Në përputhje me mandatin ligjor dhe objektivat strategjike institucionale, gjatë vitit 2025, KLSH ka kryer 190 auditime nga 180 të programuara, si auditime financiare, përputhshmërie, performance, auditime të sistemeve të teknologjisë dhe informacionit, auditime të kombinuara, për zbatimin e rekomandimeve dhe auditime tematike për çështje të veçanta.

| | |
|------------------------------|-----------|
| Financiare | 63 |
| Përputhshmërie | 44 |
| Të kombinuara | 32 |
| Performance | 13 |
| IT | 10 |
| Mbi zbatimin e rekomandimeve | 15 |
| Tematik | 13 |

**222**
OPINIONE/MESAZHE/
KONKLUZIONE

Bazuar në evidencën e auditimit dhe gjykimin profesional të audituesit, në vlerësim të kriterëve të auditimit, materialitetit të gjetjeve dhe përhapjes së tyre, është konkluduar respektivisht me opinione/mesazhe/konkluzione auditimi, si më poshtë:

| | |
|----------------------|------------|
| Financiare | 95* |
| Përputhshmërie | 76* |
| Mesazhe | 13 |
| Konkluzione IT | 10 |
| Konkluzione të tjera | 28 |

**4994** REKOMANDIME

Për mangësitë, parregullsitë dhe problematikat e identifikuar në misionet e auditimit janë dhënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, të klasifikuara sipas llojit, si më poshtë:

| | |
|--------------------------------------------------------------|-------------------|
| Masa organizative | 3268 |
| Përmirësime ligjore | 29 |
| Disiplinore | 916 |
| Administrative | 59 |
| Efekte financiare (nr) | 722 |
| Dëm ekonomik/parregullsi me efekte financiare (në mijë lekë) | 26,210,795 |

*opinione/konkluzione për auditimet financiare dhe ato të përputhshmërisë



TREGUESIT KRYESORË, VITI 2025



271 SUBJEKTE TË
AUDITUARA

Në përputhje me mandatin ligjor, KLSH ka kryer auditime, të qeverisjes qendrore, vetëqeverisjes vendore, shoqëri publike me kapital shtetëror mbi 50% dhe auditime të investimeve me financim të huaj dhe institucione të administrimit të pronës publike si më poshtë:

| | |
|------------------------------------------|------------|
| Institucione qëndrore | 126 |
| Vetëqeverisja vendore | 87 |
| Shoqëri publike | 45 |
| Inst. të administrimit të pronës publike | 13 |



70 % ZBATUESHMËRIA* E
REKOMANDIMEVE

Në përmbushje të detyrimit ligjor, KLSH ka kryer auditime mbi zbatimin e 4348 rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme, me qëllim verifikimin e statusit të tyre, rezultatet e të cilëve paraqiten si më poshtë:

Masa të pranuar

| | |
|--------------------|-------------|
| nga të cilat: | 4294 |
| Zbatuar plotësisht | 1598 |
| Zbatuar pjesërisht | 645 |
| Në proces zbatimi | 746 |
| Pa zbatuar | 1305 |

*Në treguesin e zbatueshmërisë, përfshihen rekomandimet e zbatuara plotësisht, pjesërisht dhe në proces zbatimi



TREGUESIT KRYESORË, VITI 2025



STRUKTURA

Për menaxhimin e burimeve njerëzore KLSH zbaton kuadrin ligjor në fuqi. Procedurat e rekrutimit të punonjësve përgjatë vitit 2025 janë zhvilluar në koherencë me Strategjinë e Zhvillimit të institucionit 2023-2027, si dhe me politikat e miratuara të menaxhimit të burimeve njerëzore, me qëllim që KLSH të sigurojë stafin e duhur me kualifikimet, aftësitë dhe përvojën e nevojshme për të plotësuar nevojat aktuale dhe të perspektivës.

| | |
|----------------------------------------------|------------|
| Punonjës gjithsej | 215 |
| Staf auditues gjithsej | 154 |
| Internship-e në ECA dhe GAO | 1 |
| Certifikim ACCA | 1 |
| Nëpunës të certifikuar nga INTOSAI & EUROSAI | 2 |



KOMUNIKIMI DHE BASHKËPUNIMI

Në zbatim të Strategjisë së Komunikimit 2022-2025 e rishikuar, KLSH ka vijuar me publikimin e rezultateve të auditimit, të cilat kanë gjetur pasqyrim të gjerë përmes medias së shkruar dhe audiovizive, duke rritur vizibilitetin e punës audituese të KLSH-së. Gjithashtu, ka vijuar bashkëpunimi me partnerët e brendshëm dhe ndërkombëtarë, sipas marrëveshjeve përkatëse.

| | |
|----------------------------------|-------------|
| Raporte auditimi, të publikuara | 190 |
| Kërkesa/ankesa të trajtuara | 189 |
| Artikuj/kronika mbi KLSH | 1115 |
| Auditime paralele/të përbashkëta | 4 |
| Marrëveshje të reja bashkëpunimi | 2 |
| Projekt me IDI i përfunduar | 1 |



ZHVILLIMI PROFESIONAL

KLSH, në përmbushje të detyrimit ligjor, ka implementuar me sukses programin e zhvillimit të integruar profesional të punonjësve, në bashkëpunime më partnerë të brendshëm si ASPA, dhe të jashtëm si SAI-e homologe, INTOSAI, EUROSAI, IDI, CEF, Banka Botërore etj.

| | |
|------------------------------------|------------|
| Ditë trajnimi/vit/auditues | 28 |
| Ditë trajnimi/vit/jo-auditues | 21 |
| Tema me trajnerë të huaj | 34% |
| Tema me trajnerë vendas | 66% |
| Konferenca, trajnime ndërkombëtare | 47 |



2. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë vitit 2025 ka zhvilluar 190 misione auditimi në institucionet publike. Këto misione kanë përfshirë 44 auditime të përputhshmërisë, 32 auditime të kombinuara, 63 auditime financiare, 13 auditime tematike, 13 auditime performance, 10 auditime të sistemeve të teknologjisë së informacionit, si dhe 15 auditime për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve. KLSH i ka kryer këto misione auditimi në 271 subjekte, nga të cilat 126 subjekte të qeverisjes qendrore, 87 të vetëqeverisjes vendore, 13 institucione të administrimit të pronës publike dhe 45 shoqëri publike me aksioner shtetin mbi 50%.

Auditimet e kryera kanë konkluduar në dhënien e 222 opinioneve, mesazheve dhe konkluzioneve, nga të cilat 71 opinione përputhshmërie, 95 opinione financiare, 18 konkluzione për auditime përputhshmërie dhe tematik, 13 mesazhe auditimi performance, 10 konkluzione auditimi IT, si dhe 15 konkluzione të tjera për zbatimin e rekomandimeve.

Nga 76 auditime që kanë vlerësuar aspekte të përputhshmërisë, në 3 prej tyre nuk janë evidentuar devijime materiale nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, në 68 prej tyre devijimet e konstatuara kanë qenë materiale, por jo të përhapura, për të cilat është dhënë opinion i kualifikuar, dhe në 5 prej tyre është konkluduar me konkluzion.

Në 25 raste, pasqyrat financiare kanë paraqitur në mënyrë të drejtë situatën financiare të subjekteve të audituara, ku vetëm në 15 prej tyre, janë evidentuar çështje për theksim. Në 3 raste, ku mangësitë janë konsideruar materiale dhe të përhapura, është dhënë opinion i kundërt, ndërsa për pjesën tjetër të subjekteve të audituara, ku është evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, është dhënë opinion i kualifikuar.

Si rezultat i auditimeve janë dhënë 4994 rekomandime, të cilat përfshijnë 29 propozime për përmirësime të kuadrit ligjor, 3268 masa organizative, 281 masa për shpërblim dëmi, 441 masa për adresimin e parregullsive me efekt negativ financiar dhe 975 masa disiplinore dhe administrative. Këto masa kanë synuar adresimin e problematikave të konstatuara, forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe rritjen e përgjegjshmërisë institucionale, me qëllim përmirësimin e administrimit të fondeve publike, në funksion të shmangies së përsëritjes së tyre në të ardhmen.

Në përputhje me detyrimin ligjor dhe si një tregues thelbësor i efektivitetit dhe ndikimit të veprimtarisë audituese, KLSH realizon në mënyrë të vazhdueshme auditime për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme. Ky proces synon të vlerësojë nivelin e zbatimit të rekomandimeve nga institucionet e audituara, si dhe të sigurojë ndjekjen e masave të marra për adresimin e tyre. Gjatë vitit 2025 është verifikuar zbatimi i rekomandimeve të lëna në 125 auditime të mëparshme, ku rezultoi se rreth 99% e tyre janë pranuar, nga të cilat 70% e tyre janë zbatuar plotësisht, pjesërisht ose janë në proces zbatimi nga institucionet përkatëse. Ky tregues, pavarësisht nivelit të lartë të pranueshmërisë së rekomandimeve, evidenton nevojën për përmirësimin e mëtejshëm të nivelit të zbatimit të tyre në praktikë. Në këtë kuadër, KLSH ka vijuar të ndjekë zbatimin e rekomandimeve në subjektet e audituara, duke kërkuar marrjen e masave konkrete për zbatimin e plotë dhe në kohë të tyre, si një mekanizëm kyç për sigurimin e ndjekjes efektive të rekomandimeve dhe për përmirësimin e performancës së institucioneve të audituara.

Në vijim paraqiten gjetjet kryesore të evidentuara gjatë auditimeve, të strukturuar sipas fushave përkatëse, mbi bazën e të cilave janë formuluar rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.



Çështje që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare

Nga auditimi u konstatua se pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara të transaksioneve financiare të shtetit nuk janë hartuar dhe dorëzuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e raportimit financiar publik. Gjithashtu, në një sërë subjektsh të audituara është konstatuar mungesa e pasqyrave financiare të konsoliduara me njësitë e varësisë, duke cenuar parimin e paraqitjes së drejtë dhe të plotë të pozicionit dhe performancës financiare të institucioneve. Mungesa e një kuadri të plotë dhe të përditësuar rregullator për raportimin financiar në sektorin publik, ku aktualisht hartimi i tyre mbështetet në një udhëzim të vitit 2018, të ndryshuar në vitin 2022, ka sjellë dobësi në standardizimin, krahasueshmërinë dhe cilësinë e raportimit financiar. Nga auditimi u konstatuan mangësi në respektimin e afateve ligjore për dorëzimin e pasqyrave financiare, mungesë e rakordimeve ndërmjet pasqyrave financiare të viteve të njëpasnjëshme, si dhe pasqyra financiare që nuk përfshijnë të gjitha transaksionet e periudhës raportuese, duke cenuar parimin e plotësisë. Gjithashtu janë evidentuar mangësi në saktësinë dhe besueshmërinë e raportimit financiar, të lidhura me keqklasifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, mosnjohjen në kohë të të ardhurave në kundërshtim me parimin e të drejtës së konstatuar, si dhe regjistrim të pasaktë të detyrimeve debitore dhe kreditore, përfshirë trajtimin e shpenzimeve kapitale si shpenzime operative, duke ndikuar në rezultatin financiar të periudhës. Njëkohësisht, u konstatua nivel i lartë i debitorëve të paarkëtuar me shtesa të vazhdueshme ndër vite, mosregjistrim i plotë i detyrimeve që lidhen me taksat vendore, taksën e ndikimit në infrastrukturë, tarifat e qirasë dhe gjobat, si dhe mungesë e ndjekjes së procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura. Në lidhje me saktësinë dhe plotësinë e aktiveve, u konstatuan mangësi që lidhen me mosregjistrimin e plotë të pasurive në regjistrat kontabël, mosregjistrimin e asetëve të transferuara me VKM nga ish-komunat ose nga qeveria qendrore për shkak të mungesës së titullit të pronësisë ose mosvlerësimit të tyre, moskontabilizim i vlerave nga pjesëmarrje në kapitale, si dhe aplikim i gabuar i normave të amortizimit, duke ndikuar në vlerën neto të aktiveve dhe në fondin e akumuluar. U evidentuan gjithashtu dobësi sistematike që lidhen me mos transferimin dhe moscentralizimin e sistemeve dhe infrastrukturës IT pranë strukturave përgjegjëse, mungesën e analizave shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat financiare, mungesën e harmonizimit ndërmjet sistemeve të kontabilitetit dhe të dhënave të raportuara në sistemin e thesarit, si dhe mungesën e regjistrave të plotë dhe të përditësuar të detyrimeve, përfshirë detyrimet ndaj furnitorëve dhe ato që burojnë nga vendimet gjyqësore. Në kuadër të procesit të inventarizimit vjetor, u konstatua se nuk janë përpiluar raporte mbi inventarizimin fizik të aktiveve, përfshirë vlerësimin e gjendjes fizike, kushtet e ruajtjes dhe diferencat e konstatuara. Gjithashtu, nuk janë analizuar shkaqet e këtyre diferencave dhe nuk janë identifikuar personat përgjegjës, ndërkohë që janë evidentuar mangësi në procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe standardet kontabël.

Në lidhje me sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, u konstatua mungesa e një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm, e cila lidhet me mos hartimin e një kuadri të plotë rregullash të shkruara për funksionimin e tij, si dhe me moszbatimin e masave dhe mekanizmave të nevojshëm për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve, garantimin e ndarjes së detyrave, monitorimin e vazhdueshëm të proceseve, si dhe sigurimin e përputhshmërisë me legjislacionin dhe procedurat në fuqi. Gjithashtu, vlerësimet e cilësisë nga struktura përgjegjëse në ministrinë përkatëse janë kryer me një mbulim të ulët vjetor, krahasuar me numrin e vlerësimeve të parashikuara çdo vit dhe me kërkesat ligjore për periodicitetin e kryerjes së tyre.

Shërbimi i auditimit të brendshëm nuk ka pasur një mbulim të plotë të të gjitha njësive brenda fushës së ligjit. Në disa raste, mungon dokumentimi i plotë i marrëveshjeve ndër-institucionale për mbulimin e shërbimit. Kapacitetet njerëzore dhe profesionale rezultojnë të



pamjaftueshme, duke evidentuar mangësi në përmbushjen e funksioneve dhe në nivelin e certifikimit profesional. Gjithashtu, janë evidentuar devijime nga afatet procedurale, pasi planet e auditimit janë dorëzuar dhe miratuar jashtë afateve të përcaktuara dhe, në disa raste, pa një analizë të dokumentuar dhe të strukturuar të riskut. U konstatua një nivel i ulët i realizimit të planit vjetor të auditimit, veçanërisht në fushat me rëndësi si auditimet e performancës dhe auditimet e teknologjisë së informacionit. Po ashtu, evidentohet një nivel i pamjaftueshëm i zbatimit të rekomandimeve, çka tregon për mangësi në mekanizmat e ndjekjes (follow-up) dhe në sigurimin e efektivitetit të masave korigjuese.

Në përfundim, mangësitë e evidentuara tregojnë për dobësi në sistemet e kontrollit të brendshëm financiar dhe në zbatimin e kuadrit ligjor dhe standardeve të raportimit financiar në sektorin publik. Këto problematika cenojnë besueshmërinë, plotësinë dhe saktësinë e informacionit financiar, duke kufizuar transparencën dhe llogaridhënien. Si rezultat, pasqyrat financiare nuk ofrojnë një paraqitje të drejtë dhe të besueshme të pozicionit dhe performancës financiare së institucioneve publike, duke rritur riskun e vendimmarrjes së pasaktë nga përdoruesit e informacionit, si dhe riskun për keqmenaxhim të burimeve financiare, mungesë transparence dhe efektivitet të ulët në arritjen e objektivave institucionale.

Çështje që lidhen me përputhshmërinë e aktivitetit të institucioneve publike

Gjatë vitit 2025, KLSH ka kryer auditime të përputhshmërisë, nga të cilat janë evidentuar mangësi në drejtim të planifikimit dhe zbatimit të buxhetit, realizimit të procedurave të prokurimit publik, zbatimit të kontratave, menaxhimit të burimeve njerëzore, si dhe aspekte të tjera të veprimtarisë së subjekteve të audituara.

Nga auditimi i procesit të planifikimit dhe zbatimit të buxhetit janë konstatuar mangësi në të gjitha fazat, ku janë evidentuar vonesa në paraqitjen e kërkesave, mangësi në dokumentacion, paraqitje kërkesash përtej tavaneve të miratuara, si dhe hartimi i listës së investimeve publike me pasaktësi dhe angazhime që tejkalojnë kufijtë trevjeçarë. Gjatë vitit janë kryer një numër i lartë rishikimesh buxhetore dhe ndryshimesh, përfshirë akte normative në fund të vitit, duke u shoqëruar me rishpërndarje fondesh dhe vendimmarrje që devijojnë nga parimet e menaxhimit të qëndrueshëm fiskal. Në fazën e ekzekutimit, janë konstatuar problematika në disiplinën buxhetore dhe respektimin e kuadrit ligjor, përfshirë pagesa të konsiderueshme për detyrime të viteve të mëparshme, regjistrime të pasakta dhe me vonesë të kontratave dhe faturave në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë. Një numër i konsiderueshëm kontratash janë lidhur dhe regjistruar me vonesë, ndërkohë që janë identifikuar angazhime kontraktuale të ndërmarra edhe pas afateve të përcaktuara, duke krijuar detyrime të prapambetura dhe tejkalim të kufijve buxhetorë. Në lidhje me nënhuanë, garancitë shtetërore dhe kreditë e tjera, auditimet kanë evidentuar se detyrimet ndaj përfituesve, veçanërisht në sektorët e energjisë, ujësjellës-kanalizimeve dhe njësisve të vetëqeverisjes vendore, kanë vijuar të rriten, për shkak të mosrespektimit të kushteve kontraktuale të shlyerjes dhe mungesës së masave efektive për përmbushjen e detyrimeve. Në këto kushte, buxheti i shtetit ka kryer pagesa për detyrimet e papaguara nga përfituesit sipas garancive shtetërore, veçanërisht ndaj ndërmarrjeve publike në sektorin e energjisë, ku vijnë të evidentohen detyrime të ndërsjella të pashlyera dhe të parakorduara. Nga auditimet e kryera në projektet të KESH SH.A, si “Fuqia energjitike dhe siguria e digës në kaskadën e Drinit” dhe “Përmirësimi i sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit”, u konstatuan vonesa në afatet e pagesave të huasë, shoqëruar me kosto shtesë për buxhetin e shtetit dhe detyrime të papaguara nga KESH SH.A drejt Ministrisë së Financave. Për më tepër, riskedulimi i pagesës së kësteve dhe afateve përkatëse nuk është reflektuar në ndryshimin e Marrëveshjes së Nënhuasë, duke sjellë mungesë koherence mbi detyrimet që KESH SH.A ka ndaj buxhetit të shtetit për huanë përkatëse.



Detyrimet kontingjente, përfshirë ato që rrjedhin nga vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe nga Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, paraqiten në nivele të larta, me impakt në qëndrueshmërinë fiskale. Nga auditimi i kryer në Avokaturën e Shtetit u evidentuan dobësi në raportimin dhe administrimin e këtyre detyrimeve, të shoqëruara me mangësi në kontrollin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së përfaqësuesve ligjor, përfshirë ndjekjen e çështjeve, si dhe problematika në procedurat e kontraktimit të shërbimeve ligjore. Nga auditimi rezultoi se vonesat dhe mosveprimet në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të GJEDNJ dhe të arbitrazhit ndërkombëtar kanë sjellë efekte negative në administrimin e fondeve publike, si dhe në përdorimin e tyre pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

Menaxhimi i likuiditetit nuk ka qenë optimal, pasi megjithëse gjendja e Thesarit paraqitet brenda kufijve, përfshirja e llogarive jashtë tij tregon tejkalim të limiteve, ndërsa fondi rezervë dhe kontingjenca janë planifikuar dhe përdorur në kundërshtim me qëllimin e tyre ligjor. Problematika janë identifikuar edhe në raportimin dhe klasifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, ku janë konstatuar mbivlerësime të të ardhurave tatimore përmes regjistrimit të parapagimeve si të ardhura të periudhës, si dhe klasifikime të pasakta të fondeve dhe transfertave që nuk plotësojnë kriteret ligjore. Në fushën e investimeve publike, janë evidentuar mospërputhje midis planifikimit dhe realizimit, projekte të përfshira jashtë dokumenteve strategjike dhe shpërndarje jo e balancuar e financimeve ndër vite. Një fenomen tjetër i konstatuar është përqendrimi i shpenzimeve në muajin dhjetor, duke reflektuar mungesë planifikimi të qëndrueshëm dhe orientim afatshkurtër të politikave buxhetore.

Nga auditimet e realizuara **në fushën e prokurimeve publike** u konstatuan mangësi të cilat lidhen kryesisht me planifikimin e procedurave të prokurimit pa u bazuar në nevoja reale, problematika në përlllogaritjen e fondit limit, problematika në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, të cilat nuk rezultojnë të jenë në përputhje me natyrën, përmasën dhe kompleksitetin e kontratës, duke mos nxitur konkurrencën dhe duke ndikuar në ekonomikitetin, eficiencën dhe efektivitetin e përdorimit të fondeve publike. Janë konstatuar parregullsi lidhur me hartimin e preventivave, pasi janë përfshirë në mënyrë të paargumentuar dhe jo të drejtë për disa zëra punimesh, si dhe në disa raste çmimet e zërave të punës nuk janë përcaktuar në përputhje me manualët përkatëse të ndërtimit. Në përbërjen e komisioneve të procedurave të prokurimit u konstatua mungesa e specialistëve të fushës. Gjithashtu, në fazën e vlerësimit të ofertave u konstatuan mangësi në zbatimin e kriterëve të kualifikimit, pasi janë kualifikuar operatorë ekonomikë (OE) që nuk i përmbushnin kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Njëkohësisht, janë evidentuar raste kur operatorë janë skualifikuar për mungesë dokumentacioni, në të njëjtat kushte apo mangësi që ka patur dhe operatori ekonomik i shpallur fitues, duke sjellë trajtim të pabarabartë të operatorëve ekonomikë dhe duke cenuar parimet e transparencës dhe konkurrencës. Si pasojë, ofertat më të ulëta janë skualifikuar dhe procedura ka vijuar me oferta më të larta, duke çuar në kontraktim me vlera mbi nivelin optimal, me efekt negativ financiar në buxhetin e shtetit. Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, u evidentua praktika e copëzimit të fondit, duke shmangur procedurat e hapura të prokurimit, në kundërshtim me parimet e transparencës, konkurrencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë. Nga auditimi i procedurës së prokurimit për Auditimin e Jashtëm (Forensic) të programit IPARD II në vitin 2023, rezultoi mungesa e dokumentacionit të plotë që argumentonte nevojën për procedurën dhe mangësi në përzgjedhjen e kompanive ofertuese, pasi asnjë prej tyre nuk kishte eksperiencë në auditime Forensic. Po ashtu, planifikimi i shërbimit nuk dokumentonte kërkesat e Bashkimit Evropian për kryerjen e auditimit nga një kompani ndërkombëtare e pavarur. Në zbatimin e kontratave u konstatuan vonesa në përfundimin e detyrimeve kontraktuale, mosaplikim i penalteteve, pagesa për punime të pakryera ose të kryera në kundërshtim me specifikimet teknike, si dhe mungesa e lejes së ndërtimit/zhvillimit dhe të oponencave teknike. Gjithashtu,



u evidentuan problematika në proceset e marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, si dhe amendime kontratash të kryera në shkelje të legjislacionit të prokurimit publik.

Në auditimin e procedurave të **administrimit të burimeve njerëzore** u evidentuan struktura të paplota dhe ndryshime të shpeshta, mungesë e pozicioneve kyçe, transferime të përkohshme dhe mbivendosje përgjegjësish. U konstatuan largime të padrejta nga puna në kundërshtim me ligjin, shoqëruar me efekte financiare negative për buxhetin e shtetit. Për vendimet gjyqësore institucionet nuk kanë publikuar grafikun e shlyerjes së tyre, si dhe janë evidentuar problematika në regjistrimin, planifikimin dhe kryerjen e pagesave ndaj gjyqfituesve, ndërkohë që Komisionet e Posaçme nuk kanë marrë masat e nevojshme për rikthimin në punë të gjyqfituesve. Nga auditimi rezultoi mosplotësimi i sistemit HRMIS, mungesë e dokumentacionit në dosjet e personelit dhe programeve strategjike për trajnimin e stafit. Procedurat e rekrutimit janë kryer me kritere të përgjithshme dhe jo të përcaktuara për secilën pozicion, janë konstatuar parregullsi në kontrata, ndërsa Komiteti i Përhershëm i Pranimit nuk ka funksionuar në mënyrë të vazhdueshme sipas kërkesave ligjore. Lidhur me veprimtarinë e bordeve kolegjiale u konstatuan mangësi lidhur me përbërjen, funksionimin dhe evidentimin e gjurmëve të auditimit apo dokumentim mbi veprimtaritë e zhvilluara dhe kontributin e tyre, në referencë të së cilave janë kryer edhe likuidimet përkatëse. Në institucionet e arsimit të lartë rezultuan punësime dhe ngritje në detyrë pa procedura konkurrimi dhe pa vlerësim të performancës, angazhim i personelit akademik pa përmbushur kriteret ligjore, si dhe mangësi në pagesat e orëve mësimore shtesë për personelin akademik.

Nga auditimet e kryera në **sektorin e shëndetësisë** janë evidentuar mangësi në kontrollin dhe monitorimin e barnave të rimbursueshme, përfshirë deklarime të pasakta të inventarëve, mospërputhje ndërmjet të dhënave në sistem dhe gjendjes fizike në depo dhe farmaci, si dhe përdorim jo i saktë i kodeve dhe regjistrimeve të barnave në sistem. U konstatuan dobësi në funksionimin e mekanizmave të mbikëqyrjes, duke lejuar qarkullimin e barnave me afat skadence shumë të afërt apo në kufijtë e skadencës, si dhe mungesë kontrolli të plotë mbi hyrje-daljet, çmimet e referencës dhe zbatimin e dispozitave kontraktuale. Janë evidentuar problematika në kontrollin e depove farmaceutike, farmacive, mjekëve dhe spitaleve, si dhe në procesin e inventarizimit dhe verifikimit, përfshirë mungesë kontrollesh në terren, verifikime të pjesshme dhe mungesë dokumentimi të plotë. Gjithashtu, u konstatuan mangësi në ndjekjen e furnizimit me barna, përfshirë vonesa, mungesa të zgjata, mosrespektim të detyrimeve kontraktuale, mungesë të aplikimit të penalteteve dhe masave administrative ndaj subjekteve të kontraktuara, si dhe raste të shpërndarjes së barnave spitalore në rrjetin e hapur në kundërshtim me përcaktimet ligjore. Në të njëjtën kohë, u evidentuan dobësi në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe në mbikëqyrjen e zinxhirit të furnizimit, përfshirë mungesë verifikimi të çmimeve, kontrolli fizik të faturave dhe monitorimi efektiv të qarkullimit të barnave. Po ashtu, u evidentuan mangësi në planifikimin dhe financimin e barnave, ku buxheti i akorduar rezultoi nënfinancuar dhe planifikimi nuk është bazuar në nevoja reale të shërbimit. U konstatuan problematika në sigurimin e barnave për trajtime specifike, të shoqëruara me mungesë koordinimi ndër-institucional, protokolle klinike të papërditësuara dhe kontroll të pamjaftueshëm mbi cilësinë dhe disponueshmërinë e barnave. Gjithashtu në auditimet e spitaleve rajonale, përveç problematikave të trajtuara më sipër, janë evidentuar edhe mangësi në funksionimin e strukturave drejtuese dhe në procesin e vendimmarrjes, përfshirë mungesën e mbledhjeve të Bordit Drejtues, si dhe mosfunksionimin e Ekipit Menaxhues, duke ndikuar në mungesën e kontrollit dhe mbikëqyrjes së veprimtarisë së tyre. U evidentua se procedurat e marrjes në dorëzim të materialeve dhe pajisjeve mjekësore nuk kanë qenë në përputhje me tipologjinë e mallit, duke mos ofruar garanci të plotë për furnizimet. Lidhur me mirëmbajtjen e makinerive dhe pajisjeve mjekësore është konstatuar se nuk është garantuar identifikimi dhe parandalimi i defekteve teknike, duke riskuar ofrimin e shërbimeve mjekësore.



Nga auditimet e kryera në **fushën e administrimit dhe mbledhjes së të ardhurave tatimore** u evidentuan problematika që lidhen me realizimin, raportimin dhe mbledhjen e të ardhurave, përfshirë mosrealizime në disa zëra kryesorë, pasaktësi në trajtimin e gjobave dhe parapagimeve, si dhe vonesa në rimbursimet e TVSH-së, të cilat kanë krijuar detyrime të prapambetura. Njëkohësisht, u konstatuan vonesa dhe një numër i lartë i kontrolleve dhe çështjeve hetimore të papërfunduara, si dhe mospërputhje ndërmjet analizës së riskut dhe zbatimit në terren, të shoqëruara me mungesë koordinimi. Në rang të drejtorive rajonale tatimore, nga raportet e kontrollit janë evidentuar problematika që kanë rezultuar në të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit, si pasojë e parregullsive në trajtimin fiskal të transaksioneve, përfshirë shitjet nën koston e blerjes, referencave apo nën çmimet e tregut, diferenca të pajustificuara në inventar të trajtuara si transaksione pa dokumentacion tatimor, kreditim të pasaktë të TVSH-së, praktika jo të rregullta në sektorin e ndërtimit për fatura shitje poshtë referencave të VKM-ve përkatëse dhe kosto poshtë nivelit të Entit Kombëtar të Banesave, faturime të përjashtuara, përpara datës së autorizimit të rindërtimit nga DPT. Gjithashtu, janë evidentuar njohje të padrejta të shpenzimeve të interesit në mungesë të kushteve të tregut për transaksione me palë të lidhura, si dhe detyrime financiare ndaj ortakëve të pa analizuar dhe të paargumentuara. Janë konstatuar mangësi në proceset e monitorimit dhe mbikëqyrjes nga zyra, të cilat lidhen me mosndjekjen e plotë të subjekteve me diferenca ndërmjet deklarimeve të TVSH-së dhe tatim fitimit, mungesë analize për subjektet me humbje të njëpasnjëshme mbi tre vite, si dhe mosverifikim të plotë të diferencave ndërmjet deklarimeve në dogana dhe atyre në sistemin tatimor. Po ashtu, janë evidentuar mangësi në administrimin e marrëveshjeve të detyrimeve të papaguara për pagesa me këste dhe mungesë monitorimi efektiv për subjekte të caktuara, përfshirë ato të përfshira në procese specifike si rindërtimi. Nga auditimi u evidentua se borxhi tatimor i papaguar ka shënuar rritje dhe përbëhet kryesisht nga detyrime të vjetra, të përqendruara në rajonin qendror dhe tek subjektet pasive, ndërsa hallkat përgjegjëse paraqesin dobësi në funksionimin e sistemeve dhe proceseve të ndjekjes së tij. Gjithashtu, u konstatuan mangësi në standardizimin dhe dokumentimin e proceseve, mospërdorim i plotë i instrumenteve ligjore për mbledhjen me forcë të borxhit, pasaktësi dhe mospërputhje në të dhënat dhe raportimet zyrtare, si dhe dobësi në koordinim, kapacitete dhe sisteme informatike, të cilat kanë kufizuar efektivitetin në monitorimin dhe reduktimin e borxhit tatimor.

Nga auditimet e kryera në **fushën e administrimit dhe mbledhjes së të ardhurave doganore** u evidentuan problematika në realizimin e të ardhurave, të cilat rezultuan nën plan, kryesisht si pasojë e mosrealizimit të të ardhurave nga TVSH-ja në import, renta minerare, akciza dhe taksat doganore. Njëkohësisht, u konstatuan mangësi në administrimin e dokumentacionit dhe në zbatimin e kontrolleve, përfshirë mosaplikimin e plotë të masave për shkeljet e konstatuara dhe dobësi në verifikimin e kundërvajtjeve administrative. U evidentuan gjithashtu dobësi në procedurat e mostrimit dhe klasifikimit tarifor, mungesë verifikimesh të plota për përjashtimet nga TVSH-ja në import, si dhe mangësi në dokumentacionin mbështetës të autorizimeve përkatëse. Në veprimtarinë e degëve doganore dhe procesin e vlerësimit doganor u evidentuan mangësi dhe parregullsi në procedurat e importit, të lidhura me mosaplikimin e saktë të elementëve të vlerësimit doganor, keqklasifikime tarifore dhe deklarime të pasakta të mallrave. Po ashtu, u konstatuan problematika në administrimin e regjimeve doganore, përfshirë tejkalim të afateve, mospërputhje në gjendjet dhe statusin e mallrave, si dhe dobësi në monitorimin e operatorëve ekonomikë dhe në ndjekjen e destinacionit të mallrave, veçanërisht për produkte specifike dhe në zona të lira. Procesi i vlerësimit doganor u karakterizua nga mungesë kontrolli mbi vlerën e deklaruar, origjinës dhe karakteristikave të mallrave, si dhe mungesë përditësimi të referencave doganore. Po ashtu, u konstatuan dobësi në bashkëpunimin ndërmjet strukturave përgjegjëse dhe në shkëmbimin e informacionit për çmimet dhe treguesit e tregut, mungesë dokumentimi të veprimeve të administratës dhe moskryerje e plotë e verifikimeve teknike dhe laboratorike. Borxhi doganor



i papaguar ka shënuar rritje dhe përbëhet në pjesën më të madhe nga detyrime të vjetra, ndërkohë që proceset e ndjekjes dhe mbledhjes së tij paraqesin dobësi të theksuara në zbatimin e procedurave, ndërmarrjen në kohë të veprimeve për rikuperim dhe përdorimin e instrumenteve ligjore për mbledhjen me forcë. Gjithashtu, u evidentuan mangësi në monitorimin dhe ndjekjen e rasteve me detyrime, administrimin dhe përditësimin e informacionit, si dhe në koordinimin ndërmjet strukturave përgjegjëse, të cilat kanë kufizuar efektivitetin e administratës doganore në rikuperimin e detyrimeve dhe reduktimin e stokut të borxhit.

Nga auditimet e kryera në **fushën e sigurisë ushqimore**, rezultoi se sistemi i kontrollit zyrtar të sigurisë ushqimore në Shqipëri paraqet mangësi thelbësore dhe sistematike përgjatë gjithë zinxhirit ushqimor, duke përfshirë importin, inspektimin, gjurmueshmërinë, testimin laboratorik dhe asgjësimin e produkteve, duke ekspozuar konsumatorët ndaj rreziqeve të larta dhe të vazhdueshme për shëndetin. Problematikat lidhen me mungesën e dokumentimit të kontrolleve, marrjen e mostrave pranë afatit të skadencës, vonesat në trajtimin e njoftimeve ndërkombëtare (RASFF), gjurmueshmërinë e dobët të produkteve me origjinë shtazore dhe bimore, mungesën e dokumentimit të proceseve të asgjësimit dhe mosrespektimin e kushteve mjedisore, si dhe mospërputhje me kërkesat rregullatore dhe standardet e Bashkimit Evropian. Gjithashtu, konstatohet mungesë e theksuar e akreditimit të laboratorëve, ku vetëm rreth gjysma e tyre disponojnë teste të akredituara, ndërkohë që pjesa më e madhe e këtyre testeve është e përqendruar në një departament të vetëm. Fusha të tjera me rëndësi kyçe, si mikrobiologjia, monitorimi i ujërave, monitorimi i mbetjeve dhe shëndeti i kafshëve, paraqesin mbulim minimal të analizave të akredituara (më pak se 5%), ndërsa fusha si kontrolli i barnave veterinarë dhe diagnostikimi i dëmtuesve të bimëve rezultojnë pa asnjë test të akredituar. Këto mangësi dobësojnë ndjeshëm besueshmërinë dhe efektivitetin e sistemit të sigurisë ushqimore, duke rritur mundësinë që produkte të pasigurta, të kontaminuara ose jokonforme të qarkullojnë në treg dhe të konsumohen. Për pasojë, mbrojtja e shëndetit publik rezulton e pamjaftueshme, pasi institucionet përgjegjëse nuk disponojnë kapacitet të plotë për të parandaluar, identifikuar dhe ndërhyrë në kohë për tërheqjen nga tregu të produkteve që paraqesin rrezik për konsumatorët.

Në të njëjtën kohë, në lidhje me ofrimin e shërbimit të ushqimit për pacientët e shtruar në institucionet spitalore, është konstatuar se nuk zbatoheshin plotësisht kërkesat për higjienën, gjurmueshmërinë dhe kontrollin e kushteve të ruajtjes së ushqimit, ndërsa në aspektin ushqimor u evidentua përdorimi i një menuje të pa diferencuar sipas dietave dhe nevojave specifike të pacientëve.

Nga auditimet e kryera në **fushën e mjedisit** janë evidentuar mangësi në përputhshmërinë me kuadrin ligjor dhe rregullator, si dhe dobësi në ushtrimin e funksioneve monitoruese dhe mbikëqyrëse nga institucionet përgjegjëse. Konkretisht, në veprimtarinë koncesionare në sektorin energjetik dhe në subjektet që ushtrojnë aktivitet minerar, u konstatuan mangësi në zbatimin e kërkesave mjedisore, përfshirë mosrespektimin e kushteve të lejeve, të kërkesave teknike dhe të detyrimeve për mbrojtjen e burimeve natyrore. Janë evidentuar gjithashtu problematika në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, mungesë e dokumentimit dhe e konsultimit publik, si dhe monitorim dhe inspektim i pamjaftueshëm në terren. Në menaxhimin e mbetjeve urbane në venddepozitime lokale u konstatuan mangësi në procedurat e ndjekura, monitorimit të vazhdueshëm, kontrolleve mjedisore dhe dokumentimit të plotë, me ndikim në ndotjen e mjedisit dhe shkelje të detyrimeve ligjore. Nga auditimi i kryer mbi ndotjen e Liqenit Artificial të Tiranës u konstatua se mungonte një sistem qarkullues uji dhe një plan i rrjetit të kanalizimeve, ndërsa nuk janë kryer analiza mikrobiologjike dhe nuk janë marrë masa për identifikimin e shkaktarëve të ndotjes. Bashkëpunimi ndërinstytucional nuk ka funksionuar, ndërsa pastrimi i liqenit ka përfshirë vetëm largimin e mbeturinave dhe bimësisë, pa ndërhyrje për eliminimin e shkaktarëve të ndotjes, si dhe nuk është realizuar monitorimi i detyrueshëm i treguesve të cilësisë së ujit. Nga



auditimi i kryer mbi administrimin e zonave të mbrojtura rezultoi se proceset inspektuese nuk janë zbatuar në mënyrë të plotë dhe të dokumentuar, ku për disa zona të mbrojtura vetëm një pjesë e planeve të menaxhimit janë aktualisht në fuqi, pasi për pjesën tjetër ka kaluar afati i vlefshmërisë, dhe zonat nuk janë regjistruar në zyrat vendore të kadastrës, duke penguar vlerësimin e gjendjes reale të infrastrukturës mjedisore dhe kontrollin efektiv mbi zbatimin e detyrimeve ligjore.

Nga auditimet e kryera në drejtim të administrimit dhe përdorimit të **pronës shtetërore**, në strukturën përgjegjëse për zhvillimin e pronës shtetërore përmes projekteve investuese, u konstatuan mangësi në kuadrin rregullator dhe metodologjik për identifikimin, përzgjedhjen dhe menaxhimin e projekt-propozimeve, mungesë analizash mbi përfitueshmërinë e investimeve, si dhe mos sigurimi i vijimësisë së projekteve të nisura. Në strukturën përgjegjëse për administrimin dhe monitorimin e përdorimit, si dhe privatizimin e pronës publike, u evidentuan mangësi në hartimin e planeve të veprimit dhe mungesë dokumentimi, raportimi mbi ecurinë e proceseve të privatizimit. U evidentuan dobësi në monitorimin e kontratave të qerasë dhe përdorimit të pronës shtetërore, përfshirë mosndjekjen e detyrimeve kontraktuale dhe mungesën e verifikimeve mbi realizimin e investimeve. Gjithashtu, u konstatuan mangësi në administrimin dhe monitorimin e shoqërive me kapital shtetëror dhe asetëve në likuidim. Nga auditimi i praktikave të shpronësimit në strukturën përgjegjëse u evidentuan mospërputhje ndërmjet sipërfaqeve të miratuara dhe atyre faktike sipas projektit, duke rezultuar në mbivlerësim të pronave dhe rritje të pajustificuar të vlerës së shpronësimit, me efekte financiare në buxhetin e shtetit. Gjithashtu, u konstatuan mangësi në dokumentim, mosrespektim i afateve ligjore dhe mungesë transparence në procesin e likuidimit të pronarëve. Në lidhje me veprimtarinë e institucioneve përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e territorit, u konstatua se niveli i ekzekutimit të vendimeve për prishjen e objekteve të paligjshme mbetet i ulët në raport me numrin e vendimeve të nxjerra. U evidentua mungesa e planeve periodike të punës dhe e inspektimeve parandaluese sipas fazave të ndërtimit, duke treguar mungesë të procedurave standarde për identifikimin në kohë të devijimeve. Gjithashtu u konstatua mungesë koordinimi ndërinstucional, e reflektuar në reagim jo të duhur ndaj sinjalizimeve të ardhura për kryerjen e inspektimeve, veçanërisht në mbrojtje të territorit nga ndërtimet e kundërligjshme në zona ose objekte me rëndësi kombëtare. Në vijim, u evidentuan mangësi në procesin e vendosjes së masave administrative, përfshirë mosnxjerrjen e vendimeve përkatëse, llogaritjen e pasaktë të vlerës së gjobave dhe zbatimin e dispozitave ligjore që nuk përputhen me natyrën e shkeljeve të konstatuara.

Nga auditimet e kryera në **fushën e prodhimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji**, u konstatua se humbjet e energjisë në rrjet kanë qenë të larta (nga 12% deri mbi 33%), ku mungesa e planeve të punës dhe urdhrave të kontrollit në zonat me humbje më të larta, veçanërisht tek subjektet private, ka treguar një fokus të pamjaftueshëm të kontrolleve dhe një qasje jo të orientuar plotësisht drejt riskut, duke mos garantuar parandalimin e humbjeve jo-teknike dhe përmirësimin e situatës. U konstatuan vonesa dhe mosrespektim i afateve të përcaktuara në rregulloret përkatëse në procesin e lidhjeve të reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese të energjisë elektrike, duke ndikuar negativisht në situatën financiare të shoqërive energjetike. Procesi i marrjes në dorëzim të punëve civile në fushën energjetike rezultoi të mos jetë kryer në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

Nga auditimet e kryera në **fushën e furnizimit me ujë, kanalizimeve dhe menaxhimit të burimeve ujore**, u konstatua se nga 14 (katërmbëdhjetë) shoqëri ujësjellësish, vetëm 6 (gjashtë) disponojnë laboratorë, duke ndikuar në moskryerjen e analizave të ujit të pijshëm dhe rrjedhimisht në mosgarantimin e sigurisë për qytetarët. Procesi i shpronësimeve për projekte të rëndësishme, si *“Përmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madhe”*, ka vijuar me hapa të ngadaltë dhe pa progres të dukshëm, ku për më tepër nuk ekziston një regjistër i centralizuar i projekteve të ujësjellës-kanalizimeve për të lehtësuar koordinimin dhe menaxhimin e burimeve. Në nivel projektesh të veçanta, si *“Infrastruktura Bashkiake V”*, janë



konstatuar vonesa në zbatim dhe pagesa të pajustificuara për komponentë të përfunduar, duke sjellë kosto shtesë për buxhetin e shtetit. Janë konstatuar mangësi në planifikimin dhe dokumentimin e punimeve dhe mirëmbajtjes për kanalet e ujitjes dhe kullimit, si dhe mungesë e akteve të kontrollit. Nga auditimet e kryer në strukturat përgjegjëse për administrimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet, u konstatuan mangësi në hartimin dhe zbatimin e planeve të veprimit, në dokumentimin e kontrolleve dhe inspektimeve në terren, si dhe në respektimin e rregullave dhe kritereve teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e kësaj infrastrukture. Për më tepër, auditimi tematik i situatës së përmbytjeve në qytetin e Vlorës evidentoi mangësi në menaxhimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, pasi hidrovori dhe kanalet kulluese funksiononin me probleme, pa pompa dhe gjeneratorë rezervë, me linja elektrike të amortizuara dhe kanale të papastruara për periudha të gjata kohore. Ndër faktorët kryesorë të emergjencës u identifikuan mungesa e dokumentacionit teknik, mirëmbajtja e pakujdesshme dhe mosfunksionimi i kapaciteteve kritike.

Nga auditimet që kanë trajtuar **çështje sociale** sensitive, në Shtëpinë e Foshnjës në Tiranë dhe në Komitetin Shqiptar të Birësimeve rezultoi se administrimi i regjistrave të takimeve të fëmijëve me familjarët dhe respektimi i afateve ligjore për shpalljen e fëmijëve të braktisur kanë pasur mangësi, duke sjellë qëndrime të zgjata të fëmijëve në institucion dhe vonesa në përfshirjen e tyre në birësim. Në procedurat e birësimit u evidentuan problematika në përzgjedhjen e aplikantëve, mungesë e dokumentacionit mbështetës, dhe mosfunksionim i regjistrit të historikut të propozimeve dhe refuzimeve, ndërsa strukturat institucionale si Sekretariati Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues nuk kanë funksionuar sipas periodicitetit të përcaktuar. Pas përfundimit të birësimit, sistemi i monitorimit nuk ka funksionuar në mënyrë të plotë, për shkak të vonesave sistematike, mungesës së raportimit dhe dokumentimit.

Nga auditimi i kryer në strukturën përgjegjëse për **nxitjen e punësimit dhe zhvillimit të aftësive profesionale për tregun e punës**, u evidentuan dobësi në planifikimin, organizimin dhe dokumentimin e procesit të monitorimit të programeve të tregut të punës, përfshirë mungesën e planeve vjetore, objektivave dhe prioritetëve, si dhe të një qasjeje të bazuar në analizë risku për përzgjedhjen e subjekteve për monitorim. Njëkohësisht u konstatuan mangësi në verifikimin dhe dokumentimin e rezultateve të programeve të formimit profesional, përfshirë mungesë të dokumentacionit mbi certifikimin e pjesëmarrësve.

Nga auditimi i kryer mbi **projektet artistike** u konstatuan mangësi në hartimin dhe zbatimin e tyre, pasi kontratat nuk përmbanin elementë thelbësorë si penalitetet, afatet, të drejtat dhe detyrimet e palëve, çështjet e pronësisë dhe të drejtës së autorit. Gjithashtu, u evidentuan mangësi në dokumentimin e proceseve, përfshirë publikimin e thirrjeve jashtë kanaleve zyrtare, mungesë të gjurmës së auditimit dhe dokumentacionit të plotë të projekteve, shoqëruar me parregullsi në procedurat e marrjes në dorëzim të mallrave.

Nga auditimi u konstatuan mangësi në procesin e monitorimit të **projekteve në fushën e turizmit**, ku mungonin evidencat e monitorimit nga struktura përgjegjëse lidhur me raportet e realizimit dhe dokumentacionin shoqëruar. Konkretisht, mungonin gjurmë të verifikimeve periodike, raportime të detajuara mbi progresin fizik dhe financiar, si dhe evidenca mbi masat e marra në rastet e devijimeve nga planet e miratuara, duke nxjerrë në pah një nivel të pamjaftueshëm të kontrollit dhe ndjekjes së zbatimit të projekteve. Gjithashtu, janë konstatuar parregullsi në procesin e nënshkrimit të kontratave, ku ato janë lidhur në mungesë të delegimit të kompetencës.

Çështje që lidhen me auditimin e performancës

Auditimet e performancës janë fokusuar në fusha me ndjeshmëri të lartë publike, si siguria dhe mirëqenia, infrastruktura, mjedisi, arsimiti, inovacioni, etj.



Në fushën e sigurisë e mirëqenies, u evidentuan mangësi në garantimin e cilësisë së produkteve dhe në hartimin e zbatimin e politikave sociale, duke ndikuar në mbrojtjen e shëndetit publik dhe zhvillimin e qëndrueshëm të kapitalit njerëzor.

Auditimi mbi cilësinë e ujit të ambalazhuar evidentoi mangësi në procedurat e prodhimit dhe certifikimit, përfshirë miratimin e lejeve për përdorim të burimeve ujore, licencat e stabilimenteve dhe monitorimin e përmbushjes së kushteve përkatëse. Analizat nuk realizohen plotësisht sipas kërkesave ligjore, laboratorët nuk janë të akredituar, kapacitetet janë të kufizuara dhe nuk përfshihen të gjithë ndotësit e detyrueshëm. Kontrolli është i fragmentuar dhe me boshllëqe të rëndësishme në të gjithë fazat e prodhimit dhe hedhjes në treg, për shkak të mungesës së koordinimit ndërinstitucional, udhëzimeve teknike dhe zbatimit të pjesshëm të detyrimeve ligjore, ndërkohë që mungesa e bashkëpunimit për analizat mikrobiologjike dhe mosraportimi i rasteve jo konform kanë cenuar funksionimin e sistemit zyrtar të kontrollit.

Auditimi mbi moshimin e popullsisë evidentoi se zbatimi i politikave në punësim, aftësi dhe përfshirje sociale ka qenë i pjesshëm, me masa të realizuara vetëm pjesërisht dhe tregues që shënojnë rënie. Rezultatet për programet rinore nuk pasqyrohen plotësisht, ndërsa objektivat për përfshirjen e të moshuarve nuk janë arritur. Strategjitë kombëtare për migracion, punësim dhe zhvillim rinor mbeten të kufizuara, nga mungesa e bazës statistikore dhe e analizave të detajuara, duke mos përfshirë analiza rajonale, gjinore dhe demografike, projeksione për popullsinë aktive dhe të dhëna mbi punësimin rural. Kjo e bën dokumentin më shumë një udhëzues orientues sesa një instrument politikash të matshme, pengon planifikimin e qëndrueshëm të politikave dhe përdorimin efikas të burimeve publike, duke kufizuar ndërhyrjen e institucioneve në zonat me risk të lartë emigrimi. Mungesa e analizës për emigracionin ekonomik, sezonal dhe të kualifikuar, si dhe lidhjes me arsimin dhe punësimin rinor, redukton efektivitetin e masave për ruajtjen e kapitalit njerëzor dhe frenimin e ikjes së të rinjve dhe të trurit.

Auditimi mbi kujdesin komunitar për të moshuarit dhe decentralizimin e shërbimit tregoi se mekanizmat bazë të identifikimit dhe vlerësimit të nevojave nuk kanë funksionuar në mënyrë efektive në të gjitha bashkitë e audituara, duke bërë që procesi i identifikimit të të moshuarve në nevojë, të jetë i pjesshëm, jo i standardizuar dhe i varur nga iniciativa ad-hoc të stafit. Si rezultat, ofrimi i shërbimeve komunitare nuk është i njëtrajtshëm dhe proporcional me nevojat, me dallime në paketën e shërbimeve, mungesë transporti dhe ndërprerje në vijimësinë e shërbimeve në shtëpitë e të moshuarve, duke ulur efektivitetin e politikës së kujdesit komunitar.

Në fushën e mjedisit, u evidentuan problematika në menaxhimin e ujërave, ndotjen mjedisore dhe monitorimin e treguesve mjedisorë, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e jetesës dhe shëndetin publik.

Auditimet treguan se cilësia e ujërave në plazhe në Shqipëri mbetet ndër më të ulëtat në Evropë, ku viti 2023 shënon nivelin më të dobët të viteve të fundit, kryesisht për shkak të kapaciteteve të kufizuara për trajtimin e ujërave të ndotura urbane, që në 9 bashkitë e audituara mbulojnë vetëm rreth 20% të popullsisë dhe reduktohen më tej gjatë sezonit turistik. Kjo situatë lidhet gjithashtu me kapacitetin e ulët të rrjetit të tubacioneve, mosrespektimin e detyrimeve ligjore nga aktivitetet ekonomike për trajtimin e ujërave, si dhe me mangësi sistematike në monitorimin e cilësisë së ujërave të larjes, njoftimin e popullsisë dhe zbatimin e kuadrit ligjor për garantimin e cilësisë së tyre.

Rrjeti i kanalizimeve në qytetin e Tiranës rezultoi i projektuar me shkarkim të drejtpërdrejtë dhe pa trajtim në lumin Lana, ndërsa në zonat periferike mbizotërojnë shkarkimet individuale, në një kohë që investimet e UKT kanë qenë të përqendruara kryesisht në furnizimin me ujë dhe jo në rrjetin e kanalizimeve. Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane Kashar vijon të jetë jashtë funksionit, ndërkohë që sipas raporteve të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit,



lumi Lana klasifikohet në Klasën V – Gjendje e keqe, me tregues ndotjeje përtej limiteve të lejuara, si rezultat i shkarkimeve të ujërave të ndotura urbane.

Auditimi në zonën naftëxjerrëse të Patos-Marinzës evidentoi se gjendja e mjedisit nuk përmbush kërkesat e legjislacionit mjedisor, ku disa gropa ekologjike operojnë pa leje dhe menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme nuk kryhet në përputhje me kuadrin ligjor. Gjithashtu, mungonte monitorimi i strukturuar mjedisor dhe të dhënat përkatëse, ndërsa investimet për përmirësimin e treguesve mjedisorë rezultuan minimale, në një kohë që institucionet përkatëse nuk kanë kryer analiza të plota mbi ndikimin në shëndetin e popullsisë, dhe të dhënat ekzistuese rezultojnë të pasakta dhe jo të besueshme.

Në fushën e infrastrukturës auditimet evidentuan mangësi në sigurinë e digave, aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara dhe në kushtet e infrastrukturës penitenciare, duke kufizuar funksionimin efektiv të strukturave, rritur rreziqet për komunitetet dhe mjedisin, dhe penguar ofrimin e shërbimeve të sigurta dhe rehabilituese.

Nga auditimi i digave rezultoi mungesë e të dhënave të sakta mbi numrin total, klasifikimin sipas nivelit të riskut dhe përcaktimin e distancave të sigurisë, ndërsa vetëm një pjesë e kufizuar e digave të mëdha disponon pasaportë dhe plane gatishmërie. Kontrolli, monitorimi dhe raportimi mbi gjendjen dhe sigurinë e digave në vendin tonë vuan mungesën e ngritjes dhe funksionimit të të gjitha strukturave mbikëqyrëse, sistemit të monitorimit dhe raportimit jo të plotë e të qartë. Gjendja e digave në vite nuk është përmirësuar, duke reflektuar mungesën e investimeve të qëndrueshme dhe vëmendjes institucionale ndaj sigurisë së tyre. Për shkak të planifikimit të pamjaftueshëm strategjik, përdorimit joefektiv të pajisjeve monitoruese dhe mos shfrytëzimit të fondeve të huaja, përpjekjet për rehabilitimin e infrastrukturës së digave kanë qenë të kufizuara. Mungesa e një vlerësimi kombëtar gjithëpërfshirës ka rritur rrezikun e dëmtimeve strukturore dhe të pasojave të mundshme për komunitetet dhe mjedisin përreth.

Auditimi mbi aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara (PAK) evidentoi mungesë të standardeve të detyrueshme në planifikimin dhe lejet e ndërtimit, ndërsa ndërhyrjet për përmirësimin e aksesit janë kryer në mënyrë të fragmentuar dhe pa një plan të strukturuar, shpesh me probleme në zbatim dhe mirëmbajtje. Në fushën e transportit publik rrugor konstatohet mungesë e një kuadri ligjor të harmonizuar me standardet e BE-së dhe OKB-së, pa detyrime të qarta për përshtatjen e shërbimeve ndaj PAK, si dhe mungesë e informacionit dhe mjeteve orientuese për përdorimin e tij.

Nga auditimi mbi trajtimin dhe riintegrimin e personave të dënuar rezultoi se sistemi penitenciar nuk garanton kushte dhe trajtim të plotë rehabilitimi në përputhje me standardet, ndërsa përdorimi i burimeve financiare nuk është orientuar drejt arritjes së objektivave për financime të qëndrueshme në institucionet e vuajtjes së dënimit. Infrastruktura paraqitet e amortizuar dhe investimet janë fokusuar kryesisht në siguri dhe transport, jo në përmirësimin e kushteve, arsimin dhe formimin profesional, duke bërë që sistemi të funksionojë më tepër si strukturë ruajtjeje sesa si mekanizëm efektiv rehabilitimi dhe riintegrimi.

Në fushën e arsimit u evidentuan mangësi në sigurimin e sigurisë dhe mbështetjes psiko-sociale në shkolla, duke ndikuar në efektivitetin e mjedisit arsimor dhe në garantimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse për nxënësit.

Nga auditimi mbi rolin e oficerit të sigurisë në shkolla rezultoi se komunikimi me drejtuesit e institucioneve arsimore është i padokumentuar, ndërsa planifikimi dhe raportimet e veprimtarisë janë të kufizuara, të pasakta dhe të paplota, me mungesë të planeve të koordinuara për trajtimin e problematikave të sigurisë. Gjithashtu, mungesa e logjistikës për këtë funksion ka kufizuar ushtrimin efektiv të detyrës, ndërsa raportimet e pamjaftueshme kanë cenuar ndarjen e informacionit me aktorët e tjerë dhe funksionimin e mekanizmave të sigurisë në shkolla.



Nga auditimi mbi shërbimin psiko-social në shkolla rezultoi se sistemi i ngritur nuk garanton ofrimin e një shërbimi të njëjtë dhe gjithëpërfshirës për nxënësit, duke funksionuar më shumë në mënyrë reaguese sesa parandaluese. Përfshirja jo e standardizuar e psikologëve dhe punonjësve socialë, kufizimet në rekrutim dhe boshllëqet në mbulim, si dhe strategjitë dhe kuadri rregullator i pa harmonizuar dhe shpesh kontradiktor me ligjin, kanë krijuar vështirësi në zbatimin e shërbimit dhe vendosin barriera për profesionistët dhe institucionet përgjegjëse.

Në fushën e teknologjisë dhe inovacionit, auditimi mbi blerjet online në Shqipëri nxori në pah se veprimtaria e institucioneve ligjzbatuese shoqërohet me mekanizma kontrolli dhe mbikëqyrjeje të pamjaftueshëm, shpesh pjesërisht funksionale, duke lënë hapësira për informalitet dhe abuzime. Koordinimi mes institucioneve është i dobët, pavarësisht marrëveshjeve të bashkëpunimit, të cilat nuk janë shfrytëzuar për shkëmbimin e informacionit dhe veprime të përbashkëta.

Auditimi mbi sigurinë kibernetike në infrastrukturën e-Taxation tregoi se mungonte metodologjia për identifikimin e operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, si dhe mekanizmat ligjorë dhe teknikë për menaxhimin efektiv të regjistrave të të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. U evidentuan gjithashtu disa mangësi, duke përfshirë mosrespektimin e distancës minimale ndërmjet primary dhe secondary site, mungesën e dokumentacionit për trajnime mbi sigurinë kibernetike dhe për përdoruesit fundorë, si dhe vakanca në strukturat përgjegjëse për monitorim.

Çështje që lidhen me auditimin e teknologjisë së informacionit

Auditimet e teknologjisë së informacionit kanë synuar vlerësimin e sigurisë, funksionalitetit, vazhdimësisë dhe menaxhimit të sistemeve informatike në institucionet publike, me fokus në administrimin e të dhënave dhe garantimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Auditimet kanë përfshirë institucione të ndryshme qendrore dhe vendore, duke evidentuar problematika të përsëritura dhe dobësi strukturore në menaxhimin e teknologjisë së informacionit. Një ndër problematikat më të përhapura lidhet me dobësitë në menaxhimin e teknologjisë së informacionit, të shoqëruara me mungesë të politikave, procedurave dhe rregulloreve të formalizuara. Auditimet kanë evidentuar gjithashtu dobësi në fushën e sigurisë kibernetike, si dhe mungesë të kontroleve bazë të sigurisë, si firewall, antivirus, enkriptim dhe mekanizma monitorimi. Në disa raste, përdoruesit disponojnë të drejta administrative pa kufizime të përshtatshme, ndërkohë që mungon gjurmueshmëria e veprimeve në sistem, duke rritur ekspozimin ndaj rreziqeve kibernetike dhe incidenteve të sigurisë. Në aspektin organizativ dhe të burimeve njerëzore, ka rezultuar mungesë e kapaciteteve të specializuara në teknologjinë e informacionit, si dhe mungesë strukturash të dedikuara për administrimin dhe sigurinë e sistemeve. Në disa institucione, funksionet IT mbulohen nga personel jashtë këtij profili, ose me kontrata të përkohshme, ndërsa mungojnë programet e trajnimit dhe zhvillimit profesional për stafin IT dhe përdoruesit fundorë, duke ndikuar negativisht në menaxhimin efektiv të sistemeve. Gjithashtu, nga auditimet kanë rezultuar mangësi në administrimin dhe mbrojtjen e të dhënave, të lidhura me mungesën e enkriptimit, kontrollin e pamjaftueshëm të aksesit dhe mungesën e procedurave të dokumentuara për backup dhe rikuperim të të dhënave. Në disa raste, nuk janë përcaktuar përgjegjësi të qarta për administrimin e të dhënave, duke rrezikuar integritetin, konfidencialitetin dhe disponueshmërinë e informacionit. Një tjetër problematikë lidhet me funksionalitetin dhe përdorimin efektiv të sistemeve informatike, ku janë evidentuar raste të sistemeve me akses të kufizuar, me mangësi në kontrollin e aksesit sipas roleve, deri në zëvendësimin e tyre me procese manuale. Mungesa e dokumentacionit teknik, procedurave për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve, si dhe dobësitë në kontrollin e ndryshimeve në kodin burimor kanë ndikuar negativisht në cilësinë dhe besueshmërinë e sistemeve. Gjithashtu, nga auditimet e sistemeve IT ka rezultuar mungesë e planeve të vazhdimësisë së shërbimeve dhe të rimëkëmbjes nga



fatkeqësitë, si dhe mungesa e procedurave të dokumentuara për backup, monitorim të log-eve dhe menaxhim të incidenteve. Në disa raste janë evidentuar edhe mospërputhje ndërmjet kuadrit ligjor dhe zbatimit praktik, si dhe paqartësi në ndarjen e përgjegjësiwe institucionale për administrimin e sistemeve dhe sigurinë kibernetike, të cilat ndikojnë negativisht në qeverisjen efektive të IT-së dhe në koordinimin ndërinstitucional.

Në kuadër të auditimeve të kryera, KLSH ka referuar raste të konstatuara me shkelje të karakterit penal tek organet e drejtësisë. Gjatë vitit 2025, KLSH ka dërguar 8 kallëzime penale, të cilat përfshijnë rastet ku auditimi zbuloi veprime ose mosveprime me shkelje të rënda të ligjit. Përveç kallëzimeve, KLSH ka përcjellë me kërkesë të organeve ligj zbatuese, edhe 43 materiale të tjera për çështje që kërkojnë hetime të mëtejshme.

Në drejtim të organizimit dhe menaxhimit institucional, në kuadër të monitorimit vjetor të Strategjisë së Zhvillimit Institucional 2023–2027, KLSH, gjatë vitit 2025, ka vijuar zbatimin e objektivave strategjikë në funksion të forcimit të rolit të tij kushtetues, rritjes së impaktit të punës audituese dhe zhvillimit të kapaciteteve profesionale të stafit. Zbatimi i strategjisë është mbështetur në planin e veprimit të miratuar dhe është monitoruar në mënyrë sistematike për të vlerësuar nivelin e realizimit të objektivave, nënobjektivave dhe aktiviteteve specifike.

Në zbatim të Qëllimit Strategjik nr. 1, *“Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH si mbështetës i Kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të enteve përdoruese të fondeve publike”*, KLSH ka vijuar konsolidimin e planifikimit strategjik dhe operacional të auditimeve, duke zbatuar metodologjitë e përditësuara dhe duke forcuar orientimin drejt fushave me risk të lartë. Institucioni ka hartuar dhe zbatuar Planin Vjetor të Auditimeve për vitin 2025, ka vijuar auditimet e performancës në zbatim të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe ka forcuar zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Një zhvillim i rëndësishëm ka qenë nisja e implementimit të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë, në përputhje me ISSAI 140 të rishikuar, si dhe përditësimi i udhëzuesve dhe manualeve që mbështesin cilësinë e proceseve audituese. Paralelisht, KLSH ka ndërvepruar rregullisht me Kuvendin e Shqipërisë përmes informimit të vazhdueshëm me raporte përfundimtare auditimi, raporte mbi zbatimin e rekomandimeve dhe buletine statistikore periodike. Gjithashtu, me Nënkomisionin Parlamentar për Auditimin e Sektorit Publik janë zhvilluar dëgjesa mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimeve të përzgjedhura, ku në përfundim të tyre janë hartuar raporte me rekomandime të adresuara për zbatim institucioneve të audituara, duke kontribuar në rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës dhe zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, si dhe në forcimin e dialogut institucional.

Në zbatim të Qëllimit Strategjik nr. 2, *“Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë, nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve”*, KLSH ka rritur impaktin e punës audituese përmes përmirësimit të komunikimit institucional, transparencës dhe aksesit të publikut në informacion, si dhe përmes ndjekjes sistematike të zbatimit të rekomandimeve të mëparshme, e cila mbetet një nga fushat me ndikim të drejtpërdrejtë dhe të matshëm në realizimin e misionit të institucionit. Për këtë qëllim, janë zhvilluar auditime tematike mbi zbatimin e rekomandimeve, duke synuar rritjen e përgjegjshmërisë dhe ndërgjegjësimin institucional, si dhe përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies në administratën publike. Institucioni i ka përcjellë Kuvendit një numër të konsiderueshëm raportesh përfundimtare auditimi dhe dokumentesh të rëndësishme, si dhe ka zgjeruar publikimin e materialeve informuese dhe promovuese. Komunikimi me publikun, median dhe palët e interesit është forcuar përmes publikimit të raporteve, buletineve statistikore dhe informuese, si dhe njoftimeve mbi aktivitetet institucionale në faqen zyrtare, e cila është konsoliduar në gjuhën shqipe dhe angleze. Gjatë vitit 2025 janë publikuar rregullisht Buletini Informues mujor dhe Buletini Vjetor i konsoliduar. Paralelisht, është përmirësuar prania digjitale e institucionit përmes përditësimin të faqes zyrtare, përdorimit të vizualizimeve dhe



infografikëve, si dhe aktivizimit të rrjeteve sociale si LinkedIn, Facebook dhe Instagram, duke mundësuar komunikim në kohë reale me publikun. Trajtimi i kërkesave, ankesave dhe denoncimeve të qytetarëve ka vijuar të jetë pjesë integrale e veprimtarisë, duke u reflektuar edhe në planifikimin e auditimeve sipas rëndësisë dhe ndjeshmërisë publike të çështjeve.

Në zbatim të Qëllimit Strategjik nr. 3, “Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese”, KLSH ka vijuar investimin në zhvillimin profesional të stafit auditues dhe jo auditues përmes analizimit periodik të nevojave për trajnim dhe zbatimin të programeve të strukturuar në bashkëpunim me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Gjatë vitit 2025 janë realizuar një numër i lartë temash trajnime duke përfshirë një numër të konsiderueshëm punonjësish, duke tejkaluar objektivat vjetore. Institucioni ka vijuar gjithashtu pjesëmarrjen në programe internship-i dhe forcimin e politikave të menaxhimit të burimeve njerëzore, përfshirë vlerësimin e performancës, përditësimin e të dhënave profesionale dhe ngritjes në detyrë si instrumente për rritjen e kapaciteteve. KLSH ka vijuar të luajë një rol aktiv në fushën ndërkombëtare si anëtare e INTOSAI dhe EUOSAI, duke zgjeruar dhe thelluar bashkëpunimi me partnerët vendas dhe ata ndërkombëtarë, si dhe duke u orientuar drejt zbatimit të standardeve dhe praktikave më të avancuara në fushën e auditimit. Në këtë kuadër, janë nënshkruar Memorandume të reja të Mirëkuptimit si dhe është intensifikuar bashkëpunimi me institucione homologe, si Zyra Kombëtare e Auditimit të Norvegjisë, Gjykata Turke e Llogarive, Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës, Enti Shtetëror i Revizionit të Maqedonisë së Veriut, Gjykata Evropiane e Audituesve (ECA), Zyra Kombëtare e Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar, Suedisë, Iniciativa e Zhvillimit të INTOSAI-t (IDI), etj., me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe përfitimin e praktikave më të mira. Janë zhvilluar auditime paralele dhe të përbashkëta, si dhe auditime me mbështetjen e institucioneve homologe. Në vitin 2025, KLSH ka marrë pjesë në një sërë aktiviteteve si takime, trajnime, konferenca, workshop-e, seminare apo sesione të ndryshme, si me prezencë fizike ashtu edhe me module online. Këto angazhime kanë shërbyer për shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira, rritjen e kapaciteteve profesionale, me qëllim rritjen e transparencës dhe ndërveprimit me qytetarët.

Për vitin 2026, KLSH synon të vijojë zbatimin e Strategjisë 2023–2027 duke thelluar planifikimin strategjik të auditimeve, implementimin e standardeve ndërkombëtare, bashkëpunimin institucional dhe përdorimin e mjeteve të komunikimit digjital për rritjen e transparencës. Njëkohësisht, institucioni do të vazhdojë të investojë në zhvillimin e kapaciteteve profesionale të stafit dhe në zgjerimin e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë, me qëllim garantimin e një auditimi publik cilësor, dhe me ndikim të lartë në mirëqeverisje dhe llogaridhënie.

Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë vitit 2025 ka vijuar të tregojë një angazhim të qëndrueshëm për forcimin e kapaciteteve profesionale dhe institucionale, duke i konsideruar burimet njerëzore si një element kyç për garantimin e cilësisë së veprimtarisë audituese. Menaxhimi i burimeve njerëzore është orientuar drejt zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi dhe standardeve ndërkombëtare të INTOSAI-t, si dhe drejt përvetësimit të praktikave më të mira për zhvillimin e kapaciteteve audituese, në funksion të realizimit të objektivave strategjike të institucionit. Struktura e stafit për vitin 2025 paraqitet e qëndrueshme dhe e orientuar drejt funksionit bazë të auditimit, ku nga 215 punonjës faktik, 154 i përkasin trupës audituese, duke përbërë rreth 72% të stafit, ndërsa pjesa tjetër ndahet ndërmjet stafit drejtues dhe atij mbështetës. Stafi i KLSH-së ka një nivel të lartë kualifikimi në fusha të ndryshme si financë, ekonomi, drejtësi, inxhinieri dhe profile të tjera, duke garantuar një qasje multidisiplinare në procesin e auditimit. KLSH ka vijuar të investojë në mënyrë të qëndrueshme në rritjen e kapaciteteve të stafit, përmes trajnimeve të vazhdueshme, programeve ndërkombëtare dhe certifikimeve profesionale, duke synuar përmirësimin e cilësisë së auditimit dhe përshtatjen me zhvillimet bashkëkohore në këtë fushë. Një pjesë e stafit ka ndjekur programe të specializuara



ndërkombëtare dhe zotëron certifikime të njohura profesionale, çka kontribuon në rritjen e ekspertizës institucionale. Ndërkohë, institucioni ka vijuar të zbatojë politika të rëndësishme në drejtim të barazisë gjinore, duke arritur një raport të balancuar ndërmjet femrave dhe meshkujve, si dhe një përfaqësim të konsiderueshëm të grave në nivelet drejtuese. Në tërësi, struktura dhe menaxhimi i burimeve njerëzore gjatë vitit 2025 tregojnë që KLSH investon vazhdimisht në zhvillimin dhe profesionalizmin e stafit. Balanca ndërmjet stafit me përvojë dhe atij të ri kontribuon në përmirësimin e cilësisë së auditimit dhe në forcimin e rolit të institucionit si një organ i besueshëm në mbikëqyrjen e financave publike.

Në lidhje me aspektet buxhetore dhe financiare të brendshme, KLSH-së, sipas Ligjit nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025” dhe akteve normative në vijim, për vitin 2025, përfshirë dhe grantin e huaj, iu miratua buxheti në vlerën 644,493 mijë lekë, i ndarë në shpenzime personeli, shpenzime për mallra dhe shërbime si dhe shpenzime kapitale. Ky buxhet u realizua në vlerën totale 633,386 mijë lekë ose në masën për 98%. Buxheti i planifikuar për zërin “Paga dhe sigurime” ka qënë në vlerën 554,100 mijë lekë dhe numri i miratuar me 243 punonjës. Ky buxhet u realizua në vlerën 547,664 mijë lekë ose në masën 99%. Ky zë përfshin pagat e stafit të KLSH-së, si dhe kontraktimin e ekspertëve, bazuar në përcaktimet e Ligjit Organik të KLSH-së dhe Strategjinë e Zhvillimit të KLSH-së 2023-2027. Krahasuar me buxhetin faktit të vitit 2024 në vlerën 525,934 mijë lekë, shpenzimet në këtë zë kanë qënë afërsisht 4% më shumë. Buxheti i planifikuar për zërin “Mallra dhe shërbime” ka qënë në vlerën 72,900 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 69,439 mijë lekë, ose në masën 95%. Ky buxhet është përdorur për përballimin e nevojave administrative të institucionit. Krahasuar me buxhetin faktit të vitit 2024 në vlerën 71,374 mijë lekë, shpenzimet në këtë zë janë afërsisht 3% më pak. Një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve në vlerën 39,582 mijë lekë e zënë shpenzimet për udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit në funksion të realizimit të aktivitetit auditues në rrethe dhe që përfaqësojnë 54% të shpenzimeve të planifikuara të këtij zëri. Në këtë zë janë përfshirë edhe shpenzimet për kremtimin e 100 vjetorit të themelimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, një institucion që për një shekull ka kontribuar në forcimin e kulturës së llogaridhënies dhe përmirësimin e qeverisjes në menaxhimin e financave publike. Gjatë periudhës ushtrimore 2025 është dhënë “Fond i veçantë” nga Ministria e Financave në vlerën 1,500 mijë lekë, për daljen e punonjësve në pension, rast fatkeqësie dhe sëmundjeje, vlerë e cila përgjatë kësaj periudhe është realizuar 1,163 mijë lekë ose në masën 78%. Buxheti i planifikuar për zërin “Investime kapitale me financim të brendshëm” ishte në masën 10,950 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 10,349 mijë lekë, ose në masën 95%. Për vitin 2025, KLSH ka realizuar procedurat e prokurimit për blerje automjeti, blerje paisje informatike, rikonstruksionin e godinës dhe blerje paisje zyre. Adresimi i fondeve të investimeve në këto projekte ka ardhur si domosdoshmëri me qëllim vijimin normal të aktivitetit auditues të KLSH-së. Kësaj shume i është shtuar granti i trashëguar nga vitet e kaluara në vlerën 273 mijë lekë dhe një pjesë e mbetur nga granti i huaj për zbatimin e projektit “Forcimi i Mbikëqyrjes së Auditimit të Jashtëm për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat në Shqipëri”, financuar nga Sekretariati Shtetëror i Zvicrës për Çështjet Ekonomike (SECO) dhe realizuar në vlerën 4,770 mijë lekë ose në masën 100%. Niveli i realizimit të fondeve buxhetore në masën 98% tregon që, KLSH përgjatë vitit 2025 vijoi veprimtarinë menaxheriale institucionale, e mbështetur nga një qeverisje e brendshme efektive dhe mirëfunksionim të sistemeve të kontrollit të brendshëm, duke siguruar përputhshmërinë me standardet e kontrollit të brendshëm, me qëllim sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe përbushjen e objektivave strategjike në nivelin e pritshmërive të synuara drejt konsolidimit të reformave të ndërmarra, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, rekomandimet e Progres Raporteve të BE-së, detyrimet kushtetuese dhe me pritshmërinë e Kuvendit, publikut dhe të gjitha palëve të interesit.







03

AKTIVITETI
AUDITUES
2025

3.1 AUDITIME TË PËRPUTSHMËRISË

Auditim i përputhshmërisë nënkupton dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord. Ky auditim mbështetet kryesisht në standardet ISSAI 100 për parimet e përgjithshme, në ISSAI 400 për parimet themelore specifike, në standardin operacional ISSAI 4000 për zbatimin e procedurave të auditimit, si dhe në deklaratat themelore të INTOSAI-t (P1, P10, P12) që përcaktojnë mandatin dhe rëndësinë e tij. Auditim i përputhshmërisë synon të vlerësojë nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e një entiteti publik janë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën rregullatore (ligjet, aktet nënligjore, politikat, kushtet e kontratave, etj.).

Opinion është një deklaratë e qartë në një format të standardizuar, i cili mund të jetë i pakualifikuar, i kualifikuar, i kundërt ose refuzues, konkretisht:

Opinion i pakualifikuar, në rastet kur nuk janë identifikuar çështje materiale të mospërputhjes me kriteret e auditimit.

Opinion i kualifikuar, në rastet kur devijimet e përputhshmërisë janë materiale, por jo të përhapura.

Opinion i kundërt, në rastet kur devijimet e përputhshmërisë janë materiale dhe të përhapura.

Refuzim opinion, në rastet kur audituesi nuk është në gjendje të marrë mjaftueshëm dëshmitë e duhura të auditimit mbi përputhshmërisë dhe efektet e mundshme janë materiale dhe të përhapura.



44
Auditime



44
Opinione/
Konkluzion

39 opinione të kualifikuara
5 konkluzione



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

Në Ministrinë e Financave, mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të vitit 2024

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka konstatuar se veprimtaria e subjektit të audituar ka devijime materiale por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator përkatës, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**. Gjatë procesit të planifikimit buxhetor në ministritë e linjës kanë rezultuar vonesa në paraqitjen e kërkesave, mangësi në plotësimin e formateve dhe kërkesa shtesë të paraqitura në fazën teknike, përtej tavaneve përfundimtare. Lista e investimeve publike të detajuara për periudhën 2024-2026, pjesë e projekt Ligjit “Për buxhetin e vitit 2024”, të paraqitur në Kuvend mbart pasaktësi në plotësimin e saj dhe angazhimet janë përtej tavaneve trevjeçare. Gjatë vitit 2024, pas datës 15 Nëntor, janë kryer 427 rishikime buxhetore të cilat konsistojnë në 4,952 transaksione. Përsa i përket afateve dhe ekzekutimit të buxhetit u konstatuan 6,651 raste të pagesave në vlerën 10,585.2 milion lekë të cilat i përkasin faturave të periudhave 2007-2023, duke përdorur buxhetin e vitit 2024. Për 4 kontrata të Fondit Shqiptar të Zhvillimit është bërë parapagim i kontratave, në vlerën 453,840 mijë lekë. Rezultuan 27 raste kur data dhe regjistrimi në sistem i urdhër-prokurimit i përkasin vitit buxhetor 2024, ndërsa data e kontratës i përket viteve paraardhëse dhe 231 raste, kur urdhër-prokurimi është regjistruar në vitin 2024, por kontrata dhe urdhër-prokurimi i përkasin viteve paraardhëse, duke evidentuar se procedura e prokurimit ka përfunduar para se urdhër-prokurimi të regjistrohet në SIFQ. Janë regjistruar me vonesë 7,868 kontrata në vlerë 46,620.41 milion lekë për vitin 2024 dhe 117,214.39 milion lekë totale të kontraktuar në harkun disa vjeçar të ekzekutimit të tyre. Konstatohen 31,315 fatura në vlerë totale 65,525.08 milion lekë, të dorëzuara në thesar jashtë afatit 30 ditor nga data e furnitorit. Rezultojnë 2,501 kontrata të lidhura në vlerën 18.17 miliard lekë për vitin 2024, me vlerë totale angazhimi 72.39 miliard lekë, përtej datës 15 Tetor. Pavarësisht se gjendja e TSA në datë 31.12.2024 ka qenë 115,039.76 milion lekë (përfshirë monedhën ALL dhe valutat e huaja), duke u paraqitur brenda limitit, në krahasim me vlerën mesatare prej dy muajsh kumulativë të shpenzimeve totale buxhetore të planifikuara, me përfshirjen edhe të gjendjeve të llogarive speciale të mbajtura jashtë llogarisë së Unifikuar të Thesarit, ky limit është tejkaluar me 25,163.19 milion lekë. Fondi rezervë dhe kontigjenca janë planifikuar mbi kufirin ligjor prej 3% të shpenzimeve totale, dhe përdorimi i tyre nuk ka respektuar parimet e planifikimit buxhetor dhe qëllimin e krijimit për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara. U konstatua krijim i detyrimeve të reja në shumën 4,283 milionë lekë të subjekteve nënhuamarrëse në kuadër të marrëveshjeve të nënhuasë dhe gjendja e detyrimeve në lidhje me garancitë shtetërore që subjektet përfituese kanë ndaj shtetit është rritur me 760 milion lekë. Rishpërndarja e fondeve të buxhetit është kryer pa burim financimi, konkretisht Këshilli i Ministrave ka miratuar një bonus shtesë për pensionistët për festat e fundvitit, duke ulur fondin e indeksimit të përhershëm të pensioneve dhe duke tejkaluar fondet fillestare të parashikuara, vetëm pak ditë para mbylljes së vitit buxhetor dhe legjitimuar me aktin e fundit normativ. Fondet në shumën 6,300 milion lekë, të regjistruara në zërin ‘Transferte për Llogarinë e Fondit të Pensioneve në BSH’, janë klasifikuar si shpenzim buxhetor megjithëse kalimi nga Llogaria e Unifikuar e Thesarit në llogarinë speciale nuk ka përmbushur kriteret për t’u trajtuar si i tillë. Kosto totale e fondeve të rindërtimit të shpërndara sipas VKM-ve të miratuara nga 2020-2024 rezultoi në shumën 122,794 milion lekë, ndërkohë që realizimi faktik për të njëjtën periudhë paraqitej në shumën 100,030 milion lekë, duke rezultuar në një diferencë në shumën 22,764 milion lekë, e cila nuk rezulton të jetë planifikuar si shpenzim për vitet e ardhshme buxhetore. Shtimi me VKM i transfertës së pakushtëzuar për Fondet e Rindërtimit, ka rezultuar jo në përputhje me ligjin e financave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore. Në tabelën e treguesve fiskal të konsoliduar nuk është pasqyruar plani i trashëguar për rindërtimin për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Janë konstatuar pasaktësi në lidhje me raportimin e pagesave të



kontratave koncesionare/PPP dhe mangësi në raportimin e risqeve dhe treguesve kryesorë në lidhje me këto kontrata. Suficiti fiskal i akumuluar gjatë muajve janar-nëntor është shpenzuar plotësisht në muajin dhjetor, duke krijuar një deficit në rreth 17 miliard lekë. Pagesat e kryera në muajin dhjetor reflektojnë akumulim të shpenzimeve, si pasojë e mungesës së planifikimit të saktë dhe orientimit të fondeve drejt nevojave të reja, pa adresuar në vijimësi nevojat buxhetore të mbartura nga vitet e mëparshme. Ky fenomen ka rritur riskun fiskal për shkak të politikave jo të kujdesshme, tejkalimit të tavanëve buxhetore në kuadër të planifikimit afatmesëm, si dhe angazhimit në marrëdhënie kontraktuale përtej hapësirës fiskale të miratuar. Të ardhurat tatimore paraqiten të mbivlerësuara, si rezultat i regjistrimit të parapagimeve të tatimit mbi fitimin në llogarinë 4665504 dhe pasqyrimin të tyre në fund të vitit si të ardhura të periudhës. Fondet e depozituara në llogarinë e shpronësimeve janë transferuar në një llogari tjetër dhe janë klasifikuar si të ardhura buxhetore, pa përmbushur kriteret ligjore për t'u trajtuar si të tilla. I njëjti konkluzion është arritur edhe për shumën prej 7,900 milion lekë, e paraqitur si 'Rezultati financiar i ISSH' në grupin e të ardhurave tatimore në tabelën e treguesve fiskalë. Janë konstatuar detajime të projekteve të investimit publik me akte normative të cilat nuk kanë qenë pjesë e PBA-së 2024-2026, si dhe nuk kanë qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitura me Projekt Buxhetin e vitit 2024. Një pjesë e konsiderueshme e fondeve të disbursuar menjëherë pas miratimit të Aktit Normativ të Dhjetorit nr. 5, datë 19.12.2024, janë përdorur për të mbuluar pagesat e prapambetura të muajve të kaluar. Konstatohen raste në të cilat autoritetet kontraktore kanë iniciuar procedurat e prokurimit për një vlerë më të lartë se fondet në dispozicion sipas shpërndarjes 3-vjeçare të buxhetit të miratuar, ndërkohë që kohëzgjatja e projektit sipas bazës së të dhënave të prokurimeve nga APP rezultoi më pak se shpërndarja e fondeve (6 muaj, 1 vit apo 2 vjet). Për projektet në vazhdim nga vitet e kaluara, u konstatua se shpërndarja e financimit nuk ka ndjekur përparësinë gjatë detajimit fillestar, si dhe nuk ka ndjekur përcaktimet e detajimit të buxhetit minimalisht 20 dhe 30% në vitet e zbatimit të tij. Në shpenzimet kapitale me financim të huaj, është konstatuar planifikim jo i saktë dhe menaxhim jo i duhur i fondeve për projektet me financim të huaj, i shoqëruar me ndryshime të konsiderueshme gjatë vitit, mungesë të planeve buxhetore për disa projekte, tejkalim të buxhetit, si dhe përdorim të fondeve të investimeve kapitale për shpenzime jo kapitale (paga dhe shpenzime operative). Gjithashtu, nga auditimi rezultuan efekte negative në administrimin dhe përdorimin e fondeve publike, në drejtim të economicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, në vlerën totale prej 5,100,769 mijë lekë, si rezultat i pagesave nga buxheti i shtetit për garancitë shtetërore jo performuese, krijimit të detyrimeve të reja nga marrëveshjet e nënhuasë për shkak të mosshlyerjes së tyre nga subjektet përfituese, si dhe kostove shtesë në formën e interesave/kamatëvonesave të krijuara nga mosekzekutimi në kohë i vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën nga 01.01.2023 deri më 31.12.2024 dhe për zbatimin e kontratave për punë publike nga 01.01.2019 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura, nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**. Nga auditimi rezultoi se aktet e MBZHR gjatë periudhës së audituar nuk kanë përcaktuar subjektin përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e tyre, nuk ofronin informacion të qartë mbi strukturat e detyruara për zbatimin, si dhe ekzistonte një sasi e madhe aktesh rregullatore brenda një periudhe, duke krijuar risk për mbivendosje. Normat e pesticideve të miratuara për disa produkte bujqësore rezultojnë disa herë më të larta se standardet e BE-së dhe disa prej tyre nuk kanë përcaktuar nivel maksimal përdorimi. Nga verifikimi i Listës nr. 1 të PMB-ve të lejuara për përdorim nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në raport me listën e PMB-ve të publikuar nga BE,



ka rezultuar se në vitin 2022-2024, kanë qenë në qarkullim në territorin shqiptar 10 (dhjetë) PMB të ndaluara në BE. Nga auditimi mbi qiradhënien e tokës bujqësore është evidentuar se, nga 673 parcela “tokë bujqësore” në administrim të MBZHR dhe të dhëna me qira, vetëm 102 parcela, ose 15% e tyre rezultojnë me tituj pronësie të regjistruar në emër të MBZHR. Gjithashtu është konstatuar se, 102 parcelat “tokë bujqësore” për të cilat posedohet titull pronësie në emër të MBZHR, nuk janë pasqyruar si rritje e vlerës së aktiveve, duke sjellë nënvlerësim të tyre në pasqyrat financiare. Janë evidentuar raste të zgjidhjes së kontratave, të kërkesave për amendim të kontratave, të mos kryerjes së investimeve sipas kushteve të kontratave, si dhe problematika me pronësinë e tokës bujqësore të dhënë me qira, për shkak se nuk janë zbatuar procedurat për verifikimin paraprak të gjendjes juridike të pronave objekt të qiradhënies para lidhjes së kontratave. Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik u konstatuan mangësi që lidhen me specifikimet teknike dhe hartimin e kriterëve për kualifikim, të paargumentuara, jo në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit. Nga auditimi mbi zbatimin e kontratave të punimeve për punë publike, janë evidentuar diferenca në volume pune të pakryera, për të cilat është kërkuar shpërblimi i dëmit në vlerën 19,053 mijë lekë, si dhe efekte negative në administrimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet në vlerën 206,962 mijë lekë, si rezultat i mosvënies në funksion të investimeve të marra në dorëzim, likuidimit të vendimeve gjyqësore për ish-punonjësit, shpenzimeve për karburant, si dhe çështjeve që lidhen me qiradhënien e tokave bujqësore.

Në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura, nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**. Nga auditimi u evidentua se Programi Buxhetor Afatmesëm është dërguar me vonesë, disa projekte janë çelur ose realizuar pa respektuar ciklin e miratimit dhe vlerat e planifikuara, dhe disa detajime të investimeve publike nuk kanë qenë pjesë e PBA-së ose listës së investimeve. Nga auditimi u konstatua mos ngritja e grupit të monitorimit për zbatimin e projekteve me financim të huaj dhe mos-pasqyrimi në kontabilitet të detyrimeve të prapambetura për rimbursimin e TVSH-së. Në fushën e prokurimeve u evidentua mangësi në hartimin e kriterëve të kualifikimit, të cilat lidhen me aplikimin e gabuar të vlerës për paraqitjen e punëve të ngjashme, mungesën e argumentimit për numrin e punonjësve dhe makinerive të kërkuara, si dhe vendosjen e kriterëve të njëjta dhe të përsëritura për disponimin e stafit mbështetës. Gjithashtu, u evidentua skualifikimi në mënyrë të padrejtë të operatorëve ekonomikë, me një efekt financiar negativ në vlerën 6,620 mijë lekë. Në kuadër të zbatimit të kontratave të mallrave/shërbimeve, nga verifikimi në terren rezultoi mungesë e aktiviteteve të nevojshme të kontrollit në fazën e planifikimit, dhe më pas në fazën e verifikimit të marrjes në dorëzim të artikujve, ku u evidentuan mospërputhje midis sasive të kërkuara dhe nevojave reale, duke tejkaluar kapacitetet funksionale dhe fizike të njësive. Nga auditimi mbi zbatimin e kontratave të punimeve për punë publike, janë evidentuar diferenca në volume pune të pakryera, për të cilat është kërkuar shpërblimi i dëmit në shumën 5,019 mijë lekë. Gjithashtu, u konstatua se nuk është ushtruar mbikëqyrjeje e mjaftueshme mbi zbatimin dhe monitorimin e kontratave të furnizimit me barna, duke ia lënë këtë përgjegjësi institucioneve spitalore të varësisë. Janë ekzekutuar vendime gjyqësore të formës së prerë për largime nga puna në vlerën 49,566 mijë lekë, me pasojë efekt financiar negativ.

Në Ministrinë e Arsimit

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën nga data 01.01.2022 deri në datën 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura, nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**. Nga auditimi



u evidentuan mangësi në procesin e planifikimit dhe programimit buxhetor, përfshirë vonesa në dorëzimin e Programit Buxhetor Afatmesëm, çeljen e projekteve jashtë ciklit të PBA-së, rishpërndarje, investime me financim të huaj të paplanifikuara në PBA, mosdërgimin e kërkesave buxhetore nga disa njësi varësie sipas formateve të kërkuara, si dhe mungesë koordinimi ndërmjet strukturave përgjegjëse për menaxhimin dhe monitorimin e shpenzimeve kapitale. Gjithashtu, u konstatua mosnjohja e detyrimeve në momentin e krijimit të tyre, por në momentin e pagesës, si dhe likuidimi i faturave në tejkalim të afatit ligjor. Në procedurat e prokurimit u evidentuan parregullsi në përbërjen e komisioneve dhe protokollimin e procesverbaleve, mangësi në dokumentacion, përcaktim jo proporcional i kriterëve të veçanta të kualifikimit, kualifikimi i operatorëve ekonomikë mbi bazën e certifikatave të paakredituara si kriterë tekniko-kualifikuese, si dhe mosverifikimi i kapaciteteve teknike në përputhje me kërkesat e dokumentacionit të tenderit. Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël u konstatuan mangësi në specifikimet teknike, mungesë e nënshkrimit të deklaratave të konfliktit të interesit, mangësi në dokumentacionin e dorëzuar dhe mos inventarizim i dosjeve. U evidentuan mangësi në procesin e inventarizimit dhe nxjerrjes nga përdorimi të aktiveve, duke përfshirë asgjësim të pajisjeve të rrezikshme pa riciklim dhe vonesa në asgjësimin e aktiveve. Në procesin e zbatimit të kontratave u evidentuan mospërputhje midis sasive të kërkuara dhe specifikimeve teknike/fondit limit pa dokumentacion shoqërues, mos ngritje e komisioneve dhe mungesë e procesverbaleve për përcaktimin e fondeve dhe specifikimeve, mungesë gjurmueshmërie dhe regjistrimi jo i plotë i aktiveve në magazina, si dhe mangësi në dokumentimin e hyrjeve dhe daljeve të mallrave, duke cenuar transparencën dhe verifikimin e përputhshmërisë me kontratat. Nga auditimi i një projekti me financim të huaj në lidhje me eficientësinë e energjisë në shkolla u evidentua mangësi në koordinimin ndërmjet strukturave zbatuese dhe përgjegjëse për planifikimin e investimeve, si dhe përfshirja e disa objekteve arsimore që ishin në fazë rikonstruksioni, duke e bërë raportin e eficientësisë së energjisë të pazbatueshëm dhe duke cenuar zbatueshmërinë e projektit. Gjithashtu, nga auditimi rezultuan efekte negative në administrimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficientësi dhe efektivitet në vlerën 26,118 mijë lekë, si rezultat i mungesës së dokumentacionit justifikues për shpenzimet e karburantit, parregullsi në përfitimin e dietave dhe shpenzimeve të udhëtimit, si dhe mos ndjekjen e procedurave për menaxhimin e aktiveve dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar padrejtësisht.

Në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura, nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**. Nga auditimi rezultoi mosmarrje e masave për sistemimin apo rikthimin në detyrë ose në pozicione ekuivalente të punonjësve të larguar nga puna, ekzekutimit të pjesshëm ose mosekzekutim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Gjithashtu, u konstatua mosnjohja e detyrimeve në momentin e krijimit të tyre por në momentin e pagesës, si dhe likuidimi i faturave në tejkalim të afatit ligjor. Nga auditimi mbi rekrutimin e punonjësve rezultoi përcaktim i kriterëve të përgjithshme për pranimin e punonjësve sipas pozicioneve. Auditimi evidentoi investime me financim të huaj të pa planifikuara në PBA dhe mos dërgim të kërkesave buxhetore nga disa njësi varësie sipas formateve të kërkuara. Në procedurat e prokurimit janë konstatuar parregullsi, përfshirë përbërjen e komisionit dhe mosprotokollimin e procesverbaleve të marrjes në dorëzim të shërbimit, hartimin e dokumenteve të tenderit dhe kriterëve të veçanta jo në përputhje me objektin e prokurimit, si dhe mospërputhje dhe mangësi në dokumentacionin e ofertës fituese. Gjithashtu, nga auditimi rezultoi dëm ekonomik në vlerën 1,852 mijë lekë pa TVSH, për shkak të llogaritjeve të gabuara, punimeve të pakryera apo mospërputhje ndërmjet volumeve të punës të pasqyruara në situacionin



përfundimtar, librezave të masave dhe punimeve faktike në terren, në zbatimin e kontratës; si dhe efekte negative në administrimin e fondeve publike me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet në vlerën 29,125 mijë lekë, si rezultat i realizimit të një procedure prokurimi për marrje me qira të automjetit në mënyrë të pajustificuar brenda periudhës së garancisë, si dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për ish-punonjësit.

Në Institutin e Sigurimeve Shoqërore

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka konstatuar se veprimtaria e subjektit të audituar ka devijime nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator përkatës të cilat janë materiale por jo të përhapura, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**. Në raportimin e të ardhurave janë përfshirë edhe të ardhurat jo tatimore, ndërsa rakordimi i të ardhurave me Ministrinë e Financave tregoi një diferencë midis të dhënave të ISSH-së dhe DPT-së. Auditimi evidentoi gjithashtu se debitorët për kontributet e sigurimeve shoqërore janë rritur në numër dhe vlerë, veçanërisht në sektorin privat. Skema vijoi të rezultonte me deficit, pavarësisht përmirësimit krahasuar me vitin paraardhës. Gjithashtu, u konstatua mungesë bashkëpunimi midis ISSH-së dhe DPT-së në transmetimin e të dhënave elektronike dhe mbledhjen e listëpagesave të periudhave të mëparshme. Nga auditimi i mbledhjeve të Këshillit Administrativ u evidentua se njoftimet dhe dokumentimi i mbledhjeve nuk kanë respektuar përcaktimet e Statutit të ISSH-së. Po ashtu, nga auditimi i VKA-ve të ISSH-së u konstatuan mospërputhje ndërmjet ligjit dhe Statutit të ISSH-së mbi nivelin e fondit rezervë. Nuk janë planifikuar inspektime në disa DRSSH me numër të konsiderueshëm përfituesish, nuk janë inspektuar të gjitha dosjet përkatëse dhe nuk janë zbatuar rekomandimet për ndalimin e pagesës së përfitimeve në përputhje me ligjin, duke krijuar vonesa në rikuperimin e shpenzimeve të paguara padrejtësisht. Janë konstatuar shkelje të afateve për caktimin e pensioneve dhe mospërputhje të të dhënave midis sistemeve informatike PAMC dhe CMIS. Gjithashtu, rezultuan efekte negative në administrimin dhe përdorimin e fondeve publike, në drejtim të ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit, në vlerën totale prej 47,929 mijë lekë, si rezultat i pagesave të dëmshpërblimeve nga vendimet gjyqësore dhe mangësive në procesin e kontrollit dhe certifikimit të përfitimeve.

Në Avokaturën e Shtetit

Nga *auditimi i përputhshmërisë* për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2024, KLSH ka konstatuar se veprimtaria e subjektit të audituar ka devijime materiale por jo të përhapura, nga kuadri ligjor dhe rregullator, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, si rezultat i pasaktësive në raportimin e detyrimeve që ka Republika e Shqipërisë ndaj palëve paditëse, pasi në raportet vjetore të Ministrisë së Financave dhe në evidencat e borxhit nuk paraqiten vlerat e interesave mbi shumat e përcaktuara në vendimet e GJEDNJ-së apo të arbitrazhit ndërkombëtar. Nga auditimi rezultuan mangësi në kontrollin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së avokatëve të shtetit, ku janë kryer vetëm inspektime tematike dhe të fokusuar mbi individët dhe jo mbi zyrat në tërësi, duke mos siguruar transparencë dhe llogaridhënie efektive. Përditësimi i dosjeve në sistemin elektronik ka qenë fokus i inspektimeve, por nuk ka patur konkluzion mbi përqindjen e dosjeve të regjistruara dhe afat të qartë për përfundimin e këtij procesi, duke rritur riskun e mungesës së informacionit statistikor për vendimet gjyqësore dhe arbitrazhet ndërkombëtare. Funksionimi i organeve kolegjiale, Këshillit Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së dhe Kolegjit të Avokaturës së Shtetit, ka paraqitur mangësi gjatë periudhës 2023-2024, me një numër të reduktuar mbledhjesh dhe pa përmbushur qëllimin e parashikuar ligjor, duke mos siguruar orientim dhe këshillim efektiv në zgjidhjen e çështjeve gjyqësore dhe mbrojtjen e interesave të shtetit. Strukturat



përgjegjëse për hartimin e buxhetit nuk kanë ngritur mekanizmat e nevojshëm për identifikimin dhe vlerësimin e nevojave reale, duke mos analizuar shpenzimet e vitit paraprak, si dhe duke mos siguruar kërkesa të bazuara në kostot dhe prioritetet reale të institucionit. Nuk është siguruar auditimi i brendshëm, nuk është hartuar Strategjia e Menaxhimit të Riskut, nuk është kryer vlerësimi i performancës së punonjësve, dhe mungesa e stafit ka penguar ndarjen e detyrave në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, duke rritur riskun për keqmenaxhim dhe konflikt interesi. Janë ekzekutuar vendime gjyqësore për ish punonjës për periudhën e audituar në vlerën 5,668 mijë lekë, dhe ka rezultuar dëm ekonomik në vlerën 83 mijë lekë, si rezultat i kryerjes së pagesave pa dokumentacionin justifikues dhe vërtetues. Mosveprimet e institucioneve respektive, përfshirë Ministrinë e Financës dhe Këshillin e Ministrave, për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe arbitrazhet ndërkombëtare, vazhdojnë të krijojnë risk të lartë për efekte të tjera negative në buxhetin e shtetit, duke kërkuar vëmendje të shtuar nga Avokatura e Shtetit si institucion mbikëqyrës. Avokatura e Shtetit në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse (Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financës dhe Këshilli i Ministrave) vijojnë të kenë në proces vendimet e GJEDNJ-së në 6 çështje kundër Shqipërisë, të cilat kanë një vlerë dëmshpërblimi 17,968,650 euro. Nga auditimi i vendimeve të arbitrazhit, ku Republika e Shqipërisë ishte pala fituese (7 vendime, nga të cilat 4 vendime janë të fituara), janë njohur nga Gjykata e Apelit Tiranë, vetëm 2 vendime në vlerën 10,091,648.7 euro dhe 325,000 USD. Në lidhje me çështjet në gjykatat e arbitrazhit ndërkombëtar dhe vendimet e tyre, ku shteti shqiptar është pala humbëse, deri në dhjetor 2024, rezultoi se nga 4 çështje, me efekte financiar në një vlerë totale 180,125,882 euro, nga të cilat kosto të gjyqësorit dhe përfaqësimit janë 11,580,103.86 euro, vetëm një prej tyre është njohur nga Gjykata e Apelit në vlerën 12,577,852 USD, e cila nuk është ekzekutuar, duke sjellë 60,776 euro interesa për shkak të vonësive në ekzekutim. Nga ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut kundër Shqipërisë, rezultuan se kanë marrë formën përfundimtare dhe janë ekzekutuar gjatë vitit 2023 dhe 2024, vendime në vlerën 30,404 mijë lekë. Gjithashtu, për vendimet që kanë marrë formë përfundimtare të GJEDNJ-së të dalë gjatë vitit 2024 në vlerë totale 88,000 euro, rezultoi se nuk janë marrë masat për ekzekutimin e tyre me VKM-të përkatëse, duke përbërë risk për penalitete në vonesa për ekzekutimin e tyre.

Në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (AKU)

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2019 deri në 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar konstatimeve në veprimtarinë e proceseve të kontrollit, gjurmueshmërisë, importit dhe asgjësimit të produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe bimore, ku janë konstatuar mangësi të konsiderueshme në zbatimin e kuadrit ligjor dhe procedural nga institucionet përgjegjëse. Auditimi evidentoi mangësi në dokumentimin e procedurave të inspektimit, pasi në shumë raste dokumentacioni administrativ nuk ofron gjurmë të plotë të auditimit për veprimet e ndërmarra gjatë kontrolleve zyrtare. Mungesa e dokumentimit të plotë kufizon mundësinë për të verifikuar nëse gjatë inspektimeve janë kontrolluar të gjithë elementët e kërkuar nga legjislacioni dhe standardet përkatëse. Po ashtu, parregullsi u konstatuan edhe në inspektimet ku janë përfshirë trupa mbështetëse nga struktura qendrore, pasi në dokumentacionin përkatës nuk pasqyrohen qartë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre gjatë procesit të inspektimit, duke dobësuar transparencën dhe përgjegjshmërinë në zhvillimin e këtyre kontrolleve. Nga auditimi u konstatua gjithashtu se procedurat e ndjekura për marrjen e mostrave nuk garantojnë gjithmonë efektivitetin e kontrollit zyrtar, pasi në një numër të konsiderueshëm rastesh mostrat janë marrë në periudha shumë pranë afatit të skadencës së



produkteve. Kjo praktikë ka kufizuar mundësinë e ndërhyrjes në kohë nga autoritetet përgjegjëse në rast të rezultateve jokonforme, duke e bërë të vështirë marrjen e masave për tërheqjen e produkteve nga tregu dhe duke rritur riskun që produkte potencialisht të pasigurta të vazhdojnë të qarkullojnë për konsum. Auditimi evidentoi gjithashtu problematika në funksionimin e laboratorëve të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, të cilët rezultojnë të pa akredituar sipas standardeve përkatëse ndërkombëtare për analizat laboratorike në fushën e sigurisë ushqimore, në të cilët për periudhën objekt auditimi janë pranuar 43,916 mostra dhe janë analizuar 89,370 tregues analitikë. Mungesa e akreditimit ka kufizuar besueshmërinë dhe pranueshmërinë e rezultateve analitike të prodhuara nga këto laboratorë. Nga auditimi rezultoi se në trajtimin e njoftimeve të ardhura nga sistemi Rapid Alert System for Food and Feed (RASFF) janë evidentuar mangësi në zbatimin e plotë dhe në kohë të procedurave ligjore dhe administrative nga strukturat përgjegjëse. Në veçanti, janë konstatuar vonesa ose mungesë veprimesh të menjëhershme për njoftimin e institucioneve përkatëse, bllokimin e produkteve të identifikuar me risk për sigurinë ushqimore dhe marrjen e masave përkatëse për tërheqjen ose asgjësimin e tyre nga tregu. Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se procedurat e ndjekura për trajtimin e njoftimeve ndërkombëtare për produkte me përmbajtje të mbetjeve të pesticideve mbi nivelet e lejuara nuk janë zbatuar në mënyrë të plotë dhe të dokumentuar. Në këtë kuadër, janë evidentuar mangësi në procesin e gjurmueshmërisë së produkteve përgjatë zinxhirit ushqimor, si dhe mungesë e gjurmës së auditimit dhe e dokumentacionit mbështetës për verifikimin e masave të marra, përfshirë procesin e asgjësimit të produkteve të identifikuar si jokonforme. Nga auditimi i proceseve të importit dhe menaxhimit të produkteve me origjinë shtazore u evidentuan mangësi të konsiderueshme në dokumentacionin shoqëruar dhe në verifikimin e gjurmueshmërisë së produkteve. Në procesin e importit të vezëve u konstatua se nuk është realizuar lidhja e plotë ndërmjet kodit të prodhuesit të stampuar në vezë, kodit të produktit të shënuar në etiketë dhe barkodit tregtar të pasqyruar në dokumentacionin fiskal, duke dobësuar sistemin e gjurmueshmërisë së produktit përgjatë zinxhirit ushqimor. Gjithashtu, para lëshimit në qarkullim të lirë nuk janë kryer në të gjitha rastet kontrollet e plota të sigurisë ushqimore. Nga auditimi i procedurave të asgjësimit u konstatuan mangësi në evidencat e plota dokumentare për proceset e trajtimit dhe asgjësimit përfundimtar të produkteve, duke krijuar rrezik për mungesë transparence dhe pamundësi për të verifikuar nëse këto produkte janë trajtuar ose asgjësuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e sigurisë ushqimore. Në disa raste, procesverbalet e asgjësimit nuk janë nënshkruar nga të gjithë përfaqësuesit e institucioneve përgjegjëse, nuk është përcaktuar qartë vendndodhja e groposjes dhe mungon dokumentacioni mbi pronësinë e tokës, planimetrinë dhe studimet teknike për përshtatshmërinë e saj. Gjithashtu nuk janë evidentuar vlerësime mbi ndikimin e mundshëm në ujërat nëntokësore, respektimin e distancave nga burimet ujore apo strukturat përreth, si dhe rreziqet e mundshme mjedisore që lidhen me procesin e dekompozimit. Po ashtu u konstatuan raste kur subjektet që kanë kryer grumbullimin, transportimin apo asgjësimin e mbetjeve nuk kanë qenë të licencuara për trajtimin e kategorive përkatëse të mbetjeve biologjike veterinarë. Në disa raste mungojnë kontratat për kryerjen e shërbimit, dokumentet e transferimit të mbetjeve, fletëdaljet për sasinë e produkteve të asgjësuar dhe faturat për shërbimet e kryera. Gjithashtu, nuk është dokumentuar verifikimi në terren i përputhshmërisë së sasisë së asgjësuar me të dhënat e pasqyruara në procesverbalet e asgjësimit. Nga auditimi u konstatua se produktet bimore, të marra në kuadër të planit të monitorimit të mbetjeve të pesticideve në produktet me origjinë bimore, kanë rezultuar me përmbajtje të pesticideve mbi normat e lejuara dhe me pesticide të ndaluara në Republikën e Shqipërisë dhe Bashkimin Evropian. Nga auditimi u konstatuan vonesa në marrjen e masave nga ana e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit për gjurmueshmërinë dhe trajtimin e produkteve të rezultuara të pasigurta ose jokonforme me standardet e sigurisë ushqimore, duke krijuar risk që produkte potencialisht të rrezikshme të mos tërhiqen në kohë nga tregu ose të mos



administrohen sipas procedurave të përcaktuara në legjislacion. Gjithashtu, u evidentua mungesë koordinimi dhe komunikimi efektiv ndërmjet strukturave përgjegjëse të kontrollit, duke kufizuar reagimin institucional në rastet që kërkojnë ndërhyrje të shpejtë për mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve. Nga auditimi u konstatuan problematika lidhur me përcaktimin e kufijve maksimalë të mbetjeve të substancave jo në përputhje me kërkesat e Bashkimit Evropian, duke caktuar kufij minimal mbi nivelin e lejuar në BE. Këto mospërputhje rregullatore, të shoqëruara me dobësi në zbatimin e mekanizmave të kontrollit, mund të ndikojnë negativisht në sigurinë ushqimore, në mbrojtjen e konsumatorit dhe në besueshmërinë e produkteve në tregjet e brendshme, në rastin kur nuk lejohen për tregtim në tregje ndërkombëtare. Auditimi evidentoi dobësi në zbatimin e procedurave për monitorimin dhe administrimin e procedurave të ndjekura për trajtimin e produkteve shtazore, me prejardhje nga kafshë të infektuara, si dhe në garantimin e gjurmueshmërisë së produkteve përgjatë procesit të përpunimit dhe tregtimit. Konkretisht, u konstatuan mangësi në dokumentimin dhe kontrollin e zbatimit të kushteve veterinare për trajtimin e mishit të përfituar nga therja sanitare, në gjurmueshmërinë e produkteve dhe konfiskateve. Auditimi konstatoi gjithashtu parregullsi në lidhje me dokumentimin e procedurave të ndjekura për asgjësimin, konfiskimin ose trajtimin sipas kushteve të veçanta veterinare, të produkteve ushqimore ose shtazore. Mungesa e evidencave të plota dokumentare për proceset e trajtimit dhe asgjësimit përfundimtar të produkteve ka krijuar risk për mungesë transparence dhe pamundësi për të verifikuar nëse këto produkte janë asgjësuar/trajtuar sipas kërkesave ligjore dhe standardeve të sigurisë ushqimore.

Në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën nga data 01.01.2023 deri më datën 31.12.2025, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura, nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**. Nga auditimi rezultoi se janë kryer një numër i konsiderueshëm rishikimesh të fondeve buxhetore të administruara nga institucioni, pa kryer një analizim apo argumentim të kërkesave buxhetore. Janë miratuar kontrata për qeramarrjen e hapësirave të plazhit ndërmjet AKB-së, subjekteve dhe bashkive përkatëse, pa paraqitur dokumentacion ligjor të plotë mbi detyrimet tatimore, pa siguruar mbulim me vrotues për çdo ditë të sezonit turistik, duke cenuar sigurinë e stacioneve të pushimit, si dhe pa dokumentuar përmes materialeve fotografike gjëndjen reale të strukturave akomoduese të përfshira. Nga inspektimet e kryera u konstatua se në dosje nuk administrohen materiale fotografike që të vërtetojnë përmbushjen e detyrimeve nga subjektet e inspektuara. Gjithashtu, në rastet e konstatuara me shkelje nuk janë aplikuar në mënyrë të duhur masat administrative të përcaktuara, si dhe inspektimet nuk janë shoqëruar në çdo rast me urdhërat për korrigjimin e shkeljeve të konstatuara. Në procedurat e prokurimit janë konstatuar parregullsi në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe kritereve të veçanta jo në përputhje me objektin e prokurimit, si dhe mospërputhje dhe mangësi në dokumentacionin e ofertës fituese. Gjithashtu, nga auditimi rezultoi dëm ekonomik në vlerën 19,319 mijë lekë, nga mos aplikimi i sanksioneve të parashikuara në kontratat e pastrimit; si dhe efekte negative në administrimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet në vlerën 13,997 mijë lekë, si rezultat i mos aplikimit të masave administrative për shkeljet e konstatuara nga inspektimet, skualifikimit të operatorëve ekonomik pa një analizë dhe argumentim të plotë ligjor, si dhe nga shpenzimet mbi vendimet gjyqësore për ish-punonjësit të larguar nga puna.

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronës Publike

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e aktivitetit 01.01.2023 - 31.12.2023, KLSH ka konstatuar se veprimtaria e subjektit të audituar ka devijime materiale por jo të



përhapura, nga kuadri ligjor dhe rregullator, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**. Nga auditimi u evidentua se nuk janë hartuar plane veprimi të strukturuar për proceset e privatizimit të shoqërive tregtare me kapital shtetëror, si në sektorët strategjikë ashtu edhe në ata jostrategjikë, si dhe për administrimin dhe tjetërsimin e asetëve shtetërore. Gjithashtu, nuk janë përgatitur relacione, analiza apo raportime periodike mbi ecurinë e proceseve të privatizimit dhe shitjes së pronës shtetërore, ndërkohë që informacioni i disponueshëm rezultoi i mangët, i pa sistemuar dhe jo i përditësuar, veçanërisht në lidhje me monitorimin e kontratave të qirasë dhe përdorimit të pronës publike. Auditimi evidentoi se strukturat përgjegjëse për administrimin dhe monitorimin e pronës shtetërore nuk kanë ndjekur në mënyrë të plotë procedurat e përcaktuara në kuadrin ligjor dhe kontraktual, duke mos llogaritur penalitete për mosrespektim të detyrimeve kontraktuale nga qiramarrësit dhe pa verifikuar realizimin e investimeve apo nivelin e punësimit të parashikuar në kontrata. Në drejtim të monitorimit të shoqërive aksionere me kapital 100% shtetëror, u konstatua se treguesit financiarë dhe pasqyrat financiare nuk janë miratuar në kohë, ndërkohë që për vitin 2022, humbja për 8 shoqëri ishte në shumën 2,446,746 mijë lekë. Gjithashtu, 9 shoqëri aksionere të shpallura në likuidim, të cilat administrojnë pasuri të paluajtshme në shumën 6,852,990 mijë lekë, nuk janë monitoruar në mënyrë efektive nga strukturat përgjegjëse, duke çuar në zgjatje të procesit të likuidimit për periudha shumëvjeçare, krijim detyrimesh ndaj punonjësve, sigurimeve shoqërore dhe palëve të treta në shumën 2,225,667 mijë lekë. Dividendi i prapambetur i palikuiduar rezultoi në shumën 4,054,214 mijë lekë. Nga auditimi u konstatua gjithashtu se proceset e privatizimit të pronës shtetërore janë zgjatur për periudha të gjata kohore, ndërkohë që një numër objektesh të miratuara për privatizim nuk janë publikuar për shitje. Në lidhje me administrimin e objekteve të ndërtuara në tejkallim të lejes së ndërtimit, auditimi evidentoi mangësi në dokumentimin dhe ndjekjen e procedurave, duke përfshirë raste të mungesës së raporteve të vlerësimit të miratuara, vonesa në lidhjen e kontratave për kalimin e të drejtave të pronësisë dhe mungesë të aplikimeve në sistemin e lejeve për rregullimin e situatës ligjore të objekteve. Po ashtu, auditimi evidentoi problematika edhe në zhvillimin dhe monitorimin e Zonave Teknologjike dhe Zonave të Zhvillimit Ekonomik, ku janë nisur procedura ndërtimi ose prokurimi përpara miratimit të kontratave me zhvilluesit. Nga auditimi rezultuan efekte negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet, të ardhura të munguara në vlerën 148,241 mijë lekë, si rezultat i mosvendosjes së penalteteve për mospërbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat e qirasë, mosaplikimit të kamatëvonesave për pagesa të vonuara, mosderdhjes në buxhetin e shtetit të të ardhurave nga shfrytëzimi i pronës shtetërore, si dhe mangësive në proceset e vlerësimit dhe privatizimit të pronës shtetërore.

Në Korporatën e Investimeve Shqiptare (AIC)

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga 17.10.2019 deri më 30.06.2024, KLSH ka konstatuar se veprimtaria e subjektit të audituar ka devijime nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator përkatës të cilat janë materiale por jo të përhapura, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**. Auditimi evidentoi se planifikimi buxhetor ishte kryer pa argumentim të detajuar dhe u identifikuan mospërputhje ndërmjet parashikimeve dhe realizimeve, duke ndikuar negativisht në performancën ekonomiko-financiare të shoqërisë. Auditimi konstatoi mungesën e një kuadri të plotë rregullator për identifikimin, përzgjedhjen, miratimin dhe menaxhimin e projekt-propozimeve, përfshirë një metodologji të unifikuar dhe të standardizuar për seleksionimin e projekt-ideve, menaxhimin e fazave të ciklit të projekteve, administrimin dhe zhvillimin e pronave shtetërore, si dhe procedurave konkrete të operimit, duke rritur riskun në menaxhimin strategjik dhe realizimin e objektivave të Korporatës. Deri në fund të periudhës së audituar, Korporata e Investimeve Shqiptare SHA nuk kishte implementuar manuale, udhëzues apo metodologji të standardizuara për përcaktimin e kritereve të përzgjedhjes, fazave të ciklit të projektit dhe hapave paraprakë



përpara shpalljes së çdo projekt-propozimi, përfshirë analizat e para-fizibilitetit/fizibiliteti. Projekt-propozimet e hartuara gjatë viteve 2022–2024 ishin realizuar pa respektuar procedurat e përcaktuara dhe pa analizë të detajuar mbi risqet, objektivat, përfitueshmërinë, vlerën e shtuar të parasë dhe rentabilitetin e investimit, duke mos mundësuar vlerësimin e impaktit ekonomik, alternativave të zhvillimit dhe përfitimeve të mundshme. Po ashtu, në kuadër të zhvillimit të pronave shtetërore u konstatuan mungesa të dokumentacionit dhe analizave mbi përfitueshmërinë e investimeve, krahasimisht me zhvillimin e tyre nga institucionet publike me financim të drejtpërdrejtë nga buxheti i shtetit. Auditimi evidentoi ndërprerje në vijimësinë e projekt-propozimeve të mëparshme, përfshirë ato në sektorin e energjisë dhe zhvillimit të zonave prioritare, pavarësisht se për këto projekte ishin kryer shpenzime për kontraktimin e ekspertëve të jashtëm për studime të para-fizibilitetit. Auditimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit evidentoi vonesa në dorëzimin e deklaratave dhe vetëvlerësimeve, mungesë manualesh, strategji të menaxhimit të riskut dhe dokumentacionit të përditësuar, si dhe standardizim të pamjaftueshëm të proceseve kryesore të punës. Gjithashtu, nuk disponohej dokumentacion i plotë që të vërtetonte përmbushjen e kriterëve ligjore për përbërjen dhe funksionimin e Këshillit Mbikëqyrës, i cili kishte funksionuar me strukturë të paplotë për periudhën 2020–2023, përfshirë mungesën e Kryetarit, si dhe mungesa e përcaktimeve të qarta mbi kriteret e shpërblimit për anëtarët e pavarur jo ndërkombëtarë. Nga verifikimi i procedurave të rekrutimit rezultoi se për disa raste nuk disponohej dokumentacion që të vërtetonte procedurat e ndjekura për punësimin, ndërsa për disa të tjerë, për të cilët ishin ndjekur procedura standarde, u konstatuan mangësi në dokumentacionin shoqërues. Nga auditimi u konstatuan efekte negative në administrimin dhe përdorimin e fondeve publike, në drejtim të ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, në vlerën totale prej 3,972 mijë lekë, si rezultat i kontraktimit të ekspertëve të jashtëm për hartimin e projekt-propozimeve pa një plan pune të miratuar dhe pa përmbushjen e kushteve paraprake për zhvillimin e projekteve, të cilat nuk kanë vijuar më tej në fazat e tjera të zbatimit, si dhe mosmenaxhimit efektiv të fondeve monetare të lira të institucionit, të cilat nuk janë investuar në instrumente financiare për gjenerimin e të ardhurave.

Në Autoritetin e Aviacionit Civil

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2022 deri në 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar mangësive dhe parregullsive, të cilat lidhen kryesisht me funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, procesin e hartimit dhe realizimit të treguesve ekonomikë, administrimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe proceset e vendimmarrjes. Nga auditimi rezultoi se AAC ka ndërmarrë një angazhim financiar përtej kompetencave të saj ligjore, duke marrë rolin e garantuesit të fondeve buxhetore në favor të një shoqërie tregtare në vlerën 2 miliard lekë. Në periudhën e audituar, u konstatua se nuk është përmbushur detyrimi ligjor për plotësimin e fondit rezervë dhe për transferimin e detyrimeve përkatëse në buxhetin e shtetit brenda afatit 5-vjeçar të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi. Nga analiza e të dhënave financiare rezultoi se niveli mesatar i tepricës së krijuar në fund të 6-mujorëve të dytë të buxhetit, i deklaruar gjatë tre viteve të fundit, ishte në vlerën 237,071 mijë lekë. Bazuar në këtë nivel, institucioni duhet të kishte transferuar çdo vit në fondin rezervë shumën 79,024 mijë lekë. Megjithatë, ky detyrim nuk është realizuar, duke sjellë si pasojë mosplotësimin e fondit rezervë, si dhe mosarkëtimin në buxhetin e shtetit të tepricave të të ardhurave përkatëse për çdo vit. U evidentua se më datë 31.12.2024, në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, llogaritë e aktiveve afatshkurtra paraqesin vlera të konsiderueshme të të drejtave për t'u arkëtuar. Konkretisht, zëri "Të arkëtueshme tregtare" rezultoi në vlerën 941,656 mijë lekë, që përfaqëson detyrime të pashlyera nga klientët, duke shënuar një rritje në vlerën 448,577 mijë lekë krahasuar me vitin paraardhës. Gjithashtu, zëri "Të arkëtueshme të tjera"



paraqitet në vlerën 2,012,788 mijë lekë, duke reflektuar ekzistencën e detyrimeve të tjera të paarkëtuara në fund të periudhës raportuese. Është konstatuar përdorim pa efektivitet të fondeve publike për pagesa që lidhen me procese gjyqësore në lidhje largimet e padrejta nga puna të punonjësve, në shumën 21,998 mijë lekë.

Në Autoritetin Portual Durrës

Nga *auditimi i përputhshmërisë*, i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar mungesës së një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, i cili nuk ka funksionuar në mënyrë të plotë, si dhe me mungesën e procedurave të standardizuara për komunikimin e brendshëm dhe raportimin periodik. Po ashtu, nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik nuk është formalizuar. Gjithashtu, u konstatua se, Këshilli Drejtues nuk ishte mbledhur rregullisht, duke sjellë vonesa në proceset vendimmarrëse, ndërsa Këshilli Konsultativ nuk ka qenë funksional, me pasojë mungesë të këshillimit profesional në vendimmarrje të rëndësishme. Nga auditimi i veprimtarisë së Këshillit Drejtues të APD-së, u konstatua se janë akorduar shpërblime për anëtarët, pa miratimin e ministrit të linjës dhe në kundërshtim me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit. Vendimet e Këshillit Drejtues lidhur me elementët e pagës dhe shpërblimet nuk janë miratuar nga ministri përgjegjës. Nga auditimi u evidentuan gjithashtu problematika në procedurat e rekrutimit, ku janë konstatuar shkelje të afateve, si dhe mungesë dokumentacioni. Në lidhje me vlerësimin e performancës, është konstatuar se ai nuk është realizuar në mënyrë të plotë; shpërblimet janë dhënë kryesisht në bazë të kohëzgjatjes së punës dhe jo të performancës, duke cenuar qëllimin e tyre. Nga auditimi i prokurimeve publike, u konstatua se kriteret e veçanta të kualifikimit nuk rezultojnë të jenë ngushtësisht të lidhura dhe proporcionale me natyrën dhe përmasën e kontratës. Gjithashtu, në disa raste janë kualifikuar, shpallur fitues dhe janë lidhur kontrata me operatorë ekonomikë që nuk plotësonin kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në zbatimin e kontratave janë evidentuar pagesa pa faturë tatimore, duke mos deklaruar në afat TVSH-në në vlerën 232,965 mijë lekë dhe janë paguar shuma më të larta se vlera e kontratës për shkak të konvertimit të gabuar të monedhës, me dëm ekonomik në buxhetin e institucionit në vlerën 19,269 mijë lekë, pagesa për punime të pakryera vlerën 1,184 mijë lekë dhe mosmbajtje e penalteteve për vonesa në vlerën 55,608 mijë lekë. U evidentua se janë kryer pagesa për shërbime pa procedurë prokurimi dhe pa dokumentacion justifikues. Niveli i llogarive të arkëtueshme (debitorëve) në fund të periudhës ishte 796,534 mijë lekë, ku për vlerën 348,057 mijë lekë nuk janë ndjekur procedurat e arkëtimit. Plan-bizneset janë hartuar pa analiza të mjaftueshme, me parashikime jo reale të investimeve, ku ndryshimet e tyre nuk janë përcjellë për miratim në ministrinë e linjës. Janë konstatuar efekte negative në lidhje me përdorimin dhe administrimin e fondeve publike nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar padrejtësisht. Nga APD u evidentua se nuk është hartuar rregullore për menaxhimin e aktiveve dhe nuk janë evidentuar persona përgjegjës, duke krijuar risk për humbje. Inventarët stok në vlerën 497,878 mijë lekë nuk janë analizuar për shfrytëzim, duke rrezikuar zhvlerësimin e tyre. Për inventarët e papërdorshëm të miratuar për asgjësim në vlerën 71,078 mijë lekë nuk është realizuar procedura e asgjësimit, duke u pasqyruar në regjistër si aktive në gjendje pune. Tarifat e kontratave të qiradhënies për pajisje nuk janë aplikuar, duke krijuar të ardhura të munguara. U konstatua se shumë subjekte operojnë pa kontrata apo me kontrata të përfunduara, duke krijuar të ardhura të munguara. Shërbime të ofruara nga APD nuk janë të pasqyruara në Librin e Tarifave, duke krijuar mungesë transparence. Nga auditimi u evidentua se, sistemi i hyrje-daljeve nuk është i integruar plotësisht, duke krijuar mundësi për shmangie të tarifave dhe duke cenuar sigurinë. Gjithashtu, mekanizmi i *"black list"* për debitorët administrohet në mënyrë manuale, duke



rritur rrezikun e gabimeve dhe pasaktësive. Si rezultat i sa më sipër janë konstatuar efekte negative në lidhje me përdorimin dhe administrimin e fondeve publike si menaxhim me mungesë ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve, në vlerën 235,362 mijë lekë dhe 549,059 euro, si dhe të ardhura të munguara në vlerën 838,818 mijë lekë.

Në Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve (AKUK)

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2021 deri më datën 30.06.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar konstatimeve në mungesën e rakordimit periodik mujor të stokut të detyrimeve të prapambetura me Degën e Thesarit, pasi në fund të vitit 2023 ka rezultuar një diferencë prej 169,564 mijë lekë. Gjithashtu, nga 14 shoqëri ujësjellësish vetëm 6 shoqëri (Berat, Elbasan, Korçë, Lushnjë, Pogradec dhe Sarandë) disponojnë ambiente për laborator, duke sjellë mos kryerjen e analizave të ujit të pijshëm dhe mos garantimin e sigurisë për qytetarët. Është konstatuar gjithashtu se procesi i shpronësimit për projektin “Përmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madhe” ka mbetur pothuajse në të njëjtin nivel ecurie dhe pa progres të dukshëm, si dhe ka rezultuar mungesa e një regjistri të centralizuar të projekteve të ujësjellësve në Shqipëri për të siguruar koordinimin dhe menaxhimin më të mirë të burimeve, etj. Gjithashtu, në kontabilitet nuk janë njohur vlerat e përlogaritura të efekteve financiare që burojnë nga vendimet gjyqësore të formës së prerë për ekzekutim, si detyrime për t’u shlyer sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, por ato janë regjistruar vetëm në momentin e likuidimit. Kjo ka sjellë një efekt financiar në buxhetin e shtetit në vlerën 71,615 mijë lekë, ndërkohë që mbetet ende pa u shlyer vlera 159,978 mijë lekë, e cila përbën risk të shtuar me efekt negativ financiar për buxhetin e shtetit. Gjithashtu, ekziston një shumë tjetër e pritshme për likuidim nga vendimet e shkallës së dytë për të shpronësuarit, në vlerën 56,801 mijë lekë. Nga auditimi rezultuan mangësi në fushën e prokurimeve që lidhen kryesisht me përcaktimin e kriterëve kualifikuese të paargumentuara teknikisht dhe jo në përputhje me grafikun, volumin dhe natyrën e punimeve apo me zërat e preventivit. Gjithashtu, u konstatuan mangësi në kërkesat lidhur me drejtuesit teknikë, licencat dhe specifikimet teknike. Në fazën e zbatimit të kontratave të punimeve, mallra dhe shërbime, si dhe kolaudit/marrja në dorëzim i objekteve të zbatuara, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe shoqëritë publike të ujësjellës kanalizimeve, janë konstatuar pagesa për punime të pakryera në shumën prej 24,337 mijë lekë, si dhe në dy kontrata nuk janë zbatuar afatet e përfundimit të punimeve sipas kushteve të përcaktuara në kontratë, duke evidentuar mungesë të ardhurash për vlerën 221,153 mijë lekë. Është konstatuar përdorim pa efektivitet i fondeve publike në shpenzimet përmbartimore për ish të shpronësuarit në vlerën 9,084 mijë lekë, shoqëruar me mos publikimin online në faqen zyrtare të grafikut e shlyerjes së detyrimeve.

Në Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve (AKUK), Projekti “Infrastruktura bashkiake V”

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për projektin “Infrastruktura bashkiake V”, për periudhën nga fillimi i projektit deri në 31.12.2024, është konstatuar se nuk është vlerësuar shkalla e realizimit të objektivit për rritjen e ndërgjegjësimit në krahasim me objektivat e përcaktuar në marrëveshje me huadhënësit, si rezultat i mungesës së një sistemi të përcaktuar matjeje në dokumentet zyrtare. Nëpërmjet amendimit të kontratës u miratuan shtesa për Komponentin A/B për Elbasanin me 124,489.5 EUR dhe Komponentin A për Kamzën me 75,980.24 EUR, për një fazë që ishte mbyllur në vitin 2020 dhe mbulimi i kostove për Fazën 1 (Komponentët A/B) u krye nga dy grante të KfW të vitit 2018, ndërsa investimi për Kamzën u anulua dhe pagesat e kryera për Komponentin A në vitin 2023 janë të



pajustificuara. Gjithashtu, si rezultat i ecurisë së ngadaltë të projektit dhe mosrespektimit të grafikut të disbursimeve, deri më 31.12.2024 janë gjeneruar kosto shtesë pa efektivitet për buxhetin e shtetit në formën e tarifës së angazhimit në vlerë 453,824 euro.

Në Operatorin e Shpërndarjes të Energjisë Elektrike (OSHEE) Group SHA

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e aktivitetit 01.01.2023 deri më 31.07.2025, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar konstatimeve mbi zbatimin e marrëveshjes për printimin dhe shpërndarjen e faturave të energjisë elektrike te klienti fundor nga Posta Shqiptare për OSHEE Group SHA, ku rezultoi se nuk ushtrohej kontroll për verifikimin e realizimit efektiv të këtij shërbimi. Akt-rakordimet përmbledhëse mujore dhe procesverbalet e inspektimit të sasisë së faturave, të firmosura nga Administratorët Rajonalë/Koordinatorët Rajonalë të FSHU SHA, nuk i nënshtroeshin procedurave të kontrollit dhe verifikimit nga strukturat përkatëse të OSHEE Group SHA, gjatë procesit apo pas kryerjes së tij. Për rrjedhojë, pagesat e kryera në zbatim të kësaj marrëveshjeje, në vlerën totale 923,369 mijë lekë, konsiderohen si efekt financiar negativ për buxhetin e shoqërisë. OSSH SHA për periudhën e auditimit ka blerë energji elektrike për mbulimin e humbjeve teknike dhe jo-teknike në rrjet në sasinë totale 3,697,128,861 kWh, me një vlerë prej 35,116,819 mijë lekë (rreth 360,172 mijë euro). Humbjet në rrjet janë shkaktuar si nga faktorë teknikë, të lidhur me amortizimin e rrjetit, mungesën e investimeve dhe gjendjen e infrastrukturës, ashtu edhe nga humbje jo-teknike, të cilat lidhen me ndërhyrje të paligjshme në sistemin e matjes, lidhje të paautorizuara me rrjetin dhe rilidhje të paautorizuara të përdoruesve të cilëve u është ndërprerë furnizimi nga OSSH. Nga kjo humbje energjie, OSSH SHA dhe DKRH ka konstatuar si ndërhyrje të paligjshme (humbje jo teknike) sasinë 22,042,080 kWh, për të cilën janë lëshuar fatura në vlerën 406,131 mijë lekë. Nga kjo shumë janë arkëtuar 36,198 mijë lekë, ose vetëm 8.9% e vlerës totale të faturuar, duke krijuar një diferencë prej 396,934 mijë lekë si të ardhura të munguara për buxhetin e shoqërisë. Nga auditimi rezultuan mangësi në fushën e prokurimeve që lidhen me mosdokumentimin e analizës së nevojave dhe mënyrës së përcaktimit të vlerës së parashikuar të prokurimit, dokumentimin e pamjaftueshëm të përlllogaritjes së fondit limit, mungesën e argumentimit teknik të kriterëve të kualifikimit në raport me natyrën e kontratës, si dhe mungesën e argumentimit për afatin e përcaktuar për realizimin e kontratave. Në fazën e zbatimit të kontratave u konstatuan pagesa për punime të pakryera në shumën prej 7,199 mijë lekë, mungesë e planit të monitorimit të zbatimit të kontratës, si dhe, në disa raste, mosdërgim i informacionit në APP lidhur me monitorimin e kontratës. Janë konstatuar përdorim pa efektivitet i fondeve publike nga humbja e çështjeve gjyqësore në vlerën prej 13,706 mijë lekë, për largimet e padrejta nga puna të punonjësve, si dhe pagesa për mos-ekzekutim vullnetar të dëmshpërblimeve, përfshirë cenimin e pronës, mos-përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, gjobat administrative dhe pavlefshmërinë e titujve, në vlerën 79,673 mijë lekë. Gjithashtu ka rezultuar se, përlllogaritja e dietës ushqimore nuk është në përputhje me legjislacionin, duke sjellë efektin financiar negativ për buxhetin e shoqërisë në vlerën 790,675 mijë lekë, si dhe shpërblimet e veçanta dhe për mbështetje financiare për punonjësit, në shumën 76,810 mijë lekë, janë kryer në mungesë të një analize paraprake të situatës ekonomike dhe financiare të shoqërisë, vlera e të cilave përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shoqërisë.

Në Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) Drejtoria Rajonale Tiranë

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e aktivitetit nga viti 01.01.2023 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar



konstatimeve për aktive të munguara në kontabilitet dhe të paidentifikuara gjatë inventarizimit fizik në vlerën gjithsej 939,182 mijë lekë. Nga verifikimi dhe analizimi i planeve të ndërprerjes së energjisë për abonentët debitor, rezultoi se niveli i realizimit të lidhjeve të reja me energji elektrike brenda afateve ligjore të përcaktuara ka qenë i ulët, si për kategorinë 0–20 kW dhe 20–50 kW, ashtu edhe për kategorinë 50–100 kW në TU dhe TM. Pjesa më e madhe e aplikimeve janë realizuar jashtë afateve kohore ose kanë mbetur ende në proces, duke reflektuar vonesa të konsiderueshme në trajtimin dhe përfundimin e tyre. Gjithashtu, nga verifikimi i planeve mujore të ndërprerjes së energjisë për të dy vitet, u evidentua një mosrealizim sistematik i planit të ndërprerjeve nga grupet përkatëse. Përqindja shumë e ulët e debitorëve ndaj të cilëve është kryer ndërprerja, krahasuar me numrin total të planifikuar, si dhe numri i konsiderueshëm i rasteve kur ndërprerja nuk është realizuar apo debitori nuk është vizituar sipas planit, ka treguar mangësi në zbatimin e procedurave dhe në monitorimin e performancës operacionale, duke paraqitur problematika të qarta në menaxhimin e proceseve, respektimin e afateve ligjore, si dhe në zbatimin efektiv të planeve të ndërprerjes, si dhe me ndikim negativ në cilësinë e shërbimit dhe në forcimin e disiplinës së pagesave. Nga auditimi rezultoi se humbja e energjisë për vitin 2023 ishte 318,393,849 kWh ose 12.59% e energjisë së futur në rrjet, ndërsa për vitin 2024 humbja totale ishte 301,689,460 kWh ose 11.18%. Nga këto humbje, rastet e konstatuara për ndërhyrje të paautorizuara nga OSSH dhe Drejtoria e Kontrollit dhe Rikuperimit të Humbjeve (DKRH) përbënin vetëm 3,510,840 kWh për vitin 2023 dhe 606,600 kWh për vitin 2024. Për diferencën midis humbjes totale dhe asaj të konstatuar nga kontrollet nuk rezultoi të jetë kryer asnjë analizë apo verifikim për të përcaktuar nëse kjo humbje është shkaktuar nga faktorë teknikë apo jo teknikë. Mungesa e planeve të strukturuar të punës dhe e urdhrave të qarta të kontrollit në zonat me nivel të lartë humbjesh ka ndikuar në mos adresimin efektiv të humbjeve jo-teknike, si në njësinë Tirana 1 për vitin 2024, ashtu edhe në njësinë Tirana 3 për vitin 2023, të identifikuara si njësitë me humbjet më të larta përkatëse. Njëkohësisht, përqindja e ulët e rasteve të konstatuara tek subjektet private, 6 nga 30 raste në vitin 2024 dhe 23 nga 51 raste në vitin 2023, ndonëse konsiderohen kategori me risk më të lartë, ka treguar një fokus të pamjaftueshëm të kontroleve ndaj kësaj kategorie dhe një qasje jo plotësisht të orientuar drejt riskut. Nga auditimi rezultuan mangësi në fushën e prokurimeve, të lidhura me mungesën e dokumentimit të analizës së nevojave dhe mënyrës së përcaktimit të vlerës së parashikuar të prokurimit. Po ashtu, u konstatuan mangësi në dokumentimin e përlogaritjes së fondit limit, në argumentimin teknik të kriterëve të kualifikimit në raport me natyrën e kontratës, si dhe në argumentimin e afatit të përcaktuar për realizimin e kontratave. Në fazën e zbatimit të kontratave janë konstatuar pagesa për punime të pakryera në shumën prej 4,223 mijë lekë, si dhe mungesa e planit të monitorimit të zbatimit të kontratës, si dhe në disa raste, mos dërgimi i informacionit në lidhje me monitorimin e kontratës në APP. Në fushën e të ardhurave u konstatua mos arkëtim i energjisë elektrike të faturuar, pa u marrë të gjitha masat për arkëtimin e plotë përkatësisht për vitin 2023 në vlerën 56,326 mijë lekë dhe për vitin 2024 në vlerën 11,256 mijë lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e shoqërisë. Është konstatuar përdorim pa efektivitet i fondeve publike nga humbja e çështjeve gjyqësore në vlerën prej 6,620 mijë lekë, për largimet e padrejta nga puna të punonjësve, e cila përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shoqërisë.

Në Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) Drejtoria Rajonale Durrës

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e aktivitetit nga viti 01.01.2023 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**. Nga verifikimi dhe analizimi i planeve të ndërprerjes së energjisë për abonentët debitor rezultoi se niveli i realizimit të lidhjeve të reja me energji elektrike brenda afateve ligjore të përcaktuara ka qenë i ulët, si për kategorinë 0–20 kW dhe 20–50 kW, ashtu edhe për kategorinë 50–100 kW në TU



dhe TM. Pjesa më e madhe e aplikimeve janë realizuar jashtë afateve kohore ose kanë mbetur ende në proces, duke reflektuar vonesa të konsiderueshme në trajtimin dhe përfundimin e tyre. Gjithashtu, nga verifikimi i planeve mujore të ndërprerjes së energjisë për të dy vitet u evidentua një mosrealizim sistematik i planit të ndërprerjeve nga grupet përkatëse. Përqindja shumë e ulët e debitorëve ndaj të cilëve është kryer ndërprerja, krahasuar me numrin total të planifikuar, si dhe numri i konsiderueshëm i rasteve kur ndërprerja nuk është realizuar apo debitori nuk është vizituar sipas planit, ka treguar mangësi në zbatimin e procedurave dhe në monitorimin e performancës operacionale, duke paraqitur problematika të qarta në menaxhimin e proceseve, respektimin e afateve ligjore, si dhe në zbatimin efektiv të planeve të ndërprerjes, si dhe me ndikim negativ në cilësinë e shërbimit dhe në forcimin e disiplinës së pagesave. Nga auditimi rezultoi se humbja e energjisë për vitin 2023 ishte 183,023,000 kWh ose 18.99 % e energjisë së futur në rrjet, ndërsa për vitin 2024 humbja totale ishte 174,657,000 kWh ose 17.56 %. Nga këto humbje, rastet e konstatuara për ndërhyrje të paautorizuara nga OSSH dhe Drejtoria e Kontrollit dhe Rikuperimit të Humbjeve (DKRH) përbënin vetëm 2,914,260 kWh për vitin 2023 dhe 378,480 kWh për vitin 2024. Për diferencën midis humbjes totale dhe asaj të konstatuar nga kontrollet, nuk rezulton të jetë kryer asnjë analizë apo verifikim për të përcaktuar nëse kjo humbje është shkaktuar nga faktorë teknikë apo jo teknikë. Mungesa e planeve të strukturuar të punës dhe e urdhrave të qarta të kontrollit në zonat me nivel të lartë humbjesh, konkretisht në Njësitë Shijak dhe Krujë, ka ndikuar në mosadresimin efektiv të humbjeve jo-teknike. Njëkohësisht, përqindja e ulët e rasteve të konstatuara tek subjektet private, 11 nga 80 raste në vitin 2023 dhe 7 nga 49 raste në vitin 2024, ndonëse konsiderohen kategori me risk më të lartë, tregon një fokus të pamjaftueshëm të kontroleve ndaj kësaj kategorie dhe një qasje jo plotësisht të orientuar drejt riskut. Nga auditimi rezultuan mangësi në fushën e prokurimeve që lidhen me mosdokumentimin e analizës së nevojave dhe mënyrës së përcaktimit të vlerës së parashikuar të prokurimit, dokumentimin e pamjaftueshëm të përlogaritjes së fondit limit, mungesën e argumentimit teknik të kriterëve të kualifikimit në raport me natyrën e kontratës, si dhe mungesën e argumentimit për afatin e përcaktuar për realizimin e kontratave. Në fazën e zbatimit të kontratave u konstatuan pagesa për punime të pakryera në shumën prej 703 mijë lekë, mungesë e planit të monitorimit të zbatimit të kontratës, si dhe, në disa raste, mosdërgim i informacionit në APP lidhur me monitorimin e kontratës. Në fushën e të ardhurave u konstatua mosarkëtim i energjisë elektrike të faturuar, pa u ndërmarrë të gjitha masat për mbledhjen e detyrimeve përkatëse, përkatësisht për vitin 2023 në vlerën 50,652 mijë lekë dhe për vitin 2024 në vlerën 7,024 mijë lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e shoqërisë. Nga auditimi rezultoi se të njëjtat mallra janë regjistruar në sistemin financiar SAP me kode dhe emërtime të ndryshme, duke sjellë për pasojë paqartësi në përcaktimet e tepricave dhe mungesave në këtë sistem. Ndërhyrja e tre komisioneve në magazinë përgjatë periudhës kohore Gusht - Tetor 2024 ka dobësuar kontrollin në sistemin financiar SAP dhe mbajtjen e fletë hyrje dhe fletë daljeve duke bërë të pamundur inventarizimin e saktë dhe të besueshëm në sasi dhe vlera.

Në Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) Drejtoria Rajonale Shkodër

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e aktivitetit ekonomik dhe financiar nga viti 01.01.2023 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar konstatimeve në rezultatet e inventarizimeve ndër vite, ku nuk është ndërmarrë asnjë veprim për identifikimin dhe saktësimin e aktiveve të munguara dhe të paidentifikuara në vlerën prej 8,852 mijë lekë. Nga verifikimi dhe analizimi i të dhënave rezultoi se realizimi i lidhjeve të reja me energji elektrike brenda afateve ligjore të përcaktuara ka qenë në nivele të ulëta, si për kategoritë 0–20 kW dhe 20–50 kW, ashtu edhe për kategorinë 50–100 kW në TU dhe TM. Pjesa më e madhe e aplikimeve janë realizuar jashtë



afateve kohore ose kanë mbetur ende në proces, duke evidentuar vonesa të konsiderueshme në trajtimin dhe përfundimin e kërkesave. Gjithashtu, nga analizimi i planeve të ndërprerjes së energjisë për abonentët debitorë për të dy vitet, u konstatua një mosrealizim sistematik i planit nga grupet përkatëse. Një pjesë e konsiderueshme e debitorëve të planifikuar nuk janë trajtuar sipas planit, ndërsa në disa raste nuk janë kryer as vizita në terren. Këta tregues evidentojnë mangësi në menaxhimin dhe monitorimin e proceseve operacionale, në respektimin e afateve ligjore dhe në zbatimin efektiv të planeve të ndërprerjes, me ndikim negativ në cilësinë e shërbimit dhe në forcimin e disiplinës së pagesave. Nga auditimi rezultoi se humbja e energjisë për vitin 2023 ishte 236,889,374 kWh ose 33.68% e energjisë së futur në rrjet, ndërsa për vitin 2024 humbja totale ishte 236,527,010 kWh ose 32.30%. Nga këto humbje, rastet e konstatuara për ndërhyrje të paautorizuara nga OSSH dhe Drejtoria e Kontrollit dhe Rikuperimit të Humbjeve (DKRH) dhe përbënin vetëm 1,142,580 kWh për vitin 2023 dhe 3,987,900 kWh për vitin 2024. Për diferencën midis humbjes totale dhe asaj të konstatuar nga kontrollet nuk rezulton të jetë kryer asnjë analizë apo verifikim për të përcaktuar nëse kjo humbje është shkaktuar nga faktorë teknikë apo jo teknikë.

Mungesa e planeve të punës dhe e urdhrave të kontrollit në zonat me humbje të larta ka penguar parandalimin efektiv të humbjeve jo-teknike dhe përmirësimin e situatës. Numri i ulët i rasteve të konstatuara tek subjektet private, të cilat paraqesin risk më të lartë, 22 nga 81 raste në 2023 dhe 27 nga 138 raste në 2024, ka treguar një fokus të pamjaftueshëm të kontrolleve ndaj kategorive më problematike. Nga auditimi rezultuan mangësi në fushën e prokurimeve, të lidhura me mungesën e dokumentimit të analizës së nevojave dhe mënyrës së përcaktimit të vlerës së parashikuar të prokurimit. Po ashtu, u konstatuan mangësi në dokumentimin e përlllogaritjes së fondit limit, në argumentimin teknik të kriterëve të kualifikimit në raport me natyrën e kontratës, përfshirë licencat profesionale dhe kriteret për stafin teknik dhe lidhjen e tyre me produktet sipas karakteristikave të paraqitura në skemat teknike apo raportet e testimit, si dhe në argumentimin e kërkesës për paraqitjen e mostrave. Në procesverbalin e rivlerësimit nuk ishin të dokumentuara arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik që ishte identifikuar fillimisht si fitues, ndërsa operatorët ekonomikë të shpallur fitues nuk përmbushnin kriteret e përcaktuara në dokumentacionin e tenderit. Në fazën e zbatimit të kontratave janë konstatuar pagesa për punime të pakryera në shumën prej 2,173 mijë lekë, shtyrje të afatit të punimeve, të cilat bazuar në arsyet e referuara, nuk përbëjnë rrethana të paparashikuara ose të panjohura për autoritetin kontraktor, si dhe janë përcaktuar afate te reja për përfundimin e punimeve të pashoqëruara me amendime kontrate. Në fushën e të ardhurave u konstatua mosarkëtim i energjisë elektrike të faturuar, pa u marrë të gjitha masat për arkëtimin e plotë përkatësisht për vitin 2023 në vlerën 27,682 mijë lekë dhe për vitin 2024 në vlerën 69,074 mijë lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e shoqërisë. Është konstatuar përdorim pa efektivitet i fondeve publike nga humbja e tre çështjeve gjyqësore në vlerën prej 4,930 mijë lekë, për largimet e padrejta nga puna të punonjësve, e cila përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shoqërisë.

Në KESH SHA, për projektin “Fuqia energjetike dhe siguria e digës në kaskadën e Drinit”

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2016 deri në 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se Marrëveshja e Nënhuasë nr. 7551/2, datë 06.01.2016, midis Ministrisë së Financave dhe KESH SHA, përcaktonte që detyrimet financiare të huasë, përfshirë principalin, interesin dhe komisionet, t'i kalonin KESH SHA. Megjithatë, ndërhyrjet në marrëveshjen e huasë sipas VKM nr. 405, datë 19.06.2019, të cilat parashikonin riskedulimin e kësteve, nuk janë reflektuar në Marrëveshjen e Nënhuasë, dhe KESH SHA nuk ka kryer asnjë pagesë ndaj Ministrisë së Financave për këtë hua, duke krijuar një detyrim të papaguar në vlerën prej 13,273,274 euro, Në lidhje me realizimin e procedurave të prokurimit, nga auditimi u konstatua se ofertat e operatorëve nuk janë protokolluar dhe nuk



dokumentohet koha e dorëzimit, pasi ato janë dorëzuar drejtpërdrejt tek Drejtori i Njesisë së Menaxhimit të Projektit. E njëjta problematikë u evidentua dhe në fazën e parakualifikimit. Vlerësimi teknik nga komisioni i vlerësimit është kryer me vonesë rreth 18 muaj pas dorëzimit të ofertave, duke shtyrë përzgjedhjen e konsulentit përtej afateve të projektit. Kontrata e konsulencës ka pësuar pesë ndryshime, duke rritur vlerën totale nga 372,700 euro në 1,526,204 euro dhe duke zgjatur afatin e saj nga 10+6 muaj në 96 muaj. Deri më 31.12.2024 janë kryer pagesa në shumën 1,508,581.26 euro, për të cilat nuk është kryer monitorim mbi përmbushjen e zërave të preventivit dhe nuk është hartuar ndonjë raport për këtë çështje. Po ashtu, për kontratën e konsulencës për periudhën 2019-2023 janë kryer pagesa për TVSH të rimbursueshme në shumën 11,673,731 lekë, bazuar vetëm në faturën me TVSH, pa disponuar dokumente justifikuese për deklarime dhe pagesën e saj. Nuk ka relacione që tregojnë praninë fizike dhe kohën e qëndrimit të stafit të huaj në Shqipëri, të nevojshme për të justifikuar shmangien nga taksimi i dyfishtë. Referuar pagesave të huasë, Ministria e Financave ka filluar pagesën e interesit në vitin 2018 dhe të principalit në vitin 2021. Deri më 31.12.2024, janë paguar 370,584 euro për interes, 12,307,692 euro për principal dhe 594,998 euro për komisione, të cilat janë likuiduar nga Ministria e Financave. Këto veprime tregojnë një moszbatim të plotë të Marrëveshjes së Nënhuasë nga ana e KESH SHA, duke krijuar kosto shtesë për buxhetin e shtetit.

Në KESH SHA, për projektin “Përmirësimi i sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit”

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2016 deri në 31.12.2024, KLSH ka evidentuar një sërë shkeljesh dhe mangësish në menaxhimin e KESH SHA lidhur me financimin, prokurimin, ekzekutimin dhe mirëmbajtjen e investimeve strategjike. Janë konstatuar shkelje të rregulloreve ligjore, statutore dhe kontraktuale, tejkallim i kompetencave, lidhje kontratash dhe kryerje pagesash pa miratim. Konkretisht, huaja e marrë nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD/IBRD) për përmirësimin e sigurisë së digave në HEC-in e Komanit dhe Fierzës nuk është shfrytëzuar plotësisht, dhe ka mbetura pa disbursuar vlera prej 6,128,224 euro. Afatet e saj janë shtyrë pa një plan të qartë të aprovuar nga Ministria e Financave. Procesi i prokurimit dhe lidhja e kontratave për rehabilitimin e portave të shkarkimit është kryer nga Njësia e Menaxhimit të Projekteve pa autorizim nga titullari i KESH SHA, duke tejkalluar kompetencat e përcaktuara në statutin dhe rregulloret e shoqërisë. Marrëveshjet dhe kontratat lidhur me projektin janë lidhur pa miratimin dhe ratifikimin përkatës nga Ministria e Financave dhe Parlamenti. Njësia e Menaxhimit të Projekteve ka miratuar pagesat e parapagimeve dhe faturave pa respektuar datat e kontratës, dokumentacionin e nevojshëm, dhe formatin e faturave sipas ligjit tatimor dhe procedurave të aprovuara nga Ministria e Financave. Procedurat për mirëmbajtjen dhe vlerësimin e aseteve të hidrocentraleve nuk janë formalizuar sipas rregulloreve aktuale dhe janë mbështetur në strategji dhe rregullore të viteve të mëparshme, duke mos vlerësuar rreziqet sistematike dhe ndryshimet mjedisore e klimaterike. Pagesat e kryera nga Ministria e Financave për huanë nga IBRD kanë filluar të kryhen me vonesë, ndërsa KESH SHA nuk ka përmbushur detyrimet e saj, duke mbartur detyrime të papaguara në vlerën prej 9,820,643 euro. Nga auditimi rezultoi se për shkak të zgjatjes së afatit të zbatimit të projektit, mosdisbursimit në kohë dhe jo sipas skedulit të parashikuar në marrëveshjen e financimit të huasë të fondeve të vendosura në dispozicion, Ministria e Financave ka paguar ndaj EBRD vlerën prej 316,624.52 euro, e cila është kosto shtesë për Ministrinë e Financave dhe KESH SHA.

Në Termocentralin Vlorë SHA

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga viti 01.01.2022 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor,



nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar konstatimeve në veprimtarinë e organeve drejtuese (Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori) kryesisht për sa i përket mbledhjeve, vendimmarrjes për situatën e shoqërisë, ku detyrimet gjithsej janë shumë më të larta se aktivet gjithsej, në vlerën prej 13,875,047 mijë lekë, të cilat nuk janë kontrolluar/inventarizuar për ekzistencën dhe vlerësimin e tyre nëpërmjet elementëve dhe dokumenteve kontabël përkatëse. Nga auditimi rezultuan mangësi në fushën e prokurimeve që lidhen me përcaktimin e kriterëve për kapacitetin ekonomik në kufi më të lartë se sa parashikon VKM-ja, përllogaritjen e fondit limit, vlerësimin e ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në drejtim të përmbushjes së kriterëve, si dhe mungesën në Njësinë e Prokurimit të specialistit të fushës përkatëse. Në fazën e zbatimit të kontratave janë konstatuar pagesa për shërbime dhe/ose punime të pakryera në shumën prej 409 mijë lekë, mangësi në procesin e marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, si dhe problematika në përdorimin e tyre gjatë veprimtarisë për konservimin e TEC-it, në kundërshtim me përcaktimet e manualeve operacionale. Është konstatuar përdorim pa efektivitet i fondeve publike në shoqëritë tregtare, konkretisht për dhënien e shpërblimeve të veçanta mbi pagë për punonjësit e shoqërisë, si dhe për pagesa që lidhen me procese gjyqësore në lidhje me shtesën e pagës prej 2% për vjetërsinë në punë, në shumën 32,447 mijë lekë.

Në Spitalin Rajonal Vlorë

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e aktivitetit nga viti 01.01.2021 deri më datën 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar mangësive të konstatuara në funksionimin e strukturave drejtuese dhe në procesin e vendimmarrjes së tyre. Problematikat kryesore të evidentuara lidhen me mungesën e mbledhjeve të Bordit Drejtues për zgjedhjen e Administratorit të Përgjithshëm, lirim nga detyra të zv/Drejtorit të shërbimeve administrative pas dorëheqjes së tij, mungesën e emërimeve nga Administratori i Përgjithshëm dhe mosfunksionimin e Ekipit Menaxhues, si dhe mungesën e një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si rezultat i mos hartimit të një kuadri të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Gjithashtu, janë konstatuar një numër i konsiderueshëm rishikimesh të buxhetit, duke kryer lëvizje fondesh ndërmjet zërave dhe duke shtuar projekte të reja gjatë vitit, si dhe mangësi në sistemimin e logarive kontabël, mos evidentim i vlerave të paarkëtueshme dhe planifikim jo real i nevojës për barna. Në procedurat e prokurimit janë konstatuar mangësi në përllogaritjen e fondit limit, e cila është kryer pa argumentim të plotë dhe duke u bazuar në çmime dhe artikuj që nuk pasqyrohen në kontratat apo referencat përkatëse; në procesin e përcaktimit të nevojave për materiale e pa mbështetur në një analizë të detajuar dhe të dokumentuar; në hartimin e kriterëve të kualifikimit, në veçanti për përcaktimin e përqindjes së punëve të ngjashme dhe të xhiros vjetore, konstatohet mungesë argumentimi, mungesë argumentimi apo analize për nevojën e numrit të punonjësve, si dhe aplikimi i kriterëve të panevojshme dhe jashtë objektit të kontratës. Në disa raste janë shpallur fitues operatorë ekonomikë me mangësi në plotësimin e kriterëve të kualifikimit. Gjithashtu u konstatua dokumentim formal i hapave të ndjekur për realizimin e këtyre procedurave, duke mos argumentuar përzgjedhjen e llojit të procedurës apo përcaktimin e afatit dyvjeçar të kontratave, etj. Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël u konstatua copëzim fondi, duke shmangur procedurat standarde të prokurimit. Janë konstatuar efekte negative në përdorimin e fondeve buxhetore në vlerën 1,097 mijë lekë, si pasojë e aplikimit të shtesave mbi pagë në mënyrë të parregullt, si dhe raste të aplikimit të shtesës për kushte të vështira pune në mungesë të dokumentacionit ligjor përkatës.



Në Spitalin Rajonal Shkodër

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 30.06.2025, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar konstatimeve në veprimtarinë e organeve drejtuese (Bordit drejtues, Administratorit dhe Komisionit mjekësor) kryesisht për sa i përket ushtrimit të detyrave dhe funksioneve lidhur me mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimtarisë së spitalit, miratimit të statutit, rregulloreve ekonomiko - financiare, procesit të planifikimit të nevojave për fonde në tërësi, në veçanti për barnat dhe materialet mjekësore, i cili kryhet në mungesë të një procedure të standartizuar, pa një analizë të detajuar. Nga auditimi rezultuan mangësi në fushën e prokurimeve sa i takon kriterëve të kualifikimit për kapacitetin ekonomik, përlllogaritjen e fondit limit, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në drejtim të përmbushjes së kriterëve, si dhe mungesë të specialistit të fushës përkatëse në përbërje të komisioneve. Në fazën e zbatimit të kontratave janë konstatuar pagesa për shërbime dhe/ose punime të pakryera në shumën prej 1,093 mijë lekë, punime civile me shtyrje afati të pabazuar, si dhe mangësi në procesin e marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve. Janë konstatuar përdorim pa efektivitet të fondeve publike në vlerë totale 2,101 mijë lekë, në fushën e prokurimeve në përlllogaritjen e fondit limit, për procese gjyqësore në lidhje me marrëdhëniet e punës, si dhe aplikimi i penaliteteve për shkak të deklarimit të vonuar të detyrimeve tatimore.

Në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura Tiranë dhe Administratën e Zonave Rajonale Berat, Kukës, Vlorë

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën nga data 03.04.2021 deri në datën 30.09.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura, nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**. Nga auditimi i rezultoi se proceset inspektuese nuk janë zbatuar në mënyrë të plotë dhe të dokumentuar, si dhe rezultuan problematika në arkëtimin e detyrimeve të konstatuara gjatë inspektimeve. Për 45 zona të mbrojtura, vetëm 14 plane menaxhimi (31% e totalit) janë aktualisht në fuqi, ku 4 prej tyre kanë kaluar afatin 10-vjeçar të vlefshmërisë, në shkelje të detyrimeve ligjore. Zonat nuk janë të regjistruara në zyrat vendore të kadastrës dhe nuk janë ngritur grupe pune për krijimin e fondit të përbashkët të sipërfaqeve të mbrojtura në shkallë qarku dhe republike, duke penguar vlerësimin e gjendjes reale të infrastrukturës mjedisore. Dokumentacioni i inspektimeve nuk është mbajtur në mënyrë të plotë dhe të verifikueshme, duke kufizuar kontrollin dhe vlerësimin e gjendjes reale të zonave të mbrojtura. Nga auditimi u evidentuan parregullsi në procedurat e lidhjes dhe administrimit të kontratave të qirasë për përdorimin e sipërfaqeve në zonat e mbrojtura, përfshirë mangësi në dokumentacion, në klasifikimin e aktiviteteve dhe përcaktimin e vlerës së qirasë, si dhe llogaritje të pasakta. Në një rast, u evidentua llogaritje e gabuar në ndarjen e sipërfaqes sipas planit të zhvillimit dhe projektit teknik, duke sjellë një diferencë në vlerën 1,472 mijë lekë. Gjithashtu u konstatuan ndërtime dhe aktivitete informale të pandjekura me masa të mëtjeshme nga institucionet përgjegjëse, duke reflektuar dobësi në ndjekjen dhe zbatimin e kuadrit ligjor. Problematika janë konstatuar edhe në drejtim të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, mbajtjes së rregullt të dokumentacionit kontabël, procedurat e inventarizimit, në pasqyrimin e saktë të llogarive në Pasqyrat Financiare Vjetore, përdorimit të përshtatshëm të të ardhurave të gjeneruara nga zonat e mbrojtura, proceset e hartimit të kriterëve të argumentuara në procedurat e prokurimit të zhvilluara, etj. Në procedurat e prokurimit u konstatua skualifikim i padrejtë i operatorëve ekonomikë. Në vlerësimin e ofertave, u konstatua se nuk janë vlerësuar drejt operatorët ekonomik pjesëmarrëse në garë, duke sjellë për pasojë kryerjen e shërbimit me një vlerë me të lartë ekonomike në vlerën 600 mijë lekë. Nga auditimi i zbatimit të kontratave u konstatuan pasaktësi me përfitim të padrejtë të sipërmarrësit të punimeve, për punime të pakryera në vlerën 2,901 mijë. Nga auditimi u evidentuan mangësi në kontabilizimin dhe arkëtimin e



detyrimeve të konstatuara nga inspektimet, si dhe mosndjekje e detyrimeve kontraktuale nga subjektet, të reflektuara në detyrime të papaguara dhe të pa kontabilizuara nga kontratat e qirasë. Gjithashtu rezultuan detyrime të papaguara dhe të pa kontabilizuara në vlerën 990,397 mijë lekë.

Në Bashkinë Tiranë dhe në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, mbi ndotjen e Liqenit Artificial të Tiranës

Nga *auditimi tematik* u konstatua se mungonte një sistem qarkullues uji, por liqeni furnizohet vetëm me prurjen natyrore (ujërat e shirave). Bashkia Tiranë dhe institucionet e varësisë nuk disponojnë një hartë/plan shtrirje të rrjetit/sistemit të kanaleve të ujërave të shiut, të cilat derdhen në liqen. Territori i parkut nuk mbulohet nga rrjeti i kanalizimit, rrjedhimisht subjektet që operojnë brenda territorit të tij e zgjidhin individualisht largimin e ujërave të ndotura urbane. UKT dhe institucionet e tjera të varësisë së Bashkisë Tiranë nuk kanë informacion mbi mënyrën e largimit të ujërave të ndotura urbane nga ana e tyre. Mungojnë evidencat të sakta mbi numrin e subjekteve, të cilat operojnë në zonën brenda territorit të Liqenit të Tiranës. Në lidhje me ndotjen e shfaqur në liqen nuk janë kryer asnjëherë analiza mikrobiologjike, por vetëm analiza fiziko-kimike. Edhe pse nga strukturat shtetërore është evidentuar që në muajin tetor 2024 se në Liqenin Artificial të Tiranës ka shkarkime të ujërave të ndotura urbane të patrajtuara, aktualisht përveç korrespondencave shkresore, nuk janë marrë masa konkrete për evidentimin e shkaqeve dhe shkaktarëve të ndotjes, marrjen e masave për ndërprerjen e menjëhershme të shkaqeve që shkaktojnë ndotje, si dhe përmirësimin e situatës mjedisore në liqenin artificial të Tiranës. Bashkëpunimi ndërinstitucional për zgjidhjen e problematikës nuk ka funksionuar, fakt i shprehur edhe nga vetë strukturat e APR gjatë auditimit. Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, në asnjë rast, nuk ka evidentuar problematika që mund të shkaktonin ndotje dhe nuk ka kërkuar bashkëpunim nga strukturat e qeverisjes qendrore për analizimin e cilësisë së ujit në liqenin e Tiranës, përpara shfaqjes në sipërfaqe të ndotjes dhe marrjes së vëmendjes mediatike të situatës. Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit ka shpenzuar 10,665 mijë lekë për pastrimin e basenit të Liqenit Artificial të Tiranës, i cili ka konsistuar vetëm në pastrim mekanik, pra heqjen e plastikave nga sipërfaqja e liqenit, e bimësisë së tepërt, etj., por jo lidhur me reduktimin/eliminimin e elementëve që shkaktojnë ndotje në ujin e liqenit, të cilët janë në nivele të larta. Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka përbushur detyrimin e monitorimit të treguesve të cilësisë së ujit në Liqenin Artificial të Tiranës, edhe pse ky stacion është i përfshirë në rrjetin e stacioneve të monitorimit, në Programet Kombëtare të Monitorimit të Mjedisit.

Në Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2024, KLSH ka konstatuar se veprimtaria e subjektit të audituar ka devijime materiale por jo të përhapura, nga kuadri ligjor dhe rregullator, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**. Procesi i rikuperimit të eshtrave të personave të zhdukur ose të ekzekutuar gjatë periudhës 29 nëntor 1944 – 2 korrik 1991 nuk kishte filluar, për shkak të mosfinalizimit nga Këshilli i Ministrave të bazës së nevojshme nënligjore që do të përcaktonte rregullat dhe procedurat për gjetjen, identifikimin dhe rikuperimin e tyre. U konstatuan mangësi në funksionimin e strukturave këshillimore të institucionit, pasi për aktivitetin e Bordit të Miqve dhe Këshillit Shkencor nuk evidentohet gjurmë auditimi apo dokumentim mbi veprimtaritë e zhvilluara dhe kontributin e tyre në mbështetje të proceseve vendimmarrëse dhe veprimtarive shkencore të Autoritetit. Databaza mbi dokumentimin e vendimmarrjes së Autoritetit paraqiste mangësi në klasifikimin e vendimeve, sipas një kriteri të standardizuar. Në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit u konstatuan raste të likuidimeve të kryera përtej afatit ligjor, mangësi në administrimin dhe arkivimin e dokumentacionit të procedurave



të prokurimit, si dhe problematika në procesin e planifikimit dhe dokumentimit të tyre. Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik, u evidentuan vendosje të kriterëve të paargumentuara ose të formuluara në mënyrë të tillë që kufizonin konkurrencën, kualifikim, si dhe shpallje fitues të operatorëve ekonomikë në kushtet e dokumentacionit të paplotë. Gjithashtu, rezultoi mungesë dokumentimi në dosjet e prokurimit, si dhe mosrespektim i procedurave gjatë administrimit të kontratave. Në aspektin organizativ dhe të menaxhimit të burimeve njerëzore u konstatuan mangësi në administrimin e dosjeve të personelit dhe mosplotësim i plotë i të dhënave në sistemin elektronik të menaxhimit të burimeve njerëzore. Sistemi për arkivimin digjital të dosjeve dhe dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit nuk ka funksionuar në mënyrë efektive, pasi nuk ka gjeneruar raporte të strukturuar dhe të përdorshme për qëllime institucionale, si rezultat i mospopullimit të plotë me dokumentacionin e nevojshëm. Gjithashtu, nga auditimi rezultoi dëm ekonomik në vlerën 2,264 mijë lekë, për shkak të mosaplikimit të penalteteve për vonesa në zbatimin e kontratave dhe shtyrjes së afatit të dorëzimit, përmes një aneks kontrate të lidhur jashtë afatit kontraktual; si dhe efekte negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet në vlerën 2,880 mijë lekë, si rezultat i funksionimit të pjesshëm të sistemit të arkivës digjitale, mungesës së popullimit të tij me dokumentacionin përkatës dhe dokumentimit të paplotë të shërbimeve të mirëmbajtjes, përfshirë mungesën e nënshkrimeve dhe konfirmimeve nga strukturat përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.

Në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**. Nga auditimi rezultoi se proceset e planifikimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit, kanë paraqitur dobësi në drejtim të mirë planifikimit, tejkalimeve në realizimin e treguesve të veçantë buxhetorë, mungesë monitorimesh periodike, si dhe lëvizje të shpeshta buxhetore përgjatë vitit. Janë evidentuar problematika, sa i përket qëndrueshmërisë së stafit policor në detyrë dhe plotësimin e vendeve vakante, pasi niveli i ndryshimeve në stafin drejtues dhe atë policor ka përbërë rreth 50% të gjithë organikës institucionale. U konstatua moslikuidim në kohë i pagesave shtesë dhe përfitimeve të tjera të punonjësve, duke sjellë akumulimin e tyre në fund të vitit. U konstatua se 39 punonjës policie nga 95 pozicione pune gjithsej nuk janë pajisur ende me Certifikatat e Sigurisë së Personelit (CSP), ndonëse e kanë këtë detyrim sipas kërkesave përkatëse. Nga auditimi u evidentuan problematika në fushën e kompetencave të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit në drejtim të garantimit të burimeve dhe mekanizmave të nevojshëm për përmbushjen e objektivave institucionale nga institucioni vartës. Nga auditimi u konstatuan mangësi në përmbushjen e plotë të rekomandimeve të dhëna nga njësitë e auditimit të brendshëm të institucioneve eprore, në kryerjen e inventarizimit periodik të pasurisë shtetërore, si dhe në procedurat lidhur me marrjen në dorëzim të automjeteve të dhuruara dhe në aspekte të tjera të veprimtarisë institucionale. Gjithashtu, kanë munguar mekanizmat efektivë për ndjekjen dhe arkëtimin e gjobave brenda afateve ligjore të parashikuara, pasi janë parashkruar 9,792 gjoba në vlerën gjithsej prej 39,579 mijë lekë, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

Në Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit Fier

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri në datën 30.06.2025, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar konstatimeve mbi veprimtarinë e institucionit, veçanërisht për sa i përket mungesës së një



parashikimi të qartë të punimeve, verifikimeve dhe grafikut të tyre në planet e veprimit për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të ujitjes, kullimit, mbrojtjes nga përmbytjet, digave, hidrovoreve dhe makinerisë së rëndë. Informacionet e sektorëve për ndjekjen e punimeve dhe mirëmbajtjeve ishin të përgjithshme, pa specifikime dhe detaje teknike, si dhe pa përpilimin e akteve të kontrollit. Nga auditimi rezultuan mangësi në fushën e prokurimeve që lidhen me mungesën e argumentimit teknike të kriterëve, mospërputhje midis nivelit të licencave të kërkuara dhe vlerës së zërave të punimeve në preventiv, si dhe moskryerja e oponencës teknike të projekteve të zbatimit. Nga auditimi i zbatimit të punimeve, kanë rezultuar punime të pakryera në volumet e situacionuara, në vlerën 1,161 mijë lekë.

Në Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri në datën 30.06.2025, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar konstatimeve në veprimtarinë e institucionit, kryesisht për sa i përket mos hartimit të gjurmës së auditimit për procedurat që lidhen me veprimtaritë kryesore në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si dhe mosregjistrimi në ASHK i aseteve të transferuara nga ish-Bordet e Kullimit. Gjithashtu, u konstatuan mangësi në hartimin nga grupet e punës të akteve të kontrollit për dokumentimin e situatës së konstatuar gjatë inspektimeve dhe kontrolleve në terren mbi gjendjen e objekteve të infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet. Nga auditimi rezultuan mangësi në fushën e prokurimeve që lidhen me mungesën e argumentimit teknike të kriterëve. Nga auditimi i zbatimit të punimeve, kanë rezultuar punime të pakryera në volumet e situacionuara, në vlerën 1,546 mijë lekë.

Në Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit Korçë

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 01.10.2025, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar konstatimeve në ngritjen dhe funksionimin e grupit për menaxhimin strategjik, grupit për menaxhimin dhe koordinimin e riskut, në zbatimin e rregullave dhe kriterëve teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit; dokumentimit të realizimit të inspektimeve dhe të raportimit të tyre mbi gjendjen e veprave ujitëse/kulluese, në regjistrimin e pronave, procesin e inventarizimit. Gjithashtu është konstatuar dëm ekonomik në administrimin e shpenzimeve të karburantit dhe të shpenzimeve për udhëtim e dieta brenda vendit në vlerën gjithsej prej 1,192 mijë lekë. Nga auditimi rezultuan mangësi në fushën e prokurimeve sa i takon planifikimit të nevojave për mallra, përfshirjen në strukturat e prokurimit të nëpunësit zbatues, përcaktimin e kriterëve të kualifikimit për kapacitetin ekonomik, përlllogaritjen e fondit limit, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, me efekt financiar në vlerën 2,092 mijë lekë. Në fazën e zbatimit të kontratave janë konstatuar pagesa për shërbime dhe punime të pakryera në shumën prej 783 mijë lekë, si dhe mangësi në procesin e marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve.

Në Rezidencën Studentore Universitare (RSU Nr.2)

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri në 01.10.2025, nuk janë evidentuar devijime materiale nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilin është konkluduar me dhënien e një **opinionit të pakualifikuar**. Megjithatë, u konstatuan disa devijime jo materiale në fushën e prokurimeve publike dhe administrimit të aktiveve, të lidhura kryesisht me dokumentimin e procedurave, si dhe me përcaktimin e kriterëve të kualifikimit. Është konstatuar përdorim pa efektivitet i fondeve



publike për pagesa që lidhen me procese gjyqësore në lidhje largimet e padrejta nga puna të punonjësve, në shumën 115 mijë lekë.

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura, nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**. Realizimi neto i të ardhurave doganore në vitin 2024 paraqitej më i ulët se plani i rishikuar dhe ai fillestar, kryesisht për shkak të mosrealizimit të të ardhurave nga TVSH-ja në import, renta minerare, akciza dhe taksa doganore. Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik u evidentuan problematika në hartimin e kriterëve në dokumentet standarde të tenderit nga njësia e prokurimit, si dhe në vlerësimin e kryer nga anëtarët e KVO-së. Gjatë procesit të hartimit të kriterëve të vlerësimit nuk ishte marrë në konsideratë rëndësia e mallrave objekt prokurimi, për produkte që lidhen drejtpërdrejt me sigurinë e mbikëqyrjes së mallrave dhe mjeteve në deklarim në territorin doganor në RSH, si dhe me procesin e mostrimit. Nga auditimi i procedurave të kontrollit u konstatuan mangësi në administrimin e dokumentacionit dhe në verifikimin e kundërvajtjeve administrative në fushën e akcizës, duke përfshirë plotësimin e kërkesave të procesverbalit, evidentimin e treguesve për sekuestrimin ose konfiskimin e mundshëm të mallrave. Kontrollat e ushtruara nga Drejtoria e Antikontrabandës nuk ishin finalizuar me aplikimin e plotë të masave ndëshkuese sipas kuadrit ligjor në fuqi për shkeljet e konstatuara, duke u trajtuar si kundërvajtje doganore të kryera në neglizhencë, me efekt në mosaplikim të plotë të masave ndëshkuese sipas kuadrit ligjor në fuqi. Nga auditimi u konstatuan mangësi në procedurat e mostrimit, transportimit, pranimit, ruajtjes dhe administrimit të mostrave, si dhe në hartimin e certifikatave për klasifikimin tarifor, pasi mostrimi 100% i karburanteve në eksport kishte bërë të pamundur mbylljen brenda afateve, ndërkohë që mungesa e një profili efektiv risku kishte sjellë vonesa në certifikimin tarifor, rrezik për tejkalimin e afatit të rishikimit aposterior dhe vështirësi në gjurmimin e shkeljeve doganore. Gjithashtu, rezultuan deklarime për mallra me qëllim përjashtimin nga detyrimet doganore të TVSH-së, për të cilat nuk ishin kryer verifikime të subjekteve deklaruese për të evidentuar përputhshmërinë faktike të gjendjes fizike të mallrave të përjashtuara me autorizimet përkatëse në funksion të realizimit të investimit. Autorizimet për përjashtim nga TVSH-ja rezultuan të pa mbështetura me dokumentacion të plotë lidhur me elementë thelbësorë, përfshirë planet e detajuara të biznesit, afatet e investimit, kodet tarifore të mallrave, dokumentacionin e pronësisë, planimetrinë, të dhënat mbi makineritë, si dhe lejet dhe licencat përkatëse nga institucionet kompetente. Nga auditimi u konstatuan të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën totale 1,884 mijë lekë, si rezultat i mangësive të konstatuara gjatë llogaritjes së detyrimeve dhe gjobave doganore për diferenca sasiore të konstatuara, mangësive në administrimin e dokumentacionit të praktikave të kontrollit të realizuar nga strukturat përgjegjëse të antikontrabandës dhe akcizës.

Gjatë auditimit të procedurave doganore të importuara dhe eksportuara nga vende të BE-së dhe CEFTA, u konstatua se dokumentacioni tregtar nuk përmbante në të gjitha rastet Certifikata Origjine Malli ose EUR-1 dhe nuk jepte informacion të detajuar për çdo produkt, duke mos u specifikuar kodi tarifor, peshat individuale ose karakteristikat teknike të mallrave.. Në rastin e mallrave të natyrës qumësht, hurrë dhe qumësht pluhur për prodhim, mungonin të dhënat mbi sasinë dhe karakteristikat teknike, me impakt në të ardhurat nga taksat kombëtare. Nuk ishin dokumentuar veprimet e administratës doganore në lidhje me verifikimin e procesit të prodhimit, sasive faktike të mallrave dhe përdorimit të kartave teknologjike të certifikuara nga laboratorë të akredituar. Për mallrat e natyrës lëndë djegëse (qymyr dhe bitume), deklarimi i pagesës nuk përputhej me klasifikimin tarifor dhe me karakteristikat reale të mallrave, me impakt në keqklasifikim dhe përlllogaritje të pagesave të taksave kombëtare, përfshirë TAM-in. Nuk ishin kryer verifikime laboratorike të akredituara që



të vërtetonin përbërjen, përqindjen e karbonit, përqindjen e bitumit natyral, fuqinë kalorifike dhe cilësinë e mallrave të eksportuara. Auditimi evidentoi mangësi në procedurat për vlerësimin doganor të mallrave. Nuk ishin kryer verifikime të faturave, origjinës së mallrave ose çmimeve të deklaruara, duke sjellë mungesë të kontrollit mbi vlerën doganore dhe riskun e deklarimeve të pasakta. Nga ana e administratës, nuk ishte përditësuar dokumentacioni i të dhënave dhe nuk kishte bashkëpunim të mjaftueshëm mes degëve doganore dhe drejtorisë së vlerësimit në qendër për procesin e importit, përfshirë rritjet e çmimeve në materialet ose lëndët e para në treg. Nga auditimi u konstatuan të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit dhe efekte negative në administrimin e fondeve publike me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet, në vlerën totale prej 5,723,728 mijë lekë, si rezultat i deklarimeve të pasakta të mallrave, trajtimit të çmimeve nën vlerën e lëndës së parë, keqklasifikimeve tarifore, përlogaritjes së pasaktë së taksave kombëtare, mungesës së verifikimeve teknike dhe laboratorike, si dhe mungesës së verifikimit dhe dokumentimit të veprimeve të administratës doganore lidhur me procedurat e përjashtimit nga TVSH-ja.

Në Degën Doganore Durrës

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën nga data 01.07.2022 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura, nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**. Nga auditimi u konstatuan mangësi dhe parregullsi në procedurat doganore të importit, me efekte financiare negative në të ardhurat e buxhetit të shtetit dhe dëm ekonomik në vlerën totale prej 1,797,334 mijë lekë, objekt ndjekjeje nga autoriteti doganor në trajtën e detyrimit doganor dhe sanksioneve respektive, të lidhura me mosaplikimin e saktë të elementëve të vlerësimit doganor, klasifikime tarifore jo në përputhje me nomenklaturën e mallrave, me pasojë rrillogaritjen e detyrimeve doganore dhe penaltiteteve përkatëse. Nga auditimi u konstatuan parregullsi në zbatimin dhe administrimin e regjimeve doganore, përfshirë diferenca në gjendjet e mallrave, tejkalim të afateve autorizuese, mosrespektim të kërkesave procedurale lidhur me regjimin e transitit dhe afatet e mbërritjes së mallrave në doganën e destinacionit, si dhe mospërputhje ndërmjet treguesve të deklaruar dhe statusit aktual doganor të mallrave në sistemet përkatëse. Po ashtu, u evidentuan problematika në trajtimin fiskal të disa kategorive mallrash dhe në ndjekjen e destinacionit të përdorimit të produkteve energjetike dhe të artikujve ambalazhues, si dhe gjatë operacioneve të shkarkimit dhe administrimit të mallrave në zonën e lirë Porto Romano, përfshirë tejkalim të normativave të firove dhe humbjeve, mospërputhje ndërmjet çmimeve të deklaruara në hyrje dhe çmimeve të shitjes në dalje nga zona e lirë, si dhe mangësi në monitorimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë që operojnë në këtë zonë.

Në Degën Doganore Rinas

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer pranë Degës Doganore Rinas për periudhën 01.01.2022–31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura, nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**. Nga auditimi u konstatuan mangësi dhe parregullsi në procedurat doganore të importit, të lidhura me mosaplikimin e saktë të elementëve të vlerësimit doganor, klasifikime tarifore jo në përputhje me nomenklaturën e mallrave, duke rezultuar me efekte financiare negative në të ardhurat e buxhetit të shtetit në vlerën totale prej rreth 46,746 mijë lekë, objekt ndjekjeje nga autoriteti doganor në trajtën e detyrimit doganor dhe sanksioneve respektive. Janë konstatuar parregullsi në administrimin e procedurave doganore, përfshirë trajtime jo të njëjta për raste të ngjashme, aplikim jo i duhur të metodës së vlerës së transaksionit dhe mospërputhje në vlerësimin e mallrave të përdorura. Janë evidentuar mangësi në administrimin dhe mbledhjen e të ardhurave doganore, përfshirë mosllogaritjen e saktë të



kamatëvonesave dhe ndjekjen e borxhit doganor. Po ashtu, janë evidentuar problematika në vendimmarrjen administrative dhe në autorizimet për magazinat fiskale dhe regjimet e veçanta doganore, raste të vlerësimit të pasaktë dhe klasifikimit tarifor, veçanërisht për mallrat e kapitullit 85, si dhe dobësi në trajtimin e shkeljeve doganore dhe në vendosjen e sanksioneve përkatëse.

Në Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura, nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**. Në raportet e kontrollit janë evidentuar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit, të evidentuara paraprakisht në vlerën 496,134 mijë lekë, të cilat lidhen me trajtimin e parregullt fiskal të punimeve ndërtimore të faturuara si shitje të përjashtuara nga TVSH-ja përpara miratimit dhe dhënies së autorizimit për përjashtim nga TVSH-ja nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, mosanalizimin dhe mospasqyrimin e diferencave të pajustificuara në inventarin fizik në raportet tatimore, raste të moskreditimit të TVSH-së, si dhe me raporte të larta të marzheve ndërmjet blerjeve dhe shitjeve të përjashtuara nga TVSH-ja, veçanërisht për subjektet e përfshira në procesin e rindërtimit, duke mbartur risk për përfitime të padrejta nga TVSH-ja. Në raportet e kontrollit në vend janë evidentuar detyrime financiare të paargumentuara të shoqërive ndaj ortakëve, si dhe mangësi në procesin e monitorimit dhe mbikëqyrjes së të ardhurave tatimore, të lidhura me mosndjekjen e plotë të subjekteve me diferenca të konstatuara në deklarin e TVSH-së në dogana, krahasuar me deklarinet në sistemin C@TS Tatime. Nga auditimi u evidentuan mangësi në analizën dhe ndjekjen e subjekteve me humbje të njëpasnjëshme, si dhe në administrimin dhe monitorimin e akt-marrëveshjeve për pagesën me këste të detyrimeve tatimore. Gjithashtu, u konstatuan mangësi në monitorimin e subjekteve të përfshira në procesin e rindërtimit, në administrimin e bazës së të dhënave të subjekteve me detyrime apo deklarime të paplota, si dhe parregullsi procedurale në respektimin e afateve administrative gjatë procesit të kontrollit tatimor. Në të njëjtën kohë, u evidentuan mangësi në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe në plotësimin e strukturës organizative, të reflektuara në numër të konsiderueshëm vendesh vakante dhe transferimeve të përkohshme të personelit, me ndikim të drejtpërdrejtë në performancën e funksioneve të administratës tatimore.

Në Drejtorinë Rajonale Tatimore Elbasan

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën nga data 01.07.2022 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura, nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**. Në raportet e kontrollit janë evidentuar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit, të evidentuara paraprakisht në vlerën 48,330 mijë lekë, si pasojë e parregullsisë të lidhura me shitje nën koston e blerjes, shitje dukshëm poshtë çmimeve të tregut, diferenca të pajustificuara në inventar të trajtuara si shitje ose blerje pa faturë tatimore, kreditim i gabuar i TVSH-së së karburantit, shitje të njërive ndërtimore nën çmimin e referencës, si dhe njohje e shpenzimeve të interesit si shpenzime të zbritshme në kushtet kur shoqëria ka kryer huadhënie ndaj ortakëve ose subjekteve të lidhura pa aplikuar norma interesi në përputhje me parimet e tregut, etj. U evidentuan raste të detyrimeve financiare të shoqërisë ndaj ortakëve të pa analizuara dhe të pa argumentuara në mënyrë të mjaftueshme. Po ashtu, nga auditimi u konstatuan mangësi në procesin e monitorimit dhe administrimit të të ardhurave tatimore, të lidhura me mosaplikimin e penalteteve për pagesat me vonesë të kësteve të tatimit mbi fitimin, mangësi në ndjekjen dhe menaxhimin e akt-marrëveshjeve për pagesën me këste të detyrimeve tatimore, mosndjekje të plotë të subjekteve me humbje të



njëpasnjëshme, si dhe mangësi në verifikimin dhe ndjekjen e subjekteve me diferenca në deklarinë e TVSH-së në dogana, krahasuar me deklarinët e tyre në sistemin C@TS Tatime.

Në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim

Nga auditimi i përputhshmërisë i kryer për periudhën e veprimtarisë nga fillimi i krijimit të Agjencisë deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar konstatimeve mbi mangësitë në funksionimin e disa komponentëve të procesit të shpronësimit të pronave për interes publik. Nga auditimi i praktikave të shpronësimit janë konstatuar mospërputhje ndërmjet sipërfaqeve të miratuara për shpronësim dhe atyre sipas projektit (fileve DWG dhe dokumentacionit të miratuar), duke ndikuar në rritjen e sipërfaqes së prekur dhe rrjedhimisht në rritjen e vlerës së shpronësimit, me një efekt financiar në buxhetin e shtetit në vlerën 32,296 mijë lekë. Gjithashtu, në listat e pasurive të paluajtshme janë përfshirë në mënyrë të pajustificuar sipërfaqe të plota trualli dhe objekte, edhe në rastet kur nga projekti është prekur vetëm një pjesë e truallit dhe jo objektet, të cilat nuk janë prishur. Kjo ka sjellë mbivlerësim të sipërfaqeve dhe të objekteve të paprekura, duke rritur artificialisht vlerën totale të shpronësimit dhe duke çuar në likuidime në mungesë të ndërhyrjeve faktike. U konstatua se nuk janë respektuar kriteret e vlerësimit për marrjen e masave parandaluese ndaj dëmit ekonomik, duke rezultuar edhe në vendime gjyqësore në favor të subjekteve të shpronësuara, me një efekt financiar në vlerën 560,230 mijë lekë. Po ashtu, janë evidentuar mungesa të rregullave të detajuara për negocimin nga ASHSH me subjektet e shpronësuara, duke cenuar garancitë ligjore për pronarët, si dhe vonesa të pajustificuara në plotësimin e dokumentacionit nga subjektet kërkuese. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se në dosjet e projekteve mungojnë të dhëna mbi hapat e ndjekur për likuidimin e pronarëve, duke krijuar paqartësi mbi ecurinë e pagesave dhe duke rritur riskun për pavlefshmëri të proceseve të shpronësimit. Gjithashtu, në relacionet shpjeguese dhe akt-marrëveshjet nuk janë përcaktuar afatet për fillimin dhe përfundimin e procesit të shpronësimit dhe të punimeve. Në disa raste nuk është respektuar afati ligjor 10-ditor për njoftimin e subjekteve të prekura, ndërsa nuk evidentohet përcjellja e vendimeve të Këshillit të Ministrave në ASHK për reflektimin e ndryshimeve në regjistrat dhe hartat kadastrale. Procesverbalet e Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit nuk janë hartuar dhe administruar në përputhje me kërkesat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, duke mos përmbushur standardet për dokumentet zyrtare.

Në Bashkinë Berat

Nga auditimi i përputhshmërisë i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar konstatimeve në lidhje me mungesën e një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si rezultat i mos hartimit të një kuadri të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim, dhe mos marrjen e masave dhe mekanizmave të nevojshëm për reduktimin e detyrimeve të prapambetura, me pasojë krijimin e detyrimeve të reja. Nga auditimi u konstatuan mangësi në fushën e prokurimeve publike, lidhur me hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, të cilat nuk rezultojnë të jenë ngushtësisht të lidhura dhe proporcionale me natyrën dhe përmasën e kontratës. Gjithashtu, në disa raste janë kualifikuar, shpallur fitues dhe janë lidhur kontrata me operatorë ekonomikë që nuk plotësonin kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në fazën e zbatimit të kontratave janë konstatuar pagesa për punime të pakryera në shumën 3,895 mijë lekë pa TVSH, si dhe mungesë e kryerjes së oponencës teknike. Në fushën e të ardhurave është konstatuar mos marrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një vlerë



e pa arkëtuar prej 219,145 mijë lekë, prej të cilave vlera 26,878 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2024, nga mospagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat. Është konstatuar përdorim pa efektivitet të fondeve publike për pagesa që lidhen me procese gjyqësore në lidhje me largimet e padrejta nga puna të punonjësve, në shumën 9,193 mijë lekë. Nga auditimi u konstatuan mangësi në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, të lidhura me mosrespektimin e kushteve urbane, përfshirë distancat nga kufijtë e pronës dhe intensitetin maksimal të lejuar të ndërtimit. Gjithashtu, u evidentuan raste kur parcelat e vendosura në funksion të zhvillimit të objektit nuk kanë lidhje fizike ndërmjet tyre, si dhe raste kur dokumentacioni teknik dhe ai shoqëruar i projektit ndërtimor rezultoi i paplotë, në kundërshtim me përcaktimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në fushën e administrimit dhe regjistrimit të aseteve u konstatua mungesë inventarizimi dhe përditësimi për asetet e transferuara me VKM. Në fushën e organizimit dhe funksionimit të Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore u konstatua se nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e urdhrat të ekzekutimit për prishjen e ndërtimeve të paligjshme dhe nuk janë vijuar me procedurat e mëtejshme ligjore.

Në Bashkinë Dimal

Nga auditimi i përputhshmërisë i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar konstatimeve në lidhje me mungesën e një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si rezultat i mos hartimit të një kuadri të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim, dhe mos marrjen e masave dhe mekanizmave të nevojshëm për reduktimin e detyrimeve të prapambetura, me pasojë krijimin e detyrimeve të reja. Nga auditimi u konstatuan mangësi në fushën e prokurimeve publike, lidhur me hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, të cilat nuk rezultojnë të jenë ngushtësisht të lidhura dhe proporcionale me natyrën dhe përmasën e kontratës. Gjithashtu, në disa raste janë kualifikuar, shpallur fitues dhe janë lidhur kontrata me operatorë ekonomikë që nuk plotësonin kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në fazën e zbatimit të kontratave janë konstatuar pagesa për punime të pakryera në shumën 3,803 mijë lekë pa TVSH, si dhe mungesë e kryerjes së oponencës teknike. Në fushën e të ardhurave u konstatuan mangësi në arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një shumë e paarkëtuar prej 309,907 mijë lekë, prej të cilave vlera 23,191 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2023-2024, kryesisht nga mospagesa e taksapaguesve familjarë dhe privatë. Nga auditimi u konstatua se në administrimin e kontratave të qiradhënies ndaj subjekteve private nuk janë ndërmarrë masa të plota për ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimeve debitore, si pasojë e së cilës në datën 31.12.2024 rezultoi një vlerë e paarkëtuar prej 14,439 mijë lekë. Nga auditimi u konstatuan mangësi në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, të lidhura me mosrespektimin e kushteve urbane, përfshirë distancat nga kufijtë e pronës dhe intensitetin maksimal të lejuar të ndërtimit, vendosjen në funksion të zhvillimit të objektit të parcelave pa lidhje fizike ndërmjet tyre, si dhe paraqitjen e dokumentacionit teknik dhe atij shoqëruar të projektit ndërtimor jo të plotë, në kundërshtim me përcaktimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në fushën e administrimit dhe regjistrimit të aseteve u konstatua mungesë inventarizimi dhe përditësimi për asetet e transferuara me VKM. Në fushën e organizimit dhe funksionimit të Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore u konstatua se nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e urdhrat të ekzekutimit për prishjen e ndërtimeve të paligjshme dhe nuk janë vijuar me procedurat e mëtejshme ligjore.



Në Bashkinë Selenicë

Nga auditimi i përputhshmërisë i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar mangësive në fushën e prokurimeve publike, lidhur me hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, të cilat nuk rezultojnë të jenë ngushtësisht të lidhura dhe proporcionale me natyrën dhe përmasën e kontratës. Gjithashtu, në disa raste janë kualifikuar, shpallur fitues dhe janë lidhur kontrata me operatorë ekonomikë që nuk plotësonin kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në zbatimin e kontratave janë konstatuar pagesa për punime të pakryera në shumën 2,655 mijë lekë pa TVSH. Nga auditimi u konstatua mosrespektim i detyrimeve kontraktuale nga subjektet private për asete të marra me qira, duke shkaktuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerën 51,853 mijë lekë. Nga auditimi i procedurave për dhënien e lejeve, u konstatuan përlllogaritje jo të sakta të taksës së ndikimit në infrastrukturë, duke sjellë të ardhura të munguara në shumën 521 mijë lekë. Në fushën e organizimit dhe funksionimit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore, nga auditimi rezultoi se vendimet për vendosjen e gjobave në shumën 1,020 mijë lekë nuk janë përcjellë për kontabilizim në Drejtorinë e Financës dhe nuk janë ndërmarrë veprime për arkëtimin e tyre. Gjithashtu, nga inspektimet në terren janë evidentuar raste të paligjshmërisë, për të cilat nuk janë vendosur masat administrative përkatëse.

Në Bashkinë Skrapar

Nga auditimi i përputhshmërisë i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar konstatimeve në lidhje me mungesën e një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si rezultat i mos hartimit të një kuadri të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Në fushën e prokurimeve rezultuan mangësi sa i takon hartimit të kriterëve të veçanta, të cilat nuk janë ngushtësisht të lidhura me natyrën dhe madhësinë e kontratës. Nga auditimi u konstatua se janë kualifikuar dhe shpallur fitues dhe lidhur kontrata me operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, me efekt financiar negativ në vlerën 372 mijë lekë. Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël u konstatua copëzim fondi, duke shmangur procedurat standarde të prokurimit. Në fazën e zbatimit të kontratave janë konstatuar pagesa për punime të pakryera në shumën 1,112 mijë lekë pa TVSH, si dhe mungesë oponencës teknike. Në fushën e të ardhurave u konstatuan mangësi në arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi vlera e paarkëtuar prej 112,221 mijë lekë, prej të cilave vlera 13,442 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2024, nga mospagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat, si dhe vlera prej 2,970 mijë lekë nga mosarkëtimi i të ardhurave të detyrimeve kontraktuale. Nga auditimi u konstatuan gjithashtu 343 mijë lekë të pakontabilizuara, si pasojë e aplikimit të gabuar të tarifimit. Në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit u konstatuan raste ku lejet e ndërtimit janë miratuar pa marrë miratimin e të gjitha autoriteteve të përfshira. Është konstatuar përdorim joefektiv i fondeve publike për pagesa që rrjedhin nga vendime gjyqësore të humbura ndaj subjekteve të biznesit, në shumën 3,784 mijë lekë. Nga auditimi i procedurave për miratimin e lejeve të zhvillimit u evidentua se disa nga objektet e miratuara nuk kanë respektuar kushtet urbane, përfshirë kriterin minimal të lejuar për ndërtim, intensitetin maksimal, lartësinë maksimale (në metra dhe numër katesh) dhe distancat nga kufiri i pronës. Gjithashtu, u konstatua mungesa e dokumentacionit shoqërues dhe e dokumenteve të kërkuara nga legjislacioni dhe rregulloret në fuqi. Janë evidentuar gjithashtu vonesa në shqyrtimin e aplikimeve, të cilat kanë tejkaluar afatet e parashikuara nga dispozitat ligjore dhe nënligjore. Në fushën e organizimit dhe funksionimit të Inspektoratit të Mbrojtjes së



Territorit të Njësisë Vendore u konstatua se Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, nuk është ngritur si strukturë.

Në Bashkinë Tropojë

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar konstatimeve në lidhje me mungesën e një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si rezultat i mos hartimit të një kuadri të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim, si dhe mos marrja e masave dhe mekanizmave të nevojshëm për reduktimin e detyrimeve të prapambetura, me pasojë krijimin e detyrimeve të reja. Në fushën e të ardhurave u konstatua mosmarrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një vlerë e paarkëtuar prej 5,501 mijë lekë, e krijuar nga ushtrimi i aktivitetit të subjekteve që tregtojnë lëndë djegëse pa u pajisur me autorizimet përkatëse ose pa likuiduar të gjitha detyrimet, sipas përcaktimeve ligjore, si dhe vlera prej 35,099 mijë lekë nga mospagesa e detyrimeve nga kategoria e taksapaguesve familjarë, prej të cilave vlera 1,981 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2023-2024. U evidentua debitorë nga kontratat e qiradhënies së parcelave nga fondi pyjor/kullosor në vlerën 12,489 mije lekë. Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit nuk janë marrë masa, përfshirë komunikimin shkresor me ASHK-në, për përditësimin e regjistrave të ndërtimeve të legalizuara gjatë viteve të fundit, me qëllim vjeljen e taksës së infrastrukturës për ndërtimet e legalizuara, duke rezultuar në të ardhura të munguara në vlerën 1,865 mijë lekë. Në fushën e prokurimeve u evidentua mungesa e referencës për çmimet e vendosura në përcaktimin e fondit limit për projektet dhe preventivat e punimeve. Gjithashtu, u evidentuan mangësi në hartimin e kriterëve të veçanta, të cilat nuk janë ngushtësisht të lidhura me natyrën dhe madhësinë e kontratës, duke lejuar kualifikim dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, me një efekt financiar negativ në vlerën 2,106 mijë lekë. Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël u konstatua copëzim fondi, duke shmangur procedurat standarde të prokurimit. Në fazën e zbatimit të kontratave janë konstatuar pagesa për punime të pakryera në shumën 5,584 mijë lekë. Në fushën e administrimit dhe regjistrimit të aseteve u konstatua mungesë inventarizimi, përditësimi, si dhe për certifikimin e pronave në DVASHK Kukës. Në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit u konstatua se në të gjitha rastet e audituara, dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, nuk ishte i plotë, dhe u evidentua mungesa e studimit gjeologjiko-inxhinierik dhe sizmiko-inxhinierik, së bashku me dokumentacionin shoqërues. Në fushën e organizimit dhe funksionimit të Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore u konstatua se nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit për prishjen e ndërtimeve të paligjshme dhe nuk janë vijuar me procedurat e mëtejshme ligjore.



3.2 AUDITIME TË KOMBINUARA

Auditimet e kombinuara përfshijnë komponentë të auditimit financiar dhe të përputhshmërisë, në përputhje me standardet përkatëse të ISSAI-t, duke siguruar një qasje të integruar që lejon mbledhjen dhe vlerësimin e konkluzioneve në një angazhim të vetëm. KLSH ka kryer auditime financiare dhe të përputhshmërisë, duke dhënë opinionet përkatëse për secilin komponent të audituar.

Referuar ISSAI 4000, kur një auditim i përputhshmërisë kombinohet me një auditim financiar, konkluzioni/opinionin mbi aspektin e pajtueshmërisë duhet të ndahet qartë nga opinionin mbi pasqyrat financiare.

Ligji(et) dhe rregulloret e identifikuara si kritere auditimi, duhet të përmbajnë të gjitha ligjet dhe rregulloret që mund të ndikojnë në rezultatet e auditimit.

Në përfundim të auditimeve kombinuara, audituesi del me opinion mbi pasqyrat financiare dhe opinion mbi përputhshmërinë.



32
Auditime



32
Opinione/konkluzione
financiare

- 3 opinione të pakualifikuara
- 4 opinione të pakualifikuara me theksim të çështjes
- 24 opinione të kualifikuara
- 1 opinion i kundërt



32
Opinione/konkluzione
përputhshmërie

- 3 opinione të pakualifikuara
- 29 opinione të kualifikuara



3.2 AUDITIME TË KOMBINUARA

Në Ministrinë e Financave

Nga *auditimi financiar* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale dhe të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kundërt**. Auditimi ka evidentuar se ndarja e ish Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nuk është reflektuar në pasqyrat financiare të vitit 2024, ndërsa procesi i ndarjes së aktiveve, i iniciuar nga Ministri i Financave, nuk ka përfunduar deri në fund të auditimit. Dorëzimi i aseteve tek MEKI nuk ishte reflektuar në regjistrat kontabël, ndërsa aktivet dhe detyrimet e ish-MFE-së vijonin të paraqiteshin në pasqyrat financiare të Ministrisë së Financave. Procesi i inventarizimit të aktiveve nuk ishte kryer i plotë dhe i saktë, duke përfshirë vetëm aktivet në ngarkim të punonjësve aktualë dhe jo për vitin 2024, ndërkohë që artikujt e magazinës nuk ishin verifikuar fizikisht dhe aktivet e propozuara jashtë funksionit nuk ishin vlerësuar sipas udhëzimit për menaxhimin e aktiveve. Disa llogari të pasqyrës së pozicionit financiar ishin paraqitur të pasakta dhe të mbivlerësuara, përfshirë ndërtime dhe rikonstruksione, si dhe shtesat e llogarive 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe 218 “Inventar ekonomik”. Investimet me financim të huaj nuk ishin përfshirë në pasqyrat financiare, ndërsa pagat dhe detyrimet tatimore rezultuan të nënvlerësuara. Formularët e deklarimit të tatimit në burim në sistemin e “e-filling” paraqiteshin të pasaktë për disa muaj.

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka konstatuar se veprimtaria e subjektit të audituar paraqet devijime nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator përkatës të cilat janë materiale por jo të përhapura, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**. Auditimi i kërkesave buxhetore dhe i realizimit të investimeve ka evidentuar disa mangësi në drejtim të planifikimit buxhetor, ku u konstatuan 16 projekte investimi me plan fillestar në vlerën 1,310,363 mijë lekë, të cilat janë realizuar gjatë vitit 2024, por nuk kanë qenë të planifikuara në PBA 2024-2026. Gjithashtu, rezultoi se për vitin 2024 janë planifikuar në PBA 2024-2026, 38 projekte investimi me një vlerë totale prej 1,359,469 mijë lekë, të cilat nuk janë përfshirë në asnjë fazë të buxhetit vjetor 2024, si në planin fillestar ose atë përfundimtar. Plani buxhetor ka pësuar ndryshime të vazhdueshme gjatë vitit 2024, si në shpenzimet korrente ashtu edhe në kapitale. Sa i përket menaxhimit të burimeve njerëzore, nuk është miratuar rregullore apo udhëzim i brendshëm për rekrutimin e punonjësve me kontratë, duke mos dokumentuar procedurat e ndjekura për përzgjedhjen e tyre. Në fillim të vitit 2024, Ministria e Financave rezultonte me 131 pozicione të paplotësuara, duke u ulur në 72 deri më 31 dhjetor 2024. Nga auditimi i procedurës së prokurimit për Auditimin e Jashtëm (Auditim Forensic) për zbatimin e programit IPARD II në vitin 2023, u konstatua mungesa e dokumentacionit të plotë për argumentimin e nevojës së procedurës së prokurimit dhe mangësi në drejtim të përzgjedhjes së kompanive ofertuese për përlllogaritjen e fondit limit, pasi asnjë prej tyre nuk kishte dëshmuar eksperiencë në auditime Forensic. Planifikimi i shërbimit nuk dokumentonte kërkesat e BE-së për kryerjen e auditimit Forensic nga një kompani ndërkombëtare e pavarur. Gjithashtu u konstatuan kritere kualifikimi të paargumentuara plotësisht dhe operatori ekonomik i shpallur fitues nuk dokumentonte plotësimin e të gjitha kritereve të përcaktuara në specifikimet teknike. Nga auditimi rezultoi dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në shumën 8,924 mijë lekë, si rezultat i mos realizimit të punimeve në disa objekte, vonesave dhe mos-ekzekutimit të saktë të detyrimeve kontraktuale nga operatorët ekonomikë, si dhe efekte negative në administrimin dhe përdorimin e fondeve publike, në drejtim të ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, në vlerën totale prej 29,340 mijë lekë, si rezultat i mangësive të konstatuara krahasuar me specifikimet teknike dhe situacionet e paraqitura, kualifikimit të paargumentuar dhe shpalljes



fitues të OE që nuk plotësonte kriteret ligjore, mungesës së dokumenteve për stafin teknik dhe kapacitetet financiare, si dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për ish-punonjësit.

Në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH)

Nga *auditimi financiar* i kryer pranë Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH), për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka konstatuar se veprimtaria e subjektit të audituar ka devijime materiale por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator përkatës, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, bazuar në mbivlerësimin e aktiveve si pasojë e përfshirjes së një shume të paarkëtueshme në llogarinë 411 “Klientë e llogari të ngjashme”, mungesën e masave të ndërmarra për arkëtimin e debitorëve të depove farmaceutike ose farmacive, keqklasifikimit të sistemeve informatike si aktive jo-materiale, të amortizuara në grup dhe jo individualisht në llogarinë 203 “Koncesione, patenta, licenca”, keqklasifikimit të debitorëve pa siguri për arkëtimin e detyrimeve në llogarinë 480 “Të ardhura për t’u klasifikuar ose rregulluar”.

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka konstatuar se veprimtaria e subjektit të audituar ka devijime materiale por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator përkatës, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**. Nga analiza e dokumentacionit për lidhjen e kontratave me subjektet farmaceutike u evidentuan mangësi në zbatimin e mekanizmave të kontrollit mbi inventarin e barnave të rimbursueshme, duke e kufizuar kontrollin kryesisht tek barnat e reja dhe duke reduktuar mundësinë e verifikimit të të gjithë inventarit të deklaruar në sistemin “e-Depo”. Në depot farmaceutike u konstatua mosdeklarim i saktë i të dhënave në lidhje me hyrjet, mungesë arsytimi për përjashtimet nga lista e kontrollit të barnave për verifikim, përdorim i pasaktë i kodeve të barnave dhe diferenca të paargumentuara në gjendjen fizike, duke krijuar risk të shtuar për keqadministrim dhe shkelje të kontratës. Raportet e kontrollit nuk pasqyronin verifikimin e të gjitha çështjeve të parashikuara në program, duke mos garantuar kontroll të plotë mbi çmimet, barnat me pullë sigurie, barnat alternative e parë dhe të vetme, datat e skadencës së produkteve në gjendje, si dhe duke evidentuar diferenca të konsiderueshme ndërmjet sasisë së raportuar dhe asaj të verifikuar, ku auditimi konstatoi mungesën e aplikimit të masave administrative në shumën 8,166 mijë lekë. Në veprimtarinë e Sektorit të Kontrollit të Farmacive u evidentuan problematika në përzgjedhjen e subjekteve objekt kontrolli, kryerje të inventarizimeve të pjesshme dhe mungesë verifikimi të plotë të barnave të rimbursueshme. Kontrollat ndaj mjekëve dhe spitaleve nuk kanë qenë të plota, duke lënë jashtë inspektimit një pjesë të konsiderueshme të subjekteve me risk të lartë. Lista e Barnave të Rimbursueshme për vitin 2024 përfshinte barna pa çmim të miratuar dhe me dokumentacion të paplotë, përfshirë 59 barna pa konsum dhe pa kontratë me ndonjë importues, si dhe 16 barna të tjera të njoftuara për ndërprerje furnizimi, të cilat ishin përfshirë sërish në listë në kundërshtim me ligjin. Kjo situatë evidenton mungesë analizimi të nevojave reale dhe cenon transparencën, përdorimin racional të fondeve publike dhe sigurimin e barnave esenciale për pacientët. Nga auditimi u konstatuan gjithashtu vonesa dhe mosfurnizime të barnave alternative të para dhe të vetme, si dhe mungesë monitorimi dhe marrje masash administrative nga FSDKSH në vlerën prej 40,000 mijë lekë. Daljet e barnave spitalore drejt rrjetit të hapur dhe kryerja e transaksioneve me fatura zero evidentojnë mungesë kontrolli dhe rrezik për përfitime financiare të pajustificuara nga farmacitë. Nga auditimi i të dhënave të sistemit “e-depo” për vitin 2024 u konstatuan 102,778 njësi barnash që kanë dalë nga depot farmaceutike me datë skadence të njëjtë me datën e shitjes/hyrjes në farmaci, si dhe 143,598 njësi barnash me datë skadence 1–5 ditë pas daljes nga depot, çka tregon mungesë monitorimi dhe kontrolli nga FSDKSH mbi qarkullimin e barnave. Në lidhje me kontratat koncesionare u konstatua mungesë e mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes për zbatimin e kontratave të koncesionit. U konstatua mungesë e procedurave të qarta për verifikimin sistematik të përmbushjes së detyrimeve kontraktuale, përfshirë komponentët



teknologjikë dhe operacional, si dhe mungesë e dokumentacionit të plotë justifikues për pagesat e kryera, përtej të dhënave statistikore. Gjithashtu, u evidentua mungesa e funksionimit të një strukture të përbashkët monitorimi ndërmjet MSHMS dhe FSDKSH për verifikimin e implementimit të infrastrukturës teknologjike të kërkuar në kontratë. Po ashtu, u konstatuan mangësi në raportimin periodik mbi funksionimin dhe përputhshmërinë me standardet e përcaktuara. Nga auditimi i lidhjes së kontratave të reja nga FSDKSH me shpërndarësit dhe importuesit farmaceutik për vitin 2024 u evidentuan diferenca të konsiderueshme ndërmjet inventarit të deklaruar në sistemin “e-depo” dhe inventarit fizik të dorëzuar nga subjekti, duke rezultuar në deklarim fiktiv dhe rimbursim të pa drejtë në vlerën 216,948 mijë lekë, ku nga FSDKSH nuk janë kryer verifikimet e nevojshme për të konfirmuar këto dalje fiktive dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim procedural.

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve

Nga *auditimi financiar* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka konstatuar se pasqyrat financiare të subjektit paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar, por janë evidentuar disa çështje që kërkojnë theksim, të cilat, në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një **opinionit të pakualifikuar me theksim të çështjes**. Në pasqyrat financiare të DPT nuk janë llogaritur provigjone dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me DRT-të përkatëse, nuk ka marrë masat e duhura për të kryer procesin e pasqyrit të plotë të të gjitha detyrimeve në sistemin C@TS, ndonëse ka ekzistuar mundësia për regjistrimin e tyre dhe pasqyrimin përkatës në kontabilitet.

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka konstatuar se veprimtaria e subjektit të audituar ka devijime materiale por jo të përhapura, nga kuadri ligjor dhe rregullator, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**. Të ardhurat janë realizuar mbi planin e parashikuar për disa zëra, por disa të ardhura të tjera, si tatimi mbi fitimin, taksat e qarkullimit dhe lojërat e fatit, kanë shënuar mosrealizime të theksuara. Të ardhurat nga gjoha dhe penalitete, janë përfshirë në realizimin e të ardhurave, ndërkohë që nuk është kryer netimi i parapagimeve në llogaritë e tatim-fitimit; si dhe gjobat janë përfshirë në të ardhurat tatimore. Procesi i rimbursimit të TVSH-së për tatimpaguesit jo-eksportues nuk ka ndjekur në mënyrë të qëndrueshme parimin FIFO, me vonesa që variojnë nga 6 deri në 79 ditë, dhe në disa raste është tejkaluar afati maksimal. Stoku i kërkesave për rimbursim deri më 31.12.2024 arrinte në 1,418 milion lekë, duke krijuar risk financiar dhe detyrime të prapambetura për administratën tatimore. Nga auditimi i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor u konstatua se një numër i konsiderueshëm i raporteve të kontrollit tatimor nuk janë përmbyllur brenda afateve procedurale, me vonesa deri në 199 ditë kalendarike. Gjithashtu, u evidentua se administrata tatimore rezultonte me një stok të lartë të kontroleve të papërfunduara (876 raste deri më 31.12.2024, me një rritje prej 8.8% krahasuar me vitin 2023), përfshirë kontrole të pafilluara, të pezulluara dhe në faza të ndryshme të procedurës. Nga auditimi i Drejtorisë së Hetimit dhe Sektorit të Parandalimit të Pastrimit të Parave u konstatua se një numër i konsiderueshëm dosjesh ka tejkaluar afatet e parashikuara. Konkretisht, disa raste hetimi kanë kaluar afatin 6-mujor të parashikuar, disa dosje të procesit të kontrollit tatimor kanë zgjatur nga 417 deri në 3,095 ditë pa përfundim ose miratim përfundimtar, dhe disa raste në procesin e vlerësimit tatimor kanë zgjatur nga 713 deri në 2,986 ditë pa dokumente justifikuese për zgjatje. Ndër këto, 51 raste kanë tejkaluar edhe afatin 1 vit e 6 muaj, duke reflektuar problematika të dukshme në administrimin dhe finalizimin e procedurave. Nga auditimi i Drejtorisë së Kontrollit të Specializuar, u konstatua mosrespektim i procedurave standarde të dokumentimit dhe administrimit të kontrollit, përfshirë mungesën e dokumenteve bazë ligjore (njoftime, autorizime), analizave të detajuara të riskut financiar, intervistave me subjektet, vetëdeklarimeve tatimore dhe raporteve përfundimtare. Ndërmjet analizës së riskut të



hartuar nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut (DMR) dhe veprimeve të kryera nga Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren (DVKT), për vitin 2024 u evidentua një nivel të lartë mospërputhjeje midis planifikimit analitik dhe zbatimit operativ. Konkretisht, u konstatuan mosrealizime të verifikimeve sipas listave të riskut, devijime nga tematika e miratuar, raste të përsëritura të mosadresimit të riskut, shkelje të dispozitave procedurale dhe dokumentuese, si dhe mosrespektim të ligjit tatimor. Auditimi gjithashtu evidentoi mungesë koordinimi funksional dhe shkëmbimi sistematik të informacionit ndërmjet DMR dhe Drejtorive Rajonale Tatimore, ndërhyrje manuale në sistemet informatike dhe mungesë të mekanizmave të qartë për gjurmim. Rregulloret e institucionit nuk ishin përditësuar në përputhje me strukturën e re organizative. Nga 60 punonjës të emëruar në vitin 2024, vetëm 3 janë përzgjedhur përmes konkurrimit të hapur, pjesa tjetër është punësuar jashtë procedurave standarde. Gjatë periudhës objekt auditimi, rezultojnë 61 gjyqfitues të pa sistemuar dhe janë objekt i pagesave të vazhdueshme në buxhetin e shtetit, për të cilat nuk është respektuar parimit FIFO. Nga auditimi u konstatuan efekte negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet në vlerën 407,141 mijë lekë, si rezultat i likuidimit të detyrimeve të prapambetura, përfshirë vendimet gjyqësore, shtypshkronjën e letrave me vlerë, dhe shpenzime përmbartimore për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë

Nga *auditimi financiar* i ushtruar për periudhën nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka konstatuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke konkluduar me dhënien e një **opinionit të kualifikuar**, si rezultat i mosrealizimit të procesit të inventarizimit të aktiveve për periudhën objekt auditimi, regjistrave të aktiveve të paplotë dhe të pa përditësuar, trajtimeve të pasakta kontabël përfshirë klasifikimin e TVSH-së së projekteve IPA si aktiv, amortizimin e gabuar të llogarisë 28 “Caktime të aktiveve afatgjata” dhe mungesës së rakordimeve për disa llogari të tjera ekonomike.

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura, nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, si rezultat i mangësive të konstatuara në procedurat e prokurimit publik, lidhur me hartimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të kualifikimit, mungesën e specialistëve të fushës, mos argumentim të nevojave teknike të artikujve, përfshirjen e zërave që nuk lidhen me objektin e kontratës, parregullsi në vlerësimin e ofertave dhe zbatimin e kontratave. U evidentuan gjithashtu raste të tejkalimit të afateve të lëvrimin të artikujve të furnizuar, mungesë dokumentimi në proceset e marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, përfshirë mosidentifikimin e origjinës dhe datës së skadencës apo afatit të përdorimit, si dhe ushtrimi i veprimtarive që përfshijnë grumbullimin, trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme pa disponuar lejet mjedisore përkatëse. Nga auditimi rezultuan parregullsi në ekzekutimin e kontratave, përfshirë përbërjen e komisioneve të marrjes në dorëzim, mosadministrim i certifikatave të kalibrimit, mungesë trajnimi apo certifikimi për shërbimin e kryer, mangësi në dokumentimin e sasive, origjinës, datës së skadencës dhe firmës prodhuese, dorëzimeve të mallrave dhe shërbimeve sipas kontratës dhe dokumenteve përkatëse, si dhe ruajtja e tyre në ambiente të papërshtatshme. Gjithashtu, u evidentua se ISUV disponon 41 laboratorë, nga të cilët vetëm 19 kanë teste të akredituara, duke rezultuar se rreth gjysma e kapaciteteve laboratorike janë të pa akredituara. Për më tepër, analizat e akredituara janë të përqendruara kryesisht në një departament të vetëm, ndërsa fusha të tjera me rëndësi për sigurinë ushqimore dhe shëndetin e kafshëve paraqesin mbulim minimal (më pak se 5%) ose mungesë të plotë të akreditimit. Nga auditimi i praktikës së kryerjes së analizave jashtë vendit rezultoi se procesi i përzgjedhjes së laboratorëve referentë është kryer pa miratimin përkatës të ministrit përgjegjës dhe pa u mbështetur në një studim të mirëfilltë të laboratorëve të akredituar. Nga auditimi rezultoi dëm ekonomik në



vlerën 7,465 mijë lekë, për shkak të vonesave në dorëzimin e furnizimeve dhe i mangësive të konstatuara në kryerjen e shërbimeve të kërkuara sipas specifikimeve teknike; si dhe efekte negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet në vlerën 43,652 mijë lekë, si rezultat i parregullsive të konstatuara në kontraktimin e këshilltarëve të jashtëm, vonesave dhe pagesave të paplota për shërbime të prokurimit, si dhe përfshirjes së TVSH-së në faturat e laboratorit CER Group (Belgjikë) për analizat jashtë vendit.

Në Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë të pozicionit financiar më 31.12.2024. Megjithatë, janë evidentuar disa çështje që kërkojnë theksim, të cilat, në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një **opinionit të pakualifikuar me theksim të çështjes**. Theksimi i çështjes lidhet me nivelin e lartë të debitorëve, i cili rezultoi në vlerën 10,070,128 mijë lekë, ku pjesa më e madhe përbëhet nga gjoha të vendosura ndër vite, si dhe detyrime të papaguara nga individë dhe subjekte të ndryshme. Në këtë kuadër, u evidentua mungesë e marrjes së masave dhe mekanizmeve të nevojshëm për reduktimin e këtyre detyrimeve, duke sjellë si pasojë akumulimin e tyre në vijimësi dhe krijimin e detyrimeve të reja. Gjithashtu, nga procesi i inventarizimit u konstatua ekzistenca e aktiveve të dala jashtë përdorimit, për të cilat nuk janë ndërmarrë veprime për vlerësimin dhe asgjësimin e tyre, duke ndikuar në pasqyrimin jo të saktë të aktiveve në pasqyrat financiare.

Nga auditimi i përputhshmërisë i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2020 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar problematikave me karakter sistematik, të lidhura me mungesën e procedurave të standardizuara, dobësinë e kontrollit të brendshëm, administrimin joefektiv të dokumentacionit dhe moszbatimin e plotë të detyrimeve ligjore. Nga auditimi u konstatua mangësi në menaxhimin e burimeve njerëzore, të shoqëruara me mungesë dokumentacioni dhe gjurmueshmërie për procedurat e rekrutimit, ndërsa në shumë raste punësimet nuk janë realizuar në përputhje me kriteret e përcaktuara për nivelin arsimor dhe përvojën profesionale. Për periudhën 2020–2024 u evidentua një qarkullim i lartë i stafit, me numër të konsiderueshëm largimesh dhe emërimesh. Njëkohësisht, janë konstatuar problematika në dhënien e masave disiplinore, për shkak të mungesës së procedurave të qarta, transparente dhe mekanizmeve të apelimit, duke krijuar rrezik për trajtim jo të barabartë të punonjësve. Nga auditimi u konstatuan mangësi në fushën e prokurimeve publike, lidhur me hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, të cilat nuk rezultojnë të jenë ngushtësisht të lidhura dhe proporcionale me natyrën dhe përmasën e kontratës. Gjithashtu, në disa raste janë kualifikuar, shpallur fitues dhe janë lidhur kontrata me operatorë ekonomikë që nuk plotësonin kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në drejtim të funksionit kryesor të institucionit, nga auditimi u konstatua se IKMT nuk i ka ushtruar në mënyrë efektive përgjegjësitë për kontrollin dhe mbrojtjen e territorit, duke mos reaguar në mënyrë të duhur ndaj sinjalizimeve të ardhura nga institucione si Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore/Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, Agjencia Kombëtare e Bregdetit/Agjencitë Rajonale të Bregdetit dhe administrata e zonave të mbrojtura, për kryerjen e inspektimeve të nevojshme në mbrojtje të territorit nga ndërtimet e kundërligjshme në zona ose objekte me rëndësi kombëtare. Gjithashtu, është konstatuar se nuk janë ndjekur në mënyrë të plotë procedurat ligjore për evidentimin dhe ndëshkimin e ndërtimeve të paligjshme, si dhe në shumë raste nuk janë ekzekutuar vendimet për prishjen e objekteve pa leje. Auditimi evidentoi mungesë koordinimi ndër-institucional, duke sjellë si pasojë lejimin e ndërtimeve të kundërligjshme në zona të mbrojtura, muzeale apo turistike.



U konstatuan sinjalizime për ndërhyrje të jashtëligjshme, të cilat janë deleguar në drejtoritë rajonale të Inspektoratit apo në institucione të tjera për shkak të pretendimit për mungesë kompetence, çka ka sjellë në shumë raste mungesë reagimi konkret. Edhe në rastet kur janë marrë vendime për prishje, ekzekutimi i tyre ka munguar, duke kontribuar në rritjen e rasteve të ndërtimeve të paligjshme. Po ashtu, u konstatua se, megjithëse këto raste janë deleguar nga Kryeinspektori, në asnjë prej tyre nuk rezultoi që IKMT të ketë organizuar apo realizuar verifikime në terren përmes grupeve të përbashkëta pune me përfaqësues të institucioneve të sipërpërmendura dhe, në rast konstatimi të shkeljeve, të ketë ndjekur dhe zbatuar procedurat ligjore në fuqi. Gjithashtu, nga auditimi u evidentua se edhe në inspektimet e realizuara paraqiten mangësi në dokumentimin dhe administrimin e proceseve, pasi në shumë raste mungojnë procesverbalet përkatëse, koordinatat gjeografike, dokumentacioni fotografik, si dhe arsyetimet e plota ligjore për vendimet administrative, duke cënuar kështu vlefshmërinë dhe gjurmueshmërinë e tyre. Njëkohësisht, është konstatuar mungesë e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe e kryerjes së inspektimeve pasuese, si dhe moszbatim i plotë i sistemeve elektronike të inspektimit. Në drejtim të zbatimit të masave ndëshkuese, janë evidentuar raste të përsëritura të mosndjekjes së procedurave ligjore për ekzekutimin e gjobave, si dhe mungesë e kallëzimeve për shkelje që përbëjnë vepra penale, duke dobësuar ndjeshëm efektivitetin e funksionit ndëshkues të institucionit. Është konstatuar përdorim jo efektiv i fondeve publike për pagesa që lidhen me procese gjyqësore, si pasojë e largimeve të padrejta nga puna të punonjësve, në shumën 14,426 mijë lekë, si dhe për detyrime të krijuara nga vendime gjyqësore për dëmshpërblim nga prishje objektsh dhe shpenzime të tjera, në vlerën 554,425 mijë lekë.

Në Institucionin e Avokatit të Popullit

Nga *auditimi financiar* i ushtruar për periudhën nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka konstatuar se pasqyrat financiare përmbajnë devijime materiale, por jo të përhapura, duke konkluduar me dhënien e një **opinionit të kualifikuar**, referuar mungesës së rakordimit ndërmjet pasqyrës së performancës dhe pasqyrës së rakordimit të thesarit për të ardhurat nga grantet, si pasojë e pasqyrimin në vitin ushtrimor të të ardhurave që i përkasin periudhave të mëparshme, duke ndikuar në saktësinë dhe krahasueshmërinë e informacionit financiar. Gjithashtu, nga auditimi i aktiveve afatgjata materiale rezultoi se për disa kategori asetesh nuk ishin aplikuar normat e duhura të amortizimit sipas legjislacionit në fuqi dhe kërkesave të udhëzimeve për raportimin financiar në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Nga auditimi rezultoi se nuk ishte përpiluar raporti lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve për kushtet e ruajtjes, gjendjen fizike dhe diferencat e konstatuara dhe personat përgjegjës. Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura u konstatua se gjendja e raportuar e detyrimeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, përfshirë detyrimin kryesor, interesin e regjistruar dhe interesin e paregjistruar, ishte e nënvlerësuar si rezultat i mos evidentimit të këtyre detyrimeve në pasqyrat financiare.

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura, nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, bazuar në dobësitë e identifikuar në sistemin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm, në drejtim të planifikimit dhe monitorimit buxhetor, ku u konstatuan mangësi në funksionimin e Ekipeve të Menaxhimit të Programit, si dhe mosrespektim i afateve dhe përmbajtjes së raporteve të monitorimit. Në fushën e prokurimeve publike, u evidentua mungesë e analizës së gjendjes së magazinës përpara inicimit të kërkesës për blerje, parregullsi në afatet procedurale për paraqitjen e kërkesës për prokurim, hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit. Gjithashtu, u konstatuan vonesa në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve në kundërshtim me përcaktimet në dokumentet standarde të tenderit, dhe mungesë dokumentimi. Afatet e lëvritimit të mallrave, shërbimeve apo punëve,



nuk rezultuan të jenë studiuar dhe argumentuar në raport me natyrën dhe kompleksitetin e tyre, si dhe të përbëra nga punonjës të sektorit të financës dhe prokurimeve, duke krijuar risk për cenim të parimit të ndarjes së funksioneve. Nga pikëpamja organizative, institucioni ka funksionuar me struktura të paplota dhe të ndryshueshme përgjatë periudhës objekt auditimi, me mungesë të disa pozicioneve kyçe, si dhe pa njësi të auditimit të brendshëm. Komiteti i Përhershëm i Pranimit nuk kishte funksionuar në mënyrë të vazhdueshme sipas kërkesave ligjore, por është ngritur rast pas rasti për procedura të veçanta. Mangësi u konstatuan edhe në administrimin e burimeve njerëzore, përfshirë mosplotësimin e sistemit HRMIS, mungesë dokumentacioni në dosjet e personelit, si dhe mungesë të programeve strategjike për trajnimin e stafit dhe monitorimin e planit strategjik. Në lidhje me implementimin e sistemit elektronik të menaxhimit të rasteve, u konstatua mungesë dokumentimi mbi testimin dhe marrjen në dorëzim të sistemit, mungesë përcaktimi të afateve të testimit në urdhrin përkatës, si dhe mungesë evidencash mbi trajnimet e stafit sipas termave të referencës së kontratës.

Në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave

Nga *auditimi financiar* i ushtruar për vitin 2024, KLSH ka konstatuar se pasqyrat financiare të ILDKPKI-së paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet, pozitën financiare, duke konkluduar me dhënien e një **opinionit të pakualifikuar**. Megjithatë, nga auditimi u evidentuan disa çështje jo materiale lidhur me regjistrin e aktiveve dhe raportimin financiar, përfshirë rivlerësimet periodike për përafrimin e vlerës kontabël me vlerën aktuale të tregut, si dhe analizat shpjeguese për rezultatin e llogarisë 85 "Rezultati i ushtrimit".

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2024, KLSH nuk ka evidentuar devijime materiale nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i pakualifikuar**. Megjithatë, u konstatuan disa devijime jo materiale në fushën e prokurimeve publike dhe administrimit të aktiveve, të lidhura kryesisht me dokumentimin e procedurave, përfshirë ndarjen në lote, përbërjen e komisioneve të vlerësimit, protokollimin e procesverbaleve, përcaktimin e kriterëve të kualifikimit dhe marrjen në dorëzim.

Në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive

Nga *auditimi financiar* i ushtruar për periudhën nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka konstatuar devijime materiale, por jo të përhapura, duke konkluduar me dhënien e një **opinionit të kualifikuar** referuar klasifikimeve të pasakta të aktiveve, si dhe përlllogaritjeve jo të sakta të amortizimit për kategori të ndryshme aktivesh, të cilat kanë ndikuar në saktësinë e pasqyrave financiare të institucionit. Pasqyrimi i aktiveve të qëndrueshme në pasqyrat financiare nuk është realizuar në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, pasi sistemet dhe infrastruktura TIK vazhdojnë të figurojnë në inventarin e AKPA-s dhe nuk janë transferuar pranë AKSHI-t.

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, bazuar në dobësitë e konstatuara në planifikimin dhe menaxhimin buxhetor, të reflektuara në një numër të konsiderueshëm rishikimesh buxhetore, devijime që lidhen me përdorimin e fondeve publike për kontraktimin e shërbimeve që përbëjnë detyra funksionale të institucionit, mangësi në dokumentimin e procedurave, përfshirë fazën e identifikimit të nevojave për prokurim, hartimin dhe argumentimin e kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike, si dhe në procesin e shpalljes dhe njoftimit të fituesit. U evidentuan problematika në respektimin e parimit të ndarjes së funksioneve dhe në përbërjen e komisioneve të vlerësimit të projekteve dhe programeve, duke krijuar risk për cenim të paanshmërisë dhe konflikt



interesi. Në drejtim të zbatimit të programeve aktive dhe pasive të tregut të punës, auditimi evidentoi mangësi në planifikimin, organizimin dhe dokumentimin e procesit të monitorimit nga ana e institucionit, përfshirë mungesën e planeve vjetore të miratuara, objektivave dhe prioriteteve të qarta, si dhe një qasjeje të bazuar në analizë risku për përzgjedhjen e subjekteve për monitorim. Sa i takon programeve të formimit profesional nëpërmjet mbështetjes financiare, u evidentuan mangësi në verifikimin dhe dokumentimin e rezultateve të raportuara nga subjektet përfituese, përfshirë mungesën e dokumentacionit mbështetës mbi certifikimin e pjesëmarrësve dhe mospërputhje në të dhënat e raportuara. Niveli i monitorimit nga struktura përgjegjëse rezultoi i kufizuar në raport me kërkesat rregullatore, duke mos siguruar kontroll të plotë në nivel kursi dhe në zbatimin real të trajnimeve, me risk të shtuar për mosrealizim efektiv të objektivave të programeve dhe për përdorim jo efektiv të fondeve publike. Gjithashtu, nga auditimi rezultuan efekte negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike me ekonomicitet, efencë dhe efektivitet në vlerën 8,167 mijë lekë, si rezultat i pagesave të kryera për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për ish-punonjësit dhe tarifave përmbartimore, si dhe shpenzimeve për shërbime konsulence të kontraktuara pa analizë paraprake të nevojës reale dhe pa vlerësim të kapaciteteve administrative ekzistuese.

Në Shkollën e Magjistraturës

Nga *auditimi financiar* i kryer për periudhën nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit dhe rezultatet e operacioneve të tyre dhe të flukseve monetare në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për raportimin financiar duke rezultuar në dhënien e një **opinionit të pakualifikuar**. Megjithatë nga auditimi rezultoi se në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” është përfshirë edhe vlera e rikonstruksionit të Shkollës së Magjistraturës, megjithëse objekti ku ushtron aktivitetin institucioni është në përdorim mbi bazën e një kontrate huapërdorjeje dhe administrimi i tij është në përgjegjësi të Ndërmarrjes Industriale Nr. 1, Tiranë.

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2024, KLSH ka konstatuar se veprimtaria e subjektit të audituar ka devijime materiale por jo të përhapura, nga kuadri ligjor dhe rregullator, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, si rezultat i mangësive të konstatuara në shpërndarjen e orëve mësimore në raportin 35% për personelin e brendshëm akademik dhe 65% për personelin e jashtëm akademik, duke rritur koston shtesë për buxhetin e Shkollës së Magjistraturës. Gjithashtu u konstatuan mangësi në administrimin e orëve shtesë të punës, në drejtim të respektimit të procedurave të kompensimit dhe të dokumentimit të plotë të tyre. Institucioni nuk ka paraqitur pranë Ministrisë së Financave referencën ligjore për trajtimin financiar të organeve kolegiale drejtuese. Nga auditimi u evidentuan mangësi në organizimin dhe funksionimin institucional, përfshirë mospërputhje të strukturës organizative me kërkesat ligjore dhe rregullatore, ekzistencën e vendeve vakante në strukturën akademike dhe administrative, si dhe mungesë të pasqyrit të plotë të të dhënave të personelit në sistemet elektronike përkatëse. Në fushën e administrimit dhe menaxhimit të aktiveve u konstatuan mangësi në procesin e inventarizimit dhe nxjerrjes nga përdorimi të aktiveve, përfshirë procesin e ndjekur të disa pajisjeve elektronike që duhet t’i nënshtroheshin procedurave të riciklimit. Po ashtu u evidentuan mangësi në administrimin e procedurave të prokurimit publik, ku u konstatuan copëzim të fondeve në procedurat me vlerë të vogël, ndryshime të kritereve kualifikuese gjatë zhvillimit të procedurave, si dhe mangësi në arkivimin dhe administrimin e dokumentacionit përkatës. Nga auditimi rezultuan efekte negative në administrimin e fondeve publike në drejtim të ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, në vlerën totale prej 1,343 mijë lekë, si rezultat i praktikave të pa mbështetura në dokumentacion të plotë dhe në analizë të mjaftueshme financiare, konkretisht nga kryerja e pagesave



kompensuese pa bazë të qartë ligjore, dhe nga realizimi i shërbimeve përmes prokurimit të drejtpërdrejtë, pa dokumentimin e përlogaritjes së fondit limit dhe pa garantuar vlerësimin e kosto-efektivitetin e shërbimeve të përfituara.

Në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër

Nga *auditimi financiar* i kryer për periudhën nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023, KLSH ka konstatuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale por jo të përhapura, duke konkluduar me dhënien e **opinionit të kualifikuar**, si rezultat i mospërputhjeve në llogarinë “Disponibilitete në thesar” të pa rakorduar sipas kërkesave ligjore, debitorëve të paarkëtuara dhe të papasqyruar në mënyrë të plotë dhe të saktë në kontabilitet. U evidentua moskontabilizimi i trullit nën administrimin e universitetit, duke sjellë nënvlerësim të aktiveve, si dhe parregullsi në vlerësimin dhe klasifikimin kontabël të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale. Gjithashtu, u konstatuan keqklasifikime të shpenzimeve kapitale si shpenzime operative, detyrime të prapambetura të pakontabilizuara dhe mangësi në rakordimin e llogarive, të cilat kanë ndikuar në saktësinë, plotësinë dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare dhe në rezultatin e ushtrimit.

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 30.06.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura, nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar konstatimeve në administrimin e burimeve njerëzore, ku janë evidentuar punësime dhe ngritje në detyrë pa procedura konkurrimi dhe pa vlerësim të performancës, lidhje kontratash në kundërshtim me vendimmarrjet përkatëse, angazhim i personelit akademik pa përmbushur kriteret ligjore për gradën shkencore, si dhe trajtim i pagave dhe orëve shtesë pa dokumentacion mbështetës dhe pa gjurmë të mjaftueshme auditimi. Nga auditimi rezultuan mangësi në fushën e prokurimit publik dhe zbatimit të kontratave, përfshirë parregullsi në hartimin e fondit limit dhe të specifikimeve teknike, kualifikim të operatorëve ekonomikë me mangësi dokumentacioni, mosrespektim të afateve dhe procedurave të verifikimit, problematika në nënshkrimin dhe zbatimin e kontratave, dobësi në planifikimin dhe realizimin e investimeve të shoqëruara me vonesa në miratimin e buxhetit, nivel të ulët të realizimit të projekteve të planifikuara, si dhe moszbatim në kohë të vendimmarrjeve administrative. Nga auditimi rezultoi dëm ekonomik në vlerën 4,451 mijë lekë, për shkak të pagesave të kryera për orët jashtë orarit zyrtar pa dokumentacion dhe miratim paraprak, vonesave në dorëzimin e pajisjeve dhe shërbimeve laboratorike, kryerjes së punimeve të dyfishta ose të pakryera sipas projektit, llogaritjeve të gabuara të volumeve të punimeve dhe materialeve, si dhe mangësive në dokumentacionin tekniko-ligjor dhe kolaudimin e punimeve, efekte negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet në vlerën 9,444 mijë lekë si rezultat i pagesave të kryera pa vendimmarrje nga organet kompetente, mangësive në procedurat e prokurimit publik, përdorimit të karburantit dhe dietave pa dokumentacion justifikues, si dhe mbivendosjes së punimeve të kryera për objektet ndërtimore të Rektoratit, të cilat nuk janë marrë ende në dorëzim dhe janë në periudhë garancie; si dhe të ardhura të munguara në vlerën prej 20,057 mijë lekë, si rezultat i problematikave të konstatuara në aktivitetin e Laboratorit të Diagnostikimit Mikrobiologjik dhe mungesës së evidentimit dhe kontabilizimit të detyrimeve nga studentët debitorë.

Në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja

Nga *auditimi financiar* i kryer për periudhën nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2024, KLSH ka konstatuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale por jo të përhapura, duke konkluduar me dhënien e **opinionit të kualifikuar** për pasqyrat financiare në datën 31.12.2024, si rezultat i keqklasifikimit të aktiveve që i përkasin llogarisë 218 “Inventar ekonomik”, në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstrukione”, aplikimit jo të njëtrajtshëm të



metodës dhe normave të amortizimit, mospërputhjeve ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të raportuara në pasqyrat financiare me të dhënat e thesarit. Gjithashtu, llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, rezultoi me tepriç zero, ndërkohë që nga verifikimi i të dhënave të administruara nga institucioni u konstatuan studentë debitorë të regjistruar në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja për periudhën 2021–2024, me vlerë totale 2,638 mijë lekë, të cilët nuk rezultojnë të jenë kontabilizuar në këtë llogari, duke sjellë pasqyrim jo të plotë të detyrimeve të të tretëve në pasqyrat financiare të institucionit.

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2024, KLSH ka konstatuar se veprimtaria e subjektit të audituar është në përputhje me të gjitha aspektet materiale me kuadrin ligjor dhe rregullator, për të cilat është dhënë **opinion i pa kualifikuar**. Megjithatë, janë evidentuar disa parregullsi të cilat janë vlerësuar si jo materiale dhe jo të përhapura, ku përmendim mangësi në planifikimin dhe realizimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, parregullsi në dokumentimin e proceseve të marrjes në dorëzim të mallrave dhe raste të vonesave në dorëzimin e tyre, si dhe dobësi në planifikimin dhe realizimin e treguesve buxhetorë, të reflektuara në nivele të ulëta të realizimit të disa zërave të shpenzimeve dhe në të ardhurave të papërdorura ndër vite.

Në Fakultetin e Ekonomisë

Nga *auditimi financiar* i kryer për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2024, KLSH ka konstatuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale por jo të përhapura, duke konkluduar me dhënien e **opinionit të kualifikuar** për pasqyrat financiare në datën 31.12.2024, si rezultat i aplikimit jo të njëtrajtshëm të metodës dhe normave të amortizimit për aktivet afatgjata materiale në llogaritë 212 “Ndërtesa dhe Konstrukione”, 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe 218 “Inventar ekonomik”, ku janë përdorur norma të ndryshme amortizimi ndër vite dhe në mospërputhje me përcaktimet e kuadrin rregullator. Gjithashtu, nga auditimi u konstatuan mospërputhje ndërmjet të ardhurave dytësore të raportuara në pasqyrën e performancës dhe të dhënave të degës së thesarit, ku për vitin 2024 rezulton diferencë në shumën 51,499 mijë lekë, për vitin 2023 në shumën 23,845 mijë lekë, për vitin 2022 në shumën 77,110 mijë lekë. Po ashtu, u evidentuan diferenca ndërmjet shpenzimeve të deklaruara në pasqyrat financiare dhe rakordimit me degën e thesarit për llogarinë “Blerje mallra e shërbime”, si rezultat i keqklasifikimit të disa shpenzimeve në llogaritë përkatëse. Në këtë kuadër, u konstatua se në nënllogarinë 6029 “Shpenzime të tjera operative”, janë klasifikuar gabimisht shpenzime që i përkasin kategorive të tjera, përfshirë shpenzimet për pjesëmarrjen në komisionin e përhershëm të dhënies së gradës “Doktor”, si dhe shpenzimet për shërbimin e blerjes së antivirusit për Fakultetin e Ekonomisë, duke sjellë pasqyrim jo të saktë të strukturës së shpenzimeve në pasqyrat financiare.

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2024, KLSH ka konstatuar se veprimtaria e subjektit të audituar është në përputhje me të gjitha aspektet materiale me kuadrin ligjor dhe rregullator, për të cilat është dhënë **opinion i pa kualifikuar**. Megjithatë, janë evidentuar disa parregullsi të vlerësuara si jo materiale dhe jo të përhapura, ndër të cilat mangësi në planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, ku një pjesë e procedurave të planifikuara nuk janë realizuar, si dhe raste kur përlllogaritja e fondit limit nuk është bazuar në specifikimet teknike të objektit të prokurimit apo kur shërbimi ka filluar realizimin, ose është marrë në dorëzim përpara përfundimit të procedurës në sistemin elektronik të prokurimit. Gjithashtu, u konstatuan mangësi në dokumentimin dhe arkivimin e procedurave të prokurimit, në raportimin institucional lidhur me planifikimin dhe përdorimin e fondeve, si dhe raste të mosrespektimit të afatit ligjor për likuidimin e faturave. Nga auditimi u evidentuan mangësi në planifikimin dhe raportimin e veprimtarisë së personelit akademik, ku në formularët e



ngarkesës akademike pasqyrohej kryesisht veprimtaria mësimdhënëse, ndërsa komponentë të tjerë të veprimtarisë akademike nuk raportoheshin në mënyrë të detajuar, si dhe raste kur deklarimi i personelit akademik me kohë të pjesshme në organet tatimore, kryhej në momentin e likuidimit të pagesave.

Në Cirkun Kombëtar

Nga *auditimi financiar* i kryer për periudhën nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023, KLSH ka konstatuar se veprimtaria e subjektit ka devijime nga kuadri ligjor, nën ligjor dhe rregullator përkatës të cilat janë materiale por jo të përhapura, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, si rezultat i moskryerjes së inventarizimit dhe mungesës së një regjistri kontabël të aktiveve. Në pasqyrat financiare të vitit 2023 është reflektuar veprimi kontabël i pakësimit të inventarit, ndërkohë që nga auditimi rezultoi mungesë e gjurmës së plotë të auditit për procesin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve, pasi nuk specifikohet mënyra e realizimit të këtij procesi dhe mungojnë evidencat përkatëse. Kategorizimi i aktiveve nuk ishte i saktë dhe llogaritja e amortizimit nuk ishte kryer konform normave përkatëse për kategori të ndryshme aktivesh.

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2024, KLSH ka konstatuar se veprimtaria e subjektit ka devijime nga kuadri ligjor, nën ligjor dhe rregullator përkatës të cilat janë materiale por jo të përhapura, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, si rezultat i mangësive të konstatuara në kontratat e shërbimit të projekteve artistike të cilat nuk parashikonin penalitete për vonesa në realizimin e shërbimit, afatet, kalendarin e shfaqjeve, të drejtat dhe detyrimet e palëve në mënyrë specifike, të drejtën e pronësisë për kostumet ose materialet skenike të prodhuara për projektin, detyrimet mbi të drejtën e autorit, apo plan buxhetin si pjesë integrale të kontratës. Publikimi i thirrjeve për aplikim projektsh ishte kryer në rrjete sociale dhe jo në faqet zyrtare të institucionit. U konstatua se urdhrat e titullarëve për ndjekjen e gjurmës së auditimit nuk ishin të qarta, mungonin relacionet përmbledhëse mbi zbatimin e projekteve dhe dokumentacioni i projekteve nuk ishte inventarizuar dhe nuk përmbante elementët e kërkuar. Në disa raste, procedurat për marrjen në dorëzim të mallrave dhe materialeve paraqesnin mangësi, duke mos lënë gjurmë të dokumentacionit dhe procesverbalet përkatëse. Bordi Artistik kishte funksionuar me përbërje jo të plotë, rregullorja nuk ishte përditësuar me proceset e punës për zbatimin e gjurmës së auditimit të projekteve, tarifat për krijimtarinë artistike nuk ishin argumentuar dhe analizuar sipas praktikave krahasuese, dhe vendimet e Bordit për miratimin e projekteve nuk përmbanin bazën ligjore apo dokumentacionin e nevojshëm. Nga auditimi rezultuan mangësi në plotësimin e strukturës organike për të gjithë pozicionet e punës, shpalljen e vakancave, parregullsi në kontratat e punonjësve dhe në dosjet e personelit. Nga auditimi mbi dorëzimin e dokumentacionit dhe aktiveve për punonjësit e larguar rezultoi se nuk ishin kryer procedurat e nevojshme mbi dorëzimin e dokumentacionit dhe aktiveve. Nuk ishte hartuar deklarata dhe raporti i cilësisë së sistemit të kontrollit, nuk ishte ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik, mungonin rregulla të brendshme për delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre, nuk ishin ngritur mekanizmat e vlerësimit të riskut, si dhe nuk ishte hartuar Strategjia e Menaxhimit të Riskut dhe Plani i menaxhimit për trajtimin e risqeve. Gjithashtu, rezultuan efekte negative në administrimin e fondeve publike me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet në vlerën 20,611 mijë lekë, si rezultat i problematikave në lidhjen dhe zbatimin e kontratave të qirasë, ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, si dhe mungesës së gjurmës së auditimit për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve.

Në Shoqërinë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Lezhë SHA

Nga *auditimi financiar* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.05.2021 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë të



pozicionit financiar më 31.12.2024. Megjithatë, janë evidentuar disa çështje që kërkojnë theksim, të cilat, në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një **opinionit të pakualifikuar me theksim të çështjes**. Theksimi i çështjes lidhet me keqklasifikimin e disa llogarive. Konkretisht, në llogarinë “Detyrime ndaj institucioneve të kredisë” janë përfshirë interesa të maturuara të huamarrjeve, të njohura si detyrime afatshkurtra, ndërkohë që në të njëjtën llogari janë regjistruar edhe penalitete për moslikuidim në afat, të klasifikuara gabimisht si detyrime afatshkurtra, ndonëse tejkalojnë periudhën 12-mujore. Po ashtu, në llogarinë “Furnitorë kamatëvonesa FSHU” është konstatuar keqklasifikimi i detyrimit të transferuar nga ish-UK Kurbin gjatë procesit të bashkimit në vitin 2022. Në të njëjtën mënyrë, në llogarinë “Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit” janë regjistruar detyrimet ndaj furnitorëve dhe palëve të treta pa një klasifikim të saktë sipas natyrës dhe afatit të shlyerjes.

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.05.2021 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**. Këshilli Mbikëqyrës nuk ishte mbledhur rregullisht të paktën një herë në muaj sipas Statutit. Drejtoritë e Ish Ujësjetllës Kanalizime Mirditë dhe Kurbin, për vitet 2021 dhe 2022 nuk kishin nxjerrë urdhra dhe vendime për vendosjen dhe përmirësimin e treguesve të performancës. Nga auditimi u konstatua se nuk ishin kryer analiza gjithëpërfshirëse për evidentimin e mangësive dhe dobësive në gjendjen e rënduar ekonomiko-financiare, si dhe për nxjerrjen e përgjegjësive për personat përgjegjës. Gjithashtu, nuk ishin përcaktuar procedura të qarta për rekrutimin e punonjësve dhe mungonin gjurmë dokumentare për shpalljen e vendeve të lira të punës, përzgjedhjen e kandidatëve që kualifikohen për fazën e intervistimit dhe zhvillimin e procesit të intervistimit. Nga auditimi rezultuan mangësi në fushën e prokurimeve dhe në zbatimin e kontratave. Këto lidhen me Ish/Ujësjetllës Kanalizimi Mirditë, i cili ka realizuar procedura prokurimi me vete për mallra të ngjashme, të cilat duhet të trajtoheshin si një grup mallrash dhe të prokurroheshin me një procedurë të vetme. Në fazën e zbatimit të kontratave janë konstatuar pagesa për shërbime/punime të pakryera në shumën prej 335 mijë lekë.

Në Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan SHA

Nga *auditimi financiar* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 09.09.2022 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë të pozicionit financiar më 31.12.2024, megjithatë, janë evidentuar disa çështje që kërkojnë theksim, të cilat, në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një **opinionit të pakualifikuar me theksim të çështjes**. Theksimi i çështjes lidhet me mangësi të evidentuara në llogaritë ‘Të drejta nga aktiviteti i shfrytëzimit’ dhe ‘Emri i mirë’, për të cilat mungon një analizë e argumentuar dhe e dokumentuar, e reflektuar në shënimet shpjeguese, mbi mënyrën e njohjes dhe trajtimit të tyre kontabël. Gjithashtu, detyrimet e transferuara nga ish-shoqëritë e ujësjetllës-kanalizimeve janë pasqyruar si detyrime afatshkurtra në llogarinë ‘Furnitorë – kamatëvonesa FSHU’.

Nga *auditimi i përputhshmërisë* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 09.09.2022 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, materiale por jo të përhapura, të cilat justifikojnë dhënien e një **opinionit të kualifikuar**. Nga auditimi u konstatuan mangësi në fushën e prokurimeve publike, lidhur me hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, të cilat nuk rezultojnë të jenë ngushtësisht të lidhura dhe proporcionale me natyrën dhe përmasën e kontratës. Gjithashtu, në disa raste janë kualifikuar, shpallur fitues dhe janë lidhur kontrata me operatorë ekonomikë që nuk plotësonin kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në fazën e zbatimit të kontratave janë konstatuar pagesa për punime të pakryera në shumën 756 mijë lekë pa TVSH, si dhe mungesë e kryerjes së oponencës teknike. Është konstatuar përdorim pa efektivitet të



fondeve publike për pagesa që lidhen me procese gjyqësore në lidhje me largimet e padrejta nga puna të punonjësve, në shumën 2,345 mijë lekë.

Në Bashkinë Belsh

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me mangësi në paraqitjen dhe klasifikimin e disa zërave kontabël. Konkretisht, në tepicën e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, në vlerën 55,486 mijë lekë, nuk është përfshirë vlera e debitorëve nga taksat dhe tarifat në shumën 100,319 mijë lekë. Gjithashtu, nga analiza e kësaj llogarie rezulton se në gjendjen e saj nuk është reflektuar vlera e pullave dhe biletave të tregut. Ndërkohë, shuma prej 5,299 mijë lekë është klasifikuar gabimisht në llogarinë 464 “Detyrime për t’u paguar për blerjen e letrave me vlerë”, kur duhej të ishte kontabilizuar në llogarinë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”. Në gjendjen e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në mbyllje të vitit 2024 nuk është përfshirë vlera prej 10,800 mijë lekë që lidhet me detyrimet për vendime gjyqësore, pasi në këtë llogari janë kryer kontabilizime për shpenzimet nga vendimet gjyqësore vetëm në momentin e kryerjes së pagesës dhe jo në momentin e krijimit të detyrimit, duke mos reflektuar në këtë mënyrë totalin e detyrimeve për vendime gjyqësore.

Nga auditimi i përputhshmërisë i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar** referuar konstatimeve në lidhje me mungesën e një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si rezultat i mos hartimit të një kuadri të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim, si dhe mos marrjes së masave dhe mekanizmave të nevojshëm për reduktimin e detyrimeve të prapambetura, me pasojë krijimin e detyrimeve të reja. Nga auditimi rezultuan mangësi në fushën e prokurimeve sa i takon plotësimin të kriterëve të kualifikimit gjatë vlerësimit të vetëdeklarimeve dhe gjatë verifikimit të dokumentacionit fizik të dorëzuar nga fituesit. Gjithashtu, në hartimin e preventivit dhe përlllogaritjen e fondit limit u konstatua se vendosja e çmimeve të zërave të punimit, nuk ishte në përputhje me manualin e ndërtimit. Në fazën e zbatimit të kontratave janë konstatuar ndryshime të projektit të zbatimit të pa argumentuara teknikisht dhe pagesa për punime të pakryera në shumën 16,497 mijë lekë pa TVSH. Në fushën e të ardhurave është konstatuar mos marrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një vlerë e pa arkëtuar prej 100,319 mijë lekë, prej të cilave vlera 33,979 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2024, nga mospagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat.

Në Bashkinë Dibër

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me mangësi në procedurat e inventarizimit të aktiveve afatgjata, materiale dhe jomateriale, të investuara ndër vite nga bashkia, si dhe me nënvlerësimin e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në shumën 56,601 mijë lekë, për shkak të mos përfshirjes së gjendjes së debitorëve për taksa dhe tarifa për familjarë dhe për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimeve.

Nga auditimi i përputhshmërisë i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar konstatimeve në lidhje me mungesën e një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe



kontrollit të brendshëm, si rezultat i mos hartimit të një kuadri të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim, si dhe mos marrja e masave dhe mekanizmave të nevojshëm për reduktimin e detyrimeve të prapambetura, me pasojë krijimin e detyrimeve të reja. Nga auditimi u konstatuan mangësi në fushën e prokurimeve publike, lidhur me hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, të cilat nuk rezultojnë të jenë ngushtësisht të lidhura dhe proporcionale me natyrën dhe përmasën e kontratës. Gjithashtu, në disa raste janë kualifikuar, shpallur fitues dhe janë lidhur kontrata me operatorë ekonomikë që nuk plotësonin kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në zbatimin e kontratave janë konstatuar pagesa për punime të pakryera në shumën 11,984 mijë lekë pa TVSH dhe vlera 294 mijë lekë për mos realizimin në kohë të kontratës. Gjithashtu, u evidentua mungesa e kryerjes së oponencës teknike dhe efekte negative mbi fondet publike si pasojë e punimeve të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike, në vlerën prej 2,351 mijë lekë. Në fushën e të ardhurave është konstatuar mos marrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një vlerë e pa arkëtuar prej 69,522 mijë lekë, prej të cilave vlera 16,228 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2024, nga mospagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat. Në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit u konstatuan raste të mosparaqitjes së saktë të plan vendosjes së miratuar, mos pasqyrimi i të dhënave të sakta të treguesve të zhvillimit, tejkalimi i koeficientit të shfrytëzimit të territorit, rritja e intensitetit të ndërtimit, tejkalimi i lartësisë, rritja e numrit të kateve, mosrespektimi i distancave, mosrespektimi i tipologjisë së ndërtimit në bazë të përcaktimit të njësisë përkatëse të zhvillimit, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi, si dhe u evidentua dëm ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerën 870 mijë lekë, si pasojë e përlllogaritjes së pasaktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë, si dhe në vlerën 9,224 mijë leke si pasojë e mosrealizimit të marrëveshjes për 3% të sipërfaqes së ndërtimit. Në fushën e organizimit dhe funksionimit të Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore u konstatua se vlera e gjobës për ndërtimet e kundërligjshme nuk është llogaritur në mënyrën e duhur, referuar vlerës së punimeve të kryera dhe sipërfaqes së ndërtimit.

Në Bashkinë Dropull

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare Bashkisë Dropull duke justifikuar dhënien e opinionit **të pakualifikuar me theksim çështje**. Këto pasaktësi lidhen me pasqyrimin në llogarinë 210 "Toka, troje, terrene" të aktiveve në vlerën 196 mijë lekë, për të cilat nuk disponohej dokumentacion justifikues i titullit të pronësisë.

Nga auditimi i përputhshmërisë i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar konstatimeve në lidhje me mungesën e një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si rezultat i mos hartimit të një kuadri të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim, dhe mos marrjen e masave dhe mekanizmave të nevojshëm për reduktimin e detyrimeve të prapambetura, me pasojë krijimin e detyrimeve të reja. Nga auditimi u konstatuan mangësi në fushën e prokurimeve publike, lidhur me hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, të cilat nuk rezultojnë të jenë ngushtësisht të lidhura dhe proporcionale me natyrën dhe përmasën e kontratës. Gjithashtu, në disa raste janë kualifikuar, shpallur fitues dhe janë lidhur kontrata me operatorë ekonomikë që nuk plotësonin kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në fazën e zbatimit të kontratave janë konstatuar pagesa për punime të pakryera në shumën 786 mijë lekë pa TVSH. Në fushën e të ardhurave është konstatuar mos marrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një vlerë e pa arkëtuar prej 6,325 mijë lekë, e krijuar nga mos pagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat. Nga auditimi u konstatuan



mangësi në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, të lidhura me mosrespektimin e kushteve urbane, përfshirë distancat nga kufijtë e pronës dhe intensitetin maksimal të lejuar të ndërtimit, vendosjen në funksion të zhvillimit të objektit të parcelave pa lidhje fizike ndërmjet tyre, si dhe paraqitjen e dokumentacionit teknik dhe atij shoqërues të projektit ndërtimor jo të plotë, në kundërshtim me përcaktimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në fushën e administrimit dhe regjistrimit të aseteve u konstatua mungesë inventarizimi dhe përditësimi për asetet e transferuara me VKM.

Në Bashkinë Gjirokastrë

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**, referuara pasaktësive në regjistrimet kontabël dhe mosrakordimeve ndërmjet strukturave përgjegjëse. Konkretisht, për llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk është kryer përditësimi dhe rakordimi ndërmjet strukturave përkatëse lidhur me taksat dhe tarifat vendore, duke sjellë si pasojë nënvlerësimin e saj në vlerën 146,065 mijë lekë. Gjithashtu, për një pjesë të pronave të transferuara me VKM nuk është kryer regjistrimi pranë ASHK-së, si dhe ato nuk janë inventarizuar, vlerësuar dhe kontabilizuar.

Nga auditimi i përputhshmërisë i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar konstatimeve në lidhje me mungesën e një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si rezultat i mos hartimit të një kuadri të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim, si dhe mos marrjes së masave dhe mekanizmave të nevojshëm për reduktimin e detyrimeve të prapambetura, me pasojë krijimin e detyrimeve të reja. Nga auditimi u konstatuan mangësi në fushën e prokurimeve publike, lidhur me hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, të cilat nuk rezultojnë të jenë ngushtësisht të lidhura dhe proporcionale me natyrën dhe përmasën e kontratës. Gjithashtu, në disa raste janë kualifikuar, shpallur fitues dhe janë lidhur kontrata me operatorë ekonomikë që nuk plotësonin kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në fazën e zbatimit të kontratave janë konstatuar pagesa për punime të pakryera në shumën 594 mijë lekë pa TVSH. Në fushën e të ardhurave u konstatuan mangësi në arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një shumë e paarkëtuar prej 161,997 mijë lekë, prej të cilave vlera 37,125 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2024, nga mospagesa e taksapaguesve familjarë dhe privatë. Në fushën e administrimit dhe regjistrimit të aseteve u konstatua mungesë inventarizimi dhe përditësimi për asetet e transferuara me VKM, si dhe mungesë informacioni i plotë mbi gjendjen reale të këtyre pronave. Nga auditimi u konstatuan mangësi në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, të lidhura me mosrespektimin e kushteve urbane, përfshirë distancat nga kufijtë e pronës dhe intensitetin maksimal të lejuar të ndërtimit, vendosjen në funksion të zhvillimit të objektit të parcelave pa lidhje fizike ndërmjet tyre, si dhe paraqitjen e dokumentacionit teknik dhe atij shoqërues të projektit ndërtimor jo të plotë, në kundërshtim me përcaktimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në fushën e organizimit dhe funksionimit të Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore u konstatua se nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit për prishjen e ndërtimeve të paligjshme dhe nuk janë vijuar me procedurat e mëtejshme ligjore.

Në Bashkinë Gramsh

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën ushtrimore nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me



mangësi në dokumentimin e procesit të inventarizimit fizik të aktiveve të institucionit, dhe si pasojë llogaritë e aktiveve në bilancin e vitit 2024 janë mbyllur mbi bazën e gjendjes kontabël dhe jo mbi bazën e verifikimit fizik të tyre. Në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk janë përfshirë debitorët që i përkasin kategorisë “Abonentë familjarë”, duke sjellë nënvlerësimin e kësaj llogarie në shumën 28,536 mijë lekë. Në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” janë përfshirë projekte me vlerë 2,811 mijë lekë (kosto historike), të cilat nuk duhet të kontabilizoheshin në këtë llogari, pasi investimet për të cilat janë hartuar këto projekte kanë përfunduar. Për rrjedhojë, vlera e tyre duhej të ishte kapitalizuar si pjesë e vlerës së investimit përkatës, duke bërë që vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare të mos paraqitet e saktë. Në llogarinë 218 “Inventar ekonomik” është përlllogaritur amortizimi me normë 20% në grup, pa u bërë ndarja e nënlllogarisë 218/6 “Pajisje kompjuterike”, për të cilën duhet të ishte aplikuar norma e amortizimit 25%. Gjithashtu, gjendja e llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” dhe e llogarisë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve”.

Nga auditimi i përputhshmërisë i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar konstatimeve në lidhje me mungesën e një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si rezultat i mos hartimit të një kuadri të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim, si dhe mos marrjes së masave dhe mekanizmave të nevojshëm për reduktimin e detyrimeve të prapambetura, me pasojë krijimin e detyrimeve të reja. Nga auditimi rezultuan mangësi në fushën e prokurimeve sa i takon hartimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, të cilat nuk kanë qenë ngushtësisht të lidhura me natyrën dhe përmasat e kontratës. Gjithashtu, janë kualifikuar, shpallur fitues dhe janë lidhur kontrata me operatorë ekonomikë që nuk plotësonin kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit, ku është konstatuar përdorim jo efektiv i fondeve publike në vlerën 11,371 mijë lekë. Në fazën e zbatimit të kontratave janë konstatuar pagesa për punime të pakryera në shumën 8,816 mijë lekë pa TVSH. Në fushën e të ardhurave është konstatuar mos marrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një vlerë e pa arkëtuar prej 2,947 mijë lekë, si dhe 48,206 mijë lekë të ardhura të munguara dhe të pa kontabilizuara.

Në fushën e administrimit dhe regjistrimit të asetëve u konstatua mungesë inventarizimi dhe përditësimi për asetet e transferuara me VKM, si dhe mungesë informacioni i plotë mbi gjendjen reale të këtyre pronave. Nga auditimi u konstatuan mangësi në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, të lidhura me mosrespektimin e kushteve urbane, përfshirë distancat nga kufijtë e pronës dhe intensitetin maksimal të lejuar të ndërtimit, vendosjen në funksion të zhvillimit të objektit të parcelave pa lidhje fizike ndërmjet tyre, si dhe paraqitjen e dokumentacionit teknik dhe atij shoqëruar të projektit ndërtimor jo të plotë, në kundërshtim me përcaktimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në fushën e organizimit dhe funksionimit të Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore u konstatua se nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e urdhrat të ekzekutimit për prishjen e ndërtimeve të paligjshme dhe nuk janë vijuar me procedurat e mëtejshme ligjore.

Në Bashkinë Kolonjë

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me kontabilizim të pasaktë të disa llogarive, duke ndikuar në paraqitjen e zërave në pasqyrën e pozicionit financiar. Konkretisht, nga auditimi rezultoi se llogaritë 101 “Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar”, 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” dhe 212 “Ndërtesa dhe konstruksione” janë paraqitur të mbivlerësuara respektivisht në vlerat 12,135



mijë lekë, 77,064 mijë lekë dhe 11,974 mijë lekë, ndërsa llogaria 26 “Aktivet afatgjata financiare” rezultoi e nënvlerësuar në vlerën 626 mijë lekë.

Nga auditimi i përputhshmërisë i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar konstatimeve në lidhje me mungesën e një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si rezultat i mos hartimit të një kuadri të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim, si dhe mos marrjes së masave dhe mekanizmave të nevojshëm për reduktimin e detyrimeve të prapambetura, me pasojë krijimin e detyrimeve të reja. Nga auditimi rezultuan mangësi në fushën e prokurimeve publike, lidhur me hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, të cilat nuk rezultojnë të jenë të lidhura ngushtësisht me natyrën dhe madhësinë e kontratës. Gjithashtu, u konstatuan raste kur janë kualifikuar dhe shpallur fitues, si dhe janë lidhur kontrata me operatorë ekonomikë që nuk plotësonin kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në fushën e të ardhurave është konstatuar mos marrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një vlerë e pa arkëtuar prej 31,085 mijë lekë, e krijuar nga mos pagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat. Nga auditimi u konstatuan mangësi në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, të lidhura me mosrespektimin e kushteve urbane, përfshirë distancat nga kufijtë e pronës dhe intensitetin maksimal të lejuar të ndërtimit, vendosjen në funksion të zhvillimit të objektit të parcelave pa lidhje fizike ndërmjet tyre, si dhe paraqitjen e dokumentacionit teknik dhe atij shoqëruar të projektit ndërtimor jo të plotë, në kundërshtim me përcaktimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në fushën e administrimit dhe regjistrimit të aseteve u konstatua mungesë inventarizimi dhe përditësimi për asetet e transferuara me VKM. Në fushën e organizimit dhe funksionimit të Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore u konstatua se nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit për prishjen e ndërtimeve të paligjshme.

Në Bashkinë Konispol

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen kryesisht me mangësi në procedurat e inventarizimit dhe administrimit të aktiveve afatgjata, materiale dhe jomateriale, të krijuara nga investimet e realizuara ndër vite nga bashkia. Nga auditimi rezultoi nënvlerësim i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në shumën 2,250 mijë lekë, si pasojë e mosregjistrimit të detyrimeve të debitorëve që rrjedhin nga dhënia me qira e sipërfaqeve të fondit pyjor-kullosor. Gjithashtu, u evidentua mosllogaritja e amortizimit për llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”, mungesa e analizës dhe rakordimit të vlerave të llogarive të aktiveve afatgjata materiale. Një tjetër pasaktësi lidhet me nënvlerësimin e llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në vlerën 23,896 mijë lekë, për shkak të mosregjistrimit në kontabilitet të kontratave në proces zbatimi, të cilat, megjithëse janë likuiduar pjesërisht ose plotësisht, realizohen dhe përfundojnë në një periudhë kohore më të gjatë se një vit.

Nga auditimi i përputhshmërisë i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar konstatimeve në lidhje me mungesën e një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si rezultat i mos hartimit të një kuadri të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Mos marrja e masave dhe mekanizmave të nevojshëm për reduktimin e detyrimeve të prapambetura, me pasojë krijimin e detyrimeve të reja. Në strukturën organizative të miratuar nuk ka njësi të auditit të brendshëm dhe nuk është lidhur



marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e shërbimit të auditimit. Nga auditimi u konstatuan mangësi në fushën e prokurimeve publike, të cilat lidhen me hartimin dhe përcaktimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, për shkak të aplikimit të kriterëve të panevojshme dhe jo të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe jo në përpjesëtim me volumin dhe natyrën e punimeve që prokurohen. Janë konstatuar parregullsi lidhur me hartimin e preventivave dhe përlllogaritjen e fondit limit, pasi janë përfshirë në mënyrë të paargumentuar dhe jo të drejtë zëra punimesh, si dhe në disa raste çmimet e zërave të punës nuk janë përcaktuar në përputhje me manualët përkatëse të ndërtimit. Këto veprime kanë sjellë rritje joreale të fondit limit, me përdorim pa efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike, në vlerën totale prej 2,416 mijë lekë. Në lidhje me procedurat e blerjeve të vogla, nga auditimi u konstatua se ato janë realizuar jashtë Sistemit të Prokurimeve Publike, duke mos respektuar rregullat dhe procedurat e parashikuara ligjore. Në fazën e zbatimit të kontratave u konstatuan mangësi në administrimin e dosjeve të zbatimit, të cilat paraqesin mungesa në dokumentacionin teknik përkatës, si dhe janë konstatuar pagesa për punime të pakryera në shumën 1,326 mijë lekë pa TVSH. Në fushën e administrimit dhe regjistrimit të asetëve u konstatua mungesë inventarizimi dhe përditësimi për asetet e transferuara me VKM. Në lidhje me planifikimin dhe realizimin e të ardhurave për vitin 2024, nga auditimi u konstatua se planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore është realizuar në masën 51.6%, që ka sjellë një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën 32,937 mijë lekë. Gjithashtu, u evidentua mosmarrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një vlerë e paarkëtuar prej 52,002 mijë lekë, prej të cilave vlera 12,984 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2024. Po ashtu, janë konstatuar të ardhura të munguara dhe të pakontabilizuara për buxhetin e bashkisë në vlerën 15,211 mijë lekë, si dhe të ardhura të munguara nga mosarkëtimi i detyrimeve kontraktuale për qiratë, në vlerën 2,763 mijë lekë. Në fushën e organizimit dhe funksionimit të Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore u konstatua se nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e urdhrat të ekzekutimit për prishjen e ndërtimeve të paligjshme dhe nuk janë vijuar me procedurat e mëtejshme ligjore.

Në Bashkinë Korçë

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023, KLSH ka evidentuar se, pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me keqklasifikime dhe mosrakterime në llogaritë kontabël, duke reflektuar mangësi në tepricat e llogarisë 4342 "Të tjera operacione me shtetin (të drejta)" në aktiv të bilancit, ku sipas analizës nuk janë debituar detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara të klasës 4 të gjendjeve të llogarisë 401-404 "Furnitorë dhe llogari të lidhura me to", në vlerën 87,693 mijë lekë, si dhe për llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm" në vlerën 8,680 mijë lekë. Po ashtu, në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" u konstatuan nënvlerësime, pasi nuk janë kontabilizuar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet, në vlerën 3,246 mijë lekë, si dhe detyrimet për gjobat për pagesë të vonuar të taksave dhe tarifave vendore, në shumën 27,847 mijë lekë.

Në auditimin e përputhshmërisë, për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar** referuar konstatimeve në lidhje me mungesën e një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si rezultat i mos hartimit të një kuadri të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim, si dhe mos marrjes së masave dhe mekanizmave të nevojshëm për reduktimin e detyrimeve të prapambetura, me pasojë krijimin e detyrimeve të reja. Nga auditimi rezultoi mangësi në fushën e prokurimeve sa i takon hartimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, të cilat nuk kanë qenë ngushtësisht të lidhura me natyrën dhe përmasat e



kontratës. Gjithashtu, janë kualifikuar, shpallur fitues dhe janë lidhur kontrata me operatorë ekonomikë që nuk plotësonin kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në fazën e zbatimit të kontratave janë konstatuar pagesa për punime të pakryera në shumën 5,198 mijë lekë pa TVSH, si dhe mungesë e kryerjes së oponencës teknike. Në fushën e administrimit të të ardhurave u konstatua mosmarrja e masave të plota për arkëtimin e detyrimeve debitore. Në datën 31.12.2024, detyrimet e paarkëtuara rezultojnë në vlerën totale prej 690,078 mijë lekë, prej të cilave vlera 78,694 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2024, nga të cilat 333,523 mijë lekë i përkasin detyrimeve të papaguara nga kategoria e taksapaguesve familjarë dhe individë privatë, 284,804 mijë lekë nga kategoria e biznesit, 31,604 mijë lekë nga mosarkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe 40,148 mijë lekë nga detyrime të papaguara që rrjedhin nga kontratat e qirave. Nga auditimi u konstatuan mangësi në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, të lidhura me mosrespektimin e kushteve urbane, përfshirë distancat nga kufijtë e pronës dhe intensitetin maksimal të lejuar të ndërtimit, vendosjen në funksion të zhvillimit të objektit të parcelave pa lidhje fizike ndërmjet tyre, si dhe paraqitjen e dokumentacionit teknik dhe atij shoqërues të projektit ndërtimor jo të plotë, në kundërshtim me përcaktimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në Bashkinë Kuçovë

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me mangësi në rakordimin e llogarive kontabël, pasqyrimin e fondeve buxhetore dhe regjistrimin e aktiveve në kontabilitet. Llogaria 4342 "Të tjera operacione me shtetin (debitor)" rezultoi me diferencë me llogarinë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti" në vlerën 10,562 mijë lekë. U evidentua gjithashtu një diferencë ndërmjet fondeve të papërdorura në vitin 2024 dhe fondeve të deklaruara për t'u trashëguar në vitin 2025 në shumën 23,379 mijë lekë. Në aktivet afatgjata materiale nuk janë kontabilizuar 3,503 asete të transferuara me VKM në pronësi të Bashkisë, për shkak se procedurat për pajisjen e tyre me titull pronësie nga ASHK nuk kanë përfunduar. Po ashtu, nuk është kryer rivlerësimi për pasuritë që janë pajisur me titull pronësie, duke ndikuar në pasqyrimin jo të plotë dhe të saktë të aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar me impakt në besueshmërinë e informacionit financiar të raportuar.

Nga auditimi i përputhshmërisë për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar konstatimeve në lidhje me mungesën e një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si rezultat i mos hartimit të një kuadri të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim, si dhe mos marrja e masave dhe mekanizmave të nevojshëm për reduktimin e detyrimeve të prapambetura, me pasojë krijimin e detyrimeve të reja. Nga auditimi rezultuan mangësi në fushën e prokurimeve dhe në zbatimin e kontratave. Në përcaktimin e fondit limit për projektet dhe preventivat e punimeve u konstatua mungesa e referencës për çmimet e vendosura dhe hartimi i kriterëve të veçanta, të cilat nuk janë ngushtësisht të lidhura me natyrën dhe madhësinë e kontratës, duke lejuar kualifikim dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, me efekt financiar negativ në vlerën 7,020 mijë lekë. Në fazën e zbatimit të kontratave janë konstatuar pagesa për punime të pakryera në shumën 1,463 mijë lekë. Në fushën e të ardhurave është konstatuar mos marrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një vlerë e pa arkëtuar prej 109,362 mijë lekë, prej të cilave vlera 27,716 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2023-2024, nga mospagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat. Në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit u konstatua se në të gjitha rastet e audituara, dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, i kërkuar me ligj, nuk ishte i plotë. Njësisia e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të



Njësisë Vendore nuk rezultonte e plotësuar me numrin e nevojshëm të personelit. dhe procesverbalet e akt-konstatimeve paraqesnin mangësi cilësore, referuar përshkrimit të kundërvajtjes pasi vlera e gjobës, nuk vërtetohej të ishte vendosur konform përcaktimeve të ligjit.

Në Bashkinë Librazhd

Nga auditimi financiarë për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me mangësi në rakordimin e llogarive kontabël, pasqyrimin e fondeve buxhetore dhe regjistrimin e aktiveve në kontabilitet. Konkretisht, llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” nuk kuadronte me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” me një diferencë në vlerë 83,698 mijë. Gjithashtu, është evidentuar një diferencë prej 86,126 mijë lekë ndërmjet fondeve të papërdorura për vitin 2024 dhe fondeve të deklaruar për t’u trashëguar në vitin 2025. Në aktivet afatgjata materiale nuk janë kontabilizuar pronat e transferuara me VKM pasi procedurat për pajisjen e tyre me titull pronësie janë të papërfunduara nga ASHK dhe nuk është bërë rivlerësimi i atyre të pajisura me titull pronësie, me ndikim në pasqyrimin e jo të plotë dhe jo të saktë të aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiarë.

Nga auditimi i përputhshmërisë, i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024 KLSH ka evidentuar devijime materiale por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar konstatimeve në lidhje me mungesën e një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si rezultat i mos hartimit të një kuadri të plot rregullash të shkruara për këtë qëllim. Nga auditimi u konstatuan mangësi në fushën prokurimeve për hartimin e kriterëve të veçanta të cilat nuk janë ngushtësisht të lidhura me natyrën dhe madhësinë e kontratës, duke lejuar kualifikimin dhe shpallur fitues operator ekonomik, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit. Në fazën e zbatimit të kontratave janë konstatuar pagesa për punime të pakryera në shumën 1,164 mijë lekë. Në fushën e të ardhurave është konstatuar mos marrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një vlerë e pa arkëtuar prej 107,748 mijë lekë, prej të cilave vlera 26,875 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2024. Në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit u konstatua se në të gjitha rastet e audituara dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor i kërkuar nuk ishte në përputhje me përcaktimet ligjore. Në fushën e organizimit dhe funksionimit të inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, njësia IMT nuk ishte krijuar me numrin e nevojshëm të personelit të inspektorëve, si dhe nuk kishin formimin profesional.

Në Bashkinë Lushnjë

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” rezultoi e mbivlerësuar në shumën 739 mijë lekë, ndërsa llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” rezultoi e mbivlerësuar në shumën 48,138 mijë lekë, si pasojë e kontabilizimit të aktiveve të Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime SH.A Lushnjë. Po ashtu, janë evidentuar parregullsi në dokumentimin e procesit të inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve.

Nga auditimi i përputhshmërisë i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar konstatimeve në lidhje me mungesën e një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe



kontrollit të brendshëm, si rezultat i mos hartimit të një kuadri të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim, si dhe mos marrjes së masave dhe mekanizmave të nevojshëm për reduktimin e detyrimeve të prapambetura, me pasojë krijimin e detyrimeve të reja. Nga auditimi rezultuan mangësi në fushën e prokurimeve sa i takon hartimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, të cilat nuk kanë qenë ngushtësisht të lidhura me natyrën dhe përmasat e kontratës. Gjithashtu, janë kualifikuar, shpallur fitues dhe janë lidhur kontrata me operatorë ekonomikë që nuk plotësonin kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në fazën e zbatimit të kontratave janë konstatuar pagesa për punime të pakryera në shumën 6,871 mijë lekë pa TVSH. Në fushën e të ardhurave është konstatuar mos marrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një vlerë e pa arkëtuar prej 1,761,812 mijë lekë, prej të cilave vlera 80,772 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2024, nga mospagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat. Në fushën e administrimit dhe regjistrimit të aseteve u konstatua mungesë inventarizimi dhe përditësimi për asetet e transferuara me VKM-të përkatëse.

Në Bashkinë Mallakastër

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se, pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me klasifikimin e pasaktë të disa llogarive kontabël. Konkretisht, llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është paraqitur në vlerën 10,420 mijë lekë, ndërkohë që kjo vlerë duhej të ishte kontabilizuar në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” rezultoi e mbivlerësuar në vlerën 21,405 mijë lekë (kosto historike), pasi përfshin projekte të realizuara që duhej të ishin kapitalizuar në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”.

Nga auditimi i përputhshmërisë i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar konstatimeve në lidhje me mungesën e një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si rezultat i mos hartimit të një kuadri të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim, si dhe mos marrja e masave dhe mekanizmave të nevojshëm për reduktimin e detyrimeve të prapambetura, me pasojë krijimin e detyrimeve të reja. Nga auditimi rezultuan mangësi në fushën e prokurimeve, ku janë aplikuar kriteret e panevojshme dhe jashtë objektit të kontratës, jo në përpjesëtim me volumin dhe natyrën e punimeve. U evidentuan parregullsi në hartimin e preventivave dhe përlllogaritjen e fondit limit, pasi disa zëra punimi janë përfshirë në mënyrë të paargumentuar dhe në disa raste çmimet e zërave të punimit nuk përputhen me manualin e ndërtimit, duke rezultuar në një rritje joreale të fondit limit në shumën 16,673 mijë lekë, e cila konsiderohet përdorim i fondeve publike pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet. Janë kualifikuar dhe shpallur fitues dhe lidhur kontrata me operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit. Në fazën e zbatimit të kontratave janë konstatuar pagesa për punime të pakryera në shumën 2,521 mijë lekë pa TVSH dhe punime të kryera pa eficiencë në vlerën 41,563 mijë lekë. Është konstatuar përdorim pa efektivitet të fondeve publike për pagesa që lidhen me procese gjyqësore në lidhje me largimet e padrejta nga puna të punonjësve, në shumën 1,715 mijë lekë. Në fushën e të ardhurave është konstatuar mos marrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një vlerë e pa arkëtuar prej 1,243,473 mijë lekë, prej të cilave vlera 30,763 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2024, nga mospagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat.



Në Bashkinë Përmet

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me mosrakordime dhe me moskontabilizim të saktë të llogarive kontabël. Konkretisht, llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitet e nënvlerësuar në shumën 5,724 mijë lekë për shkak të moskontabilizimit të plotë të detyrimeve. Gjithashtu, nuk janë kontabilizuar asetet e transferuara me VKM-të përkatëse. Amortizimi i aktiveve nuk është llogaritur për secilin aktiv në mënyrë individuale, por vetëm në nivel grupi, duke mos siguruar informacion të saktë mbi aktivet që kanë arritur një vlerë të mbetur të papërfillshme ose zero. Po ashtu, llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” paraqitet e nënvlerësuar në shumën 583,299 mijë lekë, pasi investimet e përfunduara nuk janë pasqyruar në këtë llogari.

Nga auditimi i përputhshmërisë i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar konstatimeve në fushën e prokurimeve sa i takon hartimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, të cilat nuk kanë qenë drejtpërdrejt të lidhura me natyrën dhe përmasat e kontratës. Gjithashtu, janë kualifikuar, shpallur fitues dhe janë lidhur kontrata me operatorë ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në fazën e zbatimit të kontratave janë konstatuar pagesa për punime të pakryera në shumën 2,640 mijë lekë pa TVSH, si dhe mungesë e oponencës teknike. Në fushën e të ardhurave është konstatuar mos marrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një vlerë e pa arkëtuar prej 99,940 mijë lekë, prej të cilave vlera 8,746 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2024, nga mospagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat. Në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit u konstatuan raste ku lejet e ndërtimit janë miratuar pa marrë miratimin e të gjitha autoriteteve të përfshira, përfshirë DV ASHK. Nga auditimi u konstatuan mangësi në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, të lidhura me mosrespektimin e kushteve urbane, intensitetin dhe distancat nga kufijtë e pronës, vendosjen e parcelave në funksion të zhvillimit të objektit pa lidhje fizike ndërmjet tyre, si dhe vonesa në shqyrtimin e aplikimeve që tejkalojnë afatet e parashikuara në dispozitat ligjore dhe nënligjore.

Në Bashkinë Vlorë

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me mangësi në administrimin, klasifikimin dhe kontabilizimin e aktiveve afatgjata materiale, si dhe në pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare. Konkretisht, llogaritë e aktiveve afatgjata materiale janë pasqyruar për vlerën kontabël pa u krahasuar me inventarin fizik; vlerat e rikonstruksioneve, mbikëqyrjes dhe kolaudit janë pasqyruar më vete dhe nuk i janë shtuar vlerës së aktivitetit përkatës pas përfundimit të investimeve. Gjithashtu janë evidentuar keqklasifikime të llogarive, me ndikim në informacionin kontabël të pasqyrave financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, numrin e tyre për efekt të inventarizimit fizik dhe llogaritjen e amortizimit, duke sjellë pasqyrim jo të saktë të gjendjes së këtyre aktiveve. Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” paraqitet e mbivlerësuar, pasi janë përfshirë projekte me vlerë 115,858 mijë lekë (kosto historike), të cilat nuk janë trajtuar drejt nga pikëpamja kontabël, pasi investimet për të cilat janë hartuar këto projekte kanë përfunduar dhe, për rrjedhojë, vlera e tyre duhej të ishte kapitalizuar dhe transferuar në vlerën e investimit përkatës. Ndërkohë, vlera prej 9,813 mijë lekë e pasqyruar me emërtimin “Të tjera” nuk është e analizuar dhe nuk është identifikuar natyra ekonomike e saj. Llogaria



213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” paraqitet e mbivlerësuar, pasi nuk është zbritur vlera e 35 artikujve në shumën 646,672 mijë lekë, të cilat i përkasin sektorit të ujësjellës-kanalizimeve. Gjithashtu, për 179 objekte inventari të pasurive të paluajtshme (ndërtesa) me kosto historike në vlerën 1,488,986 mijë lekë të evidentuara në kontabilitet, bashkia nuk dispononte tituj pronësie, duke krijuar pasiguri mbi të drejtat e pronësisë dhe mbi saktësinë e pasqyrimin të këtyre aktiveve në pasqyrat financiare.

Nga auditimi i përputhshmërisë, i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar konstatimeve në lidhje me mungesën e një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si rezultat i mos hartimit të një kuadri të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim, si dhe mos marrja e masave dhe mekanizmave të nevojshëm për reduktimin e detyrimeve të prapambetura, me pasojë krijimin e detyrimeve të reja. Nga auditimi u konstatuan mangësi në fushën e prokurimeve publike, lidhur me hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, të cilat nuk rezultojnë të jenë ngushtësisht të lidhura dhe proporcionale me natyrën dhe përmasën e kontratës. Gjithashtu, në disa raste janë kualifikuar, shpallur fitues dhe janë lidhur kontrata me operatorë ekonomikë që nuk plotësonin kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit, me efekt financiar negativ në vlerën 17,194 mijë lekë. Në fazën e zbatimit të kontratave janë konstatuar pagesa për punime të pakryera në shumën 6,744 mijë lekë pa TVSH dhe punime të kryera pa efikasitet në vlerën 8,447 mijë lekë, si dhe mungesë të lejes së ndërtimit/zhvillimit dhe kryerjes së oponentëve teknike. Në fushën e të ardhurave është konstatuar mos marrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një vlerë e pa arkëtuar prej 708,616 mijë lekë, prej të cilave vlera 55,776 mijë lekë përbën shtesën e krijuar gjatë vitit 2024, nga mospagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat. Gjithashtu, rezultuan të ardhura të paarkëtuara në vlerën 191,756 mijë lekë, si pasojë e mos derdhjes në llogaritë e Bashkisë Vlorë të mjeteve të mbledhura nga qytetarët nga Shoqëria UK Vlorë. Nga auditimi rezultoi se në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dokumentacioni teknik dhe shoqëruar i projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë dhe i saktë. U konstatua se disa nga objektet e miratuara nuk kanë respektuar kushtet urbane, duke përfshirë distancat nga objektet kufitare, lartësinë maksimale të lejuar të objektit, numrin minimal të vendparkimeve, intensitetin maksimal të lejuar, sipërfaqen e lejuar të katit të fundit dhe vijën e ndërtimit. Gjithashtu, u evidentua se nuk është kërkuar dhe respektuar mendimi i të gjitha autoriteteve që duhet të shprehen lidhur me miratimin e lejeve të ndërtimit. Nga auditimi rezultoi se zhvilluesi ka filluar ndërtimin e objekteve pa u pajisur paraprakisht me dokumentin e konfirmuar të fillimit të punimeve. U konstatua gjithashtu se certifikata e ndërtimit është miratuar në mungesë të kompetencave të autoritetit vendor të zhvillimit të territorit dhe se një kat banimi është certifikuar si i tillë, ndërkohë që në projektin e miratuar ishte parashikuar si ambient teknik, duke sjellë mosvjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Nga auditimi u evidentua se objektet nuk respekton përcaktimet për kontributin që subjektet private duhet të japin ndaj fondit publik për strehim social për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2,000 metra katrorë, pasi nga subjektet përfitues nuk është realizuar likuidimi i 3% të detyrimit, në masën 41,546 mijë lekë, duke krijuar mungesë të ardhurash për bashkinë. Në fushën e organizimit dhe funksionimit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV) janë konstatuar mangësi në ndjekjen e procedurave ligjore. U evidentuan raste të zhvillimit të ndërtimeve në mospërputhje me lejen e ndërtimit dhe deklaratën paraprake të punimeve. Nga auditimi u konstatua se nuk është vijuar me ekzekutimin e vendimeve për prishjen e objekteve të kundërligjshme dhe nuk janë referuar rastet e ndërtimeve pa leje në Prokurori. Po ashtu, nuk janë marrë masa për identifikimin e subjekteve dhe vendosjen e gjobave brenda afateve ligjore. Mungon gjithashtu evidenca mbi realizimin e vendimeve për prishje. Gjithashtu, janë



konstatuar të ardhura të munguar në vlerën 6,189 mijë lekë, si pasojë e mosllogaritjes së saktë të vlerës së gjobave për ndërtimet e paligjshme. Në fushën e administrimit dhe regjistrimit të asetëve u konstatua mungesë inventarizimi dhe përditësimi për asetet e transferuara me VKM. Në lidhje me menaxhimin e hapësirave publike për plazh u konstatua mosrespektim i procedurave ligjore për menaxhimin dhe planifikimin e hapësirave publike të plazhit.

Në Bashkinë Sarandë

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023 KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me kontabilizimin e pasaktë të llogarive dhe hartimin e pasqyrave financiare mbi baza informacioni jo të plotë. Konkretisht, nuk është kryer verifikimi fizik i aktiveve për “Pyje, kullota, plantacione”, si dhe nuk është analizuar vlera prej 1,761 mijë lekë e kontabilizuar në llogarinë 212 “Ndërtesa Konstrukione”, e emërtuar “Aktive të trashëguara, të pa inventarizuara (nga viti 1999)”, për të cilën nuk ka informacion mbi përbërjen dhe natyrën e saj. Mungonte informacioni i detajuar për secilin aktiv afatgjatë të pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar, duke mos siguruar një pasqyrim të saktë të gjendjes kontabël dhe sigurisë mbi vlerat e raportuara. Nga auditimi u konstatuan mosregjistrime në kontabilitet të sipërfaqeve të konsiderueshme të tokave të përfituara nga Bashkia Sarandë nëpërmjet VKM-ve, përfshirë 430.9 ha pyje dhe 783.3 ha kullota (në total 5,133.81 ha), si dhe moskontabilizimi i 8 aktiveve për të cilat është marrë certifikata pronësie për pasuri të llojit kullotë dhe pyll.

Nga auditimi i përputhshmërisë i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**. Nga auditimi rezultuan mangësi në fushën e prokurimeve dhe në zbatimin e kontratave sa i takon hartimit të kriterëve të veçanta, të cilat nuk kanë qenë ngushtësisht të lidhura me natyrën dhe madhësinë e kontratës. Gjithashtu, rezultoi se janë kualifikuar, shpallur fitues dhe lidhur kontrata me operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësonin kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, duke shkaktuar një efekt financiar negativ në vlerën 22,142 mijë lekë. Nga auditimi u konstatua se janë realizuar projekte artistike dhe aktivitete kulturore, të cilat nuk janë kryer në përputhje me procedurat e prokurimit. Në fazën e zbatimit të kontratave janë konstatuar pagesa për punime të pakryera në shumën 9,929 mijë lekë. Në fushën e të ardhurave u konstatuan mangësi në arkëtimin e debitorëve, ku vlera totale prej 51,512 mijë lekë ka rezultuar si pasojë e mospagesës së detyrimeve kontraktuale, tejkalimit të sipërfaqeve të lejuara, kontratave për investime publike në dhe taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 8,459 mijë lekë. Nga auditimi i veprimtarisë së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit u evidentuan mangësi në zbatimin e procedurave për dokumentimin dhe trajtimin e kundërvajtjeve, përfshirë mbajtjen e procesverbaleve dhe ndjekjen e masave të nevojshme ndaj subjekteve që nuk kanë respektuar projektet e miratuara. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ai shoqëruar i projekteve ndërtimore nuk ishte i plotë sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore. Konkretisht, janë evidentuar mungesa të vërtetimeve të regjistrimit në QKB për hartuesit e projekteve ndërtimore, mungesë të licencave profesionale të tyre, mungesë të policave të sigurimit dhe të deklaratave të përgjegjësisë profesionale. Po ashtu, në projektet ndërtimore janë konstatuar mangësi në dokumentacionin që vërteton të drejtat pronësore, mungesë e projektit në formatin DWG, studimit sizmiko-inxhinierik dhe gjeologo-inxhinierik, preventivit të punimeve, oponencës teknike, si dhe marrëveshjeve midis palëve. Gjithashtu, është evidentuar mungesa e licencave të kolaudatorit dhe situacionet përfundimtare të kryerjes së punimeve, akti i menaxhimit të mbetjeve urbane, si dhe projekti për mirëmbajtjen e objektit dhe dokumentacioni të ngjashëm.



Në Bashkinë Elbasan

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023, KLSH ka evidentuar se, pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me mangësi në procedurat e inventarizimit të aktiveve afatgjata, materiale dhe jomateriale, të investuara ndër vite nga bashkia, nënvlerësimin e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në shumën 17,222 mijë lekë, si pasojë e mos përfshirjes së gjendjes së debitorëve për taksa dhe tarifa; si dhe me mos-hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduara në nivel të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke përfshirë të gjitha njësitë në varësi.

Nga auditimi i përputhshmërisë i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar konstatimeve në lidhje me mungesën e një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si rezultat i mos hartimit të një kuadri të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim, si dhe mos marrja e masave dhe mekanizmave të nevojshëm për reduktimin e detyrimeve të prapambetura, me pasojë krijimin e detyrimeve të reja. Nga auditimi u konstatuan mangësi në fushën e prokurimeve publike, lidhur me hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, të cilat nuk rezultojnë të jenë ngushtësisht të lidhura dhe proporcionale me natyrën dhe përmasën e kontratës. Gjithashtu, në disa raste janë kualifikuar, shpallur fitues dhe janë lidhur kontrata me operatorë ekonomikë që nuk plotësonin kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në zbatimin e kontratave janë konstatuar pagesa për punime të pakryera në shumën 991 mijë lekë pa TVSH, mungesë e kryerjes së oponencës teknike, si dhe përdorim paefektivitet të fondeve publike në vlerën 519 mijë lekë. Në fushën e të ardhurave është konstatuar mos marrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2023 rezultoi një vlerë e pa arkëtuar prej 21,348 mijë lekë, e krijuar nga mos pagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat, si dhe nga detyrimet që lidhen me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve. Nga auditimi u konstatuan mangësi në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, të lidhura me mosrespektimin e kushteve urbane, përfshirë distancat nga kufijtë e pronës dhe intensitetin maksimal të lejuar të ndërtimit. Gjithashtu, u evidentuan raste kur parcelat e vendosura në funksion të zhvillimit të objektit nuk kanë lidhje fizike ndërmjet tyre, si dhe raste kur dokumentacioni teknik dhe ai shoqëruar i projektit ndërtimor rezultoi i paplotë, në kundërshtim me përcaktimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Nga auditimi i organizimit dhe funksionimit të Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore u konstatua se nuk është ushtruar ri-inspektim në objektet me “leje pezullimi” apo “Vendim prishje”.

Në Bashkinë Fier

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri në 31.12.2023, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me kontabilizimin e pasaktë të llogarive dhe hartimin e pasqyrave financiare mbi baza informacioni jo të plotë. Nga auditimi u konstatua mbivlerësim i disa llogarive, përfshirë 520 “Disponibilitete në thesar” në vlerën 30,557 mijë lekë dhe 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në vlerën 776,688 mijë lekë, si dhe nënvlerësim i llogarive 468 “Debitorë të ndryshëm”, për shkak të mos përfshirjes së të gjitha kategorive të debitorëve, 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 33,579 mijë lekë, 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara” në vlerën 543 mijë lekë dhe 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” në vlerën 843,803 mijë lekë. Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” rezultoi e mbivlerësuar në vlerën 13,915 mijë lekë, për shkak të moskapitalizimit të këtyre vlerave në aktivet përkatëse ku janë



kryer investimet dhe që kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Po ashtu, nuk është pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar llogaria 470 “Llogari në pritje – të ardhura për t’u marrë”, e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për arkëtim, dhe nuk është kontabilizuar vlera 103,450 euro në zbatim të Marrëveshjes së Nënhuasë me MFE të lidhur më datë 13.02.2008. Llogaritë 230–231 “Investime në proces” rezultojnë me diferenca me llogaritë kundërparti 115 “Nga fondet e veta të investimeve” dhe 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme” për shumën 2,519,162 mijë lekë. Gjithashtu, u evidentua mosrealizim i procesit të inventarizimit për të gjitha aktivet e institucionit dhe aplikimi i normave të gabuar të amortizimit për disa llogari të aktiveve afatgjata, me ndikim në fondet neto të institucionit. Nga auditimi u konstatuan mangësi në informacionin kontabël për llogaritë 411 “Klientë e llogari të ngjashme”, 401–408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, 464 “Detyrime për t’u paguar për blerjen e letrave me vlerë” dhe 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, të cilat nuk janë analizuar dhe kanë ndikuar në saktësinë dhe besueshmërinë e informacionit kontabël.

Nga auditimi i përputhshmërisë i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinionin i kualifikuar**, referuar konstatimeve në lidhje me mungesën e një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si rezultat i mos hartimit të një kuadri të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim, si dhe mos marrja e masave dhe mekanizmave të nevojshëm për reduktimin e detyrimeve të prapambetura, me pasojë krijimin e detyrimeve të reja. Nga auditimi rezultuan mangësi në fushën e prokurimeve sa i takon hartimit të kriterëve të veçanta, të cilat nuk kanë qenë ngushtësisht të lidhura me natyrën dhe madhësinë e kontratës. Gjithashtu, u konstatua se janë kualifikuar, shpallur fitues dhe lidhur kontrata me operatorë ekonomikë, të cilët nuk kanë plotësuar kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit. Në fazën e zbatimit të kontratave janë konstatuar pagesa për punime të pakryera në shumën 10,796 mijë lekë pa TVSh. Në fushën e të ardhurave është konstatuar mos marrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2023 rezultoi një vlerë e pa arkëtuar prej 221,751 mijë lekë, e krijuar nga mos pagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat. Nga auditimi është konstatuar përdorim pa efektivitet të fondeve publike për pagesa që lidhen me procese gjyqësore në lidhje me largimet e padrejta nga puna të punonjësve, në shumën 13,000 mijë lekë. Nga auditimi u konstatuan mangësi në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, të lidhura me mosrespektimin e kushteve urbane, përfshirë distancat nga kufijtë e pronës dhe intensitetin maksimal të lejuar të ndërtimit. Gjithashtu, u evidentuan raste kur parcelat e vendosura në funksion të zhvillimit të objektit nuk kanë lidhje fizike ndërmjet tyre, si dhe raste kur dokumentacioni teknik dhe ai shoqëruar i projektit ndërtimor rezulton i paplotë, në kundërshtim me përcaktimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.



3.3 AUDITIME FINANCIARE

“**Auditim Financiar**” nënkupton një vlerësim të pavarur, që rezulton në një opinion me siguri të arsyeshme, nëse gjendja e raportuar financiare e një subjekti të audituar, rezultatet dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar. Ky auditim mbështetet kryesisht në standardet ISSAI 100 dhe ISSAI 200 për parimet themelore, në standardet e detajuara ISSAI 2000-2899 për kryerjen e auditimit, dhe në ISSAI 130/140 për etikën dhe cilësinë. Qëllimi i auditimit financiar është të rrisë shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, duke ofruar siguri të arsyeshme se ato janë hartuar, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar.

Opinion i pakualifikuar, në rastet kur arrihet në përfundimin se llogaritë vjetore janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar.

Opinion i kualifikuar, në rastet kur Pasqyrat Financiare përmbajnë gabime materiale dhe jo të përhapura, që çojnë në ndryshim të rezultatit financiar.

Opinion i kundërt, në rastet kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe përshtatshme dhe arrin në përfundimin se parregullsitë janë materiale dhe të përhapura.

Refuzim opinionioni, në rastet kur audituesi nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi.



63
Auditime



63
Opinione

- **4** opinione të pakualifikuara
- **11** opinione të pakualifikuara me theksim të çështjes
- **46** opinione të kualifikuara
- **2** opinione të kundërta



3.3 AUDITIME FINANCIARE

Në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, programi “Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbimet publike të standardit të lartë nëpërmjet operacionit Govtech”

Nga *auditimi financiar* i kryer për periudhën nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, nuk u evidentuan anomali ose mospërputhje materiale në kuadër të kornizës së zbatueshme financiare dhe u konkludua me dhënien e **opinionit të pakualifikuar**. Megjithatë, gjatë auditimit të procesit të marrjes dhe dorëzimit të aktiveve nga njësitë bazë të qeverisjes vendore, u konstatua se institucionet përkatëse (AKSHI, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe njësitë vendore) nuk kanë ngritur komisione të posaçme për marrjen në dorëzim të aktiveve, në përbërje të cilave të përfshiheshin specialistë të fushës përkatëse dhe jo më pak se tre anëtarë, problematikë kjo e konstatuar edhe në auditimin e mëparshëm të KLSH për pasqyrat financiare të programit Govtech për vitin 2023.

Në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

Nga *auditimi financiar* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 30.06.2025, KLSH ka konstatuar se pasqyrat financiare të subjektit paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar në datën 31.12.2024. Megjithatë, janë evidentuar disa çështje që kërkojnë theksim, të cilat, në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një **opinionit të pakualifikuar me theksim të çështjes**. Gjatë auditimit u konstatua se vlera e pasqyruar në llogarinë 520 ‘Disponibilitete në Thesar’, si mjete në ruajtje në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, nuk është reflektuar si e ardhur për t’u trashëguar dhe nuk është paraqitur e strukturuar sipas natyrës së saj në dokumentacionin shoqëruar të llogarisë vjetore. Nga auditimi u konstatua se për vitin 2024, ndonëse është ngritur komisioni i inventarizimit, përfshirja në përbërjen e tij e specialistit të Drejtorisë Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse nuk është në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore që lidhen me shmangien e konfliktit të interesit dhe respektimin e parimit të ndarjes së detyrave në sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Po ashtu, gjatë auditimit u evidentuan mangësi në drejtim të planifikimit dhe zbatimit të buxhetit, ku u konstatuan urdhër shpenzime të cilat janë likuiduar nga ana e KPA-së në tejkallim të afatit ligjor 30-ditor, duke mos respektuar disiplinën financiare dhe kërkesat e kuadrit ligjor për menaxhimin e fondeve publike.

Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (GJAJP)

Nga *auditimi financiar* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 30.06.2025, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka konstatuar se pasqyrat financiare të subjektit paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar në datën 31.12.2024. Megjithatë, janë evidentuar disa çështje që kërkojnë theksim, të cilat, në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një **opinionit të pakualifikuar me theksim të çështjes**. Megjithatë, gjatë auditimit u konstatua se, procedura e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve është kryer faktikisht përpara marrjes së miratimit përkatës, dhe përpara ngritjes së komisionit të autorizuar për këtë proces. Vendimet gjyqësore të formës së prerë nuk janë njohur në kontabilitet në momentin e lindjes së detyrimit, por vetëm në momentin e likuidimit të tyre. Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se një pjesë e vendimeve gjyqësore nuk janë ekzekutuar në mënyrë vullnetare nga institucioni, por nëpërmjet procedurave përmbartimore, në vlerën totale prej 1,223 mijë lekë, të cilat përbëjnë shpenzim pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficiencë në përdorimin e fondeve publike.



Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

Nga *auditimi financiar* i kryer për periudhën e veprimtarisë 01.01.2023 – 30.06.2025, KLSH ka konstatuar se pasqyrat financiare të subjektit paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar në datën 31.12.2024. Megjithatë, janë evidentuar disa çështje që kërkojnë theksim, të cilat, në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një **opinionit të pakualifikuar me theksim të çështjes**. Gjatë auditimit u konstatua se detyrimet e pasqyruara në llogarinë 423/429 ‘Personeli, paradhënie, deficite, gjoba’ rezultojnë të mbartura prej vitit 2000, pa dokumentacion shoqërues dhe pa informacion analitik të mjaftueshëm për identifikimin e debitorëve, duke mos mundësuar marrjen e masave për arkëtimin, sistemimin dhe paraqitjen e saktë të tyre në pasqyrat financiare. Detyrimi i regjistruar në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk rezultoi të jetë ndjekur në rrugë gjyqësore nga institucioni, nuk rezultoi që të jenë marrë masa për arkëtimin e tyre, duke ndjekur të gjitha veprimet ligjore, me risk në parashkrim. Gjithashtu, u konstatua se një pjesë e aktiveve të regjistruara në kontabilitet paraqiten me vlerë të mbetur shumë të ulët për shkak të amortizimit të akumuluar, ndonëse ato vijnë të jenë funksionale dhe në përdorim, pa u ndërmarrë masa për rivlerësimin e tyre, duke ndikuar në paraqitjen jo të plotë të vlerës reale të tyre.

Në Universitetin e Tiranës (Rektorati)

Nga *auditimi financiar* i kryer për periudhën nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2023, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare individuale dhe të konsoliduara paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit dhe rezultatet e operacioneve dhe flukseve monetare në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për raportimin financiar për të cilat është dhënë **opinion i pakualifikuar**. Megjithatë, nga auditimi u konstatuan mangësi që lidhen me mos marrjen e masave për vlerësimin e debitorëve të krijuar në vite dhe të pasqyruar në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, mosrealizimin e procedurave të regjistrimit të pasurisë dhe pajisjes me certifikata pronësie për disa objekte, të cilat rezultojnë në proces regjistrimi, si dhe mungesë informacioni mbi vlerën e pasqyruar në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, që përfaqëson garanci të mbajtura për punime të projekteve të realizuara në vite të mëparshme.

Në shoqërinë “Trajtimi i Studentëve” Gjirokastër

Nga *auditimi financiar* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 01.10.2025, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar mangësive në kryerjen e inventarizimit për të gjithë Aktivet Afatgjata Materiale (AAM), si dhe në plotësimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve që institucioni ka në pronësi apo në posedim. Po ashtu, në gjendjen e AAM nuk është përfshirë investimi i kryer nga Agjencia Turke (TIKA) që prej vitit 2019 dhe nuk janë kryer përditësimet përkatëse në lidhje me aplikimin e normave të amortizimit. Në datën 31.12.2024 është kontabilizuar vlera prej 6,967 mijë lekë si llogari të arkëtueshme që i përket debitorëve të pa mbledhur, ndërkohë që shoqëria nuk disponon dokumentacion për vlerësimin e riskut të mosarkëtimit nëpërmjet përlllogaritjes së provizioneve. Gjithashtu, pasqyrat financiare nuk ishin depozituar pranë Degës së Thesarit. Struktura organizative dhe niveli i pagave nuk janë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme Aksionare dhe nuk është nënshkruar kontrata individuale e punës së Administratorit me Këshillin Mbikëqyrës. Gjithashtu, nuk është respektuar raporti 1 punonjës për 11 studentë. Nga auditimi rezultoi se nuk disponohet bazë ligjore për hartimin e programit ekonomik financiar pas kalimit të institucionit në varësi të Këshillit Bashkiak. Programet ekonomike financiare janë hartuar dhe realizuar në kushte pamjaftueshmërie financiare. Gjithashtu, u evidentua se shoqëria paraqet humbje të mbartur në vlerën 56,548 mijë lekë. Nga auditimi i



veprimeve të kryera në bankë, vlera 671 mijë lekë e klasifikuar me objekt “Shpenzime honorare”, është shpenzuar duke shmangur rregullat e prokurimit publik, pasi nga verifikimi rezultoi se kjo pagesë nuk i përket natyrës së shpenzimeve për honorare, por lidhet me marrjen në punë të punonjësve të jashtëm me kontratë shërbimi.

Në shoqërinë “Trajtimi i Studentëve” Korçë

Nga *auditimi financiar* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 01.10.2025, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar konstatimeve në humbjet respektivisht për vitin 2022 në vlerën 13,102 mijë lekë, për vitin 2023 në vlerën 8,938 mijë lekë dhe për vitin 2024 në vlerën 4,156 mijë lekë. Regjistrimet e veprimeve kontabël kryer në Excel dhe jo nëpërmjet programeve informatike. U konstatua se nxjerrja e aktiveve jashtë përdorimit nuk është dokumentuar për mënyrën e asgjësimit, transportit dhe vendin e asgjësimit, ndërkohë që aktivet e klasifikuara për skrap nuk janë bërë hyrje në magazinë. Po ashtu, nuk është plotësuar regjistri i aktiveve që institucioni ka në pronësi apo posedim. Nga auditimi rezultoi se struktura organizative dhe niveli i pagave nuk janë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme Aksionare dhe nuk është respektuar raporti 1 punonjës për 11 studentë. Gjithashtu, subvencionimi nga MAS nuk është kryer në referencë të situacionit të shpenzimeve mujore. U evidentua se Rregullorja nuk është paraqitur pranë Këshillit Mbikëqyrës për miratim dhe nuk përmban rregullat për regjistrimin e studentëve apo personave që do të përdorin konviktin. Programet ekonomike janë hartuar dhe realizuar në kushte pamjaftueshmërie financiare, duke mos mundur realizimin e investimeve dhe shpenzimeve operative të parashikuara ndër vite për mirëmbajtjen e godinave të konvikteve. Në fazën e zbatimit të kontratave për shërbime është konstatuar mungesa e urdhrat nga Administratori mbi caktimin e një personi apo komisioni për ndjekjen dhe monitorimin e kontratës.

Në shoqërinë “Trajtimi i Studentëve” Shkodër

Nga *auditimi financiar* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 01.10.2025, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**. referuar mangësive në plotësimin dhe përditësimin e regjistrit të aktiveve që institucioni ka në pronësi ose në administrim, u konstatua se mbyllja e gjendjes nuk përputhet me çeljen e saj. Konkretisht, për zërat “Ndërtime”, “Impiante dhe makineri” dhe “Të tjera instalime dhe pajisje” është kontabilizuar vlera prej 634 mijë lekë, si llogari e arkëtueshme, e cila i përket debitorëve të paarkëtuar. Për këta debitorë shoqëria nuk disponon dokumentacion për vlerësimin e riskut të mosarkëtimit nëpërmjet përlllogaritjes së provizioneve. Pasqyrat financiare nuk janë depozituar pranë Degës së Thesarit. U konstatua gjithashtu se shërbimi kontabël është realizuar përmes regjistrimeve të veprimeve kontabël në Excel dhe jo nëpërmjet programeve informatike. Po ashtu, nuk është nënshkruar kontrata individuale e punës së Administratorit me Këshillin Mbikëqyrës. Nga auditimi u evidentua se Rregullorja e Brendshme e Shoqërisë nuk përmban rregullat për regjistrimin e studentëve apo personave që do të përdorin konviktin. Gjithashtu, nuk është respektuar raporti 1 punonjës për 11 studentë dhe subvencionimi nga MAS nuk është kryer në referencë të situacionit të shpenzimeve mujore të realizuara nga shoqëria.

Në shoqërinë “Trajtimi i Studentëve” Elbasan

Nga *auditimi financiar* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri në 01.10.2025, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor,



nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar mangësive në llogaritë e pasqyrave financiare, të cilat nuk janë të rakorduara me gjendjen fizike, si dhe nuk është plotësuar regjistri i aktiveve që shoqëria ka në pronësi apo posedim, sipas kërkesave minimale që duhet të përmbajë ky regjistër. Në gjendjen e Aktiveve Afatgjata Materiale (AAM) nuk është përfshirë në inventar investimi i kryer nga Agjencia Turke (TIKA) që prej vitit 2019, për të cilin shoqëria nuk disponon dosjen teknike përkatëse. Gjithashtu, nuk janë kryer përditësimet përkatëse në lidhje me aplikimin e normave të amortizimit për aktivet afatgjata materiale. U konstatua gjithashtu se nuk disponohet një bazë e mirëfilltë ligjore për hartimin e programit ekonomik-financiar. Programet ekonomik-financiare janë hartuar dhe realizuar në kushte pamjaftueshmërie financiare, pasi aktiviteti i shoqërisë nuk mbulohet plotësisht nga buxheti. Nga auditimi u evidentua gjithashtu se për auditimin dhe certifikimin e pasqyrave financiare të Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve” Elbasan për vitet 2023–2024, ekspertët kontabël nuk janë emëruar me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të Bashkisë Elbasan.

Në shoqërinë “Trajtimi i Studentëve” Vlorë

Nga *auditimi i financiar* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri në 01.10.2025, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë të pozicionit financiar më 31.12.2024. Megjithatë, janë evidentuar disa çështje që kërkojnë theksim, të cilat, në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një **opinionit të pakualifikuar me theksim të çështjes**, që lidhen me mangësi në miratimin e pasqyrave financiare nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, edhe pse pasqyrat janë dërguar nga Shoqëria “Trajtimi i Studentëve” Vlorë, si dhe me hartimin dhe realizimin e programeve ekonomik-financiare në kushte pamjaftueshmërie financiare, ndërkohë që nuk disponohet një bazë e mirëfilltë ligjore për hartimin e programit ekonomik-financiar.

Në Agjencinë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizimeve (AKUK), mbi programin kombëtar të modernizimit të sektorit të ujësjetllës kanalizimeve në Shqipëri

Nga *auditimi financiar* i kryer në Agjencinë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizimeve (AKUK), mbi programin kombëtar të modernizimit të sektorit të ujësjetllës kanalizimeve në Shqipëri, për periudhën nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH nuk ka evidentuar devijime materiale, por disa çështje që kërkojnë theksim, të cilat, në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një **opinionit të pakualifikuar me theksim të çështjes**. Theksimi i çështjes lidhet me faktin se, mungon një sistem i konsoliduar për administrimin dhe koordinimin e dokumentacionit financiar ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizimeve dhe njësive zbatuese në nivel vendor, si dhe evidentohen dobësi në mekanizmat e kontrollit të brendshëm për mbledhjen, ruajtjen dhe vënien në dispozicion në kohë të këtij dokumentacioni. Gjithashtu, pasqyrat financiare të Agjencisë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizimeve përgatiten dhe mbahen manualisht në Excel, pa qenë të integruara me sistemin e Thesarit apo me programe të dedikuara financiare, çka ka sjellë mosrakordimin e vlerave të urdhër-shpenzimeve për projektet e zhvilluara nga bashkitë dhe ujësjetllësit me vlerat e raportuara nga Banka Botërore.

Në Entin Kombëtar të Banesave

Nga *auditimi financiar* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri në 01.10.2025, KLSH ka evidentuar devijime materiale, dhe jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, referuar mangësive në lidhje me regjistrin e aktiveve afatgjata materiale, i cili nuk përmban informacion për identifikim të saktë, të dhëna ekonomike, mbi pronësinë, si dhe identifikimin



e personit përgjegjës për secilin aktiv. Në analizën e llogarisë “Të drejta të arkëtueshme dhe të tjera” u konstatua se shoqëria nuk disponon një metodologji të miratuar dhe të unifikuar për zhvlerësimin (provigjonimin) e klientëve. Gjithashtu, në listën e klientëve debitorë të paraqitur për arkëtim përfshihen edhe detyrime që i përkasin periudhave që prej vitit 1995, të cilat paraqiten si detyrime të prapambetura të vjetra, dhe me probabilitet të ulët arkëtimi, ndërkohë që për to nuk është kryer rivlerësim kontabël për njohjen e humbjeve nga zhvlerësimi apo çregjistrimi nga pasqyrat financiare.

Në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes

Nga *auditimi financiar* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 30.06.2025, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë të pozicionit financiar më 31.12.2024, megjithatë janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të cilat justifikojnë dhënien e një **opinionit të pakualifikuar me theksim çështje**. Theksimi i çështjes lidhet me me faktin se një pjesë e konsiderueshme e llogarive të arkëtueshme rezultoi e mbartur prej më shumë se 3 deri në 5 vite, pa u shoqëruar me veprime të dokumentuara dhe të vazhdueshme për ndjekje administrative apo ligjore, duke rritur riskun e mosarkëtimit. Gjithashtu, në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” paraqitet e regjistruar, që prej vitit 2013, një vlerë e pandryshuar, e pambështetur me dokumentacion justifikues, duke krijuar pasiguri mbi saktësinë dhe besueshmërinë e paraqitjes së pozicionit financiar.

Në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore

Nga *auditimi financiar* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri me datën 30.06.2025, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me mangësi në mbajtjen e kontabilitetit dhe përgatitjen e pasqyrave financiare. Për periudhën objekt auditimi, llogaria materiale për shërbimin e armatimit është administruar vetëm në sasi dhe jo në vlerë, në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe me udhëzimet për kontabilitetin e sektorit publik, duke ndikuar në saktësinë dhe besueshmërinë e informacionit kontabël të paraqitur në pasqyrat financiare. Gjithashtu, është konstatuar moskontabilizim i saktë i llogarive kontabël në përputhje me udhëzimet e miratuara për kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare. Konkretisht, në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” nuk janë paraqitur detyrimet që rrjedhin nga totali i llogarive 421–436, të cilat në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024 rezultojnë në vlerën 21,161 mijë lekë, ndërkohë që në bilanc janë paraqitur vetëm në vlerën 300 mijë lekë. Teprica e llogarisë “Debitorët e ndryshëm” në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 1,192 mijë lekë, ndërsa gjatë periudhës dyvjeçare 01.01.2023 – 31.12.2024 niveli i arkëtimit të këtyre detyrimeve rezulton në vlerën 245 mijë lekë, ose rreth 18% e totalit. Nga auditimi rezultoi se vlera neto totale e aktiveve e paraqitur në dokumentin “Regjistri i Aktiveve” nuk përputhej me vlerën neto të aktiveve të pasqyruar në Pasqyrat Financiare të Llogaridhënies Vjetore (Formati 7/b). Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” është pasqyruar në bilanc me vlerë 0 lekë, për shkak të moskontabilizimit të vlerës së truallit në administrim të institucionit, duke ndikuar në plotësinë dhe saktësinë e informacionit kontabël të paraqitur në pasqyrat financiare. Gjithashtu, mungonte gjurma e rakordimit periodik të librave/partitarëve analitikë të aktiveve ndërmjet Sektorit të Buxhetit dhe Financës dhe magazinierit përgjegjës për administrimin e aktiveve dhe armatimit. Po ashtu, nuk ishte hartuar lista e aktiveve për inventarizim në bazë të regjistrave kontabël. Është konstatuar përdorim pa efektivitet i fondeve publike për pagesa që lidhen me procese gjyqësore në lidhje largimet e padrejta nga puna të punonjësve, në shumën 14,001 mijë lekë.



Në shoqërinë Albafilm

Nga *auditimi financiar* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 30.09.2025, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë të pozicionit financiar më 31.12.2024. Megjithatë, janë evidentuar disa çështje që kërkojnë theksim, të cilat, në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një **opinionit të pakualifikuar me theksim të çështjes**. Theksimi i çështjes lidhet me administrimin dhe analizimin e disa llogarive kontabël. Konkretisht, nuk është kryer analizimi i llogarisë “Klientë mbi një vit”, e pasqyruar në vlerën 7,747 mijë lekë, si dhe i llogarive “Debitorë dhe kreditorë të ndryshëm”, të paraqitura në vlerën 26,555 mijë lekë, dhe “Të ardhura të shtyra”, të pasqyruara në vlerën 27,026 mijë lekë. Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” është kontabilizuar si një aktiv i vetëm, me sipërfaqe totale 15,487 m², pa u evidentuar në mënyrë analitike sipas pasurive përkatëse dhe pa u lidhur me dokumentacionin ligjor që provon të drejtat e pronësisë. U konstatua se llogaritë e klasës 3 “Inventarët” për periudhën 2024 nuk i janë nënshtruar procedurës së vlerësimit për zhvlerësim, në përputhje me kërkesat e standardeve dhe udhëzimeve për kontabilitetin në sektorin publik.

Në Drejtorinë e Përgjithshme Detare Durrës

Nga *auditimi financiar* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 30.09.2025, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë të pozicionit financiar më 31.12.2024. Megjithatë, janë evidentuar disa çështje që kërkojnë theksim, të cilat, në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një **opinionit të pakualifikuar me theksim të çështjes**. Theksimi i çështjes lidhet me trajtimin kontabël të disa zërave të aktiveve dhe detyrimeve. Konkretisht, janë kontabilizuar 3 (tre) ngurtësime në vlerën 2,182 mijë lekë në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, për të cilat rezultoi se ka kaluar afati i ngurtësimit pa u kryer veprimet përkatëse kontabël për sistemimin e tyre. Në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstrukcione” janë kontabilizuar ndërtesat së bashku me vlerat e rikonstrukcioneve të realizuara ndër vite, pa u evidentuar në mënyrë të veçantë sipas natyrës së investimit. Nga verifikimet rezultoi se këto aktive, ndonëse ishin në përdorim të institucionit, nuk shoqëroheshin me dokumentacion pronësie që të vërtetonte të drejtat e pronësisë mbi to.

Në Bashkinë Berat

Nga *auditimi financiar* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kundërt**. Këto pasaktësi lidhen me mangësi në proceset e inventarizimit, regjistrimit dhe rakordimit të llogarive kontabël, si dhe në pasqyrimin e saktë të zërave të pasqyrave financiare. Konkretisht, u evidentuan mangësi në procedurat e inventarizimit të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, si dhe mungesë informacioni për 59 projekte të kontabilizuara në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”, me vlerë 85,469 mijë lekë (kosto historike). Në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk ishte kontabilizuar vlera e debitorëve nga taksat dhe tarifat në shumën 43,620 mijë lekë, si dhe detyrimet nga qiraja/shfrytëzimi i fondit pyjor/kullosor në vlerën 126,595 mijë lekë, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara në vlerën totale 170,215 mijë lekë. Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” paraqitej e mbivlerësuar në vlerën 155,966 mijë lekë, për 8 objekte që i përkasin Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat SH.A. Gjithashtu, u evidentua nënvlerësim i llogarisë 85 “Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në vlerën 35,175 mijë lekë, si dhe i llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” në vlerën 78,710 mijë lekë, si dhe mosrakordimi ndërmjet Pasqyrës së Flukseve Monetare (“Cash Flow”) dhe shpenzimeve buxhetore në vlerën 740,846 mijë lekë. U konstatua pasqyrim i pasaktë i llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe i llogarisë 606 “Transferime për



buxhetet familjare dhe individë”, të cilat nuk rakordonin me të dhënat e thesarit përkatësisht në vlerat 1,195 mijë lekë dhe 11,949 mijë lekë. Po ashtu, u evidentua pasqyrim i pasaktë i llogarive 16, 17, 18 “Huatë afatgjata” në vlerën 4,206 mijë lekë, llogarisë 470 “Llogari në pritje – të ardhura për t’u marrë” në vlerën 113,359 mijë lekë, llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në vlerën 68,645 mijë lekë dhe llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në vlerën 66,204 mijë lekë, duke ndikuar në paraqitjen jo të saktë të pasqyrës së pozicionit financiar në pasqyrat e konsoliduara të institucionit. Gjithashtu, gjendja e llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” dhe e llogarisë 230 “Investime për aktive afatgjata jomateriale” nuk rakordonte me llogaritë kundërpanti 115 “Nga fondet e veta të investimeve” dhe 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme”, duke rezultuar një diferencë prej 123,500 mijë lekë. Është konstatuar përdorim pa efektivitet të fondeve publike për pagesa që lidhen me procese gjyqësore në lidhje me largimet e padrejta nga puna të punonjësve, në shumën 14,207 mijë lekë.

Në Bashkinë Bulqizë

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me mangësi në mosrakordim të llogarive dhe keqklasifikime të diferencave të tyre në pasqyrat financiare. Konkretisht, rezultoi mospërputhje ndërmjet llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale (investime në proces)” të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar dhe llogarive kundërpanti 106 “Teprica e granteve kapitale të huaja” dhe 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme” në fondin e konsoliduar, për shumën 114,866 mijë lekë. Kjo llogari nuk rezultoi e rakorduar edhe me shtesat e aktiveve afatgjata materiale pas kapitalizimeve të paraqitura në pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve afatgjata, për shumën 24,514 mijë lekë. U evidentua mospërputhje ndërmjet llogarisë 105 “Grante kapitale të brendshme nga buxheti” dhe zërit “Akordim fonde buxhetore për shpenzime kapitale (+)” në pasqyrën e flukseve monetare, në shumën 223,558 mijë lekë, diferencë e lidhur me fondet e trashëguara. Nga auditimi rezultoi mospërputhje në shumën 14,938 mijë lekë ndërmjet të ardhurave jotatimore të paraqitura në pasqyrën e performancës dhe të ardhurave të së njëjtës natyrë të raportuara në pasqyrën e rezultatit. U konstatua pasqyrim jo i saktë i rezultatit të veprimtarisë për vitin ushtrimor në shumën 26,956 mijë lekë, që lidhej me të ardhura të transferuara, të cilat duhej të ishin trajtuar në zërin “Shpenzime të tjera”, si veprime rregulluese për përcaktimin e rezultatit financiar. U evidentua gjithashtu nënvlerësim i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në shumën 39,220 mijë lekë, e përbërë nga taksa dhe tarifa vendore në shumën 2,442 mijë lekë, taksa e ndikimit në infrastrukturë në shumën 940 mijë lekë; tarifa e autorizim/licencës për tregtimin e karburanteve në shumën 5,800 mijë lekë, si dhe tarifa e qirasë nga kontratat e qiradhënies së parcelave nga fondi pyjor/kullor në shumën 30,038 mijë lekë. Në fushën e të ardhurave është konstatuar mos marrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një vlerë e pa arkëtuar prej 109,625 mijë lekë, prej të cilave vlera 9,691 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2024, nga mospagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat.

Në Bashkinë Cërrik

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me kontabilizimin e pasaktë të disa llogarive, me ndikim në saktësinë e pasqyrimit të aktiveve dhe fondeve neto të institucionit. Konkretisht, llogaria 101 “Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar” paraqitet e nënvlerësuar për vlerën 78,961 mijë lekë, llogaria 4342 “Të tjera



operacione me shtetin (debitor)” paraqitet e nënvlerësuar për vlerën 142,766 mijë lekë, si dhe llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione” paraqitet e mbivlerësuar për vlerën 39,521 mijë lekë. Është konstatuar përdorim pa efektivitet të fondeve publike për pagesa që lidhen me procese gjyqësore në lidhje me largimet e padrejta nga puna të punonjësve, në shumën 1,893 mijë lekë. Në fushën e të ardhurave është konstatuar mos marrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një vlerë e pa arkëtuar prej 97,795 mijë lekë, e krijuar nga mospagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat.

Në Bashkinë Delvinë

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë të pozicionit financiar më 31.12.2024. Megjithatë, janë evidentuar disa çështje që kërkojnë theksim, të cilat, në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një **opinionit të pakualifikuar me theksim të çështjes**. Për pronat e transferuara sipas VKM-ve përkatëse, nga bashkia nuk janë ndjekur procedurat për regjistrimin, vlerësimin dhe pasqyrimin e tyre në regjistrat kontabël. Nga 391 pasuri të transferuara, vetëm për 9 prej tyre është kryer aplikimi për regjistrim pranë ASHK-së. Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se ekzistojnë mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Konkretisht, mungojnë procedurat për sinjalizimin e rasteve të parregullsive, mashtrimeve dhe veprimeve korruptive, si dhe raportimet periodike për monitorimin e planit të veprimit të kontrollit të brendshëm. Nga auditimi u konstatua se nuk janë përcaktuar objektiva konkrete dhe të matshëm, mungonte një program strategjik dhe vjetor për trajnimin dhe zhvillimin e stafit, si dhe nuk ishte kryer vlerësimi i riskut të mashtrimit, për shkak të mungesës së politikave dhe procedurave për menaxhimin e këtij risku. Në fushën e të ardhurave është konstatuar mos marrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një vlerë e pa arkëtuar prej 93.304 mijë lekë, prej të cilave vlera 13,119 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2024, nga mospagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat.

Në Bashkinë Devoll

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto gabime materiale lidhen me pasaktësitë në kontabilizimin e disa llogarive. Konkretisht, llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione” është paraqitur e mbivlerësuar në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 119,680 mijë lekë. Po ashtu, llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata” rezultoi e mbivlerësuar në shumën 271,112 mijë lekë, pasi 36 investime janë kontabilizuar me vlerën e mbetur të kontratave dhe jo me vlerën reale të investimeve të realizuara.

Në Bashkinë Dimal

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me moskontabilizimin e aktiveve, regjistrimin e saktë të të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe pasqyrimin korrekt të transaksioneve kontabël në pasqyrat financiare. Konkretisht, janë konstatuar mos kryerje e kontabilizimeve të trojeve, parcelave bujqësore dhe guroreve. Rezultati i periudhës kontabël nuk është pasqyruar saktë në shumën 51,951 mijë lekë, për shkak të mospërfshirjes në “Shpenzime të tjera” të operacioneve të korigjimit të rezultatit,



përfshirë transferimet e të ardhurave në buxhet, derdhjen e të ardhurave të papërdorura dhe caktimin e të ardhurave të funksionit për investime. Po ashtu, është evidentuar se investimet e përfunduara nuk janë kapitalizuar në aktivet afatgjata për një vlerë prej 9,258 mijë lekë. Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” rezulton e nënvlerësuar për 5,516 mijë lekë, si pasojë e moskontabilizimit të detyrimeve për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë”.

Në Bashkinë Divjakë

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri në 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me mangësi në paraqitjen dhe klasifikimin e disa zërave kontabël. Konkretisht, në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” janë evidentuar pesë projekte në vlerën 6,570 mijë lekë, të cilat vazhdojnë të mbahen të regjistruara në këtë llogari, megjithëse investimet përkatëse janë përfunduar në vitet e mëparshme dhe nuk janë klasifikuar në llogaritë përkatëse të aktiveve materiale. Po ashtu, në llogarinë 210 “Troje, toka, terrene” janë përfshirë tre aktive në vlerën 2,553 mijë lekë që duhej të kontabilizoheshin në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”, ndërsa në llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione” janë përfshirë aktive që duhej të kontabilizoheshin në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”. Nga auditimi u evidentua moszbatim i normave të amortizimit për llogaritë 210 “Troje, toka, terrene” dhe 218 “Inventar ekonomik”, në kundërshtim me normat e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Gjithashtu, u konstatua mbivlerësim i llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kaptalet e veta” në vlerën 353,975 mijë lekë, si dhe mbivlerësim i llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata”.

Në Bashkinë Durrës

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me kontabilizimin e pasaktë të llogarive në pasqyrën e pozicionit financiar. Konkretisht, llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” ishte e nënvlerësuar për 27,228 mijë lekë, llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” për 380,511 mijë lekë, ndërsa llogaria 210 “Toka, troje, terrene” dhe llogaria 211 “Pyje, plantacione” rezultuan të mbivlerësuar për 2,508 mijë lekë dhe 22,685 mijë lekë. Gjithashtu, llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe llogaria 218 “Inventar ekonomik” ishin të nënvlerësuar për 15,267 mijë lekë dhe 40,445 mijë lekë, ndërsa llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” rezultoi e mbivlerësuar për 34,791 mijë lekë.

Në Bashkinë Elbasan

Nga auditimi financiar i kryer në Bashkinë Elbasan për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, nga KLSH është evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me mangësi në regjistrimin dhe klasifikimin kontabël të disa llogarive, si dhe me pasqyrimin jo të saktë të informacionit financiar. Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitet e nënvlerësuar, pasi nuk janë kontabilizuar në total vlera 82,739 mijë lekë e cila është gjithashtu e ardhur e munguar për buxhetin e bashkisë dhe lidhet me debitorët e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 17,714 mijë lekë, gjobat e IMTV-së për 21 subjekte në vlerën 52,657 mijë lekë, si dhe debitorët nga kontratat e qirasë së fondit pyjor-kullosor në vlerën 12,369 mijë lekë. Në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” janë paraqitur 14 projekte në vlerën 41,908 mijë lekë (kosto historike), të cilat nuk janë analizuar



sipas investimeve përkatëse që u përkasin, ndërsa për 45 projekte në vlerën 127,030 mijë lekë nuk disponohet informacion në lidhje me përfundimin e objekteve përkatëse. Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” paraqitet e mbivlerësuar, pasi 33 objekte në vlerën 516,441 mijë lekë, të pasqyruara në këtë llogari, përfaqësojnë në fakt asete të ujësjellësit, të cilat duhet të klasifikoheshin në llogaritë përkatëse. Llogaritë 16, 17, 18 “Hua afatgjata”, sipas pasqyrës së pozicionit financiar të pasqyrës së konsoliduar, nuk rakordojnë me të dhënat e thesarit, duke paraqitur një diferencë në vlerën 110,617 mijë lekë. Gjithashtu, janë konstatuar keqklasifikime të transaksioneve të të ardhurave dhe shpenzimeve në pasqyrën e performancës financiare, me ndikim në paraqitjen jo të saktë dhe të besueshme të rezultateve financiare të periudhës.

Në Bashkinë Fier

*Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me nënvlerësimin e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, si pasojë e moskontabilizimit të detyrimeve të individëve dhe subjekteve, në vlerën 551,025 mijë lekë. Gjithashtu, të ardhurat e periudhës rezultojnë të mbivlerësuara në shumën 608,251 mijë lekë, për shkak të përfshirjes në kontabilitet të të ardhurave të trashëguara nga periudhat e mëparshme. U konstatua pasqyrim jo i saktë i rezultatit të veprimtarisë për vitin ushtrimor në shumën 175,111 mijë lekë, që lidhet me të ardhura të transferuara, të cilat duhej të ishin trajtuar në zërin “Shpenzime të tjera”, si veprime rregulluese për përcaktimin e rezultatit financiar.*

Në Bashkinë Finiq

*Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me moskontabilizimin e blerjeve në shumën 32,182 mijë lekë, si dhe me mosparaqitjen e saktë të rezultatit të periudhës kontabël në shumën 11,084 mijë lekë, si pasojë e përdorimit të të ardhurave të veta për financimin e investimeve. Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatuan mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Konkretisht, nga auditimi rezultoi se mungonte strategjia e menaxhimit të riskut dhe regjistri i riskut, nuk ishte ngritur një sistem i brendshëm raportimi për shkeljet e rregullave apo rastet e mundshme të mashtrimit, nuk ishte hartuar një plan vjetor rekrutimi, si dhe mungonte gjurma e auditimit dhe harta e proceseve kryesore, duke kufizuar aftësinë për monitorim efektiv, parandalimin e shkeljeve dhe mbrojtjen e burimeve publike. Nga auditimi i veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm u konstatuan mangësi në plotësimin e inventarëve të dosjeve sipas Manualit të Auditimit të Brendshëm, si dhe në planin vjetor të auditimit nuk janë përfshirë disa fusha kritike, si hartimi i programeve të veçanta mbi prokurimet publike.*

Në Bashkinë Fushë Arrëz

*Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë të pozicionit financiar më 31.12.2024. Megjithatë, janë evidentuar disa çështje që kërkojnë theksim, të cilat, në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një **opinionit të pakualifikuar me theksim të çështjes**. Theksimi i çështjes lidhet me nivelin e lartë të debitorëve të evidentuar në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, që burojnë nga detyrime të papaguara për taksa dhe tarifa vendore. Në datën 31.12.2024, debitorët për taksa*



vendore rezultuan në shumën 51,885 mijë lekë, ndërsa shtesa e tyre gjatë vitit 2024 për tatime dhe taksa rezultoi në vlerën 5,124 mijë lekë. Nga auditimi u konstatua gjithashtu pasqyrim jo i saktë i llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” në mbyllje të vitit ushtrimor 2024, në vlerën 122,100 mijë lekë, pasi kjo llogari nuk reflektonte ndryshimet që lidhen me aksionet e Bashkisë Fushë-Arrëz në Shoqërinë Rajonale të Ujësjellës-Kanalizimeve.

Në Bashkinë Has

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me paraqitjen e pasaktë dhe keqklasifikimin e disa zërave kontabël. Konkretisht, nga auditimi rezultoi se në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” nuk ishin përfshirë detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore, të cilat në fund të vitit 2024 rezultuan në vlerën 277 mijë lekë. Po ashtu, nga auditimi rezultoi se në llogarinë nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” nuk është regjistruar vlera prej 660 mijë lekë e aksioneve që zotëron Bashkia Has në “Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Kukës SH.A.”, duke bërë që gjendja e kësaj llogarie në fund të vitit 2024 të mos paraqitej saktë. Është konstatuar përdorim pa efektivitet të fondeve publike për pagesa që lidhen me procese gjyqësore në lidhje me largimet e padrejta nga puna të punonjësve, në shumën 108 mijë lekë. Në fushën e të ardhurave u konstatuan mangësi në arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një shumë e paarkëtuar prej 89,783 mijë lekë, prej të cilave vlera 19,322 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2024, nga mospagesa e taksapaguesve familjarë dhe privatë.

Në Bashkinë Kamëz

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë të pozicionit financiar më 31.12.2024. Megjithatë, janë evidentuar disa çështje që kërkojnë theksim, të cilat, në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një **opinionit të pakualifikuar me theksim të çështjes**. Theksimi i çështjes lidhet me pasaktësitë në klasifikimin e aktiveve, rritjen e gjendjes së llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e lidhur me debitorët për taksa dhe tarifa vendore, si dhe raste të likuidimit të faturave jashtë afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në Bashkinë Kavajë

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me mosrakordimin, keqklasifikimin dhe paraqitjen jo të saktë të disa zërave kontabël, me ndikim në saktësinë dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare. Konkretisht, nga auditimi rezultoi se disa llogari kontabël nuk janë analizuar në mënyrë të detajuar, si llogaritë 411 “Klientë e llogari të ngjashme”, 423/429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba (debitor)”, 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, kullota, plantacione” dhe 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, duke ndikuar në saktësinë e informacionit kontabël. Po ashtu, debitorët nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk janë pasqyruar në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, ndërsa llogaria 470 “Llogari në pritje – të ardhura për t’u marrë” nuk është reflektuar në momentin e konstatimit të të drejtës për arkëtim. Gjithashtu, u konstatuan pasaktësi në trajtimin e aktiveve dhe investimeve, ku llogaria 202 “Studime dhe kërkime” rezultoi e mbivlerësuar në vlerën 122,396 mijë lekë, ndërsa aktivet afatgjata materiale të trashëguara nga ish-komunat Kavajë nuk janë analizuar në mënyrë të plotë. Po ashtu, nuk



dokumentohen pakësimet e kryera në llogarinë 231 “Për aktive afatgjata materiale”, ndërsa shumat e llogarive 230-231 nuk përputhen me llogaritë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” dhe 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme”. Në vijim, u konstatua se llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar/Deficiti i akumuluar)” rezultoi e nënvlerësuar në vlerën 494,125 mijë lekë.

Në Bashkinë Këlcyrë

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar, me rezervë**. Këto pasaktësi lidhen me mangësi në procedurat e inventarizimit, keqklasifikim dhe paraqitje jo të saktë të aktiveve afatgjata, materiale dhe jomateriale, si dhe me mosmarrje të masave të plota për arkëtimin e debitorëve, duke ndikuar në saktësinë dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare. Konkretisht, llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” është nënvlerësuar me 55,561 mijë lekë, për shkak të mos përfshirjes së gjendjes së debitorëve për taksën e tokës. Në llogarinë 218 “Inventar ekonomik” është përlllogaritur amortizimi me normë 20% në grup, pa bërë ndarjen e nënlllogarisë 218/6 “Pajisje kompjuterike”, për të cilën duhet të ishte aplikuar norma 25%. Llogaria 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” është nënvlerësuar me 6,800 mijë lekë, si pasojë e mosregjistrimit të likuidimit të pjesshëm të investimeve. Në fushën e të ardhurave u konstatuan mangësi në arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një shumë e paarkëtuar prej 102,033 mijë lekë, prej të cilave vlera 71,724 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2024, nga mospagesa e taksapaguesve familjarë dhe privatë.

Në Bashkinë Klos

Nga auditimi financiar i kryer në Bashkinë Klos për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me mos përfshirjen dhe mospasqyrimin e saktë të disa llogarive të aktiveve afatgjata dhe të të ardhurave të pritshme, duke ndikuar në saktësinë dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare. Nga auditimi rezultoi se aktiviteti i njësisë vendore nuk pasqyron në mënyrë të plotë dhe të saktë pasurinë në llogaritë 210 “Toka, troje, terrene”, 212 “Ndërtime e konstruksione” dhe 211 “Pyje, kullota, plantacione”, për shkak të mos përfundimit të procedurave të regjistrimit të këtyre pasurive në ASHK, duke ndikuar në paraqitjen e plotë dhe të besueshme të aktiveve në pasqyrat financiare. Në llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të pasqyrës së performancës financiare nuk është pasqyruar vlera e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”. Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” është nënvlerësuar në shumën 17,676 mijë lekë, si pasojë e mos përfshirjes së vlerës së debisë për nëntë subjekte qeramarrëse, të cilët kanë lidhur kontrata me njësinë vendore për marrje me qira të fondit pyjor. Në fushën e të ardhurave u konstatuan mangësi në arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një shumë e paarkëtuar prej 159,883 mijë lekë, prej të cilave vlera 13,850 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2024, nga mospagesa e taksapaguesve familjarë dhe privatë. Është konstatuar përdorim pa efektivitet të fondeve publike për pagesa që lidhen me procese gjyqësore në lidhje me largimet e padrejta nga puna të punonjësve, në shumën 9,202 mijë lekë.

Në Bashkinë Korçë

Nga auditimi financiar për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se, pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me mangësi në



rakordimin e llogarive kontabël, pasqyrimin e fondeve buxhetore dhe regjistrimin e aktiveve në kontabilitet. Konkretisht, llogaria 4342 "Të tjera operacione me shtetin (Debitor)" paraqitet e nënvlerësuar në vlerën 23,403 mijë lekë, si pasojë e mosreflektimit të vlerës së llogarisë së pagueshme/pasiveve afatshkurtra në llogaritë 401-408 "Furnitorë dhe llogari të lidhura me to". Llogaria 215 "Mjete transporti" paraqitet e mbivlerësuar në vlerë 950 mijë lekë, pasi pjesë e inventarit është përfshirë automjeti që i përket Qendrës Rezidenciale të Zhvillimit. Llogaria 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" paraqitet e nënvlerësuar në vlerën 722,602 mijë lekë, pasi nuk është pasqyruar vlera e aksioneve që i përket pjesëmarrjes së Bashkisë Korçë në shoqëri tregtare dhe publike. Llogaria 231 "Për aktivet afatgjata materiale" paraqitet e nënvlerësuar në vlerën 15,419 mijë lekë, si rezultat i moskontabilizimit të investimeve në proces të likuuduara nga institucioni. Gjithashtu, gjendja e llogarisë 231 "Për aktive afatgjata materiale" dhe e llogarisë 230 "Investime për aktive afatgjata jo materiale" nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 "Nga fondet e veta të investimeve" dhe llogarinë 105 "Teprica e grandeve kapitale të brendshme" me një diferencë në vlerën 23,143 mijë lekë. Në llogarinë 218 "Inventar ekonomik" është përlllogaritur amortizimi me normë 20% në grup, pa u bërë ndarja e nënllogarisë 218/6 "Pajisje kompjuterike", për të cilën duhet të ishte aplikuar norma e amortizimit 25%. Asetet e transferuara nga ish-komunat nuk janë përfshirë në mënyrë të analizuar në aktivet afatgjata, me ndikim në saktësinë dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare.

Në Bashkinë Krujë

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me keqklasifikime dhe mangësi në llogaritë kontabël, përfshirë mos pasqyrimin e një numri të konsiderueshëm asetesh në llogaritë e aktiveve afatgjata në pasqyrat financiare, të cilat me VKM të posaçme kanë kaluar në pronësi ose përdorim të Bashkisë. Nuk disponohet informacion i detajuar mbi listën e projekteve që përbëjnë vlerën 42,423 mijë lekë, me të cilën është rritur llogaria 202 "Studime dhe kërkime" gjatë vitit 2024, duke mos identifikuar se cilat investime janë përfunduar dhe marrë në dorëzim në mënyrë përfundimtare. Gjithashtu, nuk janë kryer kontabilizimet e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale sipas vlerave fillestare (kostos historike) në momentin e kalimit të pronësisë, nuk është llogaritur amortizimi përkatës dhe nuk është realizuar inventarizimi i aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, si dhe i aktiveve afatshkurtra. Po ashtu, llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" në pasqyrën e pozicionit financiar nuk reflekton gjendjen reale, pasi nuk administrohen listat e debitorëve familjarë, përfshirë detyrimet për taksën e tokës bujqësore, debinë progresive dhe detyrimet e krijuara përgjatë vitit 2024. Në fushën e të ardhurave u konstatuan mangësi në arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një shumë e paarkëtuar prej 829,442 mijë lekë, prej të cilave vlera 74,599 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2024, nga mospagesa e taksapaguesve familjarë dhe privatë.

Në Bashkinë Kukës

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me procedurat kontabël për regjistrimin dhe administrimin e aktiveve, si dhe me mungesën e rakordimit ndërmjet llogarive të aktiveve kapitale dhe llogarive të shpenzimeve në proces. Nga auditimi rezultoi moskryerja e veprimeve për regjistrimin në hipotekë të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale në pronësi të bashkisë, si dhe kontabilizimi i disa aktiveve pa mbështetjen e dokumentacionit përkatës. Në mbyllje të vitit ushtrimor 2024, llogaria 231



“Shpenzime në proces për rritjen e AQT” paraqitej në vlerën 532,969 mijë lekë, e cila nuk rakordonte me gjendjen e llogarive të aktiveve kapitale, përkatësisht me llogarinë 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme” në vlerën 609,151 mijë lekë dhe llogarinë 106 “Teprica e granteve kapitale të huaja” të fondit të konsoliduar në vlerën 126,984 mijë lekë. Gjithashtu, u konstatua se nuk ishin marrë të gjitha masat për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën 117,163 mijë lekë.

Në Bashkinë Kurbin

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me mosrakordimin e llogarive dhe me keqklasifikimin e diferencave të tyre në pasqyrat financiare. Fondet buxhetore të akorduara për shpenzime kapitale sipas pasqyrës së investimeve rezultuan me diferencë prej 39,278 mijë lekë, krahasuar me fondet për shpenzime kapitale të paraqitura në pasqyrën e flukseve monetare. Gjithashtu, të ardhurat jostatimore të kontabilizuara gjatë vitit në pasqyrën e performancës rezultuan me diferencë në shumën 99,698 mijë lekë, duke treguar pasaktësi në strukturën e të ardhurave të realizuara gjatë periudhës ushtrimore. Në pasqyrën e flukseve monetare, teprica në fillim të vitit ushtrimor 2024 nuk përputhej me tepricën e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor 2023, duke rezultuar një diferencë prej 321,865 mijë lekë. Po ashtu, në pasqyrën e flukseve monetare, në rubrikën “Veprimtaritë e investimeve”, daljet e mjeteve monetare për detyrime dhe investime të vitit ushtrimor paraqiten me diferencë prej 1,046 mijë lekë krahasuar me shpenzimet për investime të pasqyruara në pasqyrën statistikore “Investimet dhe burimet e investimeve”. Gjithashtu, u konstatua mbivlerësim i aktiveve në llogaritë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje dhe vegla pune” dhe 28 “Caktime të aktiveve afatgjata”, si pasojë e aplikimit të normave të gabuara të amortizimit, duke ndikuar në pasqyrimin e fondeve neto të institucionit. Në fushën e të ardhurave u konstatuan mangësi në arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një shumë e paarkëtuar prej 426,652 mijë lekë, prej të cilave vlera 49,790 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2024, nga mospagesa e taksapaguesve familjarë dhe privatë.

Në Bashkinë Lezhë

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare nuk përmbanin gabime materiale, por ekzistojnë aspekte që duhen nënvizuar, duke justifikuar dhënien e **opinionit i pakualifikuar me theksim çështje**. Këto mangësi lidhen me mungesën e analizës së llogarive dhe me keqklasifikimin e disa aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, si në regjistrimet kontabël ashtu edhe në pasqyrimin e gjendjes së tyre fizike. Në pasqyrimin kontabël të nxjerrjeve jashtë përdorimit të aktiveve janë konstatuar regjistrime të pasakta ndërmjet llogarive përkatëse, duke sjellë klasifikim të gabuar të tyre në kontabilitet. Gjithashtu, konstatohet moslikuidimi i detyrimeve brenda afateve të miratuara, të cilat në fund të vitit 2024 paraqiten në vlerën 46,248 mijë lekë. Mosrespektimi i parimit FIFO ka sjellë mbartjen e këtyre detyrimeve nga vitet e mëparshme dhe rritjen e riskut për aplikimin e penaliteteve. Në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” u evidentua se nuk janë kontabilizuar detyrimet që rrjedhin nga taksat dhe tarifat e taksapaguesve familjarë, për shkak të mungesës së një regjistri të plotë dhe të saktë për evidentimin dhe ndjekjen e tyre. Në fushën e të ardhurave është konstatuar mos marrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një vlerë e paarkëtuar prej 402,418 mijë lekë, prej të cilave vlera 24,508 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2024, nga mospagesa e taksapaguesve familjarë dhe privatë.



Në Bashkinë Libohovë

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me mangësitë e identifikuara në kontabilizimin e plotë të debitorëve, duke rezultuar në nënvlerësimin e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në shumën 936 mijë lekë. Të ardhurat e periudhës janë mbivlerësuar për 54,153 mijë lekë, si pasojë e kontabilizimit të të ardhurave të trashëguara nga periudhat e mëparshme. Rezultati i periudhës kontabël paraqitet me diferencë në shumën 39,534 mijë lekë për shkak të përfshirjes së fondeve buxhetore për investime në “Shpenzime të tjera” gjatë korigjimit të rezultatit, dhe kapitalizimit të investimeve në proces në shumën 34,988 mijë lekë. Në fushën e të ardhurave është konstatuar mos marrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një vlerë e pa arkëtuar prej 25,121 mijë lekë prej të cilave vlera 936 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2024, nga mospagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat. Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm u konstatua se ekzistojnë mangësi në njohjen dhe zbatimin e të pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Rregullorja e brendshme e bashkisë nuk pasqyron ndryshimet e fundit në strukturën organizative, ndërsa ndarja e detyrave, të drejtave, përgjegjësi dhe linjave të raportimit nuk është përcaktuar qartë për secilën strukturë. Bashkia nuk ka hartuar strategjinë e menaxhimit të riskut dhe regjistrin e riskut, duke mos evidentuar dhe dokumentuar monitorimin e tyre. Nuk disponohet një sistem i brendshëm raportimi për shkeljet e rregullave ose rastet e mundshme të mashtrimit, dhe nuk janë krijuar gjurmë auditimi dhe hartë e proceseve kryesore të punës.

Në Bashkinë Lushnjë

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me mangësi në kontabilizimin dhe klasifikimin e disa zërave kontabël, si dhe me pasqyrimin jo të saktë të transaksioneve financiare në pasqyrat financiare. Kontabilizimi i trullit dhe ndërtesave është bërë me vlera simbolike, përkatësisht 17 dhe 12 lekë. Të ardhurat e periudhës janë mbivlerësuar në shumën 362,367 mijë lekë, si pasojë e përfshirjes së të ardhurave të trashëguara nga periudhat kontabël të mëparshme. Ndryshimi i gjendjes së mallrave nuk është pasqyruar në pasqyrën e performancës financiare për shumën 1,913 mijë lekë, duke ndikuar në rezultatin e periudhës. Rezultati i periudhës kontabël nuk është nxjerrë saktë në shumën 170,255 mijë lekë, si rezultat i përfshirjes së fondeve buxhetore për investime në zërin “Shpenzime të tjera” gjatë operacioneve të korigjimit të rezultatit. Gjithashtu, u evidentua nënvlerësim i mjeteve monetare në zërin “Mjete në ruajtje” në vlerën 17,630 mijë lekë. Pagesat për “Për detyrime e investime të vitit ushtrimor (-)” nuk janë pasqyruar saktë në pasqyrën e fluksit monetar, për shumën 10,254 mijë lekë. Transaksionet në debi të llogarisë 231 “Shpenzime për investime” nuk përputhen me pagesat për “Për detyrime e investime të vitit ushtrimor”, duke rezultuar një diferencë prej 33,462 mijë lekë.

Në Bashkinë Malësi e Madhe

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me mosrakordimin e llogarive dhe keqklasifikimin e diferencave të tyre në pasqyrat financiare. Amortizimi për të gjitha aktivet ishte përlllogaritur në mënyrë të pasaktë, duke rezultuar në mbivlerësim prej 13,909 mijë lekë dhe nënvlerësim prej 67,767 mijë lekë. Shpenzimet e



realizuara për llogarinë 606 “Transferta për buxhet familjarë” rezultuan me një diferencë prej 3,258 mijë lekë krahasuar me të dhënat e thesarit. Në pasqyrën e pozicionit financiar, llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” më datë 31.12.2024 rezultoi në një diferencë prej 278,381 mijë lekë. Në pasqyrën e performancës financiare, ndryshimi i gjendjes së inventarit është dubluar në tepricën e llogarive 73 dhe 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve”. Po ashtu, investimet financiare nuk janë njohur, pasqyruar dhe raportuar si kapital në pasqyrat financiare, duke përfshirë pjesëmarrjen në shoqërinë e re “Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër SH.A” në vlerën 2,472 mijë lekë. Në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk janë kontabilizuar detyrimet për tarifën e autorizimit/licencës për tregtimin e karburanteve, në shumën 8,800 mijë lekë. Në fushën e të ardhurave është konstatuar mos marrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një vlerë e pa arkëtuar prej 112,580 mijë lekë, prej të cilave vlera 5,756 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2024, nga mospagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat.

Në Bashkinë Maliq

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me mangësi në rakordimin e llogarive kontabël, pasqyrimin e fondeve buxhetore dhe regjistrimin e aktiveve në kontabilitet. Konkretisht, llogaria 4342 “Të tjera operatione me shtetin (Debitor)” paraqitet e nënvlerësuar në vlerën 55,225 mijë lekë, si pasojë e mosreflektimit të vlerës së detyrimeve (pasiveve afatshkurtra) në llogaritë 401–408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”. Në aktivet afatgjata materiale nuk janë kontabilizuar 4,133 asete të transferuara me VKM në pronësi të Bashkisë, për shkak se procedurat për pajisjen e tyre me titull pronësie nga ASHK nuk kanë përfunduar, si dhe nuk është kryer rivlerësimi për ato pasuri që janë pajisur me titull pronësie. Në fushën e të ardhurave është konstatuar mos marrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2023 rezultoi një vlerë e pa arkëtuar prej 109,095 mijë lekë, prej të cilave vlera 2,650 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2023, nga mospagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat. Gjithashtu, për vitin 2023 u konstatuan moskontabilizime të të ardhurave nga taksat dhe detyrimeve kontraktuale, në vlerën 76,595 mijë lekë.

Nga auditimi financiar i kryer në Bashkinë Maliq për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, nga KLSH është evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me mangësi në procedurat e inventarizimit, nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, si dhe me moskontabilizimin e saktë të disa llogarive. Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet e mbivlerësuar në vlerën 5,669 mijë lekë; Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vetë” paraqitet e nënvlerësuar në vlerën 583,815 mijë lekë; Llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale” paraqitet e nënvlerësuar në vlerën 49,067 mijë lekë, pasi transferimi i vlerave nga investimet në proces në aktive afatgjata nuk është kryer në përputhje me parimet dhe rregullat e organizimit dhe mbajtjes së kontabilitetit, lidhur me regjistrimin e shtesave të aktiveve afatgjata. Nga auditimi është konstatuar përdorim pa efektivitet të fondeve publike për pagesa që lidhen me procese gjyqësore në lidhje me largimet e padrejta nga puna të punonjësve, në shumën 911 mijë lekë.

Në Bashkinë Mat

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të



përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me mosrakordime dhe keqklasifikime në llogaritë kontabël në pasqyrat financiare. Llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale” rezultoi me diferencë me llogaritë kundërparti 106 “Teprica e granteve kapitale të huaja” dhe 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme” në fondin e konsoliduar, për shumën 1,324,111 mijë lekë. Investimet në proces nga fondet e përfituara nga organizata ndërkombëtare për projekte rezultuan me diferencë prej 2,798 mijë lekë. Po ashtu, llogaria 231 rezultoi me diferencë edhe me shtesat e aktiveve afatgjata materiale pas kapitalizimeve në pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata, për shumën 7,038 mijë lekë. Llogaria 105 “Grante kapitale të brendshme nga buxheti” rezultoi me diferencë me llogarinë “Akordim fonde buxhetore për shpenzime kapitale (+)” në pasqyrën e flukseve monetare, për shumën 15,673 mijë lekë. Nga auditimi u konstatuan se llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitej e nënvlerësuar për shkak të mos pasqyrit të detyrimeve të plota për taksat dhe tarifën e taksapaguesve, duke përfshirë taksat dhe tarifën vendore 45,353 mijë lekë, taksën e ndikimit në infrastrukturë 3,769 mijë lekë, tarifën e autorizimit/licencës për tregtim karburantesh 600 mijë lekë dhe tarifën e qirasë nga kontratat për parcelat e fondit pyjor/kullosor 8,119 mijë lekë, në një shumë totale prej 57,841 mijë lekë. Në fushën e të ardhurave është konstatuar mos marrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një vlerë e pa arkëtuar prej 64,245 mijë lekë, prej të cilave vlera 1,894 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2024, nga mospagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat.

Në Bashkinë Memaliaj

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me kontabilizimin e pasaktë të disa llogarive, duke ndikuar në paraqitjen e saktë të pasqyrës së pozicionit financiar. Konkretisht, në llogarinë 411 “Klientë e llogari të ngjashme” është kontabilizuar vlera 48,437 mijë lekë, e cila përfaqëson debitorë për taksat dhe tarifa vendore, të cilat referuar trajtimit kontabël, nuk përfaqësojnë të ardhura nga shitja e mallrave apo shërbimeve me arkëtim të mëvonshëm, dhe duhet të kontabilizoheshin në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”. Për llogaritë e AAGJM nuk është llogaritur amortizimi, duke ndikuar në paraqitjen jo të saktë të vlerave të periudhës ushtrimore. Në aktivet afatgjata materiale nuk janë kontabilizuar 3,293 asete të transferuara me VKM në pronësi të Bashkisë, për shkak se procedurat për pajisjen e tyre me titull pronësie nga ASHK nuk kanë përfunduar, si dhe për pasuritë që janë pajisur me titull pronësie nuk është kryer rivlerësimi. Nga auditimi është konstatuar mungesë e një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si rezultat i mos hartimit të një kuadri të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim, mos marrja e masave dhe mekanizmave të nevojshëm për reduktimin e detyrimeve të prapambetura, me pasojë krijimin e detyrimeve të reja.

Në Bashkinë Mirditë

Nga auditimi financiar për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se, pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me mosrespektimin e procedurave kontabël për regjistrimin e aktiveve, si dhe me mungesën e koordinimit ndërmjet llogarive të aktiveve kapitale dhe llogarive të shpenzimeve në proces. Konkretisht, konstatohet moskryerja e veprimeve për hipotekimin e AAGJM-ve në pronësi të Bashkisë, si dhe kontabilizimi i aktiveve pa u mbështetur në dokumentacionin e duhur justifikues. Nga auditimi rezultoi mospërputhje në vlerat e granteve, në rezultatet e ushtrimit dhe në fondet e investimeve, duke sjellë një pasqyrim më të ulët të fondeve neto në vlerën 262,058 mijë



lekë. Llogaria 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” paraqitet me diferencë me llogaritë kundërparti 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme” dhe 106 “Teprica e granteve kapitale të huaja” të fondit të konsoliduar. Gjithashtu, u konstatua moskontabilizimi në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” i vlerës prej 2,450 mijë lekë, detyrim nga subjektet e tregtimit të karburanteve.

Në Bashkinë Patos

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me kontabilizimin e pasaktë të disa llogarive, duke ndikuar në pasqyrën e pozicionit financiar. Konkretisht, llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitet e nënvlerësuar me vlerën 35,545 mijë lekë, pasi nuk janë përfshirë debitorët për kontratat e dhënies me qira të tokave bujqësore, abonentët familjarë, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa për ndikimin në infrastrukturë. Llogaria 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” paraqitet e mbivlerësuar me vlerën 537,876 mijë lekë, pasi ka përfshirë edhe vlerën e investimeve të përfunduara dhe të marra në dorëzim, të cilat duhej të kontabilizoheshin në llogarinë 213 “Rrugë, rrjeta ujore”. Nga auditimi është konstatuar mungesë e një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si rezultat i mos hartimit të një kuadri të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim, si dhe mos marrja e masave dhe mekanizmave të nevojshëm për reduktimin e detyrimeve të prapambetura, me pasojë krijimin e detyrimeve të reja.

Në Bashkinë Pogradec

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me kontabilizimin e pasaktë të llogarive në pasqyrën e pozicionit financiar. Konkretisht, llogaria 101 “Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar” paraqitet e nënvlerësuar në vlerën 4,369 mijë lekë, llogaria 85 “Rezultati i vitit ushtrimor” paraqitet e mbivlerësuar në vlerën 50,383 mijë lekë, si dhe llogaria 26 “Aktivet Afatgjata Financiare” paraqitet e nënvlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar në vlerën 973 mijë lekë.

Në Bashkinë Poliçan

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri në 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me kontabilizimin jo të saktë të disa llogarive në pasqyrat financiare, si dhe me mungesën e evidentimit të plotë analitik në kontabilitet. Konkretisht, paraqitet e nënvlerësuar llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” në vlerën 39,048 mijë lekë, llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” në vlerën 358 mijë lekë, llogaria 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në vlerën 93,340 mijë lekë, si dhe llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” në vlerën 20,993 mijë lekë. Pasqyrimi i aktiveve afatgjata në llogaritë 202 “Studime dhe kërkime”, 212 “Ndërtesa dhe konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” nuk është i detajuar në evidencën kontabël. Nga auditimi rezultoi se nuk është hartuar regjistri analitik, për të mundësuar identifikimin, ndarjen dhe pasqyrimin e saktë të elementeve përbërëse dhe të vlerave përkatëse në kontabilitet.



Në Bashkinë Përrenjas

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me mosrakordime dhe me moskontabilizim të saktë të llogarive kontabël. Llogaria 520 "Disponibilitete në thesar" rezultoi me diferencë me mbylljen e shumës së llogarisë 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore" dhe me llogarinë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje". Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" paraqitet e nënvlerësuar, përkatësisht në vlerën 3,073 mijë lekë, që i përket debitorit DPSHTRR dhe në vlerën 5,020 mijë lekë për gjobat e IMTV. Në gjendjen e llogarisë 202 "Studime dhe kërkime" janë përfshirë projekte në vlerën 9,622 mijë lekë (kosto historike), pavarësisht se investimet për të cilat janë hartuar këto projekte kanë përfunduar dhe, për pasojë, vlera e projekteve duhej të transferohej tek investimi përkatës. Llogaria 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" paraqitet e nënvlerësuar në vlerën 1,290 mijë lekë. Ndërkohë, llogaritë 230 "Investime për aktive afatgjata jo materiale" dhe 231 "Investime për aktive afatgjata materiale" rezultuan me diferencë me llogaritë kundërpartit 115 "Nga fondet e veta të investimeve" dhe 105 "Teprica e granteve kapitale të brendshme". Në fushën e të ardhurave është konstatuar mos marrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një vlerë e pa arkëtuar prej 139,904 mijë lekë, prej të cilave vlera 23,924 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2024, nga mospagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat.

Në Bashkinë Pukë

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me kontabilizimin jo të saktë të disa llogarive në pasqyrat financiare, si dhe me mungesën e evidentimit të plotë analitik në kontabilitet. Konkretisht, llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)" nuk reflekton gjendjet e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm", e cila paraqitet në vlerën 48,504 mijë lekë, duke mos evidentuar detyrimin që institucioni ka ndaj shtetit për të ardhurat e konstatuara dhe të paarkëtuara. Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" paraqitet e nënvlerësuar në vlerën 8,206 mijë lekë, për shkak të keqklasifikimit të kësaj vlere në llogaritë 401-408 "Furnitorë dhe llogari të lidhura me to". Pasqyrimi i aktiveve afatgjata në llogaritë 210 "Toka, troje, terrene", 211 "Pyje, plantacione", 212 "Ndërtesa dhe konstruksione" dhe 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" nuk rezultoi i detajuar në evidencën kontabël, si dhe mungonte regjistri analitik, i cili do të mundësonte identifikimin, ndarjen dhe pasqyrimin e saktë të elementeve përbërëse dhe të vlerave përkatëse. Gjithashtu, nuk është kryer inventarizimi fizik i AAGJ-ve, ndërsa në librin e aktiveve, për një pjesë të tyre, vlerat janë regjistruar jo në vitin e krijimit, por në vitet kur ka filluar kontabilizimi, me ndikim në saktësinë e pasqyrave financiare. U konstatua përdorim pa efektivitet të fondeve publike për pagesa që lidhen me procese gjyqësore në lidhje me largimet e padrejta nga puna të punonjësve, në shumën 14,249 mijë lekë. Në fushën e të ardhurave është konstatuar mos marrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një vlerë e pa arkëtuar prej 25,423 mijë lekë, prej të cilave vlera 2,516 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2024, nga mospagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat.

Në Bashkinë Pustec

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me kontabilizimin e pasaktë të disa llogarive kontabël në pasqyrën e pozicionit financiar.



Konkretisht, llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” paraqitet e mbivlerësuar në shumën 461,608 mijë lekë, pasi janë kontabilizuar pesë aktive që duhej të transferoheshin tek Shoqëria Rajonale Ujësjellës Korçë SH.A, sipas Marrëveshjes me MIE dhe AKUM dhe kontratës me SHRUK Korçë SH.A. Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” paraqitet e mbivlerësuar për shumën 1,757 mijë lekë, ndërsa llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” paraqitet e nënvlerësuar në shumën 101 mijë lekë, që i korrespondon kapitalit të 640 aksioneve të “UK Korçë” SH.A dhe 2.26 aksioneve të “KRMW” SH.A.

Në Bashkinë Roskovec

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri në 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me kontabilizimin e pasaktë të llogarive dhe hartimin e pasqyrave financiare mbi baza informacioni jo të plotë. Në llogarinë 230 “Për aktive afatgjata jo materiale” u konstatua një keqklasifikim i vlerës 1,000 mijë lekë, e cila duhej të pasqyrohej në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”. Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” paraqitet e mbivlerësuar në vlerën 656,885 mijë lekë, ndërsa llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” paraqitet e nënvlerësuar në vlerën 107,546 mijë lekë. Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” paraqitet e mbivlerësuar në shumën 27,794 mijë lekë, si pasojë e moskapitalizimit të këtyre vlerave në aktivet ku janë realizuar investimet, të cilat kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për llogaritë 210 “Toka, troje, terrene” dhe 211 “Pyje, kullota, plantacione” nuk është kryer inventarizimi fizik. Asetet e transferuara nga ish-komunat e Roskovecit nuk janë përfshirë në mënyrë të analizuar në aktivet afatgjata dhe nuk janë regjistruar veprimet sistemuese për asetet e nxjerra jashtë përdorimit. Gjithashtu, është aplikuar në mënyrë të gabuar norma e amortizimit, duke ndikuar në besueshmërinë dhe saktësinë e pasqyrave financiare.

Në Bashkinë Rrogozhinë

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri në 31.12.2024, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me kontabilizimin e pasaktë të llogarive dhe hartimin e pasqyrave financiare mbi baza informacioni jo të plotë, Konkretisht, llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitet e nënvlerësuar në vlerën 236,660 mijë lekë, si pasojë e moskontabilizimit të të gjitha kategorive të debitorëve. Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” paraqitet e mbivlerësuar në shumën 3,354 mijë lekë, pasi vlerat përkatëse nuk janë kapitalizuar në aktivet ku janë realizuar investimet, të cilat kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Në pasqyrën e pozicionit financiar, llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” paraqitet e mbivlerësuar në shumën 59,836 mijë lekë, llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale” në shumën 21,994 mijë lekë, dhe llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar / Deficiti i akumuluar)” në shumën 269,173 mijë lekë, duke ndikuar në saktësinë dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare. Gjithashtu, u evidentua mos transferimi i inventarëve për llogari të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës në vlerën 212,246 mijë lekë. Llogaritë 230–231 “Investime në proces” rezultuan me diferencë me llogaritë kundërparti 115 “Nga fondet e veta të investimeve” dhe 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme”. Nga auditimi u konstatua mosaplikimi i normave të amortizimit sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore, me ndikim në fondin neto të institucionit. Po ashtu, në aktivet afatgjata janë përfshirë asete të transferuara nga ish-komuna Rrogozhinë, të cilat nuk janë analizuar dhe vlerësuar në mënyrë të plotë.



Në Bashkinë Selenicë

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me mos regjistrimin dhe mos inventarizimin në kontabilitet të aktiveve afatgjata materiale të transferuara me VKM, konkretisht 985 prona me sipërfaqe totale 26,899.56 ha pyje/kullota. Gjithashtu, u evidentua mosnjohja në të ardhurat e njësisë e të ardhurave nga grantet korrente të huaja për periudhën ushtrimore, në vlerën 6,209 mijë lekë. Në të njëjtën kohë, evidentohen keqklasifikime në regjistrimin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime, duke ndikuar në paraqitjen e saktë të zërave përkatës në pasqyrat financiare.

Në Bashkinë Shijak

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me mangësi në procedurat e inventarizimit të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, si dhe me moskryerjen e verifikimit fizik të administrimit të tyre, proces i rëndësishëm për vlerësimin e saktësisë dhe besueshmërisë së pasqyrave financiare. Gjithashtu, u konstatua moskontabilizimi i 54 pronave të transferuara me VKM, të cilat paraqiten vetëm në sipërfaqe dhe jo në vlerë, si dhe mosregjistrimi në ASHK i 115 pronave të paluajtshme shtetërore. Janë evidentuar gjithashtu pasaktësi në llogaritjen e amortizimit për disa zëra të aktiveve, me ndikim në fondin neto të institucionit, si dhe pasaktësi në kontabilizimin e shpenzimeve për paga dhe të ardhurave të përfituara nga grantet.

Në Bashkinë Shkodër

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me faktin se Regjistri i Aktiveve Publike për asetet që zotëron dhe administron bashkia nuk është përditësuar, si dhe aktivet nuk janë pasqyruar me koston historike në regjistrat kontabël, duke ndikuar në përlllogaritjen e amortizimit dhe në paraqitjen e tyre në pasqyrat financiare. Gjithashtu, në pasqyrën e performancës janë konstatuar pasaktësi dhe keqklasifikime të shpenzimeve për paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, me një diferencë në vlerën prej 19,879 mijë lekë, e cila lidhet me pagesat për punonjësit e përkohshëm. Në fushën e të ardhurave është konstatuar mos marrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2023 rezultoi një vlerë e pa arkëtuar prej 551,547 mijë lekë, prej të cilave vlera 232,455 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2023, nga mospagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat.

Në Bashkinë Skrapar

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me mangësi në procedurat e inventarizimit të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, njohjen e shpenzimeve në pasqyrën e performancës financiare jo sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, si dhe me pasqyrimin e pasaktë të llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm", e cila, në krahasim me të dhënat e sistemit të thesarit, rezultoi e mbivlerësuar në vlerën 6,803 mijë lekë. U evidentua gjithashtu moskontabilizimi i tarifave të qirasë nga kontratat e qiradhënies së parcelave nga fondi pyjor/kullor në vlerën 2,837 mijë lekë. U



konstatua përdorim pa efektivitet të fondeve publike për pagesa që lidhen me procese gjyqësore në lidhje me largimet e padrejta nga puna të punonjësve, në shumën 2,695 mijë lekë.

Në Bashkinë Tepelenë

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me kontabilizimin e pasaktë të disa llogarive, duke ndikuar në paraqitjen e saktë të pasqyrës së pozicionit financiar. Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitet e nënvlerësuar, pasi nuk është kontabilizuar vlera prej 41,091 mijë lekë, e cila përfaqëson debitorë për taksa dhe tarifa vendore, të cilët nga bashkia janë klasifikuar si debitorë pa shpresë arkëtimi. Në aktivet afatgjata materiale nuk janë kontabilizuar 2,308 asete të transferuara me VKM në pronësi të Bashkisë, për shkak se procedurat për pajisjen e tyre me titull pronësie nga ASHK nuk kanë përfunduar, si dhe nuk është kryer rivlerësimi për ato pasuri që janë pajisur me titull pronësie, me ndikim në pasqyrimin jo të plotë e të saktë të aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiarë dhe në besueshmërinë e informacionit financiarë të raportuar. Nga auditimi është konstatuar mungesë e një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si rezultat i mos hartimit të një kuadri të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim, si dhe mos marrja e masave dhe mekanizmave të nevojshëm për reduktimin e detyrimeve të prapambetura, me pasojë krijimin e detyrimeve të reja.

Në Bashkinë Tropojë

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me mangësi në kontabilizimin dhe vlerësimin e aseteve, detyrimeve dhe të ardhurave. Në llogarinë 210 “Toka, troje, terrene” nuk është kontabilizuar vlera e trojeve të pajisura me certifikata pronësie, në shumën 34,332 mijë lekë. Në llogarinë 211 “Pyje, plantacione” nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe kullotave të transferuara me VKM nga ish-komunat dhe tashmë pjesë e Bashkisë. Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” rezultoi e nënvlerësuar në shumën 26,038 mijë lekë, për shkak të moskontabilizimit të detyrimeve nga vendimet gjyqësore. Llogaria 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore” paraqitet e nënvlerësuar në shumën 263,727 mijë lekë, si pasojë e moskapitalizimit të investimeve për 8 objekte të marra në dorëzim. Llogaria 215 “Mjete transporti” rezultoi e nënvlerësuar në shumën 3,452 mijë lekë, ndërsa llogaria 606 “Transferata për buxhetet familjare dhe individët” e mbivlerësuar në shumën 263 mijë lekë, për shkak të keqklasifikimit të shpenzimeve në pasqyrën e performancës financiare. Në fushën e të ardhurave është konstatuar mos marrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një vlerë e pa arkëtuar prej 61,390 mijë lekë, prej të cilave vlera 19,784 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2024, nga mospagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat. Nga auditimi është konstatuar përdorim pa efektivitet të fondeve publike për pagesa që lidhen me procese gjyqësore në lidhje me largimet e padrejta nga puna të punonjësve, në shumën 14,575 mijë lekë.

Në Bashkinë Vau Dejës

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale dhe të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kundërt**. Këto pasaktësi lidhen me



mosrakordim të llogarive dhe keqklasifikime të diferencave të tyre në pasqyrat financiare. Llogaria 231 “Investime në proces” sipas thesarit rezultoi me diferenca me këtë llogari analoge në pasqyrën “Investimet dhe burimet e Financimit” për vlerën 224,442 mijë lekë. Llogaria 23 “Investimet” në pasqyrën e pozicionit financiar paraqitej me diferenca me llogarinë 23 “Investimet”, sipas të dhënave të gjeneruara nga sistemi i thesarit, për vlerën 74,320 mijë lekë. Amortizimi nuk ishte llogaritur në mënyrë të saktë për llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione” dhe llogarinë 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore”, duke i mbivlerësuar këto llogari përkatësisht me vlerën 80,135 mijë lekë dhe 90,202 mijë lekë. Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” paraqitej e nënvlerësuar, si rezultat i mosnjohjes dhe pasqyrimin në kontabilitet të investimeve financiare në vlerën 25,455 mijë lekë për dy shoqëritë “Zadrime Agrikulturë” dhe “Ndërkomunale Bushat”, si dhe pjesëmarrjes në kapitalin e “Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër Sha”, ku zotëron 3.23% të kuotave. Llogaria 4342 “Operacione me shtetin të drejta” rezultoi me diferenca me vlerën e tepricave të llogarive kundërparti të detyrimeve afatshkurtra në pasiv, për vlerën 112,683 mijë lekë. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” u konstatua e nënvlerësuar në vlerën 234,356 mijë lekë. Gjithashtu, llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitej e nënvlerësuar, si rezultat i moskontabilizimit të një pjesë të detyrimeve debitore në vlerën 226,390 mijë lekë, e krijuar nga mos pagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat. Në fushën e të ardhurave është konstatuar mos marrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, ku në datën 31.12.2024 rezultoi një vlerë e kontabilizuar dhe e pa arkëtuar prej 126,200 mijë lekë, prej të cilave vlera 65,284 mijë lekë përbëjnë shtesën e krijuar gjatë vitit 2024, nga mospagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat.

Në Bashkinë Vorë

Nga auditimi financiar i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë të pozicionit financiar më 31.12.2024. Megjithatë, janë evidentuar disa çështje që kërkojnë theksim, të cilat, në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një **opinionit të pakualifikuar me theksim të çështjes**. Theksimi i çështjes lidhet me mangësi në kryerjen e amortizimit të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, mungesë të analizës dhe vlerësimit të detyrimeve të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, si dhe mos pasqyrimin në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” të pjesëmarrjes së Bashkisë Vorë si ortak i vetëm i Klubit të Futbollit “Vora” SH.A., në shumën 2,000 mijë lekë.

Në Bashkinë Sarandë

Nga auditimi financiar për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka evidentuar se, pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e **opinionit të kualifikuar**. Këto pasaktësi lidhen me mangësi në rakordimin e llogarive kontabël, pasqyrimin e fondeve buxhetore dhe regjistrimin e aktiveve në kontabilitet. Konkretisht, në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”, e identifikuar si “Aktive të trashëguara, të pa inventarizuara (nga viti 1999)”, llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, e klasifikuar si “Rikonstruksion” rezultojnë vlera të paanalizuara dhe mungon identifikimi i saktë i përmbajtjes së tyre ekonomike, duke ndikuar në saktësinë dhe besueshmërinë e informacionit kontabël të paraqitur në pasqyrat financiare. Në llogarinë 218 “Inventar ekonomik” është përlllogaritur amortizimi me normë 20% në grup, pa u bërë ndarja e nënlllogarisë 218/6 “Pajisje kompjuterike”, për të cilën duhet të ishte aplikuar norma e amortizimit 25%. Llogaria 26 “Aktivet afatgjata financiare” paraqitet e nënvlerësuar në vlerën 3,462 mijë lekë, ndërsa për llogaritë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” dhe 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje dhe vegla pune” nuk rezultoi të mbahet regjistër kontabël analitik, duke kufizuar mundësinë për evidentim dhe monitorim të saktë të këtyre aktiveve.



3.4 AUDITIME TEMATIKE

Bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, auditimi tematik është një qasje e integruar që ndërthur elementë të auditimit të përputhshmërisë, financiar dhe të performancës, me qëllim adresimin e çështjeve specifike. Kjo qasje mundëson një vlerësim më të thelluar të problematikave të identifikuara, e cila ka si objektivi kryesor verifikimin e një teme, çështjeje, problematike apo fushe të caktuar, me ndikim të rëndësishëm.

Në kuadër të ankesave, denoncimeve apo kërkesave të mbërritura pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit gjatë vitit 2025, janë inicuar një sërë auditimesh tematike për çështje të rëndësishme të veçantë, të cilat janë karakterizuar nga një nivel i lartë i ndjeshmërisë dhe impaktit të drejtpërdrejtë për qytetarët. Këto auditime kanë përfunduar me dhënien e një konkluzioni lidhur me çështjen apo temën e trajtuar, bazuar në evidencat e mbledhura në një apo më shumë subjekte të audituara, duke adresuar problematikat e konstatuara dhe përcjelljen e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes.



13 Auditime



13 Konkluzione



3.4 AUDITIME TEMATIKE

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajone, mbi vlerësimin e ecurisë, performancës dhe efektivitetit të masave të marra në lidhje me borxhin tatimor

Nga *auditimi tematik* i kryer për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, rezultoi se në fund të vitit 2024 gjendja e detyrimeve tatimore të papaguara paraqitej në vlerën 162,535,463 mijë lekë, duke shënuar një rritje prej 7,370,054 mijë lekë krahasuar me fundin e vitit 2023. Rajoni Qendror përfaqësonte pjesën më të madhe të këtij borxhi, duke mbajtur rreth 77% të totalit të detyrimeve tatimore të papaguara në nivel kombëtar dhe subjektet me status pasiv përfaqësojnë 74% të vlerës së detyrimit. Rreth 81.8% e borxhit tatimor të papaguar në nivel kombëtar i përkiste detyrimeve me moshë mbi dy vjet. Struktura e ndjekjes së borxhit, si në nivel qendror ashtu edhe në nivel rajonal, nuk funksiononte mbi bazën e një sistemi të integruar, të automatizuar dhe të unifikuar, duke kufizuar kapacitetin institucional për monitorimin, kontrollin dhe reduktimin efektiv të stokut të borxhit tatimor. Nga auditimi u evidentua gjithashtu se proceset kryesore që lidhen me administrimin e borxhit tatimor, përfshirë pasqyrimin e detyrimeve në sistemin elektronik C@TS, përpunimin dhe analizimin e të dhënave mbi debitorët, administrimin e akt-marrëveshjeve për pagesë me këste, si dhe zbatimin e masave shtrënguese ligjore për mbledhjen me forcë, nuk rezultojn të standardizuara dhe në disa raste nuk mbështeteshin në dokumentacion të plotë dhe të gjurmueshëm. Nga auditimi rezultoi mosaplikim i plotë i instrumenteve ligjore për mbledhjen me forcë, ku përmendim procedurat për sekuestrimin e xhiros së kasës për tatimpagues me risk. U evidentuan mospërputhje midis marrëveshjeve aktive dhe atyre të ngarkuara në C@TS, si dhe pasaktësi në ndarjen e detyrimeve (principal/gjobë/interes), duke ndikuar në mungesë gjurmueshmërie dhe raportimi. Po ashtu, u konstatua mospërputhje midis të dhënave të regjistruara në sistem dhe atyre të pasqyruara në raportimet zyrtare, duke sjellë pasaktësi në evidencat zyrtare dhe nënvlerësim të borxhit të raportuar në vlerën 391,290 mijë lekë, si dhe duke ndikuar negativisht në transparencën dhe besueshmërinë e informacionit fiskal. Dobësitë në sistemin informatik, mungesa e metodologjive të standardizuara për përpunimin dhe analizimin e të dhënave, si dhe kapacitetet e kufizuara njerëzore dhe teknike të strukturave përgjegjëse kanë ndikuar drejtpërdrejt në uljen e efektivitetit operacional të administratës tatimore, në mungesën e koordinimit ndërstrukturor, dhe në kufizimin e aftësisë së administratës për të realizuar objektivat e administrimit fiskal në drejtim të reduktimit të borxhit tatimor.

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe degët doganore, mbi ecurinë, performancën dhe efektivitetin e masave të marra në lidhje me borxhin doganor

Nga *auditimi tematik* i kryer për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, KLSH ka konstatuar se veprimtaria e subjektit të audituar ka devijime nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator përkatës. Administrata doganore nuk ka siguruar një proces efektiv mbledhjeje për detyrimet doganore të mbartura nga vitet e kaluara, duke rritur rrezikun e borxhit të pambledhshëm për shkak të kalimit të afateve dhe mosrealizimit të procedurave për rikuperim në kohë. Në fund të vitit 2024, niveli i detyrimeve të papaguara doganore paraqitej në vlerën 48,588,510 mijë lekë për 4684 raste, me një rritje prej 994,940 mijë lekë ose 2.1% krahasuar me një vit më parë, ku 334,003 mijë lekë ose 0.7% e totalit vinte nga detyrimet e reja të vitit 2024, ndërsa pjesa tjetër e shtesës vjen nga kamatëvonesat mbi borxhet e vjetra që janë paguar gjatë vitit. U konstatua se veprimet administrative kanë rezultuar efektive për detyrimet e reja, por të papërfillshme për detyrimet e mbartura nga vitet e kaluara. Detyrimet e papaguara mbi 5 vjet nga momenti i lindjes përbëjnë 44,048,161 mijë lekë ose 90% të totalit të stokut të detyrimeve. Përsa i përket masave të marra për



rikuperimin e detyrimeve, auditimi ka konstatuar vonesa dhe mosmarrje të hapave proceduralë, ku janë evidentuar të paktën 613 raste në shumën 13,976,213 mijë lekë, për të cilat nuk ka të dhëna për vendimin e rikuperimit me forcë, 840 raste në shumën 2,470,271 mijë lekë për të cilat nuk është bërë kërkesa në gjykatë për lëshimin e urdhrat të ekzekutimit, dhe 105 raste në shumën 404,347 mijë lekë, ku urdhrat e lëshuar nga gjykata nuk janë dërguar për ekzekutim. Për më tepër, janë konstatuar 765 raste në shumën 14,284,686 mijë lekë, ku megjithëse urdhër-ekzekutimet janë dërguar për ekzekutim në përmbarrim, autoriteti doganor nuk ka ndërmarrë masat për rikuperimin e detyrimeve për bllokim NIPT, llogari bankare apo asetë të tjera. Nga degët doganore nuk janë disponuar gjithmonë informacionet e përditësuara mbi statusin e çështjeve të dërguara për ekzekutim dhe nuk ka patur dokumentacion që të sigurojë komunikim të vazhdueshëm me përmbarruesit gjyqësorë. Gjithashtu, u konstatua se nuk ka patur bashkëpunim efektiv ndërmjet degëve dhe strukturave të brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për veprimet e sekuestrimit. Si pasojë, administrata doganore nuk ka vepruar në përputhje me përcaktimet ligjore, duke orientuar ndjekjen e detyrimeve drejt ekzekutimit përmes përmbarrimit, ndërkohë nga vetë autoritetet doganore nuk janë ndërmarrë masat administrative.

Në Ministrinë e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale (MSHMS), Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUNT), Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH), Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM), mbi disponibilitetin e barnave në trajtimin e sëmundjeve tumorale

Nga *auditimi tematik* u arrit në konkluzion se institucionet e përfshira në auditim, nuk kanë ezauruar në mënyrë të plotë veprimet e ndërmarra në kuadër të sigurimit të disponibilitetit të barnave të përdorura në trajtimin e sëmundjeve tumorale, veçanërisht në kuadër të mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes, si dhe bashkëpunimit ndërinstitutional. Kjo si rezultat, jo vetëm i masave të njëanshme të ndërmarra ose jo nga vetë institucionet, por edhe si pasojë e mangësive në bashkëpunim. Buxheti i akorduar për sektorin shëndetësor për barna rezultoi i nënfinancuar, duke sjellë riskun e mungesës së barnave e për pasojë mungesën e vijimit të terapisë në përputhje me protokollet e trajtimit të sëmundjeve. Gjithashtu, janë evidentuar mangësi në marrjen e masave për përditësimin e protokolleve të trajtimit të sëmundjeve tumorale, ku rezultojnë protokolle klinike që datojnë nga viti 2014, duke ndikuar potencialisht në cilësinë e trajtimit të pacientëve me tumor pasi rritet risku i përdorimit të një bari pa patur mundësi zëvendësimin e tyre. Nga auditimi janë konstatuar mangësi si në fazën e planifikimit të nevojave për barna ashtu dhe në mirëadministrimin e barnave. Mangësitë në mirëadministrim kanë konsistuar në receta të dublikuara, mungesë shënimesh të sakta, shkarkime të pasakta në sistem, mospërputhje ndërmjet sasive në gjendje progresive dhe inventarit në sistem, dhe kërkesa të përsëritura të paplotësuara për të njëjtin pacient, duke reflektuar dobësi në proceset e menaxhimit, dokumentimit dhe gjurmueshmërisë së barnave në sistemet përkatëse (SISP dhe Pentaho). Procesi i furnizimit është gjithashtu i ndikuar negativisht nga mungesa e penaliteteve për vonesat në zbatimin e kontratave në vlerën 49,000 mijë lekë dhe nga praktikat joefektive të mbikëqyrjes së zbatimit të kontratave dhe kushteve të furnizimit. Në raste të caktuara është konstatuar certifikim i padrejtë të operatorëve ekonomikë si “pa probleme”, edhe kur janë evidentuar mungesa të zgjatura të barnave në periudha kritike për trajtimin e pacientëve. Në aspektin rregullator, është konstatuar se procedura e autorizimit të tregtimit të barnave është e zgjatur në kohë, dhe me boshllëqe rregullatore, duke penguar potencialisht reagimin e shpejtë institucional në raste emergjente. Rezultoi se nga 253 barna antitumorale të autorizuara për tregtim në Republikën e Shqipërisë, 46% nuk janë importuar në asnjë moment gjatë periudhës së auditimit, duke treguar për mungesë të mekanizmave efektivë që lidhin autorizimin me furnizimin real në treg. Gjithashtu, u konstatua një nivel i ulët i kontrollit laboratorik mbi cilësinë e barnave antitumorale.



Në Shtëpinë e Foshnjës “Hannah dhe Rozafa” Tiranë dhe Komitetin Shqiptar të Birësimeve, mbi përputhshmërinë në ofrimin e shërbimit rezidencial dhe procedurat për birësimin e të miturve

Në *auditimin tematik* i kryer për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2024, në shërbimin rezidencial u evidentuan parregullsi në administrimin e regjistrave të takimeve të fëmijëve me familjarët. Gjithashtu u konstatuan 28 raste në të cilat Shtëpia e Foshnjës ka dërguar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm kërkesat për shpalljen e fëmijëve të braktisur jashtë afateve ligjore, duke sjellë si pasojë qëndrime të zgjatura të fëmijëve në institucion dhe vonesa në përfshirjen e tyre në procesin e birësimit. Në rregulloren e brendshme të institucionit nuk ishte përcaktuar pozicioni i mjekut dhe detyrat funksionale të tij, me impakt në organizimin dhe funksionimin efektiv të shërbimeve shëndetësore brenda institucionit. Në procedurat e birësimit u konstatuan mangësi në respektimin e procedurave të përzgjedhjes së aplikantëve birësues, konkretisht në mosrespektimin e renditjes së listës së pritjes, mungesën e dokumentacionit mbështetës për përzgjedhjen e aplikantëve dhe të mbledhjeve në të cilat realizohet kjo përzgjedhje. Gjithashtu u konstatua mungesa e një regjistri që të pasqyrojë historikun e propozimeve dhe refuzimeve për çdo aplikant birësues. Në vijim, nga auditimi rezultoi se Sekretariati Ekzekutiv i Komitetit nuk rezultonte funksional, ndërsa Këshilli Drejtues nuk ishte mbledhur në përputhje me periodicitetin dhe kërkesat e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të institucionit.

Në Komitetin Shqiptar të Birësimeve, mbi rolin dhe përgjegjësitë për monitorimin e mirëqenies së fëmijëve të birësuar

Auditimi tematik i kryer për periudhën nga data 01.01.2020 deri më 31.12.2025 ka konstatuar se sistemi i monitorimit të ecurisë pas birësuese, si një garanci thelbësore për mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës pas finalizimit të birësimit, nuk funksionon në mënyrë të plotë, të qëndrueshme dhe të besueshme, për shkak të dobësive të kombinuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, organizimin institucional, zbatimin praktik dhe menaxhimin e dokumentacionit. Në aspektin ligjor, u evidentua se Ligji nr. 9695, datë 19.03.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, i ndryshuar, nuk parashikon kohëzgjatjen e periudhës së monitorimit pas birësues, organin kompetent që duhet ta përcaktojë atë apo aktin nënligjor përkatës. Si pasojë, periudha 2-vjeçare e monitorimit është përcaktuar ndër vite vetëm në rregulloret e brendshme të KSHB-së, të cilat janë akte administrative të brendshme dhe lehtësisht të ndryshueshme. Kjo mënyrë rregullimi nuk ka siguruar standardin e nevojshëm të stabilitetit juridik për një proces që lidhet drejtpërdrejt me të drejtat dhe mirëqenien e fëmijës, duke krijuar risk që procesi i monitorimit të mos ketë garancinë më të lartë ligjore. Në aspektin organizativ u evidentua se Komiteti Shqiptar i Birësimeve nuk garanton respektimin e parimit të paanshmërisë dhe të ndarjes së funksioneve, pasi të njëjtat struktura që kryejnë vlerësimin e aplikantëve, japin përshtatshmërinë, pëlqimin dhe finalizojnë hallkat e procesit birësues, janë gjithashtu përgjegjëse për monitorimin pas birësues. Kjo situatë krijon konflikt funksional, cenon objektivitetin e procesit të monitorimit dhe dobëson rolin e tij si “garancia e fundit” për të vlerësuar nëse birësimi është realisht i suksesshëm dhe nëse kërkohet ndërhyrje nga institucionet përgjegjëse. Në aspektin e zbatimit praktik të birësimeve vendase dhe ndërvendase, auditimi evidentoi vonesa sistematike në realizimin e monitorimeve, mosrespektim të periodicitetit të përcaktuar, mungesa në raportim dhe dokumentim, si dhe praktika të pamjaftueshme verifikimi, të kufizuara shpesh në takime në ambientet e institucionit apo edhe takime në mënyrë virtuale. Për birësimet ndërvendase në veçanti, u evidentuan problematika në ndjekjen dhe mbikëqyrjen e agjencive ndërmjetësuese të huaja, përfshirë moskërkimin e informacionit për periudha të gjata nga Komiteti Shqiptar i Birësimeve, mosrespektimin e afateve nga agjencitë ndërmjetësuese dhe pranimin e



raporteve nga agjenci ndërmjetësuese të palicencuara në vendin tonë, duke cenuar besueshmërinë dhe ligjshmërinë e procesit. Paralelisht, u konstatuan mangësi në kontrollin e brendshëm dhe në ushtrimin e rolit verifikues të Këshillit Drejtues, përfshirë mos verifikimin e dokumentacionit dhe të përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me atë të vendeve pritëse, duke rritur riskun e dështimit të birësimit dhe cenimit të interesit më të lartë të fëmijës. Në përfundim, nga auditimi vlerësohet se Komiteti Shqiptar i Birësimeve nuk e garanton në mënyrë të mjaftueshme dhe të qëndrueshme funksionin mbrojtës të monitorimit pas birësues dhe nuk respekton plotësisht kërkesat ligjore/rregullatore për monitorimin, mbikëqyrjen, kontrollin e brendshëm dhe administrimin e dokumentacionit, duke dobësuar dhe ekspozuar procesin e birësimit ndaj risqeve të larta të mosidentifikimit në kohë të problematikave që prekin mirëqenien e fëmijës, të cenimit të interesit më të lartë të tij, si dhe të dobësimit të besueshmërisë dhe integritetit të sistemit të birësimit në tërësi.

Në Bashkinë Vlorë, Prefekturën e Qarkut Vlorë, Këshillin e Qarkut Vlorë, Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike Vlorë, Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit Fier, Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Vlorë, Autoritetin Rrugor Shqiptar dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, për verifikimin e shkaqeve, pasojave dhe reagimit të institucioneve, lidhur me situatën e krijuar nga përmytjet masive në qytetin e Vlorës

Nga auditimi i kryer në vijim të përmytjeve masive në qytetin e Vlorës në datën 04.10.2024, u evidentuan problematika lidhur me administrimin dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit në Bashkinë Vlorë. Konkretisht, procesi i transferimit të disa kanaleve ishte realizuar për objekte që ndodheshin jashtë territorit administrativ të qytetit të Vlorës, ndërsa në rastin e hidrovorit ishte transferuar vetëm godina, pa u përfshirë kanali që furnizon hidrovorin me ujë brenda qytetit. Gjithashtu, procesi i transferimit të kësaj infrastrukture ishte shoqëruar me mungesë të dokumentacionit teknik përkatës, si planvendosje, profile gjatësore dhe tërthore të kanaleve, si dhe dokumente të tjera teknike të nevojshme për administrimin e tyre. Nga verifikimet në terren u konstatua se hidrovori funksiononte pa pompa rezervë, me linjë elektrike të amortizuara dhe pa gjenerator rezervë për raste emergjence. Po ashtu, në Hidrovorin e Akërnisë niveli i tensionit rezultoi i paqëndrueshëm, pasi në linjën e furnizimit me energji ishin të lidhura edhe subjekte private, duke ndikuar negativisht në kapacitetin e punës së hidrovorit. Ndërkohë, kanalet kulluese KK2 Akërnë, KK3 Akërnë dhe KUL Orikum rezultuan të papastruara për më shumë se 15 vite, duke treguar mungesë të mirëmbajtjes së rregullt të kësaj infrastrukture. Në përfundim u konstatua se mosfunksionimi i kolektorëve dhe kanaleve kryesore kulluese, mosfunksionimi në kapacitet të plotë i hidrovorit të qytetit dhe ITUN, si dhe mospastrimi i kanaleve të hapura, kanë qenë ndër faktorët kryesorë që ndikuan në përmytjen e datës 04.10.2024 në qytetin e Vlorës. Gjithashtu, mangësitë e evidentuara në lidhje me kryerjen periodike të procesit të pastrimit të kunetave dhe pusëve të shiut krijojnë kushte për bllokimin e kanaleve të kullimit, për shkak të grumbullimit të materialeve dhe mbetjeve në segmente të ndryshme të rrjetit të kullimit.

Në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, mbi monitorimin e kontratës koncesionare për ndërtimin dhe operimin e HEC "Sasaj", Sarandë

Nga *auditimi tematik* i kryer për periudhën nga fillimi i koncesionit deri më 31.01.2025, KLSH ka konstatuar se veprimtaria monitoruese nga institucionet përgjegjëse nuk ka qenë në përputhje me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, me mangësi të shtrira në të gjitha fazat e koncesionit. Auditimi ka evidentuar se dëmtimi i basenit të presionit ka ardhur si pasojë e mosrespektimit të kërkesave teknike për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e veprave, duke shkaktuar dëmtime në mjedis, banesa, biznese dhe infrastrukturën publike, si dhe duke krijuar rrezik për sigurinë e komunitetit. Nga ana e AKBN-së nuk ishin realizuar monitorime të



mjaftueshme dhe të vazhdueshme, duke mos mundur identifikimin në kohë të devijimeve dhe marrjen e masave parandaluese. Nga auditimi është konstatuar se koncesionari nuk kishte respektuar detyrimet kontraktuale lidhur me mirëmbajtjen, afatet e përfundimit të punimeve dhe kushtet mjedisore, përfshirë prurjet ekologjike, ndërkohë që autoritetet përgjegjëse nuk kanë aplikuar penaltitetet e parashikuara në marrëveshjen koncesionare. U evidentua devijim i fuqisë së instaluar nga ajo e miratuar në kontratë, si dhe mungesë e dokumentacionit teknik të plotë, duke shkaktuar problematika të natyrës teknike dhe risk afatgjatë për funksionimin e veprës. Dobësitë në monitorimin dhe mbikëqyrjen institucionale, të shoqëruara me moszbatim të detyrimeve kontraktuale nga koncesionari, kishin krijuar një nivel të lartë risku për sigurinë teknike, mjedisin dhe interesin publik, uke nxjerrë në pah mungesën e mekanizmave të monitorimit dhe zbatimin rigoroz të kuadrit ligjor për koncesionet në sektorin energjetik.

Në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe Bashkinë Shkodër, mbi procedurat e dhënies së lejeve, licencave dhe monitorimin e aktivitetit minerar me vendndodhje në Rasek, Shkodër

Nga *auditimi tematik* i ushtruar për periudhën nga data 30.06.2017 deri më 30.03.2025, KLSH ka konstatuar se aktiviteti minerar i shoqërive operuese është zhvilluar në kushtet e mangësive ligjore, mjedisore, sociale dhe institucionale, të cilat kanë prekur të gjithë procesin, nga shpallja e zonës minerare dhe dhënia e lejeve përkatëse, deri te menaxhimi dhe monitorimi i veprimtarisë në terren. Nga auditimi rezultoi se procedurat për shpalljen e zonës minerare dhe për dhënien e lejeve minerare e mjedisore, ishin zhvilluar pa respektuar plotësisht kërkesat për koordinim ndërinstitucional, vlerësim strategjik mjedisor dhe konsultim me komunitetin lokal. U konstatuan mangësi në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, mungesë dokumentimi të konsultimeve publike, si edhe verifikim të pamjaftueshëm të dokumentacionit nga institucionet përgjegjëse gjatë dhënies së lejeve mjedisore. Koordinatat e miratuara për shfrytëzimin minerar nuk përputheshin me vendndodhjen faktike të aktivitetit, i cili zhvillohej në afërsi të zonave të banuara dhe brenda sipërfaqeve që vazhdojnë të kenë status fond pyjor/kullosor, pa marrë miratimet e detyrueshme ligjore për heqjen e tyre nga ky fond dhe ndryshimin e destinacionit të tokës. Rezultuan shkelje të kushteve të lejeve mjedisore dhe devijime nga projektet e miratuara, përfshirë ndërhyrje të pakontrolluara në shtratin e lumit, depozitimin e materialeve inerte dhe sterile, ndërtimin e veprave teknike të paautorizuara dhe rrezikimin e burimeve të ujit të pijshëm. Monitorimi dhe inspektimi i aktivitetit minerar nga institucionet përgjegjëse nuk ishte realizuar në mënyrë të rregullt dhe efektive, me periudha të gjata kohore pa kryer kontrole në terren dhe me mungesë të ndjekjes së detyrimeve për vetëmonitorim nga subjektet minerare. Këto dobësi institucionale kishin krijuar hapësira për ushtrimin e aktivitetit minerar jashtë kushteve ligjore dhe për përkeqësimin e ndikimeve mjedisore dhe sociale në zonë.

Në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Bashkinë Përmet, mbi ankesën e banorëve të fshatit Piskovë në lidhje me vend-depozitimin e mbetjeve urbane

Nga auditimi i kryer lidhur me *ankesat e banorëve* të fshatit Piskovë për venddepozitimin ekzistues të mbetjeve urbane rezultoi se menaxhimi i tij nuk është në përputhje me vendimet dhe legjislacionin përkatës. Nga auditimi u evidentua se vend-depozitimi i Piskovës nuk ka funksionuar në përputhje me legjislacionin dhe vendimet e miratuara. Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve kishte vendosur rehabilitimin e vend-depozitimit të Brackovës për të zgjatur funksionimin e tij, ndërsa Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në rolin e zhvilluesit, nisi procedurat për ndërtimin e një venddepozitimi të ri në Piskovë, në kundërshtim me



Vendimin nr.10, datë 18.11.2020 të Komitetit. Dosja e aplikimit për VNM paraprake dhe leje infrastrukture për venddepozitimin e Piskovës kishte mungesa dokumentacioni, duke shkelur Vendimet nr.686, datë 29.7.2015 dhe nr.408, datë 13.5.2015. Po ashtu, Plani Kombëtar Sektoral për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta parashikonte ndërtimin e një stacioni transferimi mbetjesh urbane në Bashkitë e Përmetit dhe Këlcyrës, i cili ende nuk ka marrë miratimin nga institucionet kompetente. Nga verifikimet në terren u evidentua se në vend-depozitimin e Piskovës nuk kryhet ndarja e mbetjeve, hedhja e tyre bëhet në mënyrë jo të rregullt, procesi i presimit dhe mbulimit me dhe nuk realizohej vazhdimisht, masat mbrojtëse nuk ishin të plota, dhe një pjesë e mbetjeve ndodheshin jashtë gropës, duke rrezikuar ndotjen e ujërave sipërfaqësorë. Monitorimi i vend-depozitimit nuk kryhej në mënyrë të vazhdueshme, duke krijuar rrezik për dëmtimin e rrethimit, zjarrvënien ose ndërhyrje të paligjshme. Gjithashtu, “Ndërmarrja e Pastrim-Gjelbërimit”, e cila kryen grumbullimin dhe transportin e mbetjeve urbane, nuk dispononte licencën e nevojshme III.2.B, ndërsa Bashkia Përmet nuk kishte aplikuar për leje mjedisi për vend-depozitimin. Institucionet kompetente, si Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, nuk kishin kryer inspektime në venddepozitimin e Piskovës dhe në Parkun Kombëtar “Bredhi i Hotovës-Dangëlli”.

Në auditimin tematik mbi verifikimin e situatës pas rrëshqitjeve në rrugën “Matogjin-Bashaj” në Bashkinë Selenicë

Nga auditimi i kryer dhe verifikimet në terren u evidentua se situata e krijuar pas rrëshqitjeve në segmentin rrugor Kthesa e Velçës – Vërmik, në zonën e fshatrave Bashaj dhe Matogjin, ka bërë që ky segment rrugor të jetë i pakalueshëm, duke shkaktuar izolimin e banorëve dhe ndërprerjen e qarkullimit normal. Nga Bashkia Selenicë nuk rezultoi të jenë ndërmarrë procedura për sigurimin e mbështetjes financiare apo materiale për familjet e prekura në fshatin Bashaj. Gjithashtu, u evidentuan mangësi në planifikimin strategjik dhe në hartimin e dokumenteve planifikuese, si dhe në vlerësimin teknik të problematikave gjeologjike. Në këtë kuadër, planifikimi i investimeve për rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor rezultoi i pamjaftueshëm, ndërsa ndërhyrjet e kryera nuk kanë garantuar zgjidhje të qëndrueshme të situatës

Në Qendrën Burimore “Ramazan Kabashi”

Nga *auditimi tematik* i ushtruar për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2024, KLSH konstatoi se veprimtaria e institucionit nuk ka qenë në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Auditimi evidentoi dobësi në procesin e planifikimit buxhetor, pasi kërkesat nuk ishin të argumentuara dhe nuk ishin shoqëruar me analiza financiare sipas artikujve buxhetorë, si dhe u konstatuan mangësi në administrimin e aktiveve publike, për shkak të mbajtjes së regjistrave të paplotë dhe zhvillimit të procedurave pa një ndarje të qartë të detyrave dhe pa plotësimin e dokumentacionit përkatës. Proceset e inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve nuk kishin garantuar menaxhim efektiv dhe mbrojtje të pasurisë publike. U konstatuan mospërputhje midis menuve javore të miratuara dhe produkteve ushqimore të dala nga magazina, si dhe mungesë e konsultimit me specialistë për garantimin e normave dhe vlerave ushqimore. Nga auditimi u konstatuan vende vakante në pozicione kyçe, duke krijuar risk të lartë për funksionimin efektiv të sistemit të kontrollit të brendshëm. Po ashtu, u evidentuan mangësi në zbatimin e legjislacionit të prokurimeve publike, duke përfshirë planifikimin jo të plotë të procedurave, moskryerjen e përlllogaritjes së fondit limit, pasaktësi në përcaktimin, argumentimin e kriterëve kualifikuese dhe në verifikimin e operatorëve ekonomikë, si dhe mangësi në përmbajtjen e kontratave dhe në evidencat shoqëruese për furnizimet ushqimore. Gjithashtu, nga auditimi rezultoi efekt negativ i konstatuar në administrimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficientë dhe



efektivitet në vlerën 516 mijë lekë, si rezultat i likuidimeve të kryera në mungesë të kontratave të nënshkruara.

Në Spitalin Rajonal Korçë, mbi ofrimin e shërbimit të ushqimit për pacientët e shtruar

Nga *auditimi tematik* i ushtruar për periudhën nga data 01.01.2024 deri më 30.09.2025, rezultuan mangësi organizative, procedurale dhe kontrolli, të cilat kanë ndikuar në sigurinë ushqimore, cilësinë e shërbimit dhe përputhshmërinë me kuadrin ligjor dhe standardet për akreditim spitalor. Spitali ofronte shërbimin e ushqimit përmes një strukture të brendshme, pa disponuar procedura të shkruara dhe të miratuara që rregullonin procesin, detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësve, si dhe hallkat e kontrollit në të gjitha fazat e qarkullimit të ushqimit. Rregullorja e brendshme e institucionit nuk ishte në përputhje me strukturën organizative të miratuar dhe nuk parashikonte funksione profesionale të nevojshme, si mjeku apo infermieri dietolog, me efekt në mbikëqyrjen profesionale të dietave dhe menuve ditore. Në zbatimin e kërkesave për sigurinë ushqimore, spitali nuk kishte hartuar dhe nuk administronte regjistra funksionale të gjurmueshmërisë për artikujt ushqimorë, dhe nuk kishte zbatuar plotësisht praktikat më të mira të higjienës dhe prodhimit, ndërkohë që ushqimi qarkullonte në ambiente me risk kontaminimi. Pajisjet frigoriferike nuk ishin të pajisura me matës temperature, duke mos mundësuar kontrollin e kushteve të ruajtjes. Në aspektin e përmbajtjes ushqimore, dietat e miratuara nuk mbulonin të gjitha grupmoshat pediatrike të trajtuara në spital dhe aplikimi i kuotave të reja ushqimore të miratuara me urdhër të MSHMS-së, ishte bërë me vonesë. Për periudhën e audituar ishte hartuar një menu e vetme për të gjithë pacientët, pa diferencim sipas dietave përkatëse, duke mos garantuar plotësimin e kalorazhit, makronutrientëve dhe shumëllojshmërinë e ushqimit, në kundërshtim me kërkesat e planit të kujdesit klinik. Nga auditimi rezultuan parregullsi në zbatimin e kontratave për furnizimin me artikuj ushqimorë, përfshirë vonesa në furnizim, mungesë dokumentimi të plotë në marrjen në dorëzim, amendime kontratash në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik dhe mos aplikim penaltitësh në vlerën 118 mijë lekë, për vonesat e operatorëve ekonomikë, duke sjellë mungesa të vazhdueshme të artikujve ushqimorë dhe ndikim negativ në ofrimin e shërbimit.

Në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, mbi verifikimin e ankesës së paraqitur nga një federatë sportive

Nga *auditimi tematik* rezultoi se ekzistenca paralele e dy federatave të njohura ligjërisht për disiplina sportive të ngjashme, si rezultat i mungesës së një mekanizmi të qartë bashkërendues ndërinstitucional midis ministrisë përgjegjëse për sportet dhe KOKSH-it, ka krijuar interpretime të ndryshme të dy llojeve të disiplinave sportive dhe pamundësi për të garantuar një standard unik përfaqësimi në sportin shqiptar në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare. Mungesa e një regjistri të unifikuar të federatave sportive theksoi nevojën për ndërhyrje institucionale, me qëllim harmonizimin dhe unifikimin e procedurave të njohjes dhe përfaqësimit të federatave, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.



3.5 AUDITIME TË PERFORMANCËS

Auditimi i performancës është një ekzaminim i pavarur, objektiv dhe i besueshëm nëse ndërmarrjet, sistemet, programet, aktivitetet ose organizatat po veprojnë në përputhje me parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar dhe nëse ka vend për përmirësim. Ky auditim mbështetet kryesisht në ISSAI 3000 dhe Manualit të Auditimit të Performancës në KLSH.

Auditimi i performancës synon të kontribuojë në përmirësimin e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit në sektorin publik. Ai gjithashtu synon të kontribuojë në mirëqeverisje, llogaridhënie dhe transparencë, duke ofruar informacione, analiza ose njohuri të reja dhe, duke rekomanduar masa për përmirësim.

Auditimet e performancës konkludojnë me Mesazhin e Auditimit, i cili mbështetet mbi një vlerësim dhe analizë të thelluar mbi temën e auditimit dhe aktivitetin e subjekteve të përfshira, mbi gjetjet e konstatuara, pikat e dobëta dhe mundësitë për përmirësim.



3 auditime në fushën e sigurisë dhe mirëqënies



3 auditime në fushën e mjedisit



3 auditime në fushën e infrastrukturës



13

Audime



2 auditime në fushën e arsimit



2 auditime në fushën e teknologjisë dhe inovacionit



13

Mesazhe auditimi



3.5 AUDITIME TË PERFORMANCËS



Në fushën e sigurisë dhe mirëqenies

I. Cilësia dhe certifikimi i ujit të pijshëm që hidhet në treg për qytetarin

Auditimi me temë "Cilësia dhe certifikimi i ujit të pijshëm që hidhet në treg për qytetarin" u zhvillua në:

- Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore.

Uji i pijshëm i ambalazhuar sipas të dhënave të INSTAT ka një përdorim gjithmonë e më të gjerë në vend. Prej burimit deri në nxjerrjen në treg për konsum të këtij produkti ndërthuren njëherazi veprimtaritë e disa institucioneve me fusha të ndryshme veprimtarie lidhur me lejet dhe licencat, analizimet e nevojshme, monitorimet, informimin publik etj. Aktualisht në vend janë të regjistruara 52 leje përdorimi të burimeve ujore të miratuara për ujë të pijshëm të ambalazhuar të cilat u përkasin 41 subjekteve tregtarë, nga të cilat 14 kontrata koncesioni dhe 38 të pajisura me leje/autorizim me afat 5 vjeçar me të drejtë rinovimi. Nga ana tjetër janë 49 stabilimente të licencuara për prodhim të ujit të ambalazhuar.

Objektivi i auditimit ishte vlerësimi i masave të marra nga institucionet përgjegjëse lidhur me garantimin e cilësisë së ujit të ambalazhuar që hidhet në treg, për qytetarin për periudhën 2020-2024, me fokus auditimi: Proceset për dhënien e lejeve/miratimeve të nevojshme për burimin ujor; Licencimet e stabilimenteve të prodhimit; Analizimet laboratorike të kryera nga autoritetet përgjegjëse dhe përputhshmërinë e tyre me Direktivat Evropiane; Kontrollimet me monitorimet e kryera nga autoritetet përgjegjëse; Bashkëveprimin mes institucioneve; Informimin dhe transparencën për qytetarin.

Me anë të gjetjeve dhe konkluzioneve kryesore të këtij raporti auditimi u arrit në këtë mesazh:

Sistemi i ngritur nuk ka arritur të garantojë qytetarin për cilësinë e ujit të pijshëm të ambalazhuar që hidhet në treg. Megjithëse konsumi i këtij produkti ka pësuar rritje të vazhdueshme çdo vit, institucionet përgjegjëse nuk kanë arritur të përmbushin plotësisht detyrimet e tyre sa i përket kontrollit, monitorimit e analizimit të tij. Ndryshimet e kompetencave në strukturat shtetërore, kanë krijuar paqartësi në rolet dhe përgjegjësitë e tyre dhe kanë ndikuar në funksionimin e fragmentuar të sistemit. Kuadri ligjor e rregullator paraqitet i pa harmonizuar dhe në disa raste kontradiktore, nuk mundëson konkurrencë mes projekteve për përdorimin e burimit ujor dhe ka kriteret e dobëta për dhënien e lejeve dhe licencave. Nga ana tjetër, mangësitë e institucioneve në drejtim të, analizimeve laboratorike, bashkëveprimeve ndër-institucionale si dhe informimit të publikut, nuk kanë garantuar cilësinë e ujit të ambalazhuar dhe sigurinë e nevojshme për qytetarin.

II. Planet gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe aspektet buxhetore për një popullsi në moshim

Auditimi me temë "Planet gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe aspektet buxhetore për një popullsi në moshim" u realizua përgjatë vitit 2025 duke pasur si periudhë objekt auditimi 2020-2025. Auditimi u zhvillua në:

- Ministrinë e Financave;
- Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
- Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit;
- Institutin e Statistikave;



○ Shërbimin Social Shtetëror.

Shqipëria po përballlet me një ndryshim të madh në përbërjen e popullsisë: numri i të moshuarve po rritet me shpejtësi, ndërsa lindjet dhe të rinjtë në vend po pakësohen. Ky proces, i njohur si plakja e popullsisë, është kthyer në një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballlet vendi ynë sot. Ky ndryshim vjen si pasojë e disa faktorëve të ndërthurur: më pak lindje, largimi i të rinjve jashtë vendit. Të dhënat e INSTAT tregojnë se në vitin 2023, 15.4% e popullsisë shqiptare ishte mbi 65 vjeç. Parashikimet flasin për një rritje të mëtejshme, ku deri në vitin 2050 kjo shifër pritet të kapërcejë 25% – një nga nivelet më të larta në rajon. Kjo situatë po sjell sfida të mëdha në shumë drejtime. Një ndër to është ndryshimi i rolit të familjes. Tradicionalisht, në Shqipëri kujdesi për të moshuarit është ofruar nga familja. Por sot, për shkak të emigracionit dhe ndryshimeve në mënyrën e jetesës, shumë të moshuar jetojnë vetëm ose me ndihmë të kufizuar. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, më shumë se 40% e të moshuarve në Shqipëri ndodhen në këtë situatë, duke rritur rrezikun për izolim social dhe probleme me shëndetin mendor e fizik.

Objektivi kryesor i këtij auditimi ishte vlerësimi i politikave, strategjive, planeve të vendit tonë që adresojnë çështjet, sfidat dhe problemet që lidhen me fenomenin e moshimit të popullsisë.

Me anë të gjetjeve dhe konkluzioneve kryesore të këtij raporti auditimi u arrit në këtë mesazh:

Shqipëria nuk ka një plan gjithëpërfshirës dhe ndërsektorial që trajton fenomenin e moshimit të popullsisë. Ky fenomen adresohet në strategji apo plane sektoriale, të cilat në vetvete nuk ofrojnë një mbështetje të plotë, të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse për çështjet e moshimit të popullsisë. Politikat sektoriale të ndërmarra deri më tani nga institucionet përgjegjëse në tërësinë e tyre, nuk kanë sjellë ndikim në përmirësimin e treguesve, pasi vendi ynë vijon të ketë rënie të lindshmërisë me afërsisht 72% nga viti 1990 në vitin 2024, bilanc migrator negativ me migrim neto nga -15,030 persona në vitin 2018, në -32,497 në vitin 2022, si dhe rritje të moshës mediane nga 32.6 vjeç në vitin 2011 në 44.3 vjeç në vitin 2025. Duke iu referuar treguesve të analizuar është e nevojshme që të hartohen dhe të zbatohen politika të drejtpërdrejta në perspektivë afatgjatë, duke pranuar se ndryshimet në politikat e punësimit, lindshmërisë, migracionit, mbrojtjes sociale dhe zhvillimit ekonomik duhen dekada që të kenë një efekt të qëndrueshëm në shoqëri.

III. Kujdesi komunitar për të moshuarit dhe decentralizimi i shërbimit

Auditimi i performancës me temë “Kujdesi komunitar për të moshuarit dhe decentralizimi i shërbimit” u zhvillua përgjatë vitit 2025 duke pasur si periudhë objekt auditimi 2020-2024. Ky auditim u zhvillua në:

- Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
- Shërbimin Social Shtetëror;
- Bashkinë Tiranë;
- Bashkinë Kamëz;
- Bashkinë Belsh;
- Bashkinë Berat;
- Bashkinë Sarandë;
- Bashkinë Malësi e Madhe.

Një pjesë e konsiderueshme e bashkive në vendin tonë kanë zhvilluar forma të shërbimeve për të moshuarit si qendra ditore, qendra rezidenciale apo shërbime ndihmëse në shtëpi shpesh në bashkëpunim me organizata joqeveritare apo projekte të financuara nga partnerë të jashtëm. Megjithatë, kapacitetet e institucioneve rezidenciale (azileve) janë shumë të kufizuara dhe të pamjaftueshme për të përballuar kërkesën në rritje. Kjo situatë ka bërë që një pjesë e të moshuarve pa mbështetje familjare të kenë vështirësi në sigurimin e strehimit apo kujdesit bazë, gjë që ndikon negativisht në mirëqenien e tyre fizike dhe psikologjike.



Organizata Botërore e Shëndetësisë rekomandon që kujdesi për të moshuarit të mos kufizohet vetëm në strehimin institucional, por të shtrihet në ofrimin e kujdesit në shtëpi, asistencës për aktivitetet e përditshme, shërbimeve mjekësore bazë, mbështetjes psikologjike dhe përfshirjes sociale. Sidoqoftë, realiteti në vendin tonë është larg këtyre rekomandimeve.

Objektivi i auditimit me temë “Kujdesi komunitar për të moshuarit dhe decentralizimi i shërbimit” ishte të vlerësonte nëse bashkitë, në bashkëpunim me institucionet qendrore, kanë marrë masat e nevojshme për të siguruar një sistem efektiv dhe të qëndrueshëm të kujdesit komunitar për të moshuarit.

Me anë të gjetjeve dhe konkluzioneve kryesore të këtij raporti auditimi u arrit në këtë mesazh:

Shërbimi i kujdesit komunitar për të moshuarit, në kuadër të decentralizimit të shërbimeve sociale, paraqet sfida të rëndësishme në nivel vendor. Megjithëse përgjegjësitë janë transferuar te bashkitë, ku zbatimi praktik shoqërohet me mangësi në organizim, planifikim, financim dhe mbështetje profesionale, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë dhe shtrirjen e shërbimeve. Mungesa e strukturave funksionale për identifikimin dhe vlerësimin e nevojave, e të dhënave të standardizuara, si dhe varësia e lartë nga financimi qendror kanë kufizuar aftësinë e bashkive për të ndërtuar shërbime të qëndrueshme dhe të barabarta në të gjithë territorin. Si pasojë, decentralizimi nuk ka arritur ende të përkthehet plotësisht në shërbime të aksesueshme, të planifikuara mbi nevoja reale dhe të ofruara në mënyrë të njëtrajtshme për të gjithë të moshuarit në nevojë.



Në fushën e mjedisit

I. Cilësia e ujërave në plazhe

Auditimi me temë “Cilësia e ujërave në plazhe” u realizua përgjatë periudhës maj 2024-qershor 2025 duke pasur si periudhë objekt auditimi 2019-2023. Auditimi u zhvillua në:

- Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e saj të varësisë;
- Agjencinë Kombëtare të Ujësjetës Kanalizimeve;
- Agjencinë Kombëtare të Mjedisit
- Bashkinë Shkodër,
- Bashkinë Lezhë,
- Bashkinë Durrës,
- Bashkinë Kavajë,
- Bashkinë Rrogozhinë,
- Bashkinë Lushnjë,
- Bashkinë Fier,
- Bashkinë Vlorë,
- Bashkinë Himarë.

Të gjitha këto institucione kanë detyra dhe kanë përgjegjësi e detyrime që ndikojnë në cilësinë e ujërave në plazhe dhe masave që duhen ndërmarrë kur cilësia e tyre nuk është e mirë.

Uji në të cilin ne notojmë mund të ndotet nga bakteret *Escherichia coli* – ose E. coli – dhe *enterokoket* e zorrëve që mund të shkaktojnë sëmundje. Zakonisht, këto baktere rrjedhin nga ujërat e zeza të patrajuara që përfundojnë në ujërat e larjes (plazheve). Klasifikimi i ujërave të larjes ofron një panoramë të plotë dhe afatgjatë të cilësisë bakteriologjike të tyre dhe gjithashtu tregon se sa mirë po menaxhohet disa nga shkaqet kryesore (kryesisht shkarkimi i ujërave të ndotura urbane).



Objektivi i këtij auditimi ishte vlerësimi i procesit të monitorimit të cilësisë së ujërave të larjes si dhe trajtimi i ujërave të ndotura urbane që ndikojnë në cilësi jo të mirë të ujërave në plazhe. Kështu më konkretisht në këtë auditim janë trajtuar si më poshtë:

- Procesi i monitorimit të cilësisë së ujërave të larjes me rezultatet e tij në vite;
- Identifikimi dhe përzgjedhja e pikave të monitorimit të ujërave të larjes;
- Hartimi dhe përditësimi i akteve ligjore/nënligjore të cilat për arsye të ndryshme nuk gjejnë zbatim;
- Masat sensibilizuese dhe kufizuese që duhen marrë në raste kur ujërat e larjes rezultojnë me cilësi të keqe;
- Gjendja e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura urbane, kapacitetet e tyre, teknologjia dhe problematika të ndryshme që ata ballafaqojnë;
- Planifikimi, nevojat, investimet dhe projektet që janë planifikuar/zbatuar përgjatë periudhës objekt auditimi;
- Procesi i instalimit të sistemeve ose impianteve individuale të trajtimit të ujërave të ndotura nga ana e subjekteve që zhvillojnë veprimtari ekonomike pranë zonave bregdetare;
- Respektimi i normave dhe standardeve mjedisore gjatë procesit të trajtimit të ujërave të ndotura urbane nga ana e impianteve të trajtimit të këtyre ujërave.

Me anë të gjetjeve dhe konkluzioneve kryesore të këtij raporti auditimi u arrit në këtë mesazh: Procesi i menaxhimit të cilësisë së ujërave të larjes nuk ka qenë efektiv. Cilësia e ujërave të larjes (plazheve) në Shqipëri ka ardhur duke u përkeqësuar në vitet e fundit dhe në vitin 2023 Shqipëria ka pasur cilësinë më të keqe se çdo shtet tjetër në Evropë. Monitorimi me qëllim vlerësimin e saktë të cilësisë së ujërave të larjes nuk ka ndjekur udhëzimet e përcaktuara në aktet nënligjore të vendit tonë si dhe direktivës përkatëse evropiane. Informimi i qytetarëve dhe turistëve mbi cilësinë e keqe të ujërave të larjes (kur kanë rezultuar si të tilla) nuk ka ndodhur në asnjë rast ashtu si edhe ndalimi i përdorimit të këtyre plazheve. Bashkitë Fier, Lushnjë, Rrogozhinë nuk kanë impiant trajtimi të ujërave të ndotura urbane e për rrjedhojë të gjitha ujërat e zeza që gjenerohen nga këto bashki përfundojnë të pa trajtuara në lumenj ose kanale të cilat më pas derdhen në det. Ndërsa bashkitë e tjera, edhe pse kanë impiante të trajtimit të ujërave të ndotura urbane, nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për të trajtuar të gjitha ujërat e ndotura të gjeneruara në territorin e tyre. Për pasojë një pjesë e konsiderueshme e tyre përsëri përfundon e pa trajtuar në det, duke ndikuar kështu në përkeqësimin e cilësisë së ujërave në plazhe. Planifikimi dhe investimet në sektorin e kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane vuajnë mungesën e koordinimit të institucioneve përgjegjëse, duke qenë se shpërndarja, prioritizimi, përthithja e fondeve si dhe shkëmbimi i informacioneve nga projektet e zbatimit nuk bëhet siç duhet. Task-Forca e ngritur për përmirësimin e infrastrukturës për trajtimin e ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse nuk ka arritur të përmbushë plotësisht detyrimet e përcaktuara në Aktin Normativ nr. 8 dt 28.12.2023.

II. Masat e ndërmarra nga institucionet përgjegjëse për eliminimin e derdhjes së ujërave të përdorura në lumin e Lanës në Tiranë

Auditimi me temë *“Masat e ndërmarra nga institucionet përgjegjëse për eliminimin e derdhjes së ujërave të përdorura në Lumin e Lanës në Tiranë”* u realizua në:

- Bashkinë Tiranë;
- Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore;
- Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve;
- Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

Ndotja e Lumit të Lanës, e cila tejkalon ndjeshëm standardet kombëtare dhe ato të Bashkimit Evropian, përbën një kërcënim serioz për shëndetin publik, mjedisin dhe cilësinë e jetës në Tiranë. Problematikat e vazhdueshme me shkarkimet e ujërave të ndotura urbane dhe



dështimi i projekteve strategjike për trajtimin e tyre kanë sjellë pasoja të konsiderueshme mjedisore dhe financiare për shtetin. Në këtë kontekst, auditimi synon të vlerësojë efektivitetin e ndërhyrjeve institucionale, përdorimin e fondeve publike dhe përgjegjësitë në menaxhimin e burimeve ujore, me qëllim orientimin e masave korrigjuese për një zhvillim urban më të qëndrueshëm.

Objektivi i këtij auditimi ishte vlerësimi i veprimtarisë së institucioneve të përfshira në auditim, lidhur me masat e marra për menaxhimin e cilësisë së ujit të trupit ujqor "Lumi Lana", duke synuar reduktimin dhe eliminimin e derdhjeve të ujërave të ndotura urbane të pa trajtuara drejtpërdrejt në këtë mjedis pritës.

Më konkretisht ai u fokusua në shkarkimin e ujërave të ndotura urbane, nisur nga evidentimi i vazhdueshëm i kësaj problematike në Raportet e Gjendjes në Mjedis të publikuara çdo vit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Periudha objekt auditimi ka qenë 2020 - 2024, megjithatë të dhëna historike jashtë kësaj periudhe janë pasqyruar për të dhënë një panoramë më të qartë të ecurisë së treguesve të ndryshëm mjedisorë ndër vite.

Me anë të gjetjeve dhe konkluzioneve kryesore të këtij raporti auditimi u arrit në këtë mesazh: Institucionet përgjegjëse nuk kanë marrë masa efektive për përmirësimin e cilësisë së ujit në lumin Lana. raportet e gjendjes në Mjedis të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit konstatojnë prej vitesh se statusi i cilësisë së ujit në këtë trup ujqor klasifikohet në gjendje shumë të ndotur, duke shfaqur përkeqësim edhe në fillim të rrjedhës në Lanabregas, përgjatë viteve të fundit.

Monitorimi i kryer nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka qenë i pjesshëm, duke mos monitoruar të gjithë stacionet e monitorimit dhe të gjithë treguesit, për të vlerësuar plotësisht cilësinë e ujit dhe statusin ekologjik të lumit Lana.

Nga ana tjetër, mungesa e ndërhyrjes nga Bashkia Tiranë dhe Ujësjellës Kanalizime Tiranë SH.A. në rrjetin e kanalizimeve, mos përfundimi i investimit për Impiantin e Trajtimit të Ujërave të Ndotura Kashar nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve, si dhe mungesa e ofrimit të zgjidhjeve alternative nga të gjithë këto institucione, ka sjellë që ujërat e ndotura urbane të pjesës më të madhe të qytetit të Tiranës të vijojnë të shkarkohen të pa trajtuara, duke ndikuar negativisht në cilësinë e ujit. Situata aktuale paraqet nevojën për angazhim të menjëhershëm të institucioneve të sipërpërmendura, për të garantuar përmirësimin e situatës.

III. Ndikimi në mjedis dhe shëndet i aktivitetit të shfrytëzimit të naftës dhe gazit në zonën Patos-Marinëz

Auditimi me temë "*Ndikimi në mjedis dhe shëndet i aktivitetit të shfrytëzimit të naftës dhe gazit në zonën Patos-Marinëz*" u realizua në:

- Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Agjencinë Kombëtare të Mjedisit;
- Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore;
- Bashkinë Patos;
- Bashkinë Roskovec;
- Bashkinë Fier;
- Bashkinë Kuçovë;
- Bashkinë Mallakastër.

Mbrojtja e mjedisit nga ndotja e dëmtimi përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë. Fusha naftëmbajtëse e Patos-Marinëz është nga më të mëdhatë në Evropë, për sa i përket rezervave të naftës. Referuar të dhënave nga Agjencia



Kombëtare e Burimeve Natyrore, për vitin 2024, subjektet e shfrytëzimit të naftës dhe gazit natyror në zonën Patos-Marinëz kanë prodhuar një sasi prej 513,318 ton naftë. Banorët që jetojnë kryesisht në zonën Patos-Marinëz janë të ekspozuar nga niveli i lartë i ndotjes në mjedis, i cili shkaktohet nga nxjerrja e naftës në këtë zonë. Situata e deritanishme paraqitet e rënduar, e konfirmuar edhe nga raportet e gjendjes së mjedisit.

Objektivi i këtij auditimi ishte vlerësimi dhe analizimi i ndikimit në mjedis dhe shëndet që vjen nga shfrytëzimi i naftës dhe gazit, si dhe adresimin e masave që duhen marrë nga institucionet përgjegjëse në rast të ndotjes mjedisore.

Me anë të gjetjeve dhe konkluzioneve kryesore të këtij raporti auditimi u arrit në këtë mesazh:

Mungesa e një kuadri të integruar rregullator, mungesa e stacioneve të monitorimit të treguesve të mjedisit, mungesa e inspektimeve dhe monitorimeve në mënyrë periodike, ka krijuar boshllëqe serioze në kontrollin dhe parandalimin e ndotjes mjedisore, si dhe në identifikimin e risqeve në shëndetin publik. Gjithashtu, është vërejtur një mungesë koordinimi ndërinstytucional dhe jo transparent në publikimin e të dhënave, duke kufizuar aftësinë për të reaguar në kohë dhe në mënyrë të përshtatshme ndaj problematikave të konstatuara në zonat e prekura. Në aspektin shëndetësor, mungesa e të dhënave të detajuara dhe studimeve të thelluara mbi impaktin shëndetësor të ndotjes në komunitetin që jeton në këtë zonë, nuk ka mundësuar vlerësimin e rreziqeve dhe planifikimin e masave për mbrojtjen e shëndetit publik. Në nivel vendor, investimet e kryera për riaftësimin dhe rehabilitimin mjedisor, kanë qenë minimale dhe të pamjaftueshme në përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe shëndetit në këtë zonë. Masat e marra nga institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit në zonën Patos-Marinëz nuk kanë qenë të mjaftueshme.



Në infrastrukturë

I. Mbrojtja dhe siguria e digave

Auditimi me temë “*Mbrojtja dhe siguria e digave*” u realizua në:

- Komitetin Kombëtar të Digave të Mëdha;
- Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Bashkinë Tiranë;
- Bashkinë Berat;
- Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore.

Në Shqipëri aktualisht janë 350 diga të mëdha dhe afro 300 diga të vogla duke e renditur vendin tonë ndër 6 vendet e para në Evropë dhe ndër 20 vendet e para në botë me numrin total më të madh të digave të mëdha. Shqipëria është vendi që ka më shumë diga të mëdha në botë për frymë dhe për 1000 km². Për vetë rëndësinë ekonomike dhe riskun e lartë që kane digat në rast prishje të mundshme të tyre apo të përmbajtjeve nga reshjet e mëdha është e domosdoshme mirëmbajtja, monitorimi, kontrolli dhe rritjen e sigurisë së tyre.

Objektivi i këtij auditimi ishte vlerësimi i masave të marra nga ana e institucioneve përgjegjëse me qëllim përmirësimin e gjendjes së digave, për periudhën e auditimit 2021 – 2024. Më konkretisht ai u fokusua në:

- Fushëveprimin e kuadrit ligjor të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së digave;
- Identifikimin dhe përditësimin e listës së digave në Shqipëri në respektim të përcaktimit të kuadrit ligjor në fuqi;
- Mbulimin dhe mbikëqyrjen me kontrole dhe inspektime nga institucionet përkatëse;



- Vlerësimin e gjendjes teknike të digave dhe klasifikimin e tyre sipas nivelit të riskut që ato përfaqësojnë;
- Masat e marra nga shfrytëzuesit e digave me qëllim përmirësimin dhe rritjen e sigurisë së digave që ato kanë në administrim;
- Planet e gatishmërisë në rastet e emergjencave civile (PGEC) si dhe sistemet e alarmit;
- Hartimin dhe raportimi i shfrytëzuesve të digave në KKDM mbi gjendjen teknike të digave;
- Braktisjen e digave etj.

Me anë të gjetjeve dhe konkluzioneve kryesore të këtij raporti auditimi u arrit në këtë mesazh: Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Bashkitë Tiranë e Berat si dhe institucionet e tjera shtetërore përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe kontrollin e digave nuk kanë vlerësuar gjendjen e të gjitha digave në vendin tonë dhe nuk kanë marrë masat e duhura për përmirësimin e gjendjes së tyre. Kuadri ligjor e rregullator nuk garanton një mbikëqyrje të plotë për të gjitha digat duke lënë jashtë vëmendjes digat e vogla. Objekt i veprimtarisë së Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha (KKDM) kanë qenë kryesisht digat e mëdha (rreth 350) ndërkohë që legjislacioni nuk i përjashton digat e vogla (rreth 300) nga fushëveprimi i tij. Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha, Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha, Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave dhe Inspektorati Teknik i Digave nëpërmjet veprimtarisë së tyre, nuk kanë garantuar mbulim me kontrole efektive të të gjitha digave në vendin tonë. Kontrolli, monitorimi dhe raportimi mbi gjendjen dhe sigurinë e digave përballet me mungesën e ngritjes dhe funksionimit të të gjitha strukturave mbikëqyrëse, sistemeve të monitorimit dhe raportimit jo të plotë e të qartë. Edhe pse janë kryer disa investime rehabilitues në 43 diga të ndryshme, ka munguar vëmendja institucionale dhe investime të qëndrueshme për përmirësimin e sigurisë së digave. Bashkia Tiranë dhe Berat nuk kanë pasur qasje pro aktive në gjurmimin dhe përthithjen e fondeve të ndryshme për të realizuar projekte rehabilituese në digat që kanë në administrim.

II. Aksesueshmëria për personat me aftësi të kufizuar

Auditimi me temë “*Aksesueshmëria për personat me aftësi të kufizuar*” u realizua në:

- Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Bashkinë Durrës;
- Bashkinë Shkodër;
- Bashkinë Pogradec.

Aksesueshmëria në infrastrukturë dhe transport është thelbësore për garantimin e barazisë, pavarësisë dhe përfshirjes së plotë sociale të personave me aftësi të kufizuara. Ajo përbën një të drejtë të sanksionuar ligjërisht dhe një kusht bazë për akses të barabartë në arsim, punësim, shërbime shëndetësore dhe jetën publike. Mungesa e aksesueshmërisë nuk është vetëm një problem teknik, por një formë diskriminimi që kufizon cilësinë e jetës dhe cenon kohezionin social dhe zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë.

Objektivi i këtij auditimi ishte paraqitja e rezultateve të arritura nga procesi i zbatimit të Planit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuar 2021 – 2025 në fushën e infrastrukturës dhe transportit rrugor, duke i kushtuar fokus të veçantë angazhimit të institucioneve subjekt auditimi në drejtim të garantimit të kushteve dhe të drejtave për personat me aftësi të kufizuar për periudhën e auditimit 2021 – 2025. Më konkretisht *ai u fokusua në:*

- zbatimi i PKPAK 2021 - 2025;
- zbatimi i ligjit për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar;
- respektimi i standardeve të aksesueshmërisë nga institucionet subjekt auditimi në të dyja fushat e përfshira (infrastrukturë dhe transport);



- licencimi i subjekteve që ofrojnë shërbim të transportit rrugor dhe respektimin e kriterëve të aksesueshmërisë në fazën e licencimit dhe dhënies së shërbimit;
- veprimtaria e KKAK në fushën e aksesueshmërisë;
- bashkëpunimi dhe ndërveprimi midis institucioneve në drejtim të monitorimit të situatës dhe arritjeve në fushën e aksesueshmërisë.

Me anë të gjetjeve dhe konkluzioneve kryesore të këtij raporti auditimi u arrit në këtë mesazh: Megjithëse kuadri ligjor dhe strategjik në Shqipëri njih të drejtën për akses dhe jetë të pavarur të personave me aftësi të kufizuara (PAK), në praktikë nuk janë krijuar ende kushte të përshtatshme për realizimin e kësaj të drejte. Auditimi tregoi se, zbatimi i masave të PKPAK 2021 - 2025 është i pjesshëm dhe i fragmentuar. MSHMS, MIE, Bashkitë Shkodër, Durrës dhe Pogradec nuk kanë siguruar një bashkëpunim të qëndrueshëm dhe funksional në këtë drejtim. Situata paraqitet problematike në fushën e transportit rrugor publik dhe infrastrukturës. Bashkitë e audituara nuk kanë miratuar plane të posaçme për aksesueshmërinë, nuk kanë kryer monitorime sistematike të kushteve ekzistuese dhe nuk kanë zbatuar kriteret për aksesueshmërinë në projektimin dhe inspektimin të ndërtimeve të reja. Kuadri ligjor aktual nuk përcakton nivelin minimal të aksesueshmërisë së garantuar në transportin rrugor publik. Për më tepër, legjislacioni kombëtar nuk është i përafëruar me standardet e Bashkimit Evropian në fushën e transportit të aksesueshëm. Në mungesë të ndërhyrjeve të strukturuar, mekanizmave funksionalë të bashkëpunimit dhe mbështetjes së qëndrueshme teknike e financiare, PAK vazhdojnë të përballen me barriera serioze në qasje dhe pjesëmarrje të barabartë në jetën publike, duke u penguar të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe dinjitoze.

III. Trajtimi, rehabilitimi dhe riintegrimi i personave të dënuar

Auditimi me temë *“Trajtimi, rehabilitimi dhe riintegrimi i personave të dënuar”* u realizua në:

- Ministrinë e Drejtësisë;
- Drejtorinë e Përgjithshme e Burgjeve;
- Shërbimin Social Shtetëror;
- Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

Trajtimi, rehabilitimi dhe riintegrimi i personave të dënuar ka ndikim të drejtpërdrejtë në respektimin e të drejtave të njeriut, sigurinë publike dhe kohezionin social të një vendi. Në kushtet kur sistemi penitenciar shqiptar përballlet me mbipopullim, mangësi infrastrukturore dhe kapacitete të kufizuara rehabilituese, një auditim i tillë shërben për të vlerësuar shkallën e përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare dhe efektivitetin e politikave të miratuara. Ai merr rëndësi të veçantë edhe për identifikimin e boshllëqeve në koordinimin ndër-institucional dhe për orientimin e masave konkrete që synojnë një proces rehabilitimi dhe riintegrimi më të qëndrueshëm dhe të matshëm.

Objektivi i këtij auditimi ishte të vlerësonte nëse institucionet përgjegjëse kanë siguruar një sistem efektiv dhe të koordinuar për trajtimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e personave të dënuar, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Auditimi u përqendrua në kushtet e trajtimit në institucionet penitenciare dhe në efektivitetin e programeve rehabilituese, pa anashkaluar këtu edhe mekanizmat e riintegritimit dhe bashkëpunimi ndër-institucional pas lirimit.

Më konkretisht ai u fokusua në mënyrë të veçantë institucionet publike që ushtrojnë funksione kyçe në hartimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e politikave për trajtimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e personave të dënuar, si pjesë e sistemit të drejtësisë penale, dhe mbuloi periudhën 2022 – 2024.

Me anë të gjetjeve dhe konkluzioneve kryesore të këtij raporti auditimi u arrit në këtë mesazh: Sistemi penitenciar në Shqipëri nuk garanton ende kushte dhe trajtim të plotë rehabilitimi dhe riintegrimi për personat e dënuar, kjo në mospërputhje me standardet kombëtare dhe



ndërkombëtare. Masat e programuara për përdorimin e burimeve financiare nuk janë orientuar dhe ndërlidhur drejt arritjes së objektivave specifike për financime të qëndrueshme në objektet e vuajtjes së dënimit. Bashkëpunimi ndërinstitucional ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Shërbimit të Provës, AKPA-së, Ministrisë së Arsimit, pushtetit vendor dhe operatorëve ekonomikë ishte i pjesshëm dhe shpesh formal, me marrëveshje që nuk zbatohen plotësisht dhe mekanizma referimi që nuk japin rezultate dhe nuk ka shërbyer plotësisht për kthimin e ish të dënuarve pranë familjeve dhe ri integrimin e tyre në shoqëri. Sistemi i burgjeve funksionon kryesisht si strukturë ruajtjeje dhe jo si mekanizëm i plotë rehabilitimi e riintegrimi, duke rritur rrezikun e recidivizmit dhe duke mos përmbushur pritshmëritë ligjore. Investimet e kryera dhe menaxhimi i shërbimeve mbështetëse në përmirësimin e kushteve nuk e kanë arritur qëllimin e tyre në kryerjen e një procesi profesional, të drejtë e efektiv në rehabilitimin dhe riintegrimin e të dënuarve pas lirim. Dobësitë në planifikimin e investimeve, menaxhimin financiar, dokumentimin, monitorimin dhe auditimin e brendshëm kufizojnë më tej efikasitetin e sistemit. Përqindja shumë e lartë e të paraburgosurve dhe mbipopullimi në disa Institucione Ekzekutimi të Vendimeve Penale (IEVP) krijojnë problematika në menaxhimin e paraburgimit dhe në përdorimin e masave alternative ndaj burgimit. Infrastruktura është e amortizuar, me raste ekstreme si në IEVP - të Rrogzhihë e Lushnjë, ndërkohë që investimet kapitale janë fokusuar kryesisht në siguri dhe transport, jo në përmirësimin e kushteve të qëndrimit, arsimit, formimit profesional dhe aktiviteteve rekreative. Programet rehabilituese – arsim, formim profesional, punësim, trajtim psiko - social dhe përgatitje prag-lirimi mbeten me shtrirje të kufizuar, cilësi të ulët dhe nuk lidhen mjaftueshëm me nevojat reale të të dënuarve dhe tregut të punës, si brenda ashtu edhe pas lirim.



I. Shërbimi psiko-social në sistemin arsimor parauniversitar

Auditimi i performancës me temë “Shërbimi psiko-social në sistemin arsimor parauniversitar” u realizua në:

- Ministrinë e Arsimit dhe Sportit;
- Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Institucionin e Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët;
- Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar;
- Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar.

Konfliktet në marrëdhëniet familje, problemet e përhershme ekonomike, ndikojnë ndjeshëm tek fëmijët, duke shkaktuar ankth, stres dhe vështirësi në përqendrim dhe motivim në mësim. Për më tepër, edhe bullizmi, si në mjediset e shkollës ashtu edhe në mediat sociale, është një fenomen që ndikon negativisht në mirëqenien psiko-sociale të nxënësve. Këto fenomene shpesh sjellin pasoja të rënda psikologjike për të rinjtë, duke i lënë ata të ndihen të izoluar dhe të pasigurt. Për këto arsye, shërbimi psiko-social në sistemin parauniversitar është një mekanizëm kyç për t'u përballur me këto sfida dhe për të siguruar një mjedis të shëndetshëm dhe mbështetës për nxënësit.

Në shërbimi psiko-social në sistemin arsimor parauniversitar punojnë gjithsej 824 punonjës nga të cilët 592 psikolog dhe 232 punonjës social, numër i cili ka ardhur në rritje vit pas viti.

Nga ana tjetër numri i nxënësve në arsimin parauniversitar publik ka pësuar ulje e cila ka impaktuar si shkollat rurale dhe ato urbane duke rritur numrin e shkollave me pak nxënës.

Objektivi i auditimi ishte vlerësimi i masave të marra nga institucionet përgjegjëse lidhur me garantimin e shërbimit psiko-social në mënyrë të njëjtë dhe gjithëpërfshirëse në sistemin



arsimor parauniversitar publik, për periudhën Janar 2020- Prill 2024. Më konkretisht auditimi u fokusua në:

- Përshtatshmërinë e strukturës së ngritur dhe infrastrukturës për dhënien e shërbimit psiko-social tek nxënësit e arsimit parauniversitar;
- Përbushjen e rolit të shërbimit psiko-social për identifikimin dhe adresimin e duhur të problematikave;
- Strategjitë e hartuara dhe veprimtaritë institucionale të ndërmarra në drejtim të mirëfunksionimit të shërbimit.

Me anë të gjetjeve dhe konkluzioneve kryesore të këtij raporti auditimi u arrit në këtë mesazh:

Institucionet përgjegjëse nuk garantojnë shërbim psiko-social të njëjtë dhe gjithëpërfshirës për nxënësit në shkollat e arsimit parauniversitar, për të mësuar në një mjedis të sigurtë dhe mbështetës. Një pjesë e shkollave, kryesisht në zonat rurale, nuk mbulohen me shërbim psiko-social. Kabinetet dhe mjetet ndihmëse mungojnë, por, dhe kur ato gjenden, në pjesën më të madhe të rasteve nuk janë të dedikuara për specialistët e këtij shërbimi. Ofrimi i shërbimit psiko-social për fëmijët me aftësi të kufizuara nuk kryhet sipas parashikimeve. Dokumentet strategjike në fuqi paraqesin në formë të fragmentuar objektiva për shërbimin psiko-social të cilat shpeshherë janë të mbivendosura. Ndërkohë, kuadri rregullator mbi të cilin është ndërtuar dhe funksionon ky shërbim është i papërshtatur me aktet e tjera ligjore dhe shpesh paraqitet kontradiktor. Megjithëse ndër vite janë ndërmarrë hapa për rritjen e numrit të stafit, shërbimi nuk e përbush ende funksionin e tij në mënyrë cilësore, për identifikimin dhe adresimin e problematikave psiko-sociale.

II. Roli dhe efektiviteti i oficerëve të sigurisë në shkolla

Auditimi me temë “Roli dhe efektiviteti i oficerëve të sigurisë në shkolla” u realizua në:

- Ministrinë e Arsimit dhe e Sportit,
- Ministrinë e Brendshme, Akademinë e Sigurisë,
- Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit,
- Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar,
- Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar,

Ky auditim është ndërmarrë si përgjigje ndaj rritjes së shqetësimeve publike dhe institucionale për sigurinë në shkolla, të shoqëruara me incidente dhune, konflikte dhe bullizimi që cenojnë mjedisin edukativ. Duke qenë se garantimi i një ambienti të sigurt për fëmijët është një prioritet shoqëror dhe pjesë e angazhimeve ligjore dhe evropiane të vendit, u vlerësua e nevojshme të analizohet roli dhe efektiviteti i oficerëve të sigurisë në shkolla. Auditimi synon të vlerësojë ndikimin real të kësaj mase, të identifikojë mangësitë dhe të propozojë përmirësime për forcimin e sigurisë dhe mirëqenies në institucionet arsimore.


Objektivi i këtij auditimi ishte të vlerësojë dhe analizojë efektivitetin e mekanizmave të ngritura nga institucionet përgjegjëse, lidhur me sigurinë e nxënësve në shkolla. për periudhën e auditimit shtator 2021 - dhjetor 2024.

Më konkretisht ai u fokusua në veprimtarinë e shumë institucioneve të arsimit parauniversitar, si Ministria e Arsimit dhe e Sportit, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Akademia e Sigurisë etj, për të shqyrtuar përgjegjësitë dhe veprimtarinë e tyre, sa i takon figurën e oficerit të sigurisë në shkolla, duke synuar vlerësimin e shkallës së zbatimit të politikave qeveritare, sipas parashikimeve në Strategjinë e Zhvillimit të Arsimit 2021 – 2026.

Me anë të gjetjeve dhe konkluzioneve kryesore të këtij raporti auditimi u arrit në këtë mesazh: Siguria në shkolla përgjatë periudhës shtator 2021 – dhjetor 2024, ka rezultuar një proces jo efektiv, si rezultat i mangësive të kuadrit rregullator, rolit të oficerëve të sigurisë, e mungesës së monitorimit të tyre, si dhe mos koordinimit të institucioneve pjesë e këtij procesi. Kuadri



rregullator, nuk ka përcaktuar rregulla të qarta sa i përket, mbledhjes, përpunimit dhe analizimit të të dhënave mbi incidentet në shkolla. Aktiviteti i ushtruar nga oficerët e sigurisë, nuk u përgjigjet nevojave të shkollës, sepse nuk përdoren “instrumente matës” për të njohur këto nevoja dhe nuk ushtrohen kontrole fizike të nxënësve ose mjediseve të shkollave. Raportimi zyrtar midis aktorëve pjesë e këtij procesi ka mangësi të theksuara duke rezultuar i pa saktë e i pa plotë. Mos mbulimi i të gjitha shkollave me oficerë sigurie ka çënuar gjithashtu sigurinë në shkolla. Koordinimi dhe bashkëpunimi midis Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar dhe Akademisë së Sigurisë, nuk është në nivele të duhura. Oficerët e sigurisë në shkolla nuk monitorohen, as nga drejtuesit e IAP-ve dhe, as nga strukturat përkatëse të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar.



Në teknologji dhe inovacion

I. Blerjet on-line në shqipëri, taksat dhe shërbimi ndaj qytetarit

Auditimi me temë “Blerjet on-line në Shqipëri, taksat dhe shërbimi ndaj qytetarit” u realizua në:

- Ministrinë e Financave;
- Drejtorinë e Përgjithshme e Doganave;
- Drejtorinë e Përgjithshme e Tatimeve,
- Inspektoratin Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut;
- Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Kjo tematikë është e rëndësishme pasi blerjet online janë shndërruar në një pjesë gjithnjë e më të pranishme të jetës së përditshme dhe po ndikojnë drejtpërdrejt në sjelljen e konsumatorëve dhe në zhvillimin ekonomik. Rritja e përdorimit të internetit dhe e tregtisë elektronike në Shqipëri, veçanërisht pas pandemisë Covid - 19, ka nxjerrë në pah nevojën për rregullim, mbrojtje të konsumatorit dhe funksionim eficient të mekanizmave fiskalë e doganorë. Në kushtet kur niveli i blerjeve online mbetet ende i ulët krahasuar me rajonin dhe Bashkimin Evropian, kjo fushë paraqet potencial të konsiderueshëm për zhvillim, por edhe kërkon vëmendje të shtuar institucionale për të garantuar siguri, transparencë dhe besim të konsumatorëve.

Objektivi i këtij auditimi ishte vlerësimi i masave të ndërmarra nga institucionet përgjegjëse në menaxhimin e tregtisë elektronike, me fokus të veçantë në formalizimin e veprimtarisë, mbrojtjen e konsumatorit dhe përmbushjen e detyrimeve fiskale. Më konkretisht ai u fokusua në mënyrë të veçantë në veprimtarinë e Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, me njësitë e tyre të varësisë, Inspektoratit Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut, Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Subjektet e përzgjedhur si edhe periudha e auditimit mundëson pasjen e një panorame të plotë lidhur me kompetencat dhe proceset që institucionet përgjegjëse ushtrojnë në funksion të mirë menaxhimit.

Me anë të gjetjeve dhe konkluzioneve kryesore të këtij raporti auditimi u arrit në këtë mesazh: Tregtia online në Shqipëri vijon të rritet, por mbetet ndjeshëm prapa vendeve të rajonit dhe Bashkimit Evropian në nivel përfshirjeje dhe formalizimi. Sipas raportit Balkan Barometer 202421, vetëm një përqindje e vogël e bizneseve shqiptare realizojnë më shumë se 5% të shitjeve online, duke e renditur vendin me nivelin më të ulët të shitjeve online në rajon. Auditimi evidentoi mungesën e politikave të qarta dhe të integruara për tregtinë online nga institucionet politikëbërës, si në aspektin e rregullimit të veprimtarive dixhitale, ashtu edhe



në rolin mbikëqyrës të tyre. Nga ana tjetër, institucionet ligjzbatuese, si ato qendrore ashtu edhe ato vendore, nuk kanë arritur të përmirësojnë procedurat e brendshme për të menaxhuar risqet e blerjeve online në mënyrë efektive. Kontrollet fiskale dhe doganore janë të fragmentuara dhe mungojnë tërësisht fushatat sensibilizuese për konsumatorët dhe shitësit online. Mungesa e një qasjeje të integruar dhe mungesa e koordinimit ndërinstitucional ka lënë hapësirë për informalitet, duke kufizuar zhvillimin e tregut dixhital. Nga institucionet përgjegjëse kërkohet një angazhim konkret për të garantuar interesin publik dhe të drejtat themelore të qytetarëve në epokën digjitale. Vetëm përmes një qasjeje të koordinuar ndërinstitucionale, përmirësimit të kuadrit ligjor, forcimit të transparencës dhe ndërtimit të besimit publik, mund të sigurohet që tregtia online të funksionojë si një mjedis i drejtë, i mbrojtur dhe i barabartë për të gjithë përdoruesit. Ndërhyrjet nuk duhet të jenë opsionale, por prioritare për të mbrojtur besimin dhe sigurinë e qytetarëve në një ekonomi që po digjitalizohet me ritme të shpejta.

II. Siguria kibernetike në infrastrukturën kritike e-taxation

Auditimi i performancës me temë “*Siguria kibernetike në infrastrukturën kritike E-taxation*” u zhvillua në:

- Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT);
- Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI);
- Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK).

Me zhvillimin e shpejtë të teknologjisë së informacionit dhe përdorimit të tij në administratën publike, rëndësia e sigurisë kibernetike është rritur ndjeshëm në nivel global, duke prekur aspekte të ndryshme të jetës sociale, ekonomike dhe institucionale të vendeve të ndryshme. Në dekadat e fundit, me rritjen e përdorimit të sistemeve digjitale në sektorë si financat, shëndetësia dhe tatimet, siguria e të dhënave dhe infrastrukturave kritike është bërë një nga çështjet më të rëndësishme për qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare. Në Shqipëri kanë ndodhur disa sulme kibernetike të rëndësishme vitet e fundit që kanë vënë në dukje dobësitë e sistemeve të sigurisë kibernetike dhe kanë shtuar nevojën për masa më të forta mbrojtëse. Disa nga sulmet kibernetike më të njohura janë: a) Sulmi ndaj sektorit bankar në vitin 2016; b) sulmi ndaj institucioneve shtetërore në korrik të vitit 2022 dhe c) sulmi ndaj sistemit TIMS në shtator të vitit 2022.

Auditimi me temë “*Siguria kibernetike në infrastrukturën kritike E-taxation*” ka pasur si objektiv kryesor vlerësimin dhe analizimin e masave të marra nga institucionet përgjegjëse (DPT, AKSHI, AKSK) mbi funksionimin dhe sigurinë kibernetike të sistemit elektronik të tatimeve.

Me anë të gjetjeve dhe konkluzioneve kryesore të këtij raporti auditimi u arrit në këtë mesazh:

Nga auditimi u konstatuan problematika që ndikojnë drejtpërdrejt në nivelin e sigurisë kibernetike dhe qartësinë e përgjegjësive institucionale. Mungonte metodologjia për identifikimin e operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, siç kërkohet nga Ligji nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike”. Megjithëse Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) është përcaktuar si operator administrues i sistemit kritik e-Taxation me VKM-në nr. 553/2020 “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit” i ndryshuar, infrastruktura administrohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), duke krijuar paqartësi në ndarjen e roleve dhe përgjegjësive. U konstatuan mospërputhje ndërmjet rregullores së Autoritetit Kombëtar të Sigurisë Kibernetike me Ligjin nr. 43/2023 “Për qeverisjen elektronike”, i cili i ngarkon AKSHI-n për garantimin e zbatimit të masave të sigurisë për infrastrukturat kritike që menaxhon, si dhe me Strategjinë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike, e cila përcakton se për infrastrukturat qeveritare të menaxhuara nga AKSHI duhet



të aplikohen të gjitha masat sipas legjislacionit dhe standardit ISO 27001. Si rrjedhojë e centralizimit të shërbimeve TI pranë AKSHI-t, DPT ka transferuar infrastrukturën dhe burimet njerëzore të teknologjisë së informacionit, duke krijuar boshllëqe në burimet njerëzore të specializuara, e cila rrit ekspozimin ndaj risqeve kibernetike dhe kufizon kapacitetin reagues ndaj incidenteve. Në aspektin teknik dhe operacional janë identifikuar mosrespektim i distancës minimale ndërmjet primary dhe secondary site, në kundërshtim me udhëzimin e AKSHI-t, mungesë dokumentimi për analizën e nevojave dhe planifikimin e trajnimeve, si dhe mungesë planesh për trajnimin e përdoruesve fundorë; mungesa e enkriptimit të të dhënave, mungesë dokumentacioni për kontrollet mjedisore në Data Center-in Qeveritar (p.sh. përmbajtje, zjarr, testime periodike), mungesë skedulimi të dokumentuar për rishikimin e logeve të sistemit, në kundërshtim me praktikat më të mira ndërkombëtare (NIST, CIS), paqartësi dhe mungesë dokumentimi të plotë mbi kontrollet e aksesit të palëve të treta në sistemin kritik.



3.6 AUDITIME TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Roli i auditimit të Teknologjisë së Informacionit (TI) në ofrimin e sigurisë së proceset e duhura janë vendosur për të menaxhuar rreziqet dhe dobësitë përkatëse të TI-së, është thelbësor nëse SAI-et do të raportojnë në mënyrë kuptimplote mbi efikasitetin dhe efektivitetin e operacioneve të qeverisë dhe sektorit publik.

Ritmi me të cilin teknologjia po përparon është më i shpejtë se kurrë, gjë që gjithashtu sjell implikime për auditimet e TI-së. Sistemet e TI janë gjithnjë e më komplekse. Këto sisteme janë të ndërlidhura me sisteme dhe rrjete të tjera të brendshme dhe të jashtme, duke përfshirë edhe internetin, e duke rritur kështu kompleksitetin e tyre.

Kalimi në sistemet e TI dhe përpunimi dixhital nga njësitë e audituara në sektorin publik, ka sjellë nevojën që edhe KLSH, të zhvillojnë kapacitetet e duhura për të kryer ekzaminimin e plotë të kontrolleve në lidhje me sistemet e TI-së, në përmbushje edhe me mandatin ligjor.

Gjatë auditimeve IT, audituesi duhet të sigurohet që kontrollet e brendshme të TI-së, në lidhje me konfidencialitetin, integritetin, vlefshmërinë dhe disponueshmërinë e të dhënave, janë miratuar dhe funksionojnë me efektivitet, duke i shërbyer objektivave të njësisë së audituar. Në përfundim të auditimeve IT, grupi i auditimit konkludon në Konkluzionin e Auditimit.



10 Auditime



10
Konkluzione

10 konkluzione
në auditimet IT



3.6 AUDITIME TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Në Qendrën Arsimore Lushnjë

Nga auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit u konstatuan mangësi në infrastrukturën TI, e cila rezultoi e amortizuar, joefikase dhe e papajisur me elementët bazë të sigurisë, si firewall, switch-e të menaxhueshme dhe pajisje kompjuterike të sigurta. Shërbimet TI mbështeteshin në një infrastrukturë të pakonsoliduar, me ndërprerje të shpeshta të lidhjes në internet përmes teknologjisë ADSL, përdorim të programeve të palicencuara dhe pajisje periferike të vjetruara. Këta faktorë rrisin ndjeshëm rrezikun për sigurinë e të dhënave dhe pengojnë funksionimin e qëndrueshëm dhe efikas të sistemeve dhe shërbimeve arsimore. Gjithashtu, mungesa e sistemeve të monitorimit në çerdhe dhe kopshte evidentoi nevojën për kryerjen e një analize të detajuar të kërkesave për infrastrukturën TI, si dhe për sigurimin e burimeve financiare të nevojshme për modernizimin dhe konsolidimin e tij.

Në Drejtorinë Rajonale Arsimore Parauniversitare Lezhë

Nga auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit u konstatua se infrastruktura TI e institucionit përballej me mangësi që rrezikonin sigurinë dhe vazhdimësinë e shërbimeve. Mungesa e një infrastrukture të qëndrueshme të rrjetit, përfshirë firewall-in dhe mbrojtjen antivirus, përdorimi i fjalëkalimeve të dobëta, mungesa e politikave të qarta për menaxhimin e aksesit dhe autentifikimit, si dhe ekspozimi fizik i pajisjeve pa masa mbrojtëse, e ekspozonin institucionin ndaj sulmeve kibernetike dhe pengonin identifikimin dhe gjurmimin e përgjegjësive për veprimet në sistem. Si përfundim, u vlerësua se drejtoria operonte në një nivel të lartë rreziku kibernetik, për shkak të mungesës së kontrolleve bazë të sigurisë dhe të politikave të formalizuara për menaxhimin e sistemeve dhe aksesit.

Në Universitetin e Sporteve të Tiranës

Nga auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit u evidentuan mangësi në menaxhimin e sigurisë dhe vazhdimësisë së shërbimeve TI. Universiteti nuk kishte politika dhe procedura të miratuara për sigurinë e informacionit, nuk kishte sisteme antivirusi të instaluar, si dhe përdorte kompjutera me sisteme operative të pa përditësuara. Marrëveshja me Rrjetin Akademik Shqiptar nuk përcaktonte procedura, kohë rikthimi ose penalitete për mosrealizim të shërbimeve, dhe nuk kishte një person të autorizuar për monitorimin e zbatimit të saj, duke ekspozuar universitetin ndaj ndërprerjeve të shërbimeve kritike. Funksionaliteti i sistemit Pitagora ishte i kufizuar, rubrikat dhe raportet nuk gjeneroheshin automatikisht, disa përdorues kishin akses në sistem, që nuk i takonin rolit të tyre, si dhe nuk ekzistonte një plan për monitorimin periodik të të dhënave të përcjella nga RASH. Gjithashtu, nuk ishin ngritur grupe pune për hartimin e rregulloreve për sistemin Pitagora, mbrojtjen e të dhënave personale dhe monitorimin me video, duke kufizuar aftësinë e institucionit për të menaxhuar në mënyrë të sigurt dhe të rregullt sistemet informatike. Mungesa e strukturave, rregulloreve, procedurave dhe kontrolleve, si dhe funksionaliteti i kufizuar i sistemit Pitagora, rrisin rrezikun e gabimeve njerëzore, ndërprerje të shërbimeve dhe cenojnë menaxhimin e të dhënave akademike dhe personale.

Në Zyrën Rajonale Statistikore Fier

Nga auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit u evidentuan mangësi në menaxhimin e teknologjisë së informacionit dhe sigurinë e të dhënave, të cilat e ekspozonin institucionin ndaj rreziqeve operative dhe kibernetike. Zyra nuk kishte specialist TI për zbatimin e standardit ISO/IEC 27001 dhe praktikat më të mira kombëtare e ndërkombëtare,



dukë bërë që problemet teknike të mos adresoheshin në kohë dhe politikat e sigurisë kibernetike të mos zbatohen në mënyrë të vazhdueshme. Infrastruktura TI nuk ishte e qendëruar për menaxhim dhe monitorim, nuk ishin përcaktuar përgjegjësi të qarta për ruajtjen e të dhënave elektronike të krijuara dhe të ruajtura lokalisht nga punonjësit, dhe përdoruesit operonin me të drejta administrative, duke pasur mundësi për instalime të ndryshme software pa aprovime paraprake. Zyra nuk disponon rregullore dhe udhëzues bazë për menaxhimin e teknologjisë së informacionit, sipas kërkesave ligjore. Politikat dhe rregulloret e INSTAT janë të fokusuar në nivel qendror dhe nuk ofrojnë udhëzime të detajuara për zyrat rajonale. Për më tepër, Zyra Rajonale nuk ishte përdoruese e sistemeve qendrore të INSTAT, dhe shkëmbimi i të dhënave kryhej përmes postës elektronike ose tradicionale, çfarë krijon rrezik operacional dhe cenon sigurinë, integritetin dhe vazhdimësinë e proceseve të punës. Këto mangësi krijojnë një mjedis me rrezik të lartë, duke kërkuar ndërhyrje për forcimin e menaxhimit dhe sigurisë së teknologjisë së informacionit.

Në Qendrën Kombëtare Kinematografike

Nga auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit u evidentuan mangësi të konsiderueshme në menaxhimin e teknologjisë së informacionit, sigurinë e të dhënave dhe vazhdimësinë e shërbimeve. QKK nuk kishte të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin dhe raportimin e incidenteve TI, si dhe nuk dispononte rregullore për menaxhimin e teknologjisë së informacionit sipas praktikave më të mira dhe legjislationit në fuqi, duke rezultuar në operim mbi baza ngjarjeje dhe përgjegjësi të paalokuar. Sistemi i Menaxhimit të Aplikimeve (AMS) dhe Sistemi i Qarkullimit të Dokumentave me Nënshkrim Elektronik (SQDNE) përdoroheshin vetëm nga specialisti TI, pa ndarje të roleve sipas funksioneve të punonjësve, duke rritur rrezikun e mbivendosjes së të drejtave dhe cenimin e integritetit të proceseve. Sistemi AMS nuk kishte rregullore të përdorimit specifike për QKK, ekzistonin rekorde testimi në sistemin live dhe nuk ishte i mundur raportimi i saktë i aplikimeve. Sistemi i mëparshëm filmcoproduction.com nuk është më në përdorim, dhe as kodi burim, as të dhënat nuk administrohen nga QKK, duke cenuar kontrollin administrativ dhe shkelur Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Për periudhën 2018–2023, për këtë sistem janë investuar 1,407 mijë lekë me TVSH, e cila përbën përdorim pa ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet të fondeve publike. Për më tepër, QKK nuk ka ndërmarrë masa për të marrë në përdorim bazën e të dhënave të gjeneruar nga operatori ekonomik gjatë periudhës së përdorimit të sistemit, duke lënë të paadministruara informacionet e krijuara ndër vite. QKK nuk ka marrë masa për hostimin dhe kontrollin e sistemit të aplikimeve online në e-Albania, duke vijuar kontrata me operatorin ekonomik pa vendndodhje të saktë të serverit dhe pa siguruar kontroll mbi të dhënat. Nuk janë përcaktuar sistemet dhe të dhënat konfidenciale që aksesohen, nuk ekzistojnë plane vazhdimësie dhe rimëkëmbjeje të shërbimeve IT, duke rritur rrezikun e ndërprerjes së shërbimeve dhe humbjes së të dhënave. Kopjet fizike të filmave të projekteve të financuara nuk janë të gjitha të lexueshme, nuk ka përgjegjës të caktuar për ruajtjen dhe dokumentimin e tyre, dhe vetëm një kopje ruhet në NAS, pa dokumentim administrativ të procedurës së backup-it.

Në Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët

Nga auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit, u konstatua se infrastruktura aktuale e rrjetit mbështetet në një lidhje të kufizuar interneti dhe në pajisje të pa konsoliduara dhe të pa menaxhueshme, të cilat nuk mundësojnë monitorimin e trafikut, identifikimin e anomalive dhe garantimin e performancës. Gjithashtu, mungesa e mekanizmave bazë të sigurisë, përfshirë firewall-in, rrit rrezikun nga sulmet e jashtme dhe evidencon nevojën për hartimin dhe zbatimin e politikave, procedurave dhe masave teknike për mbrojtjen e



informacionit dhe asetëve të TI, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira.

Në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Nga auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit u konstatuan mangësi në menaxhimin e TIK, pasi institucionit nuk i është siguruar një strukturë e qëndrueshme e TI-së dhe gjithashtu nuk ka përfituar mbështetje të vazhdueshme nga AKSHI dhe nga strukturat përgjegjëse për teknologjinë e informacionit pranë Ministrisë së Brendshme, ndërkohë që aktiviteti i menaxhimit të sistemit mbështetet kryesisht në njohuritë bazë të punonjësve dhe në një specialist të përkohshëm me kontratë njëvjeçare, gjë që rrit rrezikun e gabimeve, vonesave dhe cenimit të sigurisë dhe integritetit të proceseve të automatizuara. Të gjithë përdoruesit kishin akses si administrator lokal, pa aprovime paraprake për instalime ose modifikime softuerësh, duke rritur ndjeshëm rrezikun e instalimit të softuerëve të paautorizuar dhe cenimin e të dhënave, në kundërshtim me standardet ISO/IEC 27001:2022. Nuk ishte instaluar asnjë antivirus për rrjetin, duke e ekspozuar institucionin ndaj viruseve, malware dhe ransomware, dhe duke rrezikuar vazhdimësinë e proceseve dhe integritetin e të dhënave. Mungesa e dokumentacionit rregullues dhe teknik për përdorimin dhe menaxhimin e TI, përfshirë dokumentimin e arkitekturës teknologjike, procedurat për ruajtjen e të dhënave, menaxhimin e përdoruesve dhe pikat e kontaktit për incidentet, cenon sigurinë, qartësinë operationale, gjurmueshmërinë dhe historikun e sistemit, duke e bërë të vështirë ndjekjen e veprimeve dhe kontrollin e proceseve. Për më tepër, në shtatë kompjuterë ishin instaluar produkte Microsoft Office pa licencë të dokumentuar, duke krijuar rrezik ligjor dhe funksional, ndërkohë që nuk ishin përcaktuar detyra dhe përgjegjësi për kryerjen e kopjeve rezervë të të dhënave elektronike, duke rritur rrezikun e humbjes së informacionit. Detyrat për mirëmbajtjen dhe përditësimin e sistemit elektronik i ishin ngarkuar një punonjësi me formim juridik, i cili nuk kishte profil teknik, duke e bërë të pamundur përmbushjen e këtyre detyrimeve në praktikë. Sistemi elektronik për regjistrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nuk ka qenë funksional dhe nuk është përdorur gjatë periudhës së auditimit, duke u përdorur si alternativë vetëm tabela Excel, e cila ka kufizuar administrimin efektiv të pasurive, shkëmbimin e informacionit me strukturat e tjera dhe ka ulur efikasitetin e investimeve të kryera për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër

Nga auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit u evidentuan mangësi në menaxhimin institucional dhe përdorimin e teknologjisë së informacionit, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin, sigurinë dhe efektivitetin e proceseve. Institucioni nuk kishte miratuar strategji apo plan strategjik për TI-it, duke mos planifikuar burimet dhe mjetet e nevojshme për mbështetjen e objektivave institucionale, gjë që rrit riskun e keqmenaxhimit të resurseve. Mungesa e një baze rregullatore për teknologjinë e informacionit, përfshirë rregulloret, procedurat dhe udhëzimet për përdorimin e sistemeve, menaxhimin e përdoruesve dhe administrimin e riskut, cënon qartësinë operationale, gjurmueshmërinë dhe historikun e proceseve. Sistemi ICMIS, i cili ka rëndësi të veçantë për sistemin e drejtësisë, ka pësuar ndryshime dhe zhvillime teknologjike ndër vite, duke përfshirë shtim funksionaliteti, role dhe zhvillime të reja. Megjithatë, janë shfaqur problematika të shumta që vështirësojnë ndjeshëm punën e përdoruesve, duke ndikuar në saktësinë dhe përmbajtjen e informacionit, si dhe reduktimin aksesueshmërisë dhe përdorueshmërisë së të dhënave nga strukturat e tjera, ku raporton Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. Infrastruktura qendrore e teknologjisë së informacionit nuk ishte në përputhje me udhëzimet, standardet dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare. Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore ICMIS nuk përdorej në mënyrë efektive për shkak të mungesës së



rregulloreve dhe procedurave për menaxhimin e përdoruesve, fjalëkalimeve, kontrollit të aksesit dhe politikave të rolit, si dhe mangësive në arkivimin dhe koordinimin e dosjeve fizike me dosjet elektronike, e cila rrit riskun e dablimeve dhe të dhënave të pasakta. Konfigurimet e Active Directory mbeten në gjendje default, duke rritur mundësinë e aksesit të paautorizuar. Hyrja në ambientet fizike nuk monitorohet siç duhet, duke çenuar sigurinë fizike. Procedurat e backup-ve, log-eve dhe menaxhimit të incidenteve nuk janë dokumentuar, duke ekspozuar institucionin ndaj humbjes së të dhënave dhe ndërprerjes së vazhdimësisë së shërbimeve. Gjithashtu, infrastruktura fizike e dhomës së serverëve nuk përmbushte standardet minimale të sigurisë dhe funksionalitetit teknik, duke përfshirë mungesën e sistemit kundër zjarrit, alarmit, kamerave dhe kushteve të përshtatshme për pajisjet. Faqja web e gjykatës nuk gjeneronte raportet statistikore për çështjet civile dhe penale, duke penguar transparencën dhe qasjen e qytetarëve në informacion.

Në Agjencinë Kombëtare të Diasporës

Nga auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit u konstatuan problematika me karakter organizativ dhe funksional në administrimin e sistemit informatikë dhe të bazës së të dhënave. Sistemi nuk përmbush kërkesat e VKM nr. 504/2020 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë”, pasi nuk janë krijuar kategori të veçanta për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare përfitues të bursave dhe për të arsimuarit jashtë vendit me vetëfinancim, duke bërë që baza e të dhënave të mos reflektojë qëllimin për të cilin është ndërtuar dhe të mos evidentohet përdorim efektiv i saj nga institucionet e tjera publike. Gjithashtu, u evidentua se agjencia ka administruar kryesisht të dhëna që burojnë nga aktiviteti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit sipas VKM nr. 160/2020 “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (fondi i ekselencës)”, duke sjellë mbivendosje funksionesh dhe paqartësi institucionale në lidhje me përgjegjësitë për administrimin, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të studentëve përfitues të bursave jashtë vendit. Auditimi konstatoi gjithashtu mungesën e miratimit të strukturës së re organizative dhe përditësimit të rregullores së brendshme, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 120/2024 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, si dhe mosfunksionimin e mekanizmave të vetë-deklarimit elektronik të të dhënave të diasporës përmes faqes zyrtare të institucionit apo platformës e-Albania, duke kufizuar ndërtimin, përditësimin dhe shfrytëzimin efektiv të bazës së të dhënave në funksion të politikë bërjes dhe vendimmarrjes.

Në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë

Nga auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit u konstatuan problematika si, mungesa e procedurave mbi administrimin e incidenteve dhe problemeve në rrjetin e pa klasifikuar, ku KMS është përdorues, mungesa e trajnimeve për burimet njerëzore që mbulojnë fushën e teknologjisë së informacionit, si dhe mungesa e trajnimeve për punonjësit që janë përdorues të pajisjeve dhe sistemeve teknologjike. Dobësitë lidhen kryesisht me menaxhimin e aksesit, kushtet e infrastrukturës së TI dhe dokumentimin e procedurave. Gjithashtu u evidentua përdorimi i pajisjeve me sisteme operative të pa përditësuara, të cilat ekspozojnë institucionin ndaj rreziqeve të sigurisë.






3.7 AUDITIME TË ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

Rekomandimet e adresuara përfaqësojnë instrumentet, nëpërmjet të cilave auditimi mund të sjellë një vlerë të shtuar për njësitë publike. Efektiviteti i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve nga KLSH, është thelbësor për arritjen e përfitimeve maksimale nga veprimtaria audituese.

Kërkesat e Kornizës së Deklaratave Profesionale të INTOSAI (IFPP) përcaktojnë qartë rolet e përgjegjësitë e subjekteve të audituara dhe Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI), sipas të cilave është thelbësore që përgjegjësia për implementimin e rekomandimeve në kohe dhe në mënyrë efektive është e subjekteve të audituara, por nga ana tjetër është përgjegjësi e SAI-ve ndjekja e zbatimit të rekomandimeve pra të verifikojë veprimet e ndërmarra dhe nëse janë arritur rezultatet e pritshme.

Procedurat për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve në KLSH, kanë për qëllim identifikimin dhe dokumentimin e shkallës së zbatueshmërisë dhe ato mbështeten në: Kërkesat e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë1 Neni 163 dhe 164, Ligjin nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, nenet 15 dhe 30, Kornizën e Deklaratave Profesionale të INTOSAI-t, Standartet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, Manualin për Ndjekjen e Zbatimit të Rekomandimeve të Auditimeve të KLSH-së, Regjistrin elektronik institucional, si dhe Strategjinë e KLSH-së, 2023-2027.



3.7 AUDITIME TË ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

Performanca institucionale nuk mund të arrihet pa konsolidimin e një sistemi efektiv të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve dhe kjo është rruga e vetme e përmbushjes së qëllimeve strategjike të misionit dhe vizionit institucional, si dhe pritshmërive të Kuvendit, publikut dhe gjithë palëve të interesit. Kërkesat e Kornizës së Deklaratave Profesionale të INTOSAI (IFPP), përcaktojnë qartë rolet e përgjegjësitë e subjekteve të audituara dhe Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI-eve), sipas të cilave është thelbësore që përgjegjësia për implementimin e rekomandimeve në kohë dhe me efektivitet është e subjekteve të audituara; por nga ana tjetër është përgjegjësi e SAI-ve ndjekja e zbatimit të rekomandimeve, pra verifikimi nëse veprimet e ndërmarra i shërbejnë rezultateve të pritshme.

Procesi për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve dhe inicimi i zbatimit të masave korrigjuese nga subjektet e audituara, jep një informacion të detajuar mbi vlerën e shtuar që sjell puna e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe njëherazi jep garanci për profesionalizmin, pavarësinë dhe objektivitetin e institucionit.

Konsolidimi i një mekanizmi efektiv të verifikimit sistematik dhe raportimit të zbatimit të rekomandimeve, bazuar në metodologji dhe procedura të standardizuara, të qarta dhe të mirë detajuara, i lejon jo vetëm Kontrollit të Lartë të Shtetit, por dhe palëve të treta Kuvendit, Qeverisë, etj., të sigurojnë në vijimësi, një informacion të plotë, lidhur me veprimet e ndërmarra nga ana e subjekteve të audituara për hartimin e dokumenteve strategjike në nivel institucional dhe kombëtar apo për iniciativa për ndryshime ligjore, administrative dhe organizative.

Skemat dhe qasja e përdorur për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, synojnë të gjenerojnë indikatorë të konsoliduar institucional, sa i takon pranueshmërisë dhe zbatueshmërisë së rekomandimeve, duke mundësuar në këtë mënyrë rritjen e mbikëqyrjes parlamentare nga ana e Kuvendit ndaj ekzekutivit, me efekt rritjen e përgjegjshmërisë së menaxhimit të fondeve publike.

Gjatë vitit 2025, KLSH kreu verifikimin e zbatimit të rekomandimeve për 125 auditime të cilat kanë përfshirë ndjekjen dhe monitorimin e 4348 rekomandimeve, rezultatet e të cilit janë dërguar në:

- Kuvendin e Republikës së Shqipërisë me shkresat: nr. 282, datë 25.02.2025; nr. 282/3 prot, datë 04.07.2025; dhe nr 282/4 prot, date 18.12.2025.
- Ministrin të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, me shkresat: nr. 282/1, datë 25.02.2025; nr. 282/2 prot datë 04.07.2025 dhe nr. 282/5 prot, datë 18.12.2025.


*Shënim: *Këtu janë përfshirë dhe 119 rekomandime për “masë disiplinore”; dhe 6 rekomandime për “masë administrative” që nuk janë më relevante*



Nga verifikimi në terren, i zbatimit të rekomandimeve, rezultoi se nga 4348 rekomandime të lëna gjatë vitit 2024, 4294 rekomandime janë pranuar, ose rreth 99% e tyre; dhe nuk janë pranuar 54 rekomandime, ose rreth 1%.

Nga 4294 masa të pranuar, 1598* masa rezultuan të jenë zbatuar plotësisht (ose rreth 37 % e total masave të pranuar), 645 masa zbatuar pjesërisht (ose rreth 15 % e total masave të pranuar), 746 në proces zbatimi (ose rreth 18 % e total masave të pranuar) dhe 1305 masa janë ende pa zbatuar (ose rreth 30 % e total masave të pranuar).

Në përfundim statusi i rekomandimeve, organizuar sipas llojit, rezultoi si vijon:



✓ 27 “Masa për përmirësime ligjore”, nga të cilat janë pranuar 26 masa ose 96% dhe 1 masë pa pranuar ose 4%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se nga masat e pranuar janë zbatuar 5 masa ose 19%, janë zbatuar pjesërisht 7 masa ose 27%, janë në proces zbatimi 8 masa ose 31% dhe nuk janë zbatuar 6 masa ose 23%.

✓ 2386 “Masa organizative”, nga të cilat janë pranuar 2350 masa ose 98% e tyre dhe nuk janë pranuar 36 masa ose 2%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 793 masa ose 34%, janë zbatuar pjesërisht 356 masa ose 15%, janë në proces zbatimi 536 ose 23% dhe nuk janë zbatuar 665 masa ose 28% e tyre.

✓ 535 “Masa për eliminimin e efekteve negative” nga të cilat janë pranuar 530 masa ose 99% dhe nuk janë pranuar 5 masa ose 1 %. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se nga masat e pranuar janë zbatuar 85 masa ose 16%, janë zbatuar pjesërisht 121 masa ose 23%, janë në proces zbatimi 134 masa ose 25% dhe nuk janë zbatuar 190 masa ose 36%.

✓ 182 “Masa për shpërblim dëmi”, nga të cilat janë pranuar 178 masa ose 98% dhe nuk janë pranuar 4 masa ose 2%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve në subjekte rezultoi se nga 178 rekomandimet e pranuar, janë zbatuar plotësisht 64 masa ose 36%, zbatuar pjesërisht 28 masa ose 16%, janë në proces zbatimi 25 ose 14% dhe nuk janë zbatuar 61 masa ose 34%.

✓ 1142 “Masa disiplinore”, nga të cilat janë pranuar 1134 masa ose 99% dhe nuk janë pranuar 8 masa ose 1%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se nga masat e pranuar janë zbatuar 621* masa ose 55%, zbatuar pjesërisht 133 masa ose 12%, në proces zbatimi 42 masa ose 4% dhe nuk janë zbatuar 338 masa ose 30% e tyre.

✓ 76 “Masa administrative”, nga të cilat janë pranuar 76 masa ose 100% e tyre. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se nga masat e pranuar janë zbatuar 30* masa ose 40% e tyre, në proces zbatimi 1 masë ose 1% dhe nuk janë zbatuar 45 masa ose 59% e tyre.

KLSH, ka rikërkuar nga të gjitha subjektet përsheptimin e zbatimit të masave të pranuar por “të pazbatuara”, si dhe të të gjitha masave që kanë rezultuar “në proces zbatimi” ose “të zbatuara pjesërisht”.







04

Menaxhimi
institucional dhe
zhvillimi strategjik

4.1 MONITORIMI VJETOR I “STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL 2023 – 2027”

Strategjia e Zhvillimit të KLSH-së 2023 - 2027 përfaqëson dokumentin strategjik kryesor të institucionit, që udhëheq aktivitetin auditues dhe jo-auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit, sipas zhvillimeve lokale dhe globale. Ky dokument është aktualisht në vitin e katërt të zbatimit të tij.

Në zbatim të strategjisë, me qëllim përmirësimin e cilësisë së auditimeve dhe përshtatjen ndaj zhvillimeve të standardeve, sidomos në ndërtimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë së auditimit janë evidentuar nënobjektivat dhe aktivitetet specifike përkatëse. KLSH ka konsoliduar praktikën e planifikimit strategjik, vjetor dhe operacional sipas metodologjive të përditësuara, duke përdorur më shumë vizualizime për të rritur efikasitetin e ndjekjes së punës audituese. Njëkohësisht, është përmirësuar komunikimi i rezultateve të auditimeve dhe i veprimtarisë së KLSH-së përmes mediave sociale, shtypit të shkruar dhe atij audio-viziv, si dhe përmes broshurave, buletineve dhe aktiviteteve të tjera ndërgjegjësuëse. Konsolidimi i marrëdhënieve me Kuvendin dhe Nënkomisionin Parlamentar për Auditimin e Sektorit Publik, përmes dëgjësive parlamentare dhe raportimeve të vazhdueshme, ka synuar të përforcojë ndjekjen e rekomandimeve dhe të rrisë efektivitetin e punës audituese për publikun e gjerë.

Me qëllim realizimin e objektivave strategjike, nën objektivave dhe aktiviteteve specifike, edhe gjatë vitit 2025, KLSH ka zbatuar planin e veprimit për implementimin e strategjisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 144, datë 01.08.2023. Ky plan është monitoruar në mënyrë sistematike për të vlerësuar realizimin e objektivave në përputhje me parashikimet. Të gjitha strukturat e institucionit janë angazhuar në vijimësi për realizimin e aktiviteteve specifike dhe raportimin e rezultateve të arritura për tre qëllimet strategjike të dokumentit:

Qëllimi 1: Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH-së si mbështetës i kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të enteve përdoruese të fondeve publike.

Qëllimi 2: Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve.

Qëllimi 3: Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese.

Sa i takon zbatimin të objektivave dhe nënobjektivave të **qëllimit të parë strategjik**, KLSH ka hartuar dhe miratuar Planin Vjetor të Auditimeve të vitit 2025 duke ndjekur Metodologjinë e Planifikimit Vjetor të Auditimeve (miratuar në vitin 2023). Kjo metodologji është përdorur dhe për planifikimin e auditimeve të performancës, duke u ndërthurur me Manualin e Auditimit të Performancës dhe Udhëzuesin e Fushave me Risk (i rishikuar), në vijim të konsolidimit të procesit të hartimit të Planit Vjetor të Auditimeve në KLSH. Në përmbushje të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) sipas Agjendës 2030, dhe rekomandimeve të paraqitura nga Kuvendi i Shqipërisë, nëpërmjet punës audituese në përputhje dhe me prioritetet strategjike të INTOSAI-t, gjatë vitit 2025, Departamenti i Auditimit të Performancës ka kryer disa auditime që mbulojnë fushat e OZHQ-ve. Për OZHQ 1 “Pa varfëri” “Efektiviteti i masave të ndërmarra në kuadër të Objektivit 1 të OZHQ - Zhdukja e varfërisë në të gjitha format”; për OZHQ 5 “Barazia gjinore” “Përfaqësimi i grave në politikë dhe qeverisje”; për OZHQ 6 “Ujë i pastër dhe kanalizime” “Cilësia dhe certifikimi i ujit të pijshëm që hidhen në treg për qytetarin”; “Cilësia e ujërave në plazhe”; “Ndotja e Liqenit Artificial të Tiranës”; “Masat e ndërmarra nga institucionet përgjegjëse për eliminimin e derdhjes së ujërave të përdorura në Lumin e Lanës në Tiranë”.



Gjatë vitit 2025, Kontrolli i Lartë i Shtetit me qëllim forcimin e cilësisë dhe profesionalizmit në zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ka vijuar përditësimin dhe implementimin e udhëzuesve dhe manualeve përkatëse. Në këtë kuadër, ka nisur implementimi i ISSAI 140 i rishikuar përmes vendosjes në funksion të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë, i hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e standardit dhe nën mbikëqyrjen metodologjike të IDI/INTOSAI. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, që përfshin udhëzues për monitorimin, vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve ka konsoliduar kalimin drejt një qasjeje të integruar të menaxhimit të cilësisë në proceset audituese. Paralelisht, është përditësuar dhe miratuar Udhëzuesi për Përcaktimin e Fushave me Risk, duke rritur efektivitetin e planifikimit dhe fokusimin e burimeve në fushat me risk të lartë. Në funksion të rritjes së cilësisë së auditimit të performancës, gjatë vitit 2025 ka vijuar procesi i rishikimit të Manualit të Auditimit të Performancës, në bashkëpunim me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Norvegjisë (OAGN), ndërsa përfundimi i draftit parashikohet në prill 2026. Gjithashtu, është rishikuar “Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve”, me synim forcimin e metodologjisë së monitorimit dhe rritjen e efektivitetit të rekomandimeve audituese.

Gjatë vitit 2025, Departamenti i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit ka vijuar bashkëpunimin me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Norvegjisë (OAGN), me qëllim forcimin e kapaciteteve profesionale dhe rritjen e cilësisë së auditimeve në fushën e sigorisë së informacionit dhe sigurisë kibernetike. Në këtë kuadër, janë realizuar trajnime dhe është pilotuar përdorimi i mjeteve IT “open source” të përdorura nga OAGN, përmes një auditimi të përbashkët të tipit “Ethical Hacking” në infrastrukturën e KLSH-së. Paralelisht, gjatë vitit 2025 janë realizuar përmirësime të rëndësishme në infrastrukturën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, duke përfshirë optimizimin e rrjetit dhe zbatimin e politikave të avancuara të sigurisë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kërkesat ligjore për sigurinë kibernetike. Janë zbatuar gjithashtu rekomandimet e auditimit të sigurisë kibernetike, duke rritur qëndrueshmërinë dhe sigurinë e ambientit digjital të institucionit.

KLSH gjatë vitit 2025, ka intensifikuar marrëdhënien me Kuvendin, duke forcuar komunikimin dhe bashkëpunimin institucional përmes një raportimi të rregullt me Nënkomisionin Parlamentar për Auditimin e Sektorit Publik. Bashkëpunimi me Kuvendin është konsoliduar më tej përmes pjesëmarrjes së KLSH-së në aktivitete të përbashkëta dhe nëpërmjet raportimit periodik të rezultateve të auditimit, përmes raporteve, buletineve statistikore dhe informuese, duke kontribuar në forcimin e dialogut institucional dhe llogaridhënies në mbikëqyrjen e financave publike.

Sa i takon realizimit të **qëllimit strategjik të dytë**, KLSH, në funksion të forcimit të komunikimit, transparencës dhe aksesit të publikut në informacion, gjatë vitit 2025 ka vijuar të komunikojë veprimtarinë audituese përmes kanaleve efektive të informimit, me synim arritjen e qytetarët dhe rritjen e rolit të auditimit publik. Me qëllim përmirësimit të cilësisë së komunikimit dhe adoptimit të praktikave më të mira, është përditësuar Plani i Veprimit mbi zbatimin e Strategjisë së Komunikimit të KLSH-së në bashkëpunim me ekspertët e NAO UK nën koordinimin e Fondacionit Westminster për Demokraci. Gjatë vitit 2025, KLSH i ka përcjellë Kuvendit të Shqipërisë 186 raporte përfundimtare auditimi, si dhe Raportin Vjetor të Performancës për vitin 2024 dhe Raportin mbi Zbatimin e Buxhetit të Shtetit 2024. Paralelisht, në faqen zyrtare të institucionit janë publikuar raporte përfundimtare auditimi, duke siguruar akses të plotë të publikut në rezultatet e punës audituese.

Në kuadër të informimit dhe promovimit institucional, gjatë vitit 2025 janë përgatitur dhe publikuar materiale informuese dhe promovionale, përfshirë Broshurën “100 vjet KLSH”, fletëpalosjen informuese të 100-vjetorit, albumin e aktiviteteve jubilarë, Buletinin Vjetor 2025 dhe 12 buletine informuese mujore. Të gjitha materialet janë publikuar në gjuhën shqipe dhe angleze, me qëllim rritjen e aksesueshmërisë për publikun vendas dhe ndërkombëtar.



Në funksion të promovimit të raporteve të auditimit, gjatë vitit 2025, Departamenti i Auditimit të Performancës ka vijuar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, përmes pjesëmarrjes në aktivitete të përbashkëta dhe realizimit të auditimeve të asistuara ose paralele me Institucione Supreme të Auditimit homologe. Janë finalizuar auditime performance të asistuara nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Norvegjisë, ndërsa auditime të tjera janë zhvilluar dhe vijojnë të zhvillohen në bashkëpunim me SAI-t e Izraelit, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Suedisë.

Veprimtaria e KLSH-së gjatë vitit 2025, ka pasur mbulim të gjerë mediatik. Në media janë publikuar gjithsej 1115 artikuj dhe kronika, nga të cilat 96 artikuj në shtypin e shkruar, 914 artikuj në median audiovizive dhe online, si dhe 105 kronika, kryesisht mbi gjetjet dhe rezultatet e auditimeve të KLSH-së.

Faqja zyrtare e institucionit ka vijuar të përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme, përmes pasurimit të përmbajtjes, riorganizimit të informacionit dhe rritjes së funksionalitetit. Këto përmirësime kanë kontribuar në rritjen e transparencës, lehtësimin e aksesit në informacion dhe forcimin e ndërveprimit me publikun dhe palët e interesuara.

Në drejtim të komunikimit me qytetarët, gjatë periudhës janar–dhjetor 2025 janë administruar gjithsej 189 letra, ankesa, kërkesa për informacion dhe denoncime nga individë dhe subjekte të ndryshme, për të cilat, në përputhje me natyrën dhe rëndësinë e tyre, janë kryer verifikime apo auditime të posaçme. KLSH ka vijuar të përmirësojë cilësinë e raporteve të auditimit, duke u fokusuar në qartësinë, kuptueshmërinë dhe përdorimin e një gjuhe të thjeshtë dhe profesionale. Për këtë qëllim, në bashkëpunim me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar janë përmirësuar proceset e redaktimit dhe standardizimit të gjuhës, si dhe janë zhvilluar trajnime të vazhdueshme mbi shkrimin, prezantimin dhe paraqitjen e raporteve. Gjithashtu, janë përdorur programe të dedikuara për krijimin e infografikëve dhe vizualizimeve, të cilat janë aplikuar në dokumente të rëndësishme institucionale, si politikat dhe udhëzuesit e menaxhimit të cilësisë, buletinet statistikore dhe raportet mbi zbatimin e rekomandimeve. Këto mjete po integrohen gradualisht edhe në dokumentet kryesore raportuese të institucionit, duke rritur efektivitetin e komunikimit dhe transparencën institucionale.

Sa i takon realizimit të **qëllimit strategjik të tretë**, KLSH nëpërmjet programit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional, ka bërë të mundur rritjen e njohurive dhe aftësive që ju nevojiten audituesve në realizimin e objektivave, duke ndikuar për rrjedhojë në përmirësimin e ndjeshëm të cilësisë së punës audituese në funksion të rritjes së transparencës, mirëqeverisjes dhe përdorimit të parasë publike, si dhe rritjes së besimit të publikut dhe palëve të jashtme tek KLSH. Institucioni ka realizuar në mënyrë periodike analizën e nevojave për trajnim dhe ka zbatuar programe trajnime në përputhje me Programin e Zhvillimit të Integruar Profesional të Stafit të KLSH-së.

Trajnimet janë zhvilluar si në nivel të brendshëm, ashtu edhe në bashkëpunim me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim rritjen e njohurive dhe aftësive profesionale të stafit në përmirësimin e cilësisë së auditimit. Gjatë vitit 2025 është zhvilluar një numër i konsiderueshëm trajnimesh, të organizuara si nga institucionet vendase ashtu edhe nga partnerë ndërkombëtarë, që kanë përfshirë auditues dhe staf jo-auditues, duke kontribuar në përmirësimin e aftësive dhe njohurive të tyre dhe duke tejkaluar objektivat minimale vjetore të përcaktuara. Institucioni ka vijuar bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në programin e intership-it në Gjykatën Evropiane të Llogarive (ECA), me qëllim forcimin e kapaciteteve audituese dhe shkëmbimin e praktikave më të mira profesionale. Në këtë kuadër, 1 (një) auditues i KLSH-së ka ndjekur programin e intership-it pranë Gjykatës Evropiane të Llogarive.



Paralelisht, KLSH ka vijuar konsolidimin e një mjedisi pune stimulues dhe motivues përmes zbatimit të politikave të qëndrueshme të menaxhimit të burimeve njerëzore. Në këtë kuadër, janë përditësuar periodikisht të dhënat mbi zhvillimin profesional dhe akademik të audituesve, si dhe është kryer vlerësimi gjashtëmuor i performancës, në funksion të monitorimit të eficiencës dhe identifikimit të nevojave për zhvillim profesional.

Objektivat e vitit 2026

Kontrolli i Lartë i Shtetit do të vijojë, edhe gjatë vitit 2026, të udhëhiqet në veprimtarinë e tij nga misioni, vizioni dhe qëllimet strategjike të përcaktuara në Planin Strategjik të KLSH-së 2023–2027, ku:

Në përmbushje të **Qëllimit Strategjik nr. 1**, institucioni do të vijojë të punojë për konsolidimin e mëtejshëm të praktikave të planifikimit strategjik të auditimeve, bazuar në analiza të përditësuar të riskut dhe në përdorimin e metodologjive bashkëkohore të auditimit, si pjesë integrale e procesit të planifikimit strategjik. Kjo qasje ka për qëllim garantimin e një mbulimi më efektiv dhe me cilësor të subjekteve publike nëpërmjet procesit të auditimit. KLSH do të angazhohet maksimalisht në implementimin e plotë të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe të praktikave më të mira profesionale gjatë gjithë fazave të auditimit, në funksion të rritjes së profesionalizmit, objektivitetit dhe besueshmërisë së produkteve të auditimit. Paralelisht, do të thellohet bashkëpunimi me Kuvendin, institucionet ligjzbatuese dhe palët e interesuara, me qëllim parandalimin e rasteve abuzive, forcimin e luftës kundër korrupsionit dhe promovimin e rezultateve të punës audituese.

Në përmbushje të **Qëllimit Strategjik nr. 2**, me qëllim promovimin e vazhdueshëm të rolit të KLSH-së dhe të punës audituese, si garant i përdorimit të mirë të fondeve publike, gjatë vitit 2026 institucioni do të intensifikojë përdorimin e mjeteve të komunikimit, në veçanti të platformave digjitale dhe rrjeteve sociale, me synim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies ndaj publikut. KLSH do të vijojë t'i kushtojë fokus të veçantë në vijimësi hartimit të raporteve të auditimit të qarta, të kuptueshme dhe të aksesueshme, duke siguruar që gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet të jenë të interpretuara lehtësisht nga publiku dhe palët e interesuara, veçanërisht në rastet e auditimeve me ndjeshmëri të lartë.

Në përmbushje të **Qëllimit Strategjik nr. 3**, edhe gjatë vitit 2026, KLSH, do të synojë optimizimin e kapaciteteve profesionale të stafit, me fokus zotërimin e njohurive inovative dhe përmirësimin e aftësive teknike në punën audituese. Ky objektivi do të realizohet përmes pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme për shkëmbimin e njohurive dhe praktikave më të mira, si seminare, workshop-e, internship-e, projekte dhe auditime të përbashkëta ose paralele me organizma dhe institucione homologe ndërkombëtare, përfshirë INTOSAI, EUROSAT, GAO, ECA, Zyren e Auditorit të Përgjithshëm të Norvegjisë dhe SAI të tjera homologe.

Zbatimi i Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së 2023–2027 do të vijojë të monitorohet në mënyrë të strukturuar, me qëllim evidentimin e progresit të arritur, identifikimin e prioriteteve dhe orientimin e masave të nevojshme për përmbushjen e objektivave strategjike të institucionit.



4.2 MBI MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE

Në përmbushje të Qëllimit nr. 3 të Strategjisë së Zhvillimit Institucional 2023-2027, "Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese", KLSH edhe gjatë vitit 2025 është angazhuar në sigurimin e një stafi auditues kompetent dhe profesional me qëllim realizimin e detyrave funksionale duke kontribuar në arritjen e objektivave të institucionit. Për menaxhimin e burimeve njerëzore, KLSH:

- Zbaton kuadrin ligjor në fuqi;
- Zbaton Standardet Ndërkombëtare të INTOSAI-t në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore, si dhe praktikatat më të mira, të përshtatshme për KLSH-në;
- Synon rekrutimin e individëve me kualifikime të larta, që njohin gjuhë të huaja, ekspertë dhe specialistë me kontribute në fusha të ndryshme, si të teknologjisë së informacionit etj.;
- Siguron zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe rritje të kapaciteteve nëpërmjet programeve internship, fellowship, si dhe trajnimeve të vazhdueshme;
- Zbaton një sistem objektiv të vlerësimit të stafit bazuar në performancë, në përmbushjen e objektivave individuale dhe kërkesave të kompetencave profesionale, etj.

Organizimi strukturor për vitin 2025

Organizimi strukturor i Kontrollit të Lartë të Shtetit është miratuar me Vendimin nr. 19, datë 31.01.2022 të Kryetarit të KLSH, "Për Strukturën e Renditjes së Punëve, Klasifikimin e Vendeve të Punës dhe Nivelin e Pagave në KLSH", i ndryshuar. Për vitin 2025 numri i punonjësve të miratuar ka qenë 243, i barabartë me numrin e punonjësve në vitin 2024. Në fund të vitit 2025, numri faktik i punonjësve në KLSH rezultoi 215 nga të cilët trupa audituese përbën 72% të numrit total faktik ose 154 auditues¹.

Struktura sipas profilit arsimor, kualifikimet dhe certifikimet

Klasifikuar sipas arsimimit, në strukturën organizative për vitin 2025, punonjësit me arsim të lartë janë 201 punonjës ose rreth 93%, kundrejt numrit total faktik të punonjësve. Të ndarë sipas profilit të diplomimit, klasifikimi i punonjësve me arsim të lartë përfshin kryesisht ekonomistë, financierë, kontabilistë, juristë, inxhinierë, arkitektë dhe profile të tjera. Me qëllim aftësimin profesional dhe metodologjik në funksion të përmirësimit të performancës, një pjesë e punonjësve kanë përfunduar studimet universitare në degë të dyta apo janë trajnuar dhe certifikuar brenda dhe jashtë vendit në përgjigje të zhvillimeve të reja në fushën e auditimit publik.

| | |
|----|-----------------------------------------|
| 83 | Ekonomistë, Financierë dhe Kontabilistë |
| 54 | Juristë |
| 20 | Inxhinierë |
| 44 | Fusha të tjera |

Të ndarë sipas profilit të diplomimit 201 nëpunësit që zotërojnë diplomë universitare janë: 33 nëpunës (16 %) zotërojnë diploma të dyta sipas profileve që vijon:

- 24 nëpunës kanë diplomë të dytë në Shkenca Juridike;
- 4 nëpunës kanë diplomë të dytë në Shkenca Ekonomike/Financë-Kontabilitet;

¹ Trupa audituese përbëhet nga 11 Kryeauditues dhe 143 auditues.




- 5 nëpunës kanë diploma të dytë në fusha të tjera.

Stafi i KLSH-së është i angazhuar në kualifikime dhe certifikime për zhvillimin e vazhdueshëm profesional ku për vitin 2025 kemi:

- 1 nëpunës zotëron titullin “Prof. Acos”;
- 2 nëpunës zotërojnë titullin “Doktor i Shkencave”;
- 1 drejtues ka diplomë ndërkombëtare CPA;
- 4 nëpunës (3 drejtues dhe një auditues i lartë) kanë certifikatë CIPFA dhe certifikatë ndërkombëtare në Auditim të Brendshëm;
- 1 nëpunës ka certifikatë ACCA;
- 19 nëpunës në marrëdhënie pune me KLSH-në kanë ndjekur ndër vite programin e intershipit në ECA (në vitin 2025 ka ndjekur programin 1 auditues);
- 4 nëpunës në marrëdhënie pune me KLSH-në kanë ndjekur ndër vite programin e Fellowship në GAO;
- 3 nëpunës kanë certifikatën “Kontabël i miratuar”;
- 16 nëpunës kanë certifikatën e Auditit të Brendshëm;
- 12 nëpunës kanë certifikatën e Vlerësimit të Pasurive të Palujtshme;
- 3 nëpunës janë certifikuar në programe trajnimi ndërkombëtare të ofruara nga Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t (IDI) si SAI Compliance Auditor.
- 2 nëpunës janë certifikuar në programe trajnimi ndërkombëtare të ofruara nga Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI&EUROSAI si IntoSAINT Moderator.

Përbërja strukturore e stafit sipas funksioneve

Stafi drejtues, ku përfshihen Sekretar i Përgjithshëm, Drejtor i Përgjithshëm, Drejtor i Kabinetit, Drejtorët e Departamenteve e të Drejtorive, Këshilltarë dhe Përgjegjës Sektorial përbën rreth 13% të numrit total faktik të punonjësve ose 28 punonjës; stafi auditues (Kryeauditues dhe Auditues) përbën 72% të numrit total faktik të punonjësve ose 154 punonjës; stafi mbështetës (Specialistë, juristë, punonjës shërbimi, etj.) përbën rreth 15% të numrit total faktik të punonjësve, ose 33 punonjës.



Procesi i rekrutimit

Procedurat e rekrutimit të punonjësve përgjatë vitit 2025, janë zhvilluar në koherencë me Strategjinë e Zhvillimit të institucionit 2023-2027, si dhe politikave të miratuara të menaxhimit të burimeve njerëzore, me qëllim që KLSH të sigurojë stafin e duhur me kualifikimet, aftësitë dhe përvojën e nevojshme për të plotësuar nevojat aktuale dhe të perspektivës. Si një proces shumë i rëndësishëm që ndikon drejtpërsëdrejti në përmirësimin



e performancës së institucionit, gjatë vitit 2025 për plotësimin e vendeve vakante janë nxjerrë në total 37 urdhra të Kryetarit të KLSH-së, konkretisht si vijon:

- 27 urdhra për plotësimin e vendeve vakante në kategorinë staf profesional në pozicion auditues dhe specialistë.
- 10 urdhra për plotësimin e vendeve vakante në nivelet drejtuese.

Nga zhvillimi i procedurave për plotësimin e vendeve në kategorinë profesionale, staf auditues dhe specialistë në përfundim kanë rezultuar fitues 15 kandidatë, ndërsa pjesa tjetër janë mbyllur pa fitues, duke u rihapur në vijimësi sipas përcaktimeve ligjore.


Nga zhvillimi i procedurave për plotësimin e vendeve në nivelet drejtuese, në përfundim kanë rezultuar fitues 9 kandidatë. Në nivelin e plotësimit të vendeve të lira ka ndikuar mbyllja e procedurave pa fitues, rihapja e tyre për më shumë se një herë në disa raste, si dhe pezullimi i procedurave të rekrutimit gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

Punonjësit e rekrutuar janë emëruar rast pas rasti në departamentet e auditimit apo në departamentet dhe drejtoritë mbështetëse në plotësim të nevojave që ka secila njësi për realizimin e planit vjetor të auditimeve apo përmbushjen e objektivave dhe detyrave funksionale. Në pozicionet që menaxhohen në zbatim të përcaktimeve të Kodit të Punës janë emëruar 8 punonjës.

Politikat e sigurimit të Barazisë Gjinore


KLSH, në procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore i ka kushtuar vëmendjen e duhur respektimit të parimit të barazisë gjinore në të gjitha politikat, aspektet, apo veprimtaritë institucionale, duke synuar eliminimin e fenomeneve të diskriminimit për shkak të gjinisë. Raporti i punonjësve femra/meshkuj është përmirësuar duke arritur në raport të barabartë në vitin 2025. Politika e KLSH-së në mbështetje të zhvillimit në karrierë të gjinisë femërore, reflektohet në numrin e konsiderueshëm që femrat zënë në të gjitha nivelet drejtuese, duke përfaqësuar 62% të pozicioneve drejtuese (24 pozicione drejtuese kundrejt 39 drejtues në total), si Sekretare e Përgjithshme, Drejtore Departamenti, Drejtore Drejtorie, Kryeaudituese, Përgjegjëse Sektori dhe Këshilltare.

Niveli drejtues, viti 2025




Raporti femra/meshkuj






Mosha mesatare e nëpunësve dhe vjetërsia në institucion

Një tregues mjaft i rëndësishëm i politikave të ndjekura në drejtim të garantimit të vijueshmërisë së punës dhe të gërshetimit të përvojës së audituesve të vjetër me stafin e ri janë dhe treguesit e moshës dhe të vjetërsisë në punë. Mosha mesatare në KLSH në fund të vitit 2025 është 42.2 vjeç e njëjtë me vitin 2023. Ndërsa vitet e eksperiencës në institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit në vitin 2025 janë mesatarisht 7.3 vite.



4.3 ZHVILLIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL

Trajnimi dhe zhvillimi i audituesve, është një proces investimi strategjik i kohës, energjisë dhe burimeve, drejt përmirësimit të kapaciteteve audituese. KLSH i ka kushtuar një vëmendje të veçantë zhvillimit të vazhdueshëm profesional të stafit, si një prej prioriteteve kryesore në ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve audituese, në bashkëpunim kjo me partnerë të brendshëm dhe të jashtëm. Për vitin 2025, KLSH ka kryer analizën e nevojave për trajnim, nëpërmjet pyetësorëve në “google form” nga i gjithë stafi auditues. Mbështetur në këto nevoja, referuar praktikave të mira të institucioneve homologe, si dhe në zbatim të qëllimeve strategjike të KLSH-së, është miratuar Programi i Zhvillimit të Integruar Profesional të Stafit të KLSH-së, me Vendimin nr. 18, datë 21.01.2025, të Kryetarit të KLSH-së.



Referuar Plan - Veprimit mbi zbatimin e “Programit të Zhvillimit të Integruar Profesional të Stafit të KLSH-së” për vitin 2025, institucioni i ka kushtuar një vëmendje të veçantë zhvillimit të vazhdueshëm profesional të stafit të tij, si prioritet kryesor për ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve audituese, kjo në bashkëpunim dhe me partnerë të brendshëm dhe të jashtëm si, INTOSAI; EUROSAL; Banka Botërore; OECD; Gjykata Evropiane e Audituesve (ECA); Qendra e Ekselencës në Financë (CEF); SAI-ve homologe; Guardia di Finanza; Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI t (IDI); ZKA; Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA); AKSHI; etj.

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2025, u realizuan gjithsej 137 tema trajnimesh, nga të cilat 29 të organizuara nga ASPA; 55 nga KLSH; 6 nga Partnerë lokalë dhe 47 nga partnerët ndërkombëtarë. Falë këtyre aktiviteteve, u realizuan mesatarisht 27.5 ditë trajnimi, nga 20 - 25 ditë trajnimi që është objektivi vjetor, për stafin auditues, dhe mesatarisht 21.3 ditë trajnimi për stafin jo-auditues, nga minimum 14 ditë që është objektivi vjetor. Numri i referohet të gjithë stafit auditues të trajnuar gjatë vitit.

Përgjatë vitit 2025, KLSH ka vijuar të jetë promotori dhe organizator i një sërë aktiviteteve për zhvillimin profesional të stafit, në përputhje kjo me orientimet strategjike për periudhën 2023 – 2027, duke mbajtur peshën më të madhe të ditëve të trajnimeve të organizuara, ndjekur nga partnerët ndërkombëtarë dhe ata lokalë. Ndërsa sa i takon larmishmërisë së temave të auditimit, rreth 47 tema ose 34 % e totalit të tyre, janë organizuar nga partnerë ndërkombëtarë si, SAI-e homologe, INTOSAI, EUROSAL, CEF etj.

Një pjesë e rëndësishme e temave të auditimit është realizuar me burime të brendshme të KLSH-së, konkretisht 55 tema, ose 40% e totalit të temave të organizuara gjatë vitit 2025, janë zhvilluar duke shfrytëzuar ekspertizën e stafit të KLSH-së, në veçanti atë auditues, të cilët



janë specializuar dhe trajnuar në vitet paraardhëse, duke kontribuar kështu në konsolidimin e transferimit të njohurive brenda institucionit. Trajnimet me organizatorë partnerët ndërkombëtarë përmbajnë kryesisht tema që kanë të bëjnë me: menaxhimin e cilësisë; transferimin e njohurive për auditimin e performancës, auditime në fushën e mjedisit, sigurinë kibernetike, auditimin e koncesioneve dhe PPP – ve; planifikimin strategjik; shkrimin e raporteve dhe antikorrupsionin etj.

Po kështu, plani i trajnimeve është mbështetur edhe nga ASPA dhe partnerët e brendshëm, të cilët kanë mbuluar 29 tema trajnimi, ose rreth 21% të numrit total të temave të trajnimeve, të organizuara gjatë 2025. Në veçanti, ASPA ka kontribuar në total me 29 tema trajnimi, nga të cilat 12 janë tema trajnimi me certifikim, (41%) dhe 17 tema të tjera trajnimesh, (59%) që kanë ndikuar në rritjen e njohurive profesionale të stafit auditues dhe jo – auditues të institucionit tonë. Aktivitetet trajnuese të KLSH-së, të kryera me synim konsolidimin e kapaciteteve audituese dhe jo – audituese, janë zhvilluar trajnime me prezencë fizike në sallën e trajnimeve të institucionit, si dhe trajnime online nëpërmjet platformës Microsoft Teams. Po kështu dhe partnerë ndërkombëtarë dhe të brendshëm kanë organizuar trajnime fizike dhe online.

Më konkretisht, rreth 75% e trajnimeve të zhvilluara gjatë vitit 2025 kanë qenë trajnime online, duke siguruar kështu një harmonizim më të përshtatshëm të nevojës për përditësim të njohurive me misionet audituese dhe jo – audituese të stafit, duke marrë parasysh këtu edhe ngarkesën e punës në institucion.


Rreth 25% e trajnimeve të tjera janë zhvilluar me prezencë fizike, qoftë në KLSH, apo edhe në institucione të tjera jashtë vendit ose brenda tij, duke shfrytëzuar kështu avantazhet që sjell ndjekja e trajnimeve specifike me prezencë fizike.



4.4 VETËVLERËSIMI VJETOR SIPAS KORNIZËS SË INDIKATORËVE TË MATJES SË PERFORMANCËS, INTOSAI

Gjatë vitit 2025, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka përdorur Kornizën e Matjes së Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit si një instrument të rëndësishëm për monitorimin dhe vlerësimin e funksionimit të tij institucional. Kjo kornizë shërben për të analizuar në mënyrë të strukturuar performancën e institucionit, duke u fokusuar në efektivitetin e proceseve, menaxhimin e burimeve dhe cilësinë e rezultateve audituese.

Përdorimi i SAI PMF mundëson një vlerësim gjithëpërfshirës të veprimtarisë së KLSH-së, duke e lidhur atë ngushtë me parimet e menaxhimit të cilësisë dhe me objektivat e Strategjisë së Zhvillimit Institucional. Kjo kornizë është njohur nga INTOSAI si një “E Mirë Publike Globale”, që mund të zbatohet nga institucionet supreme të auditimit në përputhje me kushtet dhe nevojat e tyre specifike.



Në këtë kuadër, KLSH ka kryer vetëvlerësimin për vitin 2025, duke u mbështetur në udhëzuesin e përditësuar INTOSAI Development Initiative, i cili rekomandon që monitorimi vjetor të fokusohet vetëm në disa komponentë dhe tregues të përzgjedhur. Kjo qasje bazohet në faktin se jo të gjithë indikatorët e performancës japin rezultate të menjëhershme, pasi një pjesë e tyre lidhen me ndikime afatmesme dhe afatgjata. Në përputhje me standardin ISSAI 140 dhe kërkesat për menaxhimin e cilësisë, vetëvlerësimi është fokusuar në fusha kyçe që janë të matshme në periudhë vjetore dhe që japin siguri mbi funksionimin efektiv të institucionit.

Konkretisht, monitorimi është përqendruar në:

- pavarësinë institucionale dhe zbatimin e saj në praktikë
- aftësinë për të përmbushur mandatin përmes planifikimit të auditimeve
- cilësinë e punës audituese

Pavarësia e KLSH-së përbën një element themelor për ushtrimin e mandatit të saj. Gjatë vitit 2025, KLSH ka forcuar bashkëpunimin me Kuvendin e Shqipërisë, duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe në ndjekjen e rekomandimeve të auditimit. Nëpërmjet dëgjësave dhe raporteve të përgatitura nga strukturat parlamentare, është synuar përmirësimi i zbatimit të rekomandimeve dhe rritja e përgjegjshmërisë së institucioneve publike. Në drejtim të përmbushjes së mandatit auditues, KLSH ka vazhduar të zbatojë qasjen e bazuar në risk në planifikimin vjetor të auditimeve. Kjo qasje siguron që auditimet të fokusohen në institucionet dhe fushat me rëndësi dhe me risk më të lartë, duke përdorur në mënyrë efektive burimet në dispozicion. Gjithashtu, një element thelbësor i vetëvlerësimit është funksionimi i sistemit të brendshëm organizativ të institucionit dhe i kontrollit të cilësisë së auditimeve. Procesi i auditimit në KLSH i nënshtrohet kontrollit të vazhdueshëm të cilësisë në të gjitha fazat e tij, nga planifikimi deri në publikimin e raportit përfundimtar. Ky proces realizohet përmes një sistemi rishikimi hierarkik dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit.

KLSH ka përmirësuar kuadrin e menaxhimit të cilësisë, duke kaluar nga një qasje e kontrollit të cilësisë në një sistem të plotë të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me ISSAI 140. Në këtë kuadër janë miratuar politika dhe instrumente të reja, si politikat e menaxhimit të cilësisë, regjistri i riskut dhe udhëzuesit përkatës.



Në kontekstin e Vetëvlerësimit vjetor sipas Kornizës së Indikatorëve të Matjes së Performancës (PMF) të INTOSAI-t, një element thelbësor i analizës është vetëvlerësimi dhe efektiviteti i Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë së Auditimit (SOAQM). Ky sistem përfaqëson një zhvillim strategjik të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të performancës institucionale. SOAQM është konceptuar dhe zbatuar si një sistem i strukturuar dhe gjithëpërfshirës, i cili mbështetet në tre procese kryesore: *menaxhimin e riskut të cilësisë, monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm, si dhe vlerësimin e sistemit*. Këto procese janë ndërtuar dhe funksionojnë në mënyrë të ndërthurur, duke krijuar një mekanizëm vetë-korrigjues që synon rritjen e cilësisë së auditimit në të gjitha fazat e ciklit auditues. Gjatë vetëvlerësimit është analizuar nëse këto procese janë hartuar dhe funksionojnë në përputhje me kërkesat e standardeve ISSAI, veçanërisht ISSAI 140, si dhe nëse ato kontribuojnë në arritjen e objektivave të cilësisë së institucionit.

Rezultatet tregojnë se procesi i menaxhimit të riskut të cilësisë është zbatuar në mënyrë sistematike, duke mundësuar identifikimin dhe vlerësimin e risqeve që mund të ndikojnë në cilësinë e auditimit, si dhe përcaktimin e përgjigjeve të përshtatshme për adresimin e tyre. Njëkohësisht, procesi i monitorimit dhe përmirësimit ka siguruar mbledhjen e informacionit të nevojshëm për të vlerësuar funksionimin e sistemit dhe për të identifikuar mangësitë, duke mundësuar ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese dhe përmirësuese. Ky proces është zhvilluar si në nivel organizativ, ashtu edhe në nivel auditimi, duke garantuar një qasje të integruar ndaj cilësisë.

Monitorimi në nivel organizativ u zhvillua përmes funksionimit të komponentëve kryesorë të sistemit, përfshirë zbatimin e politikave dhe procedurave të cilësisë. Monitorimi në nivel auditimi u zhvillua përmes inspektimit të një kampioni auditimesh financiare, të përputhshmërisë, performancës dhe IT. Procesi i rishikimit u krye për 30% të dosjeve të auditimit të evaduar gjatë vitit 2025, konkretisht për 35 dosje auditimi, të përzgjedhura në mënyrë rastësore nga të gjithë departamentet e auditimit në KLSH.

Rishikimi i cilësisë për vitin 2025 tregon se sistemi i menaxhimit të cilësisë në KLSH funksionon në mënyrë të qëndrueshme dhe auditimet zhvillohen në përputhje me standardet profesionale dhe kuadrin rregullator në fuqi.

Në përfundim të këtyre proceseve, është realizuar vlerësimi i përgjithshëm i SOAQM, i cili ka shërbyer si bazë për arritjen e një konkluzioni mbi efektivitetin e sistemit. Ky vlerësim është mbështetur në analizën e mangësive të identifikuara, si në nivel individual, ashtu edhe në nivel të agreguar, duke respektuar kërkesat metodologjike të përcaktuara për këtë qëllim.

Gjetjet e këtij vlerësimi tregojnë se sistemi ofron një nivel të arsyeshëm sigurie për arritjen e objektivave të cilësisë dhe se mangësitë e identifikuara nuk kanë ndikim material në funksionimin e tij.

Në vijim të këtij vlerësimi, në kuadër të ciklit të përmirësimit të vazhdueshëm, është hartuar dhe miratuar një plan veprimi për adresimin e mangësive të evidentuara, i cili përbën një instrument konkret për forcimin e mëtejshëm të SOAQM dhe rritjen e efektivitetit të tij në periudhat pasuese. Gjithashtu, vetëvlerësimi sipas PMF evidenton se implementimi i SoAQM ka kontribuar në rritjen e koherencës dhe standardizimit të proceseve audituese, duke forcuar lidhjen ndërmjet planifikimit, zbatimit dhe raportimit të auditimit. Rezultatet e vetëvlerësimit konfirmojnë se SoAQM është një mekanizëm funksional dhe në zhvillim të vazhdueshëm, i cili mbështet arritjen e objektivave strategjike të institucionit dhe përmirëson në mënyrë të qëndrueshme performancën e tij. Në përfundim, vetëvlerësimi sipas kornizës SAI PMF për vitin 2025, ka shërbyer si një mekanizëm i rëndësishëm për identifikimin e arritjeve dhe sfidave të institucionit, duke ndihmuar në përmirësimin e vazhdueshëm të performancës dhe të cilësisë së auditimit.









05

Komunikimi dhe
bashkëpunimi
institucional


KOMUNIKIMI DHE BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL


 **2** Raportime të KLSH-së në Kuvend


- Raporti i Performancës së KLSH-së për vitin 2024
- Raporti për Zbatimin e Buxhetit të vitit 2024


 **186** Raporte auditimi të dërguara

- 3** Raporte Përmbledhëse të Zbatimit të rekomandimeve
- Buletine mujore
- 3** Buletine 4-mujore të Veprimtarisë së KLSH-së


 **5** Aktivitete të përbashkëta dhe me fokus veprimtarinë Kuvend-KLSH.


 **2** Marrëveshje të reja bashkëpunimi të nënshkruara me institucione homologe


 **4** Auditime paralele/ të përbashkëta

 **190** Raporte përfundimtare auditimi

Publikime në web **12** Buletine mujorë

 **96** Artikuj në shtypin e shkruar

1115 Artikuj të publikuar në media  **914** Artikuj në median audiovizive / online

 **105** Kronika / emisione televizive



5.1 KLSH DHE KUVENDI

Intensifikimi i komunikimit me Kuvendin ndikon drejtpërdrejt në rritjen e zbatueshmërisë dhe efektivitetit të rekomandimeve të KLSH-së. Si një nga objektivat strategjike të Kontrollit të Lartë të Shtetit, por dhe si kërkesë e institucioneve të BE-së, e specifikuar në progres raportet e Komisionit Evropian, Kapitulli 32 “Kontrolli financiar/Auditimi i jashtëm”, KLSH ka patur në prioritetet e saj forcimin e marrëdhënieve me Kuvendin.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2025, krahas raportimeve në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore të KLSH-së, është punuar intensivisht për thellimin e bashkëpunimit me Nënkomisionin për Auditimin në Sektorin Publik, i krijuar me Vendimin e Kuvendit nr. 70, datë 25.07.2024 dhe më pas me Vendimin nr. 104, datë 04.12.2025. Në këtë proces bashkëpunimi, KLSH dhe Kuvendi janë mbështetur nga Instituti Kombëtar Demokratik për Çështje Ndërkombëtare (NDI).

Raportime të Kontrollit të Lartë të Shtetit në Kuvend

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përmbushje të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, konkretisht në referencë të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, neni 31 “Raportimi në Kuvend”, pika 3. gjatë vitit 2025 ka përcjellë në Kuvend:

- Raportin e Performancës së KLSH-së për vitin 2024, me shkresën nr. 9/2, datë 28.03.2025. Raportimi mbi veprimtarinë e vitit 2024 ka vijuar me 1 seancë dëgjimore, në datë 29.10.2025 në mbledhjen e përbashkët të Komisionit për Ekonominë, Punësimin dhe Financat dhe Komisionit për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale. Raportimi mbi veprimtarinë e institucionit gjatë vitit 2024 është përmbyllur në seancën plenare të datës 06.11.2025 të Kuvendit të Shqipërisë, ku dhe është miratuar Rezoluta për Vlerësimin e Veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2024.
- Raportin mbi Zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2024, me shkresën nr. 1056/1-2, datë 29.10.2025. Ky raportim ka vijuar me seancën dëgjimore të datës 04.11.2025 në Komisionin për Ekonominë, Punësimin dhe Financat;
- 186 raporte auditimi;
- 3 raporte përmbledhëse mbi zbatimin e rekomandimeve;
- buletine informuese mujore;
- buletine statistikore 4-mujore të Veprimtarisë së KLSH-së.

Pjesëmarrja e KLSH-së në seanca dëgjimore dhe aktivitete të përbashkëta

Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar një sërë seancash dhe aktivitete të përbashkëta me objekt, intensifikimin e bashkëpunimit midis Kuvendit dhe KLSH-së, ku ka patur përfaqësim nga dy institucionet, si:

- Seanca dëgjimore e datës 28.01.2025, mbi miratimin e projektvendimit të Nënkomisionit “Për shpalljen e procedurës përzgjedhëse të grupit të audituesve të pavarur, të cilët do të auditojnë llogaritë financiare të Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Seanca dëgjimore e datës 11.02.2025, ku u prezantua raporti mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e ushtruara në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe drejtoritë vendore të saj, për periudhën 2022-2023;
- Seanca dëgjimore e datës 12.03.2025, mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve dhe ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e ushtruara në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe drejtoritë vendore të saj për periudhën 2022-2023;
- Seanca dëgjimore e datës 09.06.2025, mbi miratimin e raportit të Nënkomisionit “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e ushtruara në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe drejtoritë vendore të saj për periudhën 2022-2023”;



- Në datat 16 – 17.12.2025, Instituti Kombëtar Demokratik për Çështje Ndërkombëtare (NDI) organizoi një tryezë diskutimi mbi forcimin e partneritetit konstruktiv ndërmjet Nënkomisionit për Auditimin e Sektorit Publik dhe KLSH-së.

Gjithashtu, Kryetari i KLSH-së ka zhvilluar një sërë takimesh në kuadër të thellimit të bashkëpunimit KLSH-Kuvend me përfaqësues të organizatave partnere si NDI dhe SIGMA.

Zbatimi i rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit

Gjatë vitit 2025, KLSH ka vijuar implementimin dhe zbatimin e rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë mbi vlerësimin e Raportit të Performancës së KLSH-së për vitin 2023, miratuar nga Kuvendi më datë 17.10.2024, përcjellë KLSH-së nga Kuvendi me shkresë nr. 4065 prot., datë 29.10.2024, ku afati i zbatimit të rekomandimeve ishte përcaktuar 30.06.2025. Nga ana e KLSH-së është raportuar mbi progresin e zbatimit të rekomandimeve të Rezolutës me shkresat nr. 68/1, datë 15.01.2025 dhe nr. 68/2, datë 15.04.2025, nr. 68/3, datë 26.06.2025, si dhe në seancën dëgjimore të datës 29.10.2025 në Komisionin për Ekonominë, Punësimin dhe Financat.

Në vijim, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar edhe Rezolutën mbi vlerësimin e veprimtarisë së KLSH-së për vitin 2024, në datë 06.11.2025, përcjellë me shkresën nr. 1244/3 prot., datë 14.11.2025, ku janë lënë 7 rekomandime, për të cilat Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka miratuar “Planin e veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve”, me shkresën nr. 1102/1, datë 12.12.2025.

Aktualisht statusi i zbatimit të rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Rekomandimi nr. 1 *“KLSH të përfundojë raportet e auditimeve të kontratave koncesionare, veçanërisht atyre që ndodhen në fazë përfundimi të afatit të zbatimit, lidhur me verifikimin e kostove të deklaruara nga operatorët privatë, përmbushjen e standardeve të shërbimit dhe respektimin e detyrimeve fiskale e kontraktore.”*

Në zbatim të këtij rekomandimi KLSH ka përfshirë në Planin vjetor të auditimeve për vitin 2026, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së, nr. 242, datë 17.12.2025, tre auditimet e kontratave koncesionare, konkretisht:

- Auditim mbi kontratën e koncesionit për paketën e shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë (aktualisht në proces auditimi);

- Auditim mbi kontratën e koncesionit/ PPP për Projektin e Rrugës “Thumanë - Fushë-Krujë – Vorë – Kashar” (aktualisht në proces auditimi);

- Auditim mbi kontratën e koncesionit/ PPP “Për shërbime të integruara për ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikal, furnizimin me material mjekësor steril një përdorimësh në sallat kirurgjikale, si dhe trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale” (aktualisht në proces auditimi).

Rekomandimi nr. 2 *“KLSH të përfundojë integrimin e metodologjisë për vlerësimin e dëmit ekonomik në Rregulloren e Procedurave të Auditimit, duke siguruar që ndryshimet përkatëse të reflektojnë parimet e INTOSAI-t, përmes mundësisë të dokumentimit të plotë të provave audituese, zbatimit të një metode të unifikuar për raste të ngjashme, kujdesit profesional në evidentimin vetëm të dëmeve të matshme dhe të provueshme”*

Me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 221, datë 27.10.2025, është rishikuar Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, duke shtuar Aneksin 12 “Mbi përlllogaritjen e dëmit ekonomik”, i cili përcakton mënyrën e dokumentimit të evidencave audituese dhe zbatimin e një metode të unifikuar për raste të ngjashme. Gjithashtu, me Urdhrin e Kryetarit të KLSH-së nr. 28, datë 13.03.2026, është ngritur grupi i punës për përditësimin e Rregullores së



Procedurave të Auditimit, ku çështjet e dëmit ekonomik dhe të efekteve financiare negative në buxhetin e shtetit, aktualisht të trajtuara si pjesë e klasifikimit të masave të lëna nga KLSH në këtë rregullore, do të rishikohen, me qëllim zhvillimin e metodologjisë, harmonizimin e saj me aktet rregullatore të brendshme, si dhe përmirësimin dhe qartësimin e formulimit të tyre në funksion të rritjes së zbatueshmërisë nga ana e institucioneve të audituara.

Rekomandimi nr. 3 *“Të krijohet dhe të vihet në funksion një sistem formal, i strukturuar dhe gjithëpërfshirës për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet, që të mundësojë ndjekjen sistematike të të gjitha subjekteve publike të audituara dhe përditësimin e rregullt të statusit të zbatimit për rekomandimet e auditimeve të viteve të mëparshme, në mënyrë që të sigurohet një proces monitorimi efektiv, transparent dhe i harmonizuar me praktikën dhe standardet ndërkombëtare të llogaridhënies publike dhe për të lehtësuar komunikimin me nënkomisionin parlamentar “Për auditimin e sektorit publik”.*

Në zbatim të Vendimit të Kuvendit nr. 134, datë 20.12.2018 “Për monitorimin e Manualit të Monitorimit Vjetor dhe Periodik”, Pjesa I “Rregulla të përgjithshme për raportimin e institucioneve në monitorim”, “Rregulla të posaçme për kategori të veçanta institucionesh të pavarura”, pika 5 dhe Pjesa II “Rregulla për titullarët e institucioneve qendrore të administratës shtetërore që kanë funksione koordinuese dhe raportuese ndaj kuvendit”, “Përgjegjësitë e ministrit të ngarkuar me marrëdhëniet me Kuvendin”, përditësimi i platformës së Kuvendit nuk ka qenë i mundur për shkak të mosfunksionimit të saj për arsye teknike. Për këtë arsye, KLSH ka vijuar me informimin e Kuvendit mbi rekomandimet e lëna dhe statusin e zbatimit të tyre nëpërmjet raporteve të konsoliduara të auditimeve mbi zbatimin e rekomandimeve, përkatësisht me shkresat drejt Kuvendit me nr. 282, datë 25.02.2025, nr. 282/3, datë 04.07.2025 dhe nr. 282/4, datë 18.12.2025, si dhe drejt Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin me nr. 282/1, datë 25.02.2025, nr. 282/2 prot., datë 04.07.2025 dhe nr. 282/5 prot., datë 18.12.2025.

Me qëllim ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, KLSH zotëron një databazë funksionale mbi rekomandimet dhe statusin e zbatimit të tyre, e cila përpunon të dhënat në kohë reale, përmban informacion të plotë, përditësohet në mënyrë të vazhdueshme nga Departamenti i Metodologjisë dhe Planifikimit Strategjik dhe shërben si burim për analizat dhe statistikën e raportuara. Megjithatë, në kushtet e rritjes së vazhdueshme të të dhënave, kjo databazë është objekt i vlerësimit për transferimin e të dhënave në një aplikacion të dedikuar për menaxhimin dhe përpunimin e tyre. Ky projekt do të bëhet pjesë e kërkesave të planifikimit buxhetor afatmesëm në PBA-në përkatëse. Gjithashtu, gjatë vitit 2025, ka vijuar puna për rishikimin e Manualit të Auditimit dhe Raportimit të Zbatimit të Rekomandimeve, i cili aktualisht është në fazën e miratimit.

Rekomandimi nr. 4 *“Të përmirësohet cilësia e auditimeve të performancës, duke u orientuar drejt standardeve të vendeve të BE-së dhe në përputhje me rekomandimet e SIGMA-s nëpërmjet zgjerimit të gamës tematike të këtyre auditimeve dhe krijimit të historisë së ndërveprimit të institucioneve/agjencive publike.”*

Bazuar në qasjen drejt praktikave më të mira evropiane si dhe në bashkëpunimin e ngushtë me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Norvegjisë (OAGN), KLSH përfshiu në marrëveshjen e bashkëpunimit rishikimin e Manualit të Auditimit të Performancës. Për këtë qëllim janë zhvilluar takime fizike dhe online me ekspertët e OAGN si dhe janë parashikuar dhe dakortësuar takimet në muajt Mars dhe Prill 2026 për të vijuar me finalizimin e Manualit dhe përcjelljen e tij për miratim brenda Qershorit 2026.

Gjithashtu, gjatë vitit 2025, me qëllim zgjerimin e tematikave, auditimet e performancës u fokusuan veçanërisht në çështje që kanë të bëjnë me trajtimin e ujërave të ndotura urbane, duke realizuar një sërë auditimesh (“Ndotja e Liqenit të Tiranës”, “Masat e ndërmarra nga



institucionet përgjegjëse për eliminimin e derdhjes së ujërave të përdorura në Lumin e Lanës në Tiranë”, “Cilësia e ujërave në plazhe”) dhe duke evidentuar mungesën dhe mos funksionimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura urbane në një sërë qytetesh të rëndësishme si Tirana, Fieri, Kavaja, Lushnja, etj. Një tjetër çështje e rëndësishme e trajtuar nëpërmjet auditimeve të performancës ishte edhe ajo lidhur me mbrojtjen dhe sigurinë e digave në Shqipëri, auditim i cili kryhej për herë të parë me qasje performance. Gjatë vitit 2025, auditim tjetër performance me fokus ndryshe nga vitet e kaluara ishte edhe auditimi me temë “Efektiviteti i masave të ndërmarra në kuadër të Objektivit 1 të OZHQ-ve - Zhdukja e varfërisë në të gjitha format”, auditim i cili për herë të parë fokusohet në monitorimin, zbatimin dhe raportimin e një objekti të vetëm nga lista globale prej 17 objektivash.

Në zbatim të këtij rekomandimi, referuar edhe Planit të Auditimeve 2026, larmishmëria e tematikave që do të auditohen nëpërmjet auditimeve të performancës është zgjeruar edhe më tej duke përfshirë tematika të ndryshme, të reja dhe që auditohen për herë të parë nëpërmjet këtyre lloj auditimeve si për shembull veprimtaria e HEC-eve në Shqipëri, sistemet diellore fotovoltaike, kontrolli i cilësisë së drithërave, efektiviteti i komisioneve të KEMP-it, etj. Përgjatë dy viteve të fundit, bashkëpunimi me institucione homologe si: SAI i Norvegjisë, Suedisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Izraelit apo edhe organizata të tjera si UN Women, etj., ka qenë i vazhdueshëm, duke realizuar një sërë auditimesh paralele performance. Këto auditime, janë një mundësi për të shkëmbyer eksperiencën, njohuri dhe praktika të mira midis audituesve të SAI-ve homologe. Këtë e dëshmon edhe prania e audituesve të performancës në seminare, workshope dhe trajnime jashtë vendit, ku vetëm për vitin 2025, pjesëmarrja e tyre në këto aktivitete ka qenë më shumë se 116 ditë/auditues.

Rekomandimi nr. 5 “KLSH të zgjerojë auditimet në fushën e teknologjisë së informacionit, duke përfshirë kontrollin e sigurisë së sistemeve, integritetin e të dhënave, funksionalitetin e platformave elektronike publike dhe përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare për menaxhimin e sistemeve të IT.”

Me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 242, datë 17.12.2025, është miratuar Programi i Veprimtarisë Audituese të KLSH-së për vitin 2026, i publikuar në faqen zyrtare të institucionit, i cili përfshin 17 programe auditimi të sistemeve IT dhe 2 programe auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve për secilin gjashtëmuor, me qëllim që gjatë këtyre programeve të verifikohen, ndër të tjera, çështje që lidhen me kontrollin e sigurisë së sistemeve, integritetin e të dhënave, funksionalitetin e platformave elektronike publike dhe përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare për menaxhimin e sistemeve të IT.

Rekomandimi nr. 6 “KLSH të intensifikojë dhe përshpejtojë procesin e digjitalizimit të plotë të proceseve të punës, duke përdorur teknologjitë moderne për automatizimin, menaxhimin dhe ruajtjen e të dhënave të auditimit.”

Lidhur me procesin e digjitalizimit të plotë të proceseve të punës, është ngritur grupi i punës me Urdhrin nr. 121, datë 31.12.2025, me objekt analizimin dhe vlerësimin e nevojave logjistike dhe kapaciteteve teknike të nevojshme për digjitalizimin e proceseve të auditimit. Kjo me qëllim për të identifikuar gjithashtu dhe nevojat për fonde për investime të cilat do të bëhen pjesë e kërkesave buxhetore që do të përfshihen në PBA-në përkatëse.

Rekomandimi nr. 7 “KLSH të intensifikojë përpjekjet për plotësimin e vendeve vakante dhe të përqendrohet në optimizimin e kapaciteteve profesionale të stafit përmes ndarjes së drejtë të ngarkesës së auditimeve, trajnimeve të specializuara dhe zhvillimit të njohurive inovative në fushën e auditimit.”

Sa i takon plotësimin e vendeve vakante, për shkak të dinamikës institucionale, KLSH shpall dhe zhvillon procedura rekrutimi në vijimësi, me qëllim plotësimin e vendeve vakante, referuar Planit Vjetor të Pranimit, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në muajin shkurt 2026.



Prej datës 06.11.2025, kur është miratuar Rezoluta mbi veprimtarinë e KLSH-së për vitin 2024 dhe deri më datë 30.03.2026, janë shpallur 18 procedura në faqen zyrtare të KLSH-së dhe në Portalin Kombëtar të Punësimit, nga ku kanë përfunduar 12 procedura dhe janë plotësuar 6 vende. Ndërkohë, janë në proces 12 procedura rekrutimi për 19 vende vakante, për plotësimin e vendeve të lira.

Lidhur me zhvillimin e trajnimeve për rritjen dhe forcimin e kapaciteteve të stafit, KLSH në vijimësi zhvillon programet e trajnimit të brendshëm dhe merr pjesë në ato ndërkombëtare. Me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 245, datë 29.12.2025 është miratuar Programi i Zhvillimit të Integruar Profesional të Stafit të KLSH-së për vitin 2026. Krahas kësaj, KLSH vijon forcimin e bashkëpunimeve me institucionet homologe ndërkombëtare, ku ndër të tjera për vitin 2026 parashikohen edhe sesione trajnimesh dhe shkëmbime eksperiencash për audituesit si dhe auditime paralele bazuar në Marrëveshjet e Bashkëpunimit me këto institucione, si: SAI i Norvegjisë, SAI i Turqisë, SAI i Kosovës, SAI i Maqedonisë së Veriut, SAI i Azerbajxhanit.

Në hartimin e Planit Vjetor të Veprimtarisë Audituese për vitin 2026 është parashikuar një ngarkesë mesatare prej 1.6 auditimesh për auditues sipas strukturës faktike, duke konsideruar një shpërndarje të balancuar të ngarkesës dhe duke marrë parasysh auditimet që kryhen çdo vit për përmbushjen e detyrimeve kushtetuese, llojin dhe objektin e secilit auditim, si dhe profilin e audituesit në çdo rast.



5.2 KLSH DHE MEDIA

Media përfaqëson një partner të rëndësishëm në përmbushjen e misionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, pasi ajo përcjell punën audituese të institucionit duke e bërë atë të aksesueshme dhe të kuptueshme për publikun e gjerë, apo palët e interesit. Përmes raportimeve të detajuara, analizave dhe kronikave, media i jep jehonë gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimeve, duke rritur rolin dhe impaktin e KLSH-së në rritjen e transparencës mbi menaxhimin e fondeve publike dhe mirëqeverisjen e fondeve buxhetore dhe pronës publike nga institucionet shtetërore.

Në të njëjtën kohë, shpërndarja mediatike e problematikave të evidentuara nga KLSH, mund të ushtrojë ndikim pozitiv në forcimin e llogaridhënies, pasi mund të rrisë reagimin institucional nga subjektet e audituara përmes marrjes së masave konkrete për zbatimin e rekomandimeve. Në këtë mënyrë, media kontribuon jo vetëm në rritjen e shkallës së zbatueshmërisë së rekomandimeve, por edhe në parandalimin e abuzimeve, në forcimin e kulturës së integritetit dhe në konsolidimin e besimit të publikut tek mekanizmat e kontrollit dhe mirëqeverisjes.

Edhe gjatë vitit 2025, aktiviteti i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka marrë një vëmendje të konsiderueshme mediatike, duke u pasqyruar në 1115 publikime në median e shkruar dhe atë vizive. Prej tyre, 96 artikuj janë botuar në shtypin e shkruar, ndërsa 914 janë shpërndarë në median audiovizive dhe platformat online. Po ashtu, 105 kronika dhe emisione televizive i janë kushtuar gjetjeve të raporteve përfundimtare të auditimit dhe rekomandimeve të adresuara subjekteve të audituara, duke reflektuar interesin e medias për çështjet që lidhen me menaxhimin e fondeve publike dhe rezultatet e veprimtarisë audituese. Në auditimet e pasqyruara nga media në vijimësi janë trajtuar gjetjet e raporteve për çështje me ndjeshmëri të lartë publike, si: disponibiliteti i banrave në trajtimin e sëmundjeve tumorale, mungesa e barnave të rimbursueshme, auditimi në HEC Sasaj Sarandë pas çarjes së digës së hidrocentralit, cilësia e ujit të pijshëm, ndotja në Liqenin Artificial të Tiranës dhe në lumin e Lanës, shërbimi psiko-social në shkollat e arsimit parauniversitar, siguria në shkolla, etj.

Në këto pasqyime mediatike është evidentuar gjithashtu rrugëtimi 100-vjeçar i institucionit, përmes prezantimit të dokumentarit historik dhe aktiviteteve të zhvilluara në kuadër të këtij përvjetori, duke sjellë në vëmendje rolin dhe kontributin e KLSH-së ndër vite.

Në përmbushje të detyrimit ligjor për transparencë dhe informim të publikut, KLSH garanton natyrën e hapur të veprimtarisë së tij përmes një sërë instrumentesh informuese në faqen zyrtare. Këto përfshijnë publikimin e raportit vjetor që i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë, raporteve të auditimit, si edhe shpërndarjen e buletineve statistikore dhe mujore mbi veprimtarinë institucionale. Gjithashtu, KLSH bën publike planet vjetore dhe mujore të auditimit, ku përcaktohen të dhënat e secilit auditim, njoftimet për shtyp, si dhe çdo informacion tjetër që, sipas vlerësimit të Kryetarit të KLSH-së, shërben për të garantuar transparencë, llogaridhënie dhe informim të plotë të opinionit publik mbi veprimtarinë e institucionit.

Risi për vitin 2025 ishte rikonceptimi i faqes zyrtare të KLSH-së, e cila u dizajnuar për të qenë më afër publikut, duke përfshirë rubrika mbi të dhëna të hapura, dritare komunikimi për qytetarët, si dhe një navigim më të lehtë lidhur me aktivitetin institucional dhe atë auditues.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2025 janë publikuar në faqen zyrtare të KLSH-së 190 raporte përfundimtare auditimi, 44 njoftime për shtyp, 2 buletine statistikore 4-mujore, 12 buletine informuese



mujore, 1 buletin informues vjetor. Kontrolli i Lartë i Shtetit garanton transparencë dhe komunikim të pandërprerë me publikun, që shtrihet përtej faqes së tij zyrtare në internet, www.klsh.org.al. Ka vijuar përgatitja dhe publikimi i buletineve mujore, një iniciativë e nisur në dhjetor 2024, e cila ka rezultuar një mjet efikas për informimin, jo vetëm mbi rezultatet kryesore të auditimeve, por edhe mbi aktivitetet e tjera të KLSH-së.

Në vijim të kësaj praktike, në dhjetor 2025 është botuar dhe publikuar dhe një përmbledhje e buletineve mujore.



KLSH shpërnda rezultatet e auditimeve dhe aktivitetin institucional përmes mediave tradicionale, platformave digjitale, si edhe në rrjetet sociale si "Facebook" dhe "Instagram" dhe LinkedIn, duke i konsideruar këto platforma, si një hapësirë të rëndësishme informimi dhe ndërveprimi më të shpejtë dhe të thjeshtë me publikun. Gjatë vitit janë publikuar 118 postime në rrjetet sociale zyrtare të KLSH-së, përmes të cilave janë ndarë me ndjekësit informacione mbi aktivitetin auditues, njoftime institucionale, promovimi i raporteve përfundimtare të auditimit, si dhe materiale që lidhen me përvjetorin 100-vjeçar të institucionit. Këto postime kanë shërbyer jo vetëm për të zgjeruar aksesin e qytetarëve në informacion në kohë reale, por edhe për të krijuar një formë më të drejtpërdrejtë komunikimi, duke rritur prezencën e punës së KLSH-së, mundësinë e ndërveprimit me audienca të ndryshme, si dhe për të promovuar punësimin nëpërmjet shpalljeve të postuara përmes platformave digjitale.

Gjatë vitit 2025, KLSH ka konsoliduar pasqyrimin e aktivitetit në faqen zyrtare në gjuhën shqipe dhe atë angleze, për të qenë më pranë jo vetëm publikut vendas, por edhe institucioneve homologe, si një mënyrë shtesë e komunikimit dhe përditësimit të informacionit për partnerët.




Në këtë mënyrë, përmes një qasjeje aktive ndërvepruese, institucioni angazhon të gjitha grupet e interesit, duke vendosur veçanërisht median si një kanal lidhës me qytetarët dhe duke garantuar që informacioni mbi aktivitetin dhe gjetjet e tij të arrijë gjerësisht dhe në kohë reale.

Publikimi i spoteve informuese dhe dokumentarëve

Në faqen zyrtare të Kontrollit të Lartë të Shtetit janë publikuar spote informuese të konceptuara si instrumente vizuale për të shpjeguar rolin dhe mandatin e Kontrollit të lartë të shtetit. Këto materiale audiovizive synojnë të paraqesin në mënyrë të qartë, të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse rolin kushtetues, misionin, funksionet dhe veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke e bërë më të kuptueshëm për publikun e gjerë.


Ky komunikim vizual është konceptuar për të rritur nivelin e informimit dhe ndërgjegjësimin të qytetarëve mbi rëndësinë që ky institucion ka në forcimin e transparencës, përgjegjshmërisë dhe integritetit në administrimin e burimeve publike.



Dokumentar - 100 vjet Kontrolli i Lartë i Shtetit



Spot Informues - Kontrolli i Lartë i Shtetit



Spot Informues – Roli, misioni dhe qëllimet e KLSH



5.3 KLSH DHE PARTNERËT STRATEGJIKË

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka zgjeruar dhe thelluar bashkëpunimin me partnerët vendas dhe ata ndërkombëtarë përgjatë vitit 2025, duke u orientuar drejt zbatimit të standardeve dhe praktikave më të avancuara në fushën e auditimit. Ky bashkëveprim ka shërbyer si një mekanizëm i rëndësishëm për rritjen e cilësisë profesionale dhe forcimin e ekspertizës së institucionit. Përmes shkëmbimit të përvojave dhe njohurive, KLSH ka synuar përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së tij, duke garantuar një përshtatje më të mirë me ndryshimet dhe sfidat e mjedisit ku ushtron veprimtarinë, si dhe duke konsoliduar rolin e tij në sistemin e kontrollit dhe llogaridhënies publike.

Memorandume Mirëkuptimi të nënshkruara gjatë vitit 2025

Bashkëpunimi bilateral u konkretizua në nënshkrimin e dy marrëveshjeve të reja:

1. Memorandumi i Mirëkuptimit i nënshkruar më datë 19 maj 2025 mes Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Dhomës së Llogarive të Republikës së Azerbajxhanit;
2. Memorandumi i Mirëkuptimit i nënshkruar më datë 10 mars 2025 mes Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women).

Sa i takon institucioneve homologe është intensifikuar bashkëpunimi në kuadër të auditimeve paralele, shkëmbimit të eksperiencave, ndjekjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe memorandumeve të mirëkuptimit në fuqi, trajnimeve, si dhe pjesëmarrjes në aktivitete ndërkombëtare, ku ndër më intensive kanë qenë bashkëpunimet si vijon:



KLSH dhe SAI i Norvegjisë (OAGN)

Në vijim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të nënshkruar në vitin 2024 me Zyrën e Audituesit të Përgjithshëm të Norvegjisë, e cila mbulon një periudhë 5 vjeçare në fushat e auditimit të IT dhe auditimit të performancës, por edhe në fushën e komunikimit dhe procedurave të auditimit në industrinë nxjerrëse, gjatë vitit 2025 janë realizuar një sërë aktivitete të parashikuara dhe dakordësuara në përmbushje të planeve të punës, të cilat përfshijnë:

- Në fushën e IT-së:
 - trajnimi me temë “External cybersecurity for web and external interfaces”
 - workshop me temë “Internal ethical hacking of ALSAI”
 - workshop me temë “Cybersecurity II” me pjesëmarrjen edhe të përfaqësuesve nga SAI të tjerë homologe, si nga TCA e Turqisë, ZKA e Kosovës, SAI i Sllovenisë, SAI i Suedisë dhe SAI i Maqedonisë së Veriut, ku u trajtuan të gjitha hapat teorikë dhe praktikë të fazave të një testi sigurie.
- Në fushën e auditimit të performancës:
 - Workshop-e të zhvilluara në kuadër të mbështetjes për auditimet e performancës me temë “Cilësia e Ujërave në Plazhe” dhe “Shërbimi psiko-social në sistemin arsimor para-universitar”, si me pjesëmarrje fizike ashtu dhe në module online.

Përpos këtyre aktiviteteve, është ndërmarrë angazhimi për përditësimin e Manualit të Auditimit të Performancës me mbështetjen e homologëve të SAI-t të Norvegjisë, në kuadër



të cilit është ngritur grupi i punës respektiv, i cilët ka zhvilluar 2 takime në ambientet e KLSH-së, si dhe 2 takime online ndërmjet grupeve të punës.

Gjithashtu, KLSH ka dakordësuar pjesëmarrjen në Programin Rajonal të Ballkanit mbi IT-në, program i iniciuar nga SAI i Norvegjisë me pjesëmarrjen e KLSH-së dhe SAI-t të Maqedonisë së Veriut. Ky program ka si objektiva strategjike forcimin e kapacitetit institucional për kryerjen e auditimeve të IT-së në rajonin e Ballkanit, promovimin e bashkëpunimit rajonal dhe zhvillimin e një grupi rajonal ekspertësh të auditimit të IT-së, si dhe rritjen e transparencës digjitale të sektorit publik dhe qëndrueshmërisë ndaj sigurisë kibernetike.



KLSH dhe SAI i Turqisë (TCA)

Në vijim të bashkëpunimit me SAI-n e Turqisë dhe në referencë të Planit të Veprimit të hartuar bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar në vitin 2024, në datat 5-9 maj 2025, është zhvilluar vizita studimore në Gjykatën Turke të Llogarive (TCA) me fokus shkëmbimin e eksperiencave në “*Auditimin e Sektorit të Sigurisë*”, me mbështetjen e Agjencisë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA). Qëllimi i vizitës së përfaqësuesve të KLSH-së ishte shkëmbimi i eksperiencës së SAI-t të Turqisë në auditimin e sektorit të mbrojtjes dhe sigurisë.



KLSH dhe SAI i Kosovës (ZKA)

Në qershor 2025 u dakordësua kryerja e auditimit paralel me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës me temë “*Mbrojtja dhe siguria e digave*” për realizimin e të cilit janë zhvilluar një sërë takimesh mes audituesve të KLSH-së dhe SAI-t të Kosovës mbi shkëmbimin e eksperiencave dhe mbarëvajtjen e procesit auditues. Aktualisht auditimi është përfunduar dhe publikuar në faqen zyrtare të institucionit.

Për më tepër, angazhimi me SAI-n e Kosovës shtrihet edhe në auditimin e përbashkët me fokus temën sociale të fuqizimit të rolit të grave në politikë, bazuar në Marrëveshjen e nënshkruar mes KLSH – ZKA – SAO e Maqedonisë së Veriut.



KLSH dhe SAI i Maqedonisë së Veriut (SAO)

Në datë 3 dhjetor 2025, u zhvillua në KLSH vizita e punës nga Auditori i Përgjithshëm i Zyrës Shtetërore të Auditimit të Maqedonisë së Veriut, z. Maksim Acevski, i cili u prit në takim nga Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu. Në takim u vlerësuan marrëdhëniet e frytshme dhe të qëndrueshme ndërmjet dy institucioneve, duke e vënë theksin në konsolidimin e bashkëpunimit të ndërsjellë, veçanërisht nëpërmjet auditimeve paralele ku të dy institucionet janë angazhuar, duke pasur në fokus tematika të ndjeshme dhe me impakt shoqëror, ndër to edhe në kuadër të Marrëveshjes së Auditimit të përbashkët me mbështetjen e organizatës UN Women.



KLSH dhe Gjykata Evropiane e Audituesve (ECA)

Gjykata Evropiane e Audituesve (ECA) është një prej partnerëve më të rëndësishëm dhe përfaqëson bashkëpunimin më të qëndrueshëm të KLSH-së për rritjen e kapaciteteve të audituesve të rinj, nëpërmjet pjesëmarrjes në programin e praktikës profesionale, ku prej



vitet 2014 KLSH numëron 23 auditues pjesëmarrës në këtë program. Roli i ECA-s është veçanërisht i theksuar në mbështetjen e SAI-ve të vendeve candidate dhe atyre me status kandidat potencial për anëtarësim në BE. Përmes këtij angazhimi, ECA kontribuon në forcimin e kapaciteteve institucionale dhe në përafrimin me standardet evropiane të auditimit.

Gjithashtu, KLSH mori pjesë në konferencën me temë “*Mbrojtja*”, organizuar nga Gjykata Evropiane e Audituesve, ku diskutimet u fokusuan në kontekstin gjeopolitik aktual dhe se si BE po i përgjigjet urgjencës së transformimit të mbrojtjes dhe forcimit të sigurisë së saj, ku u paraqitën edhe perspektiva nga vendet anëtare apo ekspertë të NATO-s. Kjo në kontekstin e rolit të audituesve në mbarëvajtjen dhe përdorimin e buxheteve të dedikuara për këtë fushë.



KLSH dhe SAI i Mbretërisë së Bashkuar (NAO UK)

Në kuadër të bashkëpunimit nën programin “Rritja e llogaridhënies së qeverisë përmes një parlamenti më reagues” të zbatuar nga Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD), KLSH ka vijuar shkëmbimin e eksperiencës me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar (NAO UK) përfaqësues të lartë të të cilit, janë pritur në disa takime nga Kryetari i KLSH-së z. Arben Shehu:

- Takimi i datës 20 mars 2025 me z. Benjamin Peters, Drejtues i Komunikimit me Jashtë në NAO UK dhe drejtues të lartë të kësaj zyre me fokus bashkëpunimin, me qëllim zhvillimin e kapaciteteve të audituesve në shkrimin e raporteve të auditimit dhe vijimin e bashkëpunimit në fushën e komunikimit.
- Takimi i datës 3 qershor 2025 me përfaqësuesit e lartë të Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD), z. Chris Levick, si dhe përfaqësues nga Ambasada Britanike.

Në vijim të këtyre takimeve, bashkëpunimi me ekspertët e NAO UK, është konkretizuar me asistencën për përditësimin e Planit të Veprimit mbi zbatimin e Strategjisë së Komunikimit të KLSH-së. Gjithashtu, janë zhvilluar sesione trajnimi me auditues të KLSH-së për përmirësimin e teknikave dhe metodave të hartimit të raporteve të auditimit, komunikimin institucional me qëllim mbulimin e aspekteve teorike dhe praktike të komunikimit të veprimitarisë audituese, si dhe shkëmbimin e eksperiencave mbi mekanizma të përmirësuar raportimi me Parlamentin, shoqërinë civile dhe median. Ky bashkëpunim u përmbyll në muajin shkurt 2026 duke lënë të hapur vijimin e komunikimit për fusha të tjera bashkëpunimi.



KLSH dhe SAI i Suedisë (SNAO)

KLSH ka treguar pjesëmarrje aktive në kuadër të programit të ofruar nga SAI i Suedisë mbi auditimet e performancës për audituesit e rinj të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë. Në këtë program, KLSH është përfaqësuar me 3 auditues të cilët kanë ndjekur sesionet e trajnimit, përkatësisht për *auditimin “Kujdesi komunitar për të moshuarit dhe decentralizimi i shërbimit”*. Pjesëmarrja në këtë program është një konkretizim i bashkëpunimit me SAI-n e Suedisë në fushën e auditimeve të performancës me qëllim rritjen e cilësisë së punës audituese dhe ruajtjen e një standardi evropian për auditimet e performancës.



Bashkëpunimi në auditime paralele, të përbashkëta dhe me mbështetjen e homologëve

Gjatë vitit 2025, KLSH ka vijuar angazhimin në auditime paralele, të përbashkëta apo me mbështetjen e institucioneve homologe me qëllim shkëmbimin e eksperiencave më të mira dhe praktikave audituese, për auditimet si në vijim:

- Auditimi i performancës *“Cilësia e ujërave në plazhe”*, zhvilluar me mbështetjen e SAI-t të Norvegjisë;
- Auditimi i performancës *“Shërbimi psiko-social në sistemin arsimor para-universitar”*, zhvilluar me mbështetjen e SAI-t të Norvegjisë;
- Auditimi i performancës në fushën e IT-së *“Siguria kibernetike në infrastrukturën kritike e-taxation”*, zhvilluar me mbështetjen e SAI-t të Norvegjisë;
- Auditimi paralel i performancës *“Moshimi i popullsisë”* nën udhëheqjen e SAI-t të Izraelit, ku janë angazhuar 6 SAI (Shqipëria, Portugalia, Paraguai, Maqedonia e Veriut, Sllovakia dhe Izraeli).
- Auditimi i përbashkët *“Mbi Inteligjencën Artificiale”* nën udhëheqjen e SAI-t të Izraelit, me pjesëmarrjen e 17 SAI-ve të ndryshëm pjesë e EUROSAT: Shqipëria, Estonia, Franca, Italia, Letonia, Lituania, Maqedonia e Veriut, Polonia, Rumania, Sllovakia, Zvicra dhe shteti kryesues Izraeli.
- Auditimi i përbashkët *“Mbrojtja dhe siguria e digave”* në bashkëpunim me SAI-n e Kosovës;
- Auditimi i përbashkët *“Fuqizimi i rolit të grave në pozita udhëheqëse dhe në marrjen e vendimeve”* si pjesë e projektit të përbashkët me SAI-n e Kosovës dhe SAI-n e Maqedonisë së Veriut dhe në bashkëpunim me UN Women, për të cilin është nënshkruar edhe marrëveshja e auditimit mes 3 SAI-ve.

Gjithashtu, gjatë vitit 2025, KLSH ka marrë angazhimin për pjesëmarrje në auditime paralele dhe të koordinuara në bashkëpunim me SAI homologe dhe grupet e punës së EUROSAT-t në fushat e menaxhimit të risqeve nga fatkeqësitë natyrore, fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, fushën e mjedisit, etj; auditime të cilat janë planifikuar të zhvillohen përgjatë vitit 2026 dhe në vijim, referuar edhe kalendarit të dakordësuar ndërmjet SAI-ve.

INTOSAI



KLSH dhe INTOSAI


Aktiviteti më i rëndësishëm i vitit 2025 i INTOSAI-t ishte *Kongresi XXV i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit*, i mbajtur nga SAI i Egjiptit në datat 27-31 tetor 2025, ku ky i fundit mori edhe Presidencën e INTOSAI-t për 3 vitet në vazhdim. Kongresi u përqendrua në dy tema teknike të një rëndësie të veçantë. Tema e parë trajtoi rolin e SAI-ve në auditimin e bankave qendrore gjatë krizave financiare dhe ekonomike. Tema e dytë kishte në fokus përdorimin e inteligjencës artificiale (AI) në auditim, duke e konsideruar atë si një mjet për të rritur efikasitetin dhe saktësinë e punës audituese, për të përmirësuar cilësinë e gjetjeve dhe për të identifikuar devijimet në mënyrë më të shpejtë. Gjatë sesioneve plenare të Kongresit, u prezantuan raportet e institucioneve drejtuese dhe komiteteve të përhershme të INTOSAI-t, si dhe organizatat rajonale: AFROSAT, ASOSAT, CAROSAT, OLACEFS, ARABOSAT, EUROSAT dhe PASAT. Në kuadër të procesit zgjedhor të Kongresit, u zgjodhën organet e reja drejtuese të INTOSAI-t, anëtarët e Bordit Drejtues si dhe audituesit e jashtëm të organizatës. Anëtarët e INTOSAI-t miratuan Deklaratën e Sharm El-



Sheikh, e cila përcakton angazhimin e përbashkët të komunitetit global të auditimit për të ndërtuar institucione supreme më të forta, më të pavarura dhe më të qëndrueshme, të afta për t'iu përgjigjur sfidave të së ardhmes.

Gjatë aktiviteteve shoqëruese të Kongresit INCOSAI XXV, u realizua edhe një *Takim me Presidentin e Gjykatës së Përgjithshme të Auditimit të Mbretërisë së Arabisë Saudite*, Dr. Hussam Alangari, ku nga ana e përfaqësuesve të KLSH-së u shpreh vlerësimi mbi forcimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe konkretizimin e bashkëpunimit institucional. Z. Alangari shprehu gatishmërinë për vijimin dhe forcimin e këtyre marrëdhënieve përmes kontributit të ndërsjellë.

Gjatë vitit 2025, KLSH është angazhuar në anëtarësimin në *Grupin e Punës së INTOSAI-t për "Follow-Up Audit" (WGFA)*. WGFA u krijua në mbledhjen e 78-të të Bordit Drejtues të INTOSAI-t në tetor 2024, duke u bërë grupi i dytë më i madh i punës së INTOSAI-t. Në kuadër të këtij angazhimi, përfaqësues të KLSH-së kanë ndjekur webinare dhe sesione online të diskutimeve mes pjesëmarrësve, si dhe kanë përcjellë sugjerime apo komente mbi Planin e Veprimit 2025-2028, i cili parashikon hartimin e një Udhëzuesi të Praktikave të Mira për Auditimin Follow-Up, me kontribut aktiv nga anëtarët.



KLSH ka marrë pjesë në *Konferencën e XIV-të UNCTAD "Menaxhimi efektiv dhe elastik i borxhit"* organizuar nga Kombet e Bashkuara dhe INTOSAI, me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe pikëpamjeve ndërmjet qeverive, organizatave ndërkombëtare, akademikëve dhe shoqërisë civile mbi zhvillimet aktuale të borxhit në vendet në zhvillim dhe mbi çështjet e menaxhimit të tij. Konferenca trajtoi çështje të ngutshme duke eksploruar strategji inovative për menaxhimin e borxhit me fokus ndërtimin e elasticitetit, zbutjen e risqeve dhe lundrimin në kompleksitetin e krizave globale.

Forumi Politik i Nivelit të Lartë të Kombeve të Bashkuara "Rritja e kompetencave të SAI-ve për zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm" i organizuar nga IDI në bashkëpunim me Komitetin Ndërkombëtar për Standarde Profesionale të Auditimit të INTOSAI (KSC), mbledhi së bashku, përfaqësues të lartë nga SAI-të, organet e INTOSAI-t, organizata të OKB-së, organizata ndërkombëtare, shoqëria civile, etj., me qëllim ndarjen e përvojave konkrete nga auditimet e OZHQ-ve, me fokus në Objektivin 3 (shëndeti dhe mirëqenia) dhe Objektivin 5 (barazia gjinore).

Workshop-i mbi trajnimin e moderatorëve për *instrumentin e vetëvlerësimit të integritetit IntoSAINT*, i mbajtur në 7-10 tetor 2025 në Rumani, mbledhi së bashku 22 përfaqësues nga 12 shtete anëtare të EUROSAI-t, përfshirë edhe KLSH. Trajnimi ishte i pari në formatin e përditësuar dhe të digjitalizuar të IntoSAINT dhe u udhëhoq nga tre trajnues me eksperiencë nga SAI-t e Norvegjisë dhe Hollandës. Në vijim të trajnimit, pjesëmarrësit do të ndjekin një fazë të mëtejshme të kualifikimit, përmes përvetësimit të platformës "Questback", e cila është thelbësore për të qenë të certifikuar dhe të aftë për të udhëhequr në mënyrë të pavarur proceset e vetëvlerësimit IntoSAINT në kuadër të integritetit të SAI-ve.

KLSH mori pjesë në *webinarin ndërkombëtar "Rojtarët e Përgjegjshmërisë Publike: Kultura e Auditimit dhe Evolucioni Institucional"* organizuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Mbretërisë së Tajlandës në kuadër të krenimit të 150 vjetorit të auditimit publik në Tajlandë si dhe në *webinarin "Duke përshkruar trendet globale – Pasojat në të ardhmen për SAI-t"*, në kuadër të raportit të INTOSAI-t, u organizua *webinari "Duke përshkruar trendet globale – Pasojat në të ardhmen për SAI-t"*, i cili kishte për qëllim të trajtonte pasojat e mundshme për



Institucionet Supreme të Auditimit, që mund të lindin nga faktorët kryesorë të ndryshimit që priten të ndikojnë gjatë 15 viteve të ardhshme.



KLSH është angazhuar me pjesëmarrje në grupet e punës EUROSAI si dhe në aktivitetet e organizuara nga EUROSAI. Ndër to, përfshihen:

- Angazhimi për anëtarësimin në Task Forcën e EUROSAI-t mbi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm drejtuar nga Gjykata Turke e Llogarive;
- Ndjekja e kursit online mbi “Çështjet e ujit” organizuar nga SAI i Estonisë në bashkëpunim me Universitetin e Tartusë;
- Pjesëmarrja online në Konferencën përmbyllëse të projektit “Përmirësimi i efikasitetit dhe transparencës së prokurimit publik” organizuar nga Gjykata Portugeze e Audituesve dhe Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD);
- Përfaqësim në webinar-in për Inteligjencën Artificiale organizuar nga SAI i Suedisë;
- Webinari për Inteligjencën Artificiale organizuar nga SAI i Suedisë;
- Webinari nën SG1 (Qëllimi Strategjik 1 – Bashkëpunimi Profesional) organizuar nga Projekt Grupi i EUROSAI-t “Për Rimëkëmbjen dhe Përgatitjen” me temë “Siguria Kibernetike dhe refleksionet e SAI-ve në punën e tyre”;
- Takimi III i Grupit të Punës së EUROSAI/ SG1 për Auditimet në kohë reale;
- Workshop-i rajonal me temë “Auditimet e Teknologjisë së Informacionit – Zhvillimet dhe Sfidat”, organizuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës, ZKA;
- Konferenca rajonale mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë së Auditimit” organizuar nga SAI i Bosnje dhe Hercegovinës;
- Seminari i organizuar nga Gjykata Portugeze e Llogarive, në kuadër të rrjetit të EUROSAI-t për Etikën (N.ET) me temë “Institucionet Supreme të Auditimit, Inteligjenca Artificiale dhe Etika”;
- Workshop-i VIII i projektit të EUROSAI-t mbi “Data Envelopment Analysis (DEA) dhe metodat e tjera të krahasimit”.



Grupi i punës mbi Auditimet e Mjedisit

Aktivitetet ku KLSH është përfaqësuar në kuadër të anëtarësimit në WGEA janë:

- Sesioni i punës “Matja e performancës mjedisore në sektorin publik” e organizuar nga WGEA në bashkëpunim me Gjykatën Franceze të Llogarive në datë 6 shkurt 2025;
- Sesioni i pranverës i EUROSAI/WGEA me temë “Përshtatja e ndryshimeve klimatike dhe zbutja e politikave si sfidë për agrikulturën” në 6-8 maj 2025;
- Takimi vjetor EUROSAI/WGEA me temë “Lidhja Klimë-Ujë-Biodiversitet” në 7-10 tetor 2025;
- Takimi i EUROSAI WGEA për bashkëpunimin ndërkombëtar në auditimin me temë “Përshtatja e menaxhimit të pyjeve ndaj ndryshimeve klimatike” organizuar nga SAI i Polonisë.





Grupi i punës mbi IT (ITWG)

Gjatë vitit 2025, KLSH ka marrë pjesë në e-seminarin me temë “Mbi auditimin e infrastrukturës kritike të informacionit”.

Grupi i punës mbi EUROSAI Development Activities (EDA)

Grupi i punës EDA, është krijuar në Qershorin e vitit 2025 në sesionin e 64-të të Bordit Drejtues të EUROSAI-t, me qëllim mbështetjen e SAI-ve në fusha si: programe trajnimi, workshope mbi metodologjinë e avancuar të auditimit, gjuha dhe shkrimi i raporteve të auditimit, si dhe çështje të lidhura me qeverisjen (ISSAI 140, 150). Në këtë kuadër, KLSH mori pjesë në workshopin “EUROSAI Development Activities Project launch and Audit Impact Workshop”, që shënon nisjen zyrtare të projektit të ri zhvillimor të EUROSAI-t organizuar nga SAI i Suedisë në 2-5 dhjetor.



Grupi i punës mbi Auditimin e Bashkive (WGMA)

KLSH është pjesëmarrëse aktive në Grupin e Punës mbi Auditimin e Bashkive, ku gjatë vitit 2025 ka marrë pjesë në seminare dhe takime online, si dhe ka ndarë mendimet/ sugjerimet mbi materiale të përbashkëta, përfshirë Planin e Veprimit për vitin. Për më tepër, KLSH është angazhuar në auditimin paralel të iniciuar nga ky grup pune dhe të udhëhequr nga SAI i Letonisë.



Grupi i punës për Auditimin e Fondeve të Alokua në raste të Fatkeqësive dhe Katastrofave (WGAFADC)

KLSH ka ndjekur takimet online dhe seminare të organizuara nga grupi i punës. Gjithashtu, gjatë vitit 2025, KLSH është angazhuar në auditimin e koordinuar të iniciuar nga ky grup pune i udhëhequr nga SAI i Ukrainës, në kuadër të të cilit, audituesit kanë ndjekur takimet online dhe seminarët e organizuara.



KLSH dhe IDI

Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t (IDI) vijon të mbetet një ndër partnerët e rëndësishëm të KLSH-së në mbështetje të punës audituese dhe rritjes së kapaciteteve profesionale. Në bashkëpunim me këtë organizatë, gjatë vitit 2025 janë kryer disa aktivitete si:

U publikua raporti i përbashkët “Auditimet Globale të Përshtatjes ndaj Klimës për një të Ardhme Rezistente: Gjetje dhe rekomandime nga Institucionet Supreme të Auditimit” nga grupi i Punës i INTOSAI-t për Auditimin Mjedisor (WGMA) në bashkëpunim me Inicativën për Zhvillim të INTOSAI-t (IDI). Si pjesë e këtij projekti, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka zhvilluar auditimin e performancës “Zbatimi i Planit Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike”, i cili lidhet me Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm nr. 13.

2 auditues të KLSH-së kanë marrë pjesë në programin profesional PESA-P gjatë vitit 2025, i cili synon të përmirësojë aftësitë dhe kapacitetet e Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) në fushën e auditimit financiar, të përputhshmërisë dhe të performancës. Qëllimi kryesor është të ndihmojë audituesit të zhvillojnë njohuri dhe praktika të avancuara, si dhe të certifikojnë njohuritë e fituara pas përfundimit të programit dhe kryerjes së testimit profesional.



Risi për vitin 2025 ishte edhe pjesëmarrja e KLSH-së në programin pilot mbi certifikimin e specialistëve për *“Menaxhimin e Cilësisë në Auditim”* AQMS në kuadër të rishikimit të ISSAI 140. Ky certifikim synon të krijojë një bazë globale të specialistëve të menaxhimit të cilësisë së auditimit të certifikuar nga IDI, të cilët janë të aftë dhe të angazhuar për të lehtësuar ngritjen, zbatimin dhe funksionimin e Sistemeve të Menaxhimit të Cilësisë së Auditimit në institucionet supreme të auditimit.

Në mbështetje të bashkëpunimit të vijueshëm mes KLSH-së dhe IDI-t, si dhe bazuar në caktimin e një *“resource person”* nga ana e KLSH-së janë ndjekur sesionet e trajnimit në kuadër të misionit mbështetës të IDI-t për Gjykatën e Llogarive të Timor Leste mbi SoAQM, si dhe sesionet e trajnimit mbi rishikimin e pavarur sipas kornizës së Matjes së Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI PMF), ku qëllimi kryesor synon të sigurojë që stafi i SAI-ve të ketë njohuri të thella mbi SAI PMF, me qëllim kryerjen e procesit të matjes së performancës së institucionit nëpërmjet metodologjisë së zhvilluar nga IDI.

Gjatë vitit 2025, KLSH ka marrë pjesë në takimin e nivelit të lartë mbi zhvillimin e kapaciteteve nga UNCTAD në bashkëpunim me IDI. Takimi kishte në fokus rëndësinë në rritje të raportimit të qëndrueshmërisë në sektorin publik dhe rolin kritik të Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) në ofrimin e auditimit dhe sigurisë së deklarimeve.



KLSH dhe SIGMA

KLSH ka vijuar komunikimin dhe bashkërendimin e punës me ekspertët e SIGMA-s përgjatë vitit 2025 në dy linja kryesore: kryerjen e procesit *“peer review”*, si dhe mbështetjen e ofruar në kuadër të bashkëpunimit me Kuvendin.

Gjatë procesit të *“peer review”* në KLSH, u zhvilluan takime me të gjitha strukturat e institucionit, përfshirë stafin auditues dhe jo-auditues. U administruan dhe shqyrtuan dokumentacione të ndryshme të auditimit, duke vlerësuar përputhshmërinë e tyre me aktet ligjore dhe nënligjore të KLSH-së. Në përfundim, sipas draft-raportit të auditimit, u evidentuan disa aspekte që mund të përmirësohen në manualët ekzistuese të institucionit, në shërbim të forcimit të cilësisë dhe efektivitetit të punës audituese.

Gjithashtu, gjatë vitit 2025, SIGMA ka mbështetur procesin e forcimit të bashkëpunimit me Kuvendin dhe Nënkomisionin e Auditimit të Sektorit Publik, në bashkërendim edhe me NDI.



KLSH dhe SECO

Në vijim të praktikës së mirë të krijuar tashmë me bashkëpunimin me SECO në kuadër të projektit *“Forcimi i Mbikëqyrjes së Auditimit të Jashtëm për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat (PPP) në Shqipëri”*, KLSH është angazhuar në vijimin e bashkëpunimit për rritjen e kapaciteteve audituese në fushën bankare dhe financiare. Ka vijuar komunikimi me SECO-n dhe Ambasadën Zviceriane me qëllim konkretizimin e një marrëveshjeje me kontribute të qarta në fushën audituese dhe në përmirësimin e kapaciteteve profesionale të institucionit. Përmes ekspertizës së jashtme, auditimeve pilot, trajnimeve për stafin dhe përfshirjes së palëve të interesuara, synohet përmirësimi i metodologjive, rritjes së kapaciteteve të auditimit dhe nxitjes së transparencës dhe llogaridhënies në qeverisjen e sektorit financiar, bazuar edhe në mandatin kushtetues të KLSH-së. Aktualisht janë duke u dakordësuar termat e Marrëveshjes së re të financimit.





Ekspertët e NDI, në bashkëpunim edhe me ekspertët e SIGMA, kanë ofruar mbështetje të vazhdueshme përgjatë vitit 2025 në kuadër të forcimit dhe konsolidimit të marrëdhënieve mes KLSH-së dhe Nënkomisionit Parlamentar për Auditimin e Sektorit Publik. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, janë zhvilluar një sërë aktiviteteve si takime pune në KLSH dhe aktivitete të përbashkëta me Kuvendin e Shqipërisë. Ekspertët e NDI kanë ndarë me KLSH eksperiencën e Komitetit për Kontrollin Buxhetor (CONT), si përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të buxhetit të BE-së, ku Komiteti bashkëpunon ngushtësisht me ECA për miratimin e zbatimit të buxhetit nga ekzekutivi.



Në vijim të nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit në mars 2025, ndërmjet KLSH-së dhe UN Women, është punuar mbi hartimin dhe miratimin e Planit të Punës me aktivitetet e dakordësuara mes palëve. Në nivel rajonal, KLSH mori pjesë në një workshop në Prishtinë, së bashku me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës dhe SAI-n e Maqedonisë së Veriut, ku u diskutua iniciativa për auditime të përbashkëta të performancës, me mbështetjen e UN Women. Plani i miratuar i punës përfshin një sërë aktiviteteve dhe takimesh me fokus auditimin paralel mes KLSH – ZKA – SAO Maqedonia e Veriut vizita studimore, si dhe trajnime me qëllim rritjen e kapaciteteve lidhur me tema sociale me bazë gjinore.

Nga UN Women u hartua dhe miratua Udhëzuesi për Auditimin e Ndjeshëm Gjinor, me qëllim nxitjen e integritetit të perspektivës gjinore në proceset audituese, si rezultat i punës së përbashkët me KLSH-në. Ky udhëzues i shtohet setit të manualeve të auditimit të performancës në fushën e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Pjesëmarrja në konferenca, trajnime, seminare dhe takime

Gjatë vitit 2025, KLSH ka marrë pjesë në një sërë aktiviteteve si takime, trajnime, konferenca, workshop-e, seminare apo sesione të ndryshme, si me prezencë fizike ashtu edhe me module online, angazhime të cilat shërbejnë për shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira, si dhe në rritjen e kapaciteteve profesionale.

Gjatë kësaj periudhe, aktivitetet janë zhvilluar nga organizata dhe institucione të njohura ndërkombëtare, duke garantuar standarde të larta profesionale dhe shkëmbim përvojash në nivel global, ku përfshihen: Projekti rajonal “*Smart Finance*” për auditimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm organizuar nga UNDP, Programi pilot mbi “*Keqpërdorimin e IT në krimet financiare*” zhvilluar nga OECD në bashkëpunim me Guardia di Finanza, trajnimi për “*Vlerësimin e Performancës së Menaxhimit të Borxhit Publik (DeMPA)*” ofruar nga Banka Botërore në bashkëpunim me Joint Vienna Institute (JVI), konferenca “*Integriteti, Transparenca dhe Inovacioni në prokurimin publik*” u zhvillua në kuadër të projektit të BE-së “*A.C.T – Anti-Corruption in Tenders*”, workshop-i rajonal për ndërtimin e kapaciteteve në Menaxhimin Financiar të Projekteve (PFM) nga Banka Islamike për Zhvillim, trajnime në fushën e auditimit të sistemeve të informacionit, e-qeverisjes dhe përdorimit të analizës së të dhënave dhe teknologjisë në auditim zhvilluar pranë Qendrës Ndërkombëtare për Sistemet e Informacionit dhe Auditimit (iCISA) në Noida, Indi, etj.

Në kuadër të 100 vjetorit të themelimit të KLSH-së

Në vitin e jubileut institucional, Kontrolli i Lartë i Shtetit i nisi aktivitetet për 100-vjetorin e krijimit të institucionit nga qyteti i “Pavarësisë”, Vlora. Në këtë kuadër, në datën 10 prill 2025, Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu dhe Auditorja e Përgjithshme e Zyrës Kombëtare të



Auditimit të Kosovës, znj. Vlora Spanca, së bashku me përfaqësues të të dyja institucioneve zhvilluan një vizitë në qytetin e Vlorës, duke çelur kështu siparin e aktiviteteve të 100-vjetorit.

Në datën 20 maj 2025, Kontrolli i Lartë i Shtetit organizoi ceremoninë zyrtare të 100 vjetorit të themelimit të institucionit, në sallën e seancave plenare të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Në ceremoni morën pjesë Kryetarja e Kuvendit, Ambasadori i Delegacionit të Bashkimit Evropian, drejtues dhe përfaqësues të lartë nga organizatat ndërkombëtare të auditimit, delegacione nga 19 institucione supreme auditimi në rajon dhe më gjerë, ambasadorë dhe përfaqësues të trupit diplomatik, partnerë ndërkombëtarë, ministra, deputetë, drejtues institucionesh të pavarura, akademikë, përfaqësues të medias dhe të shoqërisë civile, punonjës dhe ish-punonjës të KLSH-së, etj.

Gjithashtu, në ceremoninë e 100-vjetorit përshëndetën Presidenti i EUROSAI-t dhe Kontrollori i Shtetit të Izraelit, Presidenca e INTOSAI-it me përfaqësues Ministrin pranë Gjykatës së Llogarive të Brazilit, Auditorja e Përgjithshme e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës, Presidenti i Zyrës Supreme të Auditimit në Poloni dhe zv. Presidentja e Gjykatës Greke të Auditimit.



Përpos ceremonisë zyrtare, KLSH zhvilloi një sërë aktiviteteve në kuadër të 100 vjetorit të themelimit të institucionit ku mori rëndësi të veçantë Konferenca Shkencore me temë *“Ndërtimi i institucioneve të adaptueshme: Përshtatja me dinamikën e mjedisit – Një perspektivë e auditimit të jashtëm”*. Pjesëmarrës në konferencë ishin Institucionet Supreme të Auditimit nga Kosova, Bosnje Hercegovina, Rumania, Greqia, Turqia, Azerbajxhani dhe Suedia. Gjithashtu, ishin të pranishëm edhe përfaqësues të lartë nga organizata ndërkombëtare e auditimit, IDI - INTOSAI dhe SIGMA – OECD.

Gjatë kësaj konference, SAI-t prezantuan punimet e tyre lidhur me trajtimin e situatave emergjente dhe diskutuan mbi qasjet moderne në metodologjitë e auditimit, rolin e teknologjisë, menaxhimin e cilësisë dhe zhvillimin e kapaciteteve, si dhe sfidat me të cilat përballen në procesin e punës. Pas zhvillimit të konferencës, KLSH botoi librin me punimet shkencore, i cili është publikuar në faqen zyrtare të institucionit.



TAKIME DHE VIZITA ZYRTARE TË KRYETARIT TË KLSH-SË



Raportimi i Kryetarit të KLSH-së, z. Arben Shehu mbi Raportin e Zbatimit të Buxhetit për vitin 2024



Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, në takim me Ambasadorin Italian në Shqipëri, z. Marco Alberti



Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, në takim me Presidentin e EUROSAT-t, z. Matanyahu Englman, njëherazi drejtues i Kontrollorit dhe Avokatit të Popullit të Shtetit të Izraelit



Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, me përfaqësuesin e Presidencës së INTOSAI-it, z. Augusto Nardes



Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, nënshkruan MoU me Kryetarin e Dhomës së Llogarive të Azerbajxhanit, z. Vugar Gulmammadov



Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, në takim me Auditoren e Përgjithshme të Kosovës, znj. Vlora Spanca





Kryetari dhe përfaqësues të KLSH-së në takim me delegacionin e Parlamentit Europian në kuadër të Misionit në Shqipëri dhe Malin e Zi



Kryetari dhe përfaqësues të KLSH-së në takim me delegacionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar



Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, në takim me delegacionin nga Autoriteti i Llogaridhënies së Emirateve të Bashkuara Arabe



Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, në takim me kryetarët e SAI-ve dhe përfaqësues të tjerë nga rajoni dhe Moldavia në kuadër të projektit “Smart Finance” për një Qeverisje të Përgjegjshme



Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, në takim me Drejtuesin e programit SIGMA, z. Gregor Virant



Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, në takim me përfaqësues të Njësisë Speciale Antikorrupsion të Guardia di Finanza



Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, në takim me Auditorin e Përgjithshëm të SAI-t të Maqedonisë së Veriut, z. Maksim Acevski



Bashkëpunimi me shoqërinë civile

Bashkëpunimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit me organizatat e shoqërisë civile përbën një komponent kyç të angazhimeve të institucionit për forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe rritjen e transparencës dhe llogaridhënies. Ky bashkëpunim ndihmon, mundëson që qytetarët dhe aktorët e shoqërisë civile të jenë pjesë e procesit të monitorimit dhe të kontribuojnë në rritjen e përgjegjshmërisë institucionale. Ky bashkëpunim ka vijuar edhe gjatë vitit 2025, duke marrë pjesë dhe kontribuar në disa tryeza diskutimi, takime, etj.



Gjatë vitit 2025, përfaqësues të KLSH kanë kontribuar në diskutime të organizuara nga Instituti Shqiptar i Shkencave mbi rolin e Parlamentit në autonominë fiskale të njësive të qeverisjes vendore, si dhe në forumin e Qendrës Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER) mbi përvojën dhe problematikat e partneriteteve publike-private (PPP). Në tryezën e organizuar nga Qëndresa Qytetare u prezantuan dhe u diskutuan gjetjet e monitorimit të procedurave të prokurimeve publike në disa bashki të vendit, duke

theksuar rëndësinë e kontrollit dhe mbikëqyrjes së shpenzimeve publike. Gjithashtu, KLSH ka qenë e angazhuar në mënyrë aktive në një sërë aktiviteteve kombëtare që lidhen me forcimin e integritetit, transparencës dhe llogaridhënies në administrimin e financave publike. Institucioni mori pjesë në konferencën kombëtare *“Budgeting with Integrity in Albania”*, organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në bashkëpunim me Delegacionin e BE-së në Shqipëri, në kuadër të projektit për rritjen e kapaciteteve të shoqërisë civile në mbikëqyrjen e transparencës buxhetore.

Përfaqësues të institucionit morën pjesë në disa tryeza të organizuara nga shoqata *“Together for Life”*, ku u diskutuan problematikat në fushën e shëndetësisë, ashtu edhe perceptimi publik mbi këtë fenomen, me pjesëmarrjen e medias dhe aktorëve të tjerë të shoqërisë civile.

Përmes këtyre aktiviteteve, KLSH ka forcuar bashkëpunimin ndër-institucional, ka shkëmbyer përvoja dhe ka kontribuar në avancimin e standardeve profesionale në fushën e auditimit publik.



Bashkëpunimi me universitetet

Kontrolli i Lartë i Shtetit vlerëson bashkëpunimin me universitetet publike përmes aktiviteteve të zhvilluara në auditore për të mundësuar shkëmbimin e ideve, përcjelljen e rolit të KLSH te studentët si auditues të ardhshëm. Gjatë vitit 2025, KLSH ka qenë e pranishme në mjediset akademike përmes leksioneve të hapura, prezantimeve dhe diskutimeve mbi rëndësinë dhe funksionin e auditimit të jashtëm publik.

Në kuadër të aktiviteteve të 100 vjetorit të KLSH-së, janë organizuar leksione të hapura me studentët në katër universitete publike të vendit, me qëllim promovimin e rolit të institucionit në një moment të rëndësishëm historik. Në këto aktivitete studentët patën mundësi të informohen më shumë rreth mënyrës se si funksionon KLSH dhe mbi rëndësinë e auditimit dhe kontrollit në administratën publike.



Në datë 9 maj 2025, KLSH organizoi leksionin me temë “100 vite besueshmëri, integritet dhe shërbim ndaj qytetarëve – Kontrolli i Lartë i Shtetit si garant i transparencës dhe mirëqeverisjes në Shqipëri” me studentët e Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës.


Më 13 maj 2025, leksioni i hapur u zhvillua me studentët e Universitetit “Ismail Qemali” në Vlorë.

Më 22 maj 2025, KLSH zhvilloi leksionin e hapur me studentë dhe pedagogë të Fakultetit të Biznesit në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës.

Më 23 maj 2025, KLSH zhvilloi leksionin e hapur në kuadër të 100-vjetorit me studentë dhe pedagogë të Fakultetit Ekonomik pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër.

Në datë 31 tetor 2025, KLSH zhvilloi një takim të hapur informues me studentë dhe pedagogë në Universitetin “Fan Noli”, Korçë.

Bashkëpunimi me Postën Shqiptare në kuadër të emetimit të pullave historike



Me rastin e 100-vjetorit të themelimit të institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Posta Shqiptare nxori në qarkullim në datë 20.05.2025 një seri të re me dy pulla postare, si dhe zarfin e personalizuar me logon “100-vjetori i Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Pulla e parë paraqet portretin e z. Fejzi Alizoti, i cili ishte drejtuesi i parë i institucionit që asokohe mbante emërtimin Këshilli Kontrollues. Z. Alizoti ishte politikan, ekonomist dhe diplomat me një kontribut të spikatur në administratën publike shqiptare, duke përfshirë edhe detyrën e Ministrit të Financave. Në maj të vitit 1925, Fejzi Alizoti u zgjodh Kryetar i Këshillit Kontrollues, duke nisur një

epokë të re në mbikëqyrjen financiare të shtetit shqiptar.

Pulla e dytë përmban stemën aktuale zyrtare të Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke përfaqësuar vazhdimësinë e historisë institucionale dhe misionin e pandryshuar të mbrojtjes së interesit publik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE



5.4 VLERËSIME NGA INSTITUCIONE NDËRKOMBËTARE

A. Komisioni Evropian dhe Raporti i Progresit “Shqipëria 2025”

Në Raportin e Progresit Shqipëria 2025, të publikuar në datë 04.11.2025, Komisioni Evropian ka vlerësuar Kontrollin e Lartë të Shtetit për punën dhe rolin e institucionit në procesin e integritetit të Shqipërisë. Në Raport evidentohet se cilësia e punës së auditimit vazhdoi të ishte në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI). Komisioni Evropian thekson se Shqipëria duhet të përmirësojë zbatimin e rekomandimeve të auditimit të jashtëm.



Kapitulli 32: Kontrolli Financiar

Korniza ligjore e Shqipërisë mbron pavarësinë e Institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Cilësia e punës audituese vazhdoi të përputhej me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI). Ndikimi i punës audituese përparoi. 99% e rekomandimeve të lëshuara në auditimet e vitit 2024 u pranuan, nga të cilat 47% u zbatuan plotësisht ose pjesërisht.


Shqipëria duhet të përmirësojë zbatimin e rekomandimeve të auditimit të jashtëm. Nënkomisioni parlamentar për auditimin ka mbajtur disa seanca dëgjimore gjatë periudhës raportuese dhe ka lëshuar rezoluta në lidhje me një numër auditimesh nga Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili është një trend pozitiv.



B. Barometri Ballkanik 2024, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (*Regional Cooperation Council - RCC*) në raportin vjetor “Barometri Ballkanik 2024”, të hartuar me mbështetjen e Bashkimit Evropian, ka vlerësuar pavarësinë dhe efikasitetin e punës së KLSH-së në interes të qytetarëve. Bazuar në rezultatet e raportit, KLSH ka ruajtur pozicionin në lidhje me pavarësinë dhe rolin e tij mbikëqyrës, duke e bërë qeverinë më llogaridhënëse ndaj qytetarëve. Sondazhet e Barometrit Ballkanik u kryen gjatë muajit mars dhe fillimit të prillit 2024 në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut dhe Serbi.

Krahasuar me vendet e rajonit, KLSH pozicionohet në krye të vlerësimit për pavarësinë institucionale, me gjithë skepticizmin e lartë të qytetarëve në të gjitha vendet e rajonit, siç paraqitet në grafikun e mëposhtëm.


Vlerësimi i Pavarësisë: Institucioni Suprem i Auditimit i lirë nga ndikimi politik



Burimi: Balkan Barometer 2024, Public Opinion

Në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, sipas gjetjeve të raportit, Shqipëria dhe Kosova janë ndër vendet me besimin më të lartë tek Institucionet Supreme të Auditimit përkatësisht 53% dhe 47% të të anketuarve që shprehin opinionin se Institucionet Supreme të Auditimit mund të shqyrtojnë në mënyrë efektive punën e Qeverisë, për ta bërë atë të përgjegjshme ndaj qytetarëve.

Fuqia e Institucionit Suprem të Auditimit për të kontrolluar Qeverinë, për t’a bërë të përgjegjshme ndaj qytetarëve



Burimi: Balkan Barometer 2024, Public Opinion

C. Komisioni Evropian vlerëson rolin e KLSH-së në luftën kundër korrupsionit



Komisioni Evropian (KE) ka vlerësuar rolin aktiv dhe të qëndrueshëm të Kontrollit të Lartë të Shtetit në luftën kundër korrupsionit në Shqipëri duke përfshirë edhe rolin e institucionit në procesin integruar.

Në raportin e KE-së “Sundimi i ligjit” për vitin 2025, për Shqipërinë, KLSH përmendet si një nga institucionet me performancë konkrete dhe bashkëpunim efektiv me organet e drejtësisë. KE nënvizon se KLSH ka krijuar një praktikë solide në adresimin e shkeljeve, duke i kaluar çështjet me prioritet të lartë organeve hetimore.

“Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) ka një histori më të fortë sa i përket referimeve gjyqësore dhe bashkëpunimit me organet e ndjekjes penale. Në vitin 2024, KLSH referoi 13 raste me elementë penalë për ndjekje penale. Përveç kësaj, 35 referime për çështje që kërkojnë hetime të mëtejshme

janë ndarë me organet e Prokurorisë me kërkesë të tyre”, thuhet në raportin e vitit 2025 të Komisionit Evropian.

KE bën thirrje për bashkëpunim të detyruar institucional midis institucioneve përgjegjëse për parandalimin e korrupsionit dhe strukturave përkatëse të zbatimit të ligjit. KE kërkon që puna e KLSH-së të mbështetet si një shtyllë kyçe në betejën kundër korrupsionit.



D. SIGMA vlerëson punën e KLSH-së



Në Raportin e SIGMA-s për “Administratën Publike Shqiptare 2024”, është vlerësuar veprimtaria e pavarur në auditimin e fondeve publike nga Kontrolli i Lartë i Shtetit si një institucion që ofron sigurinë për përdorimin e burimeve publike dhe ndihmon në përmirësimin e funksionimit të sektorit publik. Në vijim paraqitet vlerësimi i raportit të SIGMA-s për KLSH-në.

KLSH është krijuar në bazë të Kushtetutës si një institucion i pavarur auditimi, e cila përcakton edhe rolin e tij në terma të gjerë. Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit përcakton më hollësisht pavarësinë funksionale, operacionale dhe financiare të KLSH-së dhe së bashku me Kushtetutën përcakton kuadrin ligjor për KLSH-në. Kuadri ligjor është në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI).

KLSH ka autoritetin për të audituar zbatimin e buxhetit dhe mbledhjen e të ardhurave, si dhe menaxhimin dhe mbrojtjen e fondeve publike dhe pronës publike ose shtetërore. Gjithashtu, KLSH ka të drejtë të auditojë, ndër të tjera, edhe përdoruesit e fondeve publike të siguruar nga Bashkimi Evropian ose organizata të tjera ndërkombëtare dhe grantet shtetërore për partitë politike. Mandati i auditimit është gjithëpërfshirës dhe rrallëherë kontestohet.

Figure 54. Perception of SSAI independence among civil servants, compared to the WB average



Notes: Percentages of valid responses to the question: "To what extent do you agree or disagree with the following statements?" "The SAI carries out its work and activities independently of the government". The percentage in the middle is the share respondents who answered "strongly agree" or "tend to agree".
Sources: SIGMA Survey of Public servants on public administration in the Western Balkans.

Sipas rezultateve të “Anketës SIGMA” të nëpunësve publikë për administratën publike në Ballkanin Perëndimor 2024, 70% e të anketuarve konsideruan se raportet e KLSH-së ishin të lehta për t’u kuptuar. Për më tepër, 69% deklaruan se raportet përmbajnë rekomandime relevante dhe të dobishme.

Rekomandimet e dhëna në raportet e auditimit përgjithësisht pranohen nga subjektet e audituara. Nga 4631 rekomandimet e dorëzuara në vitin 2022, 97% (4494) u pranuan nga subjektet e audituara. Kjo paraqet një përmirësim në krahasim me normën e pranimit të vitit 2021 prej 80%.



KLSH synon të angazhohet me palët e jashtme të interesit (publiku, shoqëria civile dhe partnerë ndërkombëtarë) në procesin e planifikimit vjetor dhe për raporte apo tema specifike të auditimit, dhe ka publikuar një Strategji për periudhën 2022-2025, për përmirësimin e komunikimit dhe rrjedhimisht besimit në KLSH.




5.5 PROGRAMI I TRANSPARENCËS DHE E DREJTA PËR INFORMIM

KLSH, në përmbushje të detyrimeve ligjore për transparencë dhe informim publik, garanton akses të plotë mbi veprimtarinë e saj duke publikuar raportet përfundimtare të auditimit, njoftimet për shtyp, si edhe çdo informacion tjetër të domosdoshëm. Në faqen zyrtare të KLSH-së është krijuar dhe përditësuar dritarja e dedikuar “*Të dhëna të hapura*” ku publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme dokumentet dhe informacionet përkatëse në format të hapur, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Përmes kësaj qasjeje, KLSH siguron që aktiviteti i institucionit të jetë i hapur, i kuptueshëm dhe i aksesueshëm për qytetarët, institucionet publike dhe palët e interesuara.

E drejta për informim është e garantuar nga Kushtetuta dhe e sanksionuar në ligjin “Për të drejtën e informimit”, si një e drejtë themelore për qytetarët, shoqërinë civile, median dhe aktorë të tjerë të shoqërisë demokratike. Në zbatim të këtij kuadri ligjor, KLSH trajton çdo vit një numër të konsiderueshëm kërkesash për informacion, duke ruajtur standarde të larta transparence. Në këtë kontekst, KLSH ka administruar dhe shqyrtuar **189** ankesa letra/ankesa nga individë dhe subjekte të ndryshme, ndër të cilat **11** kërkesa për informacion (6 përfaqësues të medias dhe 5 qytetarë). Pjesa më e madhe e ankesave kanë qenë të lidhura me çështje të Vetëqeverisjes Vendore dhe Pronës Publike, me rreth **90** ankesa të administruara.

Çdo kërkesë dhe ankesë është shqyrtuar me kujdes dhe ka marrë përgjigje, duke garantuar që qytetarët të pajisen me informacion të saktë dhe brenda afateve të përcaktuara.







06

Treguesit buxhetor dhe
financiarë të KLSH-së dhe
opinionit të auditit të
brendshëm

6.1 TREGUESIT BUXHETOR DHE FINANCIARË TË KLSH-SË

Politika buxhetore e KLSH-së është fokusuar në përmbushjen me cilësi të lartë dhe në kohë të detyrimeve ligjore, të objektivave, si dhe prioriteteve të institucionit të parashikuar në Planin e Zhvillimit Strategjik 2023-2027, duke konsideruar kërkesat e organizmave ndërkombëtarë të auditimit dhe të BE-së, të përcaktuara në MSA-në e Shqipëri-BE dhe të monitoruara në kuadrin e Integritimit Evropian.

Buxheti i akorduar për programin “Veprimtari audituese e KLSH-së” është hartuar në përputhje me Deklaratën e Politikës të përgatitur gjatë procesit të PBA 2025–2027.

Për vitin 2025, performanca e realizimit të buxhetit për Kontrollin e Lartë të Shtetit është mbështetur në Ligjin nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, dhe në vijim të udhëzimit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.07.2018, “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”.

Buxheti i akorduar për vitin 2025, në vlerën 694,000 mijë lekë është ndarë sipas zërave të mëposhtëm:

- Shpenzime për Paga dhe Sigurime në vlerën 598,100 mijë lekë
- Shpenzime për mallra dhe Shërbime në vlerën 80,900 mijë lekë
- Shpenzime Kapitale me Financim të Brendshëm në vlerën 15,000 mijë lekë

Ky buxhet është shtuar në zërin 606 “Ndihmë Financiare” në vlerën për 1,500 mijë lekë si dhe Grantin Kapital me Financim të Huaj, në vlerën 5,043 mijë lekë. Bazuar në nevojat për mjete financiare plani vjetor i buxhetit është rishpërndarë brenda zërave të shpenzimeve korente dhe kapitale. Fondet e alokuara dhe realizuara për funksionimin e aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, sipas zërave për vitin 2025, paraqiten si më poshtë:

Në mijë lekë

| Kap. | Artikulli | Pershkrimi | Kod Projekti | Fakti 2024 | Ligji i Buxhetit | Akt Normativ Tetor | Akt Normativ Dhjetor | Fakti 2025 | % |
|------|----------------|-------------------------|--------------|----------------|------------------|--------------------|----------------------|----------------|-------------|
| 01 | 600 | Paga | 92401AA | 456,121 | 531,300 | 486,300 | 480,300 | 475,960 | 99% |
| 01 | 601 | Sigurime | 92401AA | 69,813 | 66,800 | 76,800 | 73,800 | 71,704 | 97% |
| | 600-601 | | 0 | 525,934 | 598,100 | 563,100 | 554,100 | 547,664 | 99% |
| 01 | 602 | Mallra dhe shërbime | 92401AA | 71,082 | 80,700 | 85,700 | 72,700 | 69,339 | 95% |
| 01 | 605 | Transferta me jashtë | 92401AA | 292 | 200 | 200 | 200 | 100 | 50% |
| 1 | 606 | Transferta per individe | | 1,151 | 1,500 | 1,500 | 1,500 | 1,164 | 78% |
| | 602-605 | | 0 | 72,525 | 82,400 | 87,400 | 74,400 | 70,603 | 95% |
| 01 | 231 | Pajisje informatike | M240009 | 0 | 7,000 | 7,000 | 3,800 | 3,742 | 98% |
| 01 | 231 | Mjete transporti | M240002 | 4,920 | 3,000 | 3,870 | 3,470 | 3,420 | 99% |
| 01 | 231 | Rikonst ndërtesa | M240003 | 0 | 4,000 | 3,130 | 3,130 | 2,658 | 85% |
| 01 | 231 | Pajisje Zyre | M240010 | 1,522 | 1,000 | 1,000 | 550 | 529 | 96% |
| 01 | 230 | Kosto Lokale | | 2,190 | | | | | |
| 01 | 230 | TVSH | | 1,817 | | | | | |
| 01 | 230-231 | | | 10,449 | 15,000 | 15,000 | 10,950 | 10,349 | 95% |
| 02 | 231 | Grant i Huaj | | 2,908 | 273 | 273 | 273 | | |
| 02 | 230 | Financimi i Huaj | | 4,129 | | 4,770 | 4,770 | 4,770 | 100% |
| | | Totali | 0 | 615,945 | 695,773 | 670,543 | 644,493 | 633,386 | 98% |

Bazuar në Ligjin nr 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, i ndryshuar, fondi i alokuar për KLSH-në në vlerën 644,493 mijë lekë përfshirë dhe grantin e huaj, është realizuar në vlerën totale për 633,386 mijë lekë, ose në masën 98 %.

Realizimi sipas zërave kryesorë të shpenzimeve paraqitet si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit në masën 99 %
- Shpenzimet e tjera operative në masën 95 %



- Shpenzimet Kapitale ME Financim të Brendshme në masën 95 %
- Financimi i Huaj në masën 100 %.

Llogaria 600-601 “Shpenzime Personeli”

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2025 në zbatim të Ligjit nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, për zërin “Paga dhe Sigurime ” është në vlerën për 598,100 mijë lekë dhe numri i miratuar i punonjësve është 243 punonjës.

Përgjatë vitit 2025, ky buxhet është rialokuar në zërin mallra dhe shërbimë në vlerën 5,000 mijë lekë, si dhe është pakësuar me akte normative. Buxheti i planifikuar në masën për 554,100 mijë lekë është realizuar në vlerën 547,664 mijë lekë ose në masën 99 %. Krahasuar me buxhetin faktit të vitit 2024 në vlerën 525,934 mijë lekë, shpenzimet në këtë zë janë rreth 4% më shumë.

Llogaria 602 “Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera”

Fondi i alokuar për zërin shpenzime operative, është në vlerën 80,900 mijë lekë, ose 12 % e planit buxhetor të vitit 2025. Përgjatë vitit 2025, ky buxhet është rishpërndarë në zërin paga dhe sigurime në vlerën 5,000 mijë lekë, si dhe është pakësuar me akte normative. Buxheti i planifikuar në vlerën 72,900 mijë lekë është realizuar në vlerën 69,439 mijë lekë ose në masën 95 %. Krahasuar me buxhetin faktit të vitit 2024 në vlerën 71,374 mijë lekë, shpenzimet në këtë zë janë rreth 3% më pak.

Një pjesë të konsiderueshme në shpenzimet operative e zënë shpenzimet për udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit në vlerën 39,582 mijë lekë, të cilat përfaqësojnë 54% të shpenzimeve të planifikuara të zërit “Mallra dhe shërbime”. Në këtë zë janë mbuluar edhe nevojat administrative, si shpenzime për shërbimin e sigurisë, drita, ujë, telefon, kancelari, bateri për ups, shërbim printimi, mirëmbajtje automjetesh, etj.

Gjithashtu në këtë zë janë përfshirë edhe shpenzimet për kremtimin e 100 vjetorit të themelimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit – një institucion që për një shekull ka kontribuar në forcimin e kulturës së llogaridhënies dhe përmirësimin e qeverisjes në menaxhimin e financave publike. Ky përvjetor përfaqëson një moment historik jo vetëm për KLSH-në, por për gjithë zhvillimin institucional të Shqipërisë moderne. E themeluar në Maj 1925, në një etapë vendimtare për konsolidimin e shtetit shqiptar, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka qenë i pranishëm në çdo fazë të transformimit të administratës publike.

Aktualisht, për vitin 2025, KLSH , ka realizuar disa procedura prokurimi në lidhje me:

- Blerie licenca IT, me qëllim funksionimin optimal të pajisjeve të teknologjisë së informacionit, rritjen e sigurisë së rrjetit si dhe lehtësimin e punës së përdoruesve të infrastrukturës teknologjike të KLSH-së.
- Shërbim interneti për institucionin, mirëmbajtje ashensori, sistem alarmi, mirëmbajtje kondicionerësh, blerje kancelari, marteriale pastrimi dhe disinfektimi, mirëmbajtje automjete transporti, karburant, etj.

Llogaria 605 “Transferta korrente dhe të huaja”

Për periudhën raportuese 2025, janë shlyer detyrimet për kuota anëtarësimi për organizatat INTOSAI dhe EUROSAI, si dhe kuotat e pjesëmarrjes në aktivitetet ndërkombëtare në shumën 100 mijë lekë, nga 200 mijë lekë të planifikuara.

Llogaria 606 “Transferta për buxhetet familjare”

Gjatë periudhës ushtrimore 2025, është dhënë Fond i Veçantë nga Ministria e Financave në vlerën 1,500 mijë lekë, për daljen e punonjësve në pension, rast fatkeqësie dhe sëmundjeje, vlerë e cila përgjatë kësaj periudhe është realizuar në vlerën 1,163 mijë lekë, ose në masën 78 %.



Llogaria 230-231 “Shpenzime për investime kapitale”

- Shpenzime Kapitale me Financim të Brendshëm

Bazuar në Ligjin nr. 115/2025, “Për buxhetin e vitit 2025”, plani i buxhetit me destinacion Investimet Kapitale është në shumën 15,000 mijë lekë, me financim të frendshëm.

Përgjatë vitit 2025, ky buxhet është pakësuar me akt normativ në vlerën 4,050 mijë lekë. Buxheti i planifikuar në vlerën 10,950 mijë lekë është realizuar në vlerën 10,349 mijë lekë, ose në masën 95%.

Fondet e alokuara dhe realizuara, sipas projekteve paraqiten si më poshtë:

| Përshkrimi | Kodi | Ligji i Buxhetit | AN Nr. 11 | Në mijë lekë | |
|-----------------------|---------|------------------|---------------|---------------|------------|
| | | | | Realizimi | % |
| Paisje kompjuterike | M240009 | 7,000 | 3,800 | 3,742 | 98% |
| Automjete | M240002 | 3,870 | 3,470 | 3,420 | 99% |
| Rikonstruksion godine | M240003 | 3,130 | 3,130 | 2,658 | 85% |
| Paisje Zyre | M240010 | 1,000 | 550 | 529 | 96% |
| | | 15,000 | 10,950 | 10,349 | 95% |

Për vitin 2025, KLSH ka realizuar procedurat e prokurimit për blerje automjeti, blerje paisje informatike, rikonstruksionin e godinës dhe blerje paisje zyre. Adresimi i fondeve të investimeve në këto projekte investimi ka ardhur si domosdoshmëri me qëllim vijim normal të aktivitetit auditues të KLSH-së.

Plani i buxhetit në zërin “Blerje automjeti”, në vlerën 3,470 mijë lekë, është realizuar në vlerën 3,420 mijë lekë ose në masën 99%.

Plani i buxhetit në zërin “Blerje pajisje informatike”, kompjuter, laptop, në funksion të veprimtarisë audituese, në vlerën 3,800 mijë lekë është realizuar në vlerën 3,742 mijë lekë, ose në masën 98 %.

Plani i buxhetit në zërin “Rikonstruksion ndërtesa”, në vlerën 3,130 mijë lekë është realizuar në vlerën 2,658 mijë lekë. Alokimi i këtyre fondeve ka ardhur si domosdoshmëri e plotësimit të kushteve të punës, si dhe rikonstruksionin e ambienteve të parkut të automjeteve pranë rrugës Don Bosko, me qëllim shfrytëzimin e hapësirave dhe transformimin e garazheve ekzistuese në magazina të KLSH-së.

Plani i buxhetit në zërin “Blerje pajisje zyre”, bazuar në një rivlerësim të gjendjes së pajisjeve të zyrave (karrike) në vlerën për 550 mijë lekë, është realizuar në vlerën 529 mijë lekë ose në masën 95 %.

- Shpenzime Kapitale me Financim të Huaj

Gjatë vitit 2025, është kryer likuidimi i këstit të fundit për projektin “Forcimi i Mbikëqyrjes së Auditimit të Jashtëm për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat në Shqipëri” duke përdorur fondet e trashëguara nga projekti, financuar nga Sekretariati Shtetëror i Zvicrës për Çështjet Ekonomike (SECO) dhe i zyrtarizuar me Marrëveshjen nr. 307, datë 09.03.2020, ndërsa nuk janë alokuar investime shtesë për Investimet Kapitale me Financim të Huaj në vitin 2025.



6.2 OPINIONI I AUDITIT TË BRENDSHËM MBI PASQYRAT FINANCIARE 2025

Bazuar në planin vjetor të auditimit, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka kryer misionin e auditimit “Mbi auditimin e sistemeve dhe përputhshmërisë në Sektorin e Financës” mbi pasqyrat financiare të vitit 2025, ku është dhënë opinionin i auditimit si vijon:

“Ne kemi audituar pasqyrat financiare të institucionit për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2025, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar në datën 31 dhjetor 2025, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e flukseve monetare, pasqyrën e ndryshimeve në aktivitet neto/fondet neto, si dhe shënimet shpjeguese përkatëse që shoqërojnë pasqyrat financiare vjetore.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të institucionit më 31 dhjetor 2025, si dhe performancën e tij financiare dhe flukset monetare për periudhën e mbyllur në këtë datë, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi për raportimin financiar në sektorin publik.”.

Auditimi është kryer në përputhje me Ligjin nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” të ndryshuar, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar e Kontrollin” të ndryshuar, Urdhërin e Ministrit të Financave nr.134 datë 17.10.2025 “Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik” etj.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të Udhëzimit të MFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 127, datë 19.12.2025 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit të vitit 2025”. Qëllimi i auditimit është të ndihmojë institucionin dhe të japë siguri, në arritjen e objektivave nëpërmjet një veprimtarie në përputhje me kërkesat ligjore, standardet dhe rregulloret në fuqi, duke identifikuar aktivitetet me risk dhe efektivitetin e sistemeve të kontrollit. Nëpërmjet auditimit është synuar vlerësimi i përgjithshëm mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe dhënia e një opinionin mbi zbatimin e buxhetit për vitin 2025, ku ka rezultuar se menaxhimi financiar dhe kontrolli në përgjithësi dëshmojnë një proces funksional e efektiv, që ofron siguri në zbatimin e legjislationit dhe proceseve tjera të kontrollit. Nga auditimi është konstatuar se proceset dhe transaksionet janë kryer në përputhje me kriteret e përcaktuara nga kuadri ligjor në fuqi.





07

Anekse

ANEKSE

ANEKSI 1: Auditimet/ Temat e realizuara nga KLSH, për periudhën Janar – Dhjetor 2025

| Nr. | Subjekti/Tema |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Departamenti i Auditimit të Institucioneve të Sigurisë, Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja | |
| 1 | “Përmirësimi i sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit”, në KESH |
| 2 | Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes |
| 3 | Agjencia e Mbikëqyrjes Policore |
| 4 | Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve |
| 5 | Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve për Programin Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësjetës-Kanalizimeve në Shqipëri |
| 6 | AlbaFilm SHA |
| 7 | Auditim tematik "Për verifikimin e shkaqeve, pasojave dhe reagimit të institucioneve, lidhur me situatën e krijuar nga përmytjet masive në qytetin e Vlorës", për një periudhë të pacaktuar |
| 8 | Autoriteti i Aviacionit Civil |
| 9 | Autoriteti Kombëtar i Ushqimit |
| 10 | Autoriteti Portual Durrës |
| 11 | Drejtorja e Përgjithshme Detare Durrës |
| 12 | Drejtorja e Ujitjes dhe Kullimit Fier |
| 13 | Drejtorja e Ujitjes dhe Kullimit Korçë |
| 14 | Drejtorja e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë |
| 15 | Drejtorja Vendore të Policisë Shkodër |
| 16 | Enti Kombëtar i Banesave |
| 17 | Fuqia energjetike dhe siguria e digës në kaskadën e Drinit”, në KESH |
| 18 | Mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në subjektin “Albgaz” sha. |
| 19 | Mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në subjektin “Shoqëria Rajonale Ujësjetës Kanalizime Vlorë” sha. |
| 20 | Mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në subjektin “Universiteti i Mjekësisë” |
| 21 | Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike |
| 22 | Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Drejtorja Rajonale Durrës |
| 23 | Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Drejtorja Rajonale Shkodër |
| 24 | Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Drejtorja Rajonale Tiranë |
| 25 | Projekti: “Infrastruktura Bashkiake V” |
| 26 | Rezidenca Studentore Universitare Nr. 2, SHA |
| 27 | Shoqëria Rajonale e Ujësjetës Kanalizime, Lezhë SHA |
| 28 | Shoqëria Rajonale Ujësjetës Kanalizime, Elbasan SHA |
| 29 | Spitali Rajonal Shkodër |
| 30 | Spitali Rajonal Vlorë |
| 31 | Termocentrali i Vlorës SHA |
| 32 | Trajtimi i Studentëve Elbasan SHA |
| 33 | Trajtimi i Studentëve Gjirokastër SHA |
| 34 | Trajtimi i Studentëve Korçë SHA |
| 35 | Trajtimi i Studentëve Shkodër SHA |
| 36 | Trajtimi i Studentëve Vlorë SHA |
| 37 | Zbatimi i rekomandimeve të auditimeve, (6 mujori I-II) |
| Departamenti i Auditimit IT | |
| 38 | Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara |
| 39 | Agjencia Kombëtare e Diasporës |
| 40 | Drejtorja Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë |
| 41 | Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër |
| 42 | Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë |



| | |
|--------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 43 | Qendra e Arsimit Bashkia Lushnje |
| 44 | Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët |
| 45 | Qendra Kombëtare e Kinematografisë |
| 46 | Siguria kibernetike në infrastrukturën kritike e-Taxation |
| 47 | Universiteti i Sporteve të Tiranës |
| 48 | Zbatimi i Rekomandimeve të auditimeve, (6 mujori I) – IT |
| 49 | Zbatimi i rekomandimeve të auditimeve, (6 mujori II) – IT |
| 50 | Zyra Rajonale Statistikore Fier |
| Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit | |
| 51 | “Mbi auditimin e procedurave të dhënies së lejeve, licencave dhe monitorimin e aktivitetit minerar me vendndodhje në Rasek, Shkodër”. |
| 52 | “Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbimet publike të standardit të lartë nëpërmjet operacionit Govtech” |
| 53 | Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive |
| 54 | Agjencia Kombëtare të Bregdetit |
| 55 | Zbatimi i Rekomandimeve të auditimeve të kryera në institucionet qendrore (6 mujori I) |
| 56 | Auditim tematik në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve mbi çështjet e trajtuara në ankesën e federatës shqiptare "Kick Boxing" |
| 57 | Zbatimi i Rekomandimeve të auditimeve (6 mujori I) |
| 58 | Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit |
| 59 | Avokati i Popullit |
| 60 | Avokatura e Shtetit |
| 61 | Cirku i Tiranës |
| 62 | Dega Doganore Durrës |
| 63 | Dega Doganore Rinas |
| 64 | Disponibiliteti i barnave në trajtimin e sëmundjeve tumorale |
| 65 | Drejtoria e Përgjithshëm e Doganave (pjesa I) |
| 66 | Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (pjesa II) |
| 67 | Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Publike |
| 68 | Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve |
| 69 | Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës |
| 70 | Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan |
| 71 | Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor |
| 72 | Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë |
| 73 | Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm |
| 74 | Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave |
| 75 | Instituti i Sigurimeve Shoqërore |
| 76 | Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë |
| 77 | Kolegji i Posaçëm i Apelit |
| 78 | Korporata e Investimeve Shqiptare |
| 79 | Mbi ecurinë, performancën dhe efektivitetin e masave të marra në lidhje me borxhin doganor |
| 80 | Mbi ofrimin e shërbimit të ushqimit në Spitalin Rajonal Korçë |
| 81 | Mbi përputhshmërinë e monitorimit të HEC “Sasaj” Sarandë |
| 82 | Mbi përputhshmërinë në ofrimin e shërbimit rezidencial dhe procedurat për birësimin e të miturve |
| 83 | Mbi vlerësimin e ecurisë, performancës dhe efektivitetit të masave të marra në lidhje me borxhin tatimor |
| 84 | Ministria e Arsimit dhe Sportit |
| 85 | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural |
| 86 | Ministria e Financave (Aparati) |
| 87 | Ministria e Financave mbi Zbatimin e Buxhetit |
| 88 | Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale |
| 89 | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit |
| 90 | Qendrën Burimore “Ramazan Kabashi” |



| | |
|------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------|
| 91 | Rektorati (Universiteti i Tiranës) |
| 92 | Shkolla e Magjistraturës |
| 93 | Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër |
| 94 | Universiteti i Tiranës : Fakulteti i Ekonomisë |
| 95 | Universiteti i Tiranës : Fakulteti i Gjuhëve të Huaja |
| 96 | Zbatimi i Rekomandimeve të auditimeve, (6 mujori I) |
| Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore dhe Pronës Publike | |
| 97 | “Mbi verifikimin e situatës pas rrëshqitjeve në rrugën Matogjin - Bashaj” |
| 98 | Agjencia Shtetërore për Shpronësim Tiranë |
| 99 | Bashkia Belsh |
| 100 | Bashkia Berat |
| 101 | Auditim i pasqyrave financiare, Bashkia Berat |
| 102 | Bashkia Bulqizë |
| 103 | Bashkia Cërrik |
| 104 | Bashkia Delvinë |
| 105 | Bashkia Devoll |
| 106 | Bashkia Dibër |
| 107 | Bashkia Dimal |
| 108 | Auditim i pasqyrave financiare, Bashkia Dimal |
| 109 | Bashkia Divjakë |
| 110 | Bashkia Dropull |
| 111 | Bashkia Durrës |
| 112 | Bashkia Elbasan |
| 113 | Auditim i pasqyrave financiare, Bashkia Elbasan |
| 114 | Bashkia Fier |
| 115 | Auditim i pasqyrave financiare, Bashkia Fier |
| 116 | Bashkia Finiq |
| 117 | Bashkia Fushë Arrëz |
| 118 | Bashkia Gjirokastrë |
| 119 | Bashkia Gramsh |
| 120 | Bashkia Has |
| 121 | Bashkia Kamëz |
| 122 | Bashkia Kavajë |
| 123 | Bashkia Këlcyrë |
| 124 | Bashkia Klos |
| 125 | Bashkia Kolonjë |
| 126 | Bashkia Konispol |
| 127 | Bashkia Korçë |
| 128 | Auditim i pasqyrave financiare, Bashkia Korçë |
| 129 | Bashkia Krujë |
| 130 | Bashkia Kuçovë |
| 131 | Bashkia Kukës |
| 132 | Bashkia Kurbin |
| 133 | Bashkia Lezhë |
| 134 | Bashkia Libohovë |
| 135 | Bashkia Librazhd |
| 136 | Bashkia Lushnjë |
| 137 | Auditim i pasqyrave financiare, Bashkia Lushnjë |
| 138 | Bashkia Malësi e Madhe |
| 139 | Bashkia Maliq |
| 140 | Auditim i pasqyrave financiare, Bashkia Maliq |
| 141 | Bashkia Mallakastër |
| 142 | Bashkia Mat |
| 143 | Bashkia Memaliaj |



| | |
|-------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 144 | Bashkia Mirditë |
| 145 | Bashkia Patos |
| 146 | Bashkia Përmet |
| 147 | Bashkia Pogradec |
| 148 | Bashkia Poliçan |
| 149 | Bashkia Prrenjas |
| 150 | Bashkia Pukë |
| 151 | Bashkia Pustec |
| 152 | Bashkia Roskovec |
| 153 | Bashkia Rogozhinë |
| 154 | Bashkia Sarandë |
| 155 | Auditim i pasqyrave financiare, Bashkia Sarandë |
| 156 | Bashkia Selenicë |
| 157 | Auditim i pasqyrave financiare, Bashkia Selenicë |
| 158 | Bashkia Shijak |
| 159 | Bashkia Shkodër |
| 160 | Bashkia Skrapar |
| 161 | Auditim i pasqyrave financiare, Bashkia Skrapar |
| 162 | Bashkia Tepelenë |
| 163 | Auditim i pasqyrave financiare, Bashkia Tropojë |
| 164 | Bashkia Tropojë |
| 165 | Bashkia Vau i Dejës |
| 166 | Bashkia Vlorë |
| 167 | Bashkia Vorë |
| 168 | Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit |
| 169 | Zbatimi i Rekomandimeve të auditimeve, (6 mujori I) |
| 170 | Verifikim i ankesës së banorëve të fshatit Piskovë në lidhje me vend depozitimin e mbetjeve urbane |
| 171 | Zbatimi i Rekomandimeve të auditimeve, (6 mujori II) |
| 172 | Zbatim Rekomandime të auditimeve për ASHK |
| Departamenti i Auditimit të Performancës | |
| 173 | Cilësia dhe certifikimi i ujit të pijshëm që hidhet në treg për qytetarin |
| 174 | Kujdesi komunitar për të moshuarit dhe decentralizimi i shërbimit |
| 175 | Planet gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe aspektet buxhetore për një popullsi në moshim |
| 176 | Roli dhe përgjegjësitë për monitorimin e mirëqenies së fëmijëve të birësuar |
| 177 | Shërbimi psiko - social në sistemin arsimor parauniversitar |
| 178 | Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura Tiranë, në Administratën e Zonave të Mbrojtura AdZM Kukës, AdZM Berat dhe AdZM Vlorë |
| 179 | Aksesueshmëria për personat me aftësi të kufizuar |
| 180 | Blerjet online në Shqipëri, taksat dhe shërbimi ndaj qytetarit |
| 181 | Cilësia e ujërave në plazhe |
| 182 | Masat e ndërmarra nga institucionet përgjegjëse për eliminimin e derdhjes së ujërave të përdorura në Lumin e Lanës në Tiranë |
| 183 | Mbrojtja dhe Siguria e Digave |
| 184 | Ndikimi në mjedis dhe shëndet i aktivitetit të shfrytëzimit të naftës dhe gazit në zonën Patos - Marinëz |
| 185 | Ndotja e Liqenit Artificial të Tiranës |
| 186 | Roli dhe efektiviteti i oficerëve të sigurisë në shkolla |
| 187 | Trajtimi, rehabilitimi dhe ri-integrimi i personave të dënuar |
| 188 | Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë, në institucionet e mjedisit, evaduar në vitin 2023 |
| 189 | Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës (6 mujori II) |
| 190 | Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës (6 mujori I) |



ANEKSI 2: Masat e rekomanduara për ndryshime dhe përmirësimet ligjore

| Nr. | Subjekti/Tema | Nr. Masave |
|-----|-----------------------------------------------------------------------------|------------|
| 1 | Roli dhe përgjegjësitë për monitorimin e mirëqenies së fëmijëve të birësuar | 1 |
| 2 | Shërbimi psiko - social në sistemin arsimor parauniversitar | 2 |
| 3 | Agjencia e Mbikëqyrjes Policore | 1 |
| 4 | Agjencia Shtetërore për Shpronësim Tiranë | 1 |
| 5 | Blerjet online në Shqipëri, taksat dhe shërbimi ndaj qytetarit | 5 |
| 6 | Cilësia dhe certifikimi i ujit të pijshëm që hidhet në treg për qytetarin | 2 |
| 7 | Cilësia e ujërave në plazhe | 3 |
| 8 | Disponibiliteti i barnave në trajtimin e sëmundjeve tumorale | 1 |
| 9 | Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Publike | 2 |
| 10 | Drejtoria Vendore të Policisë Shkodër | 1 |
| 11 | Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit | 1 |
| 12 | Mbrojtja dhe Siguria e Digave | 2 |
| 13 | Roli dhe efektiviteti i oficerëve të sigurisë në shkolla | 2 |
| 14 | Siguria kibernetike në infrastrukturën kritike e - Taxation | 2 |
| 15 | Trajtimi, rehabilitimi dhe ri-integrimi i personave të dënuar | 3 |
| | Total | 29 |

ANEKSI 3: Masat e organizative të rekomanduara

| Nr. | Subjekti/Tema | Nr. Masave |
|-----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| 1 | "Kujdesi komunitar për të moshuarit dhe decentralizimi i shërbimit" | 21 |
| 2 | "Mbi auditimin e procedurave të dhënies së lejeve, licencave dhe monitorimin e aktivitetit minerar me vendndodhje në Rasek, Shkodër". | 16 |
| 3 | "Mbi verifikimin e situatës pas rrëshqitjeve në rrugën Matogjin-Bashaj" | 5 |
| 4 | "Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbimet publike të standardit të lartë nëpërmjet operacionit Govtech" | 1 |
| 5 | "Përmirësimi i sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit", në KESH | 5 |
| 6 | "Planet gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe aspektet buxhetore për një popullsi në moshim" | 12 |
| 7 | "Roli dhe përgjegjësitë për monitorimin e mirëqenies së fëmijëve të birësuar" | 17 |
| 8 | "Shërbimi psiko - social në sistemin arsimor parauniversitar" | 14 |
| 9 | "Verifikimin e shkaqeve, pasojave dhe reagimit të institucioneve, lidhur me situatën e krijuar nga përmbytjet masive në qytetin e Vlorës" | 23 |
| 10 | Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara | 8 |
| 11 | Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes | 10 |
| 12 | Agjencia e Mbikëqyrjes Policore | 19 |
| 13 | Agjencia Kombëtare e Diasporës | 7 |
| 14 | Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive | 20 |
| 15 | Agjencia Kombëtare e Ujësllës Kanalizimeve | 25 |
| 16 | Agjencia Kombëtare e Ujësllës Kanalizimeve për Programin Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësllës - Kanalizimeve në Shqipëri | 6 |
| 17 | Agjencia Kombëtare të Bregdetit | 10 |
| 18 | Agjencia Kombëtare të Zonave të Mbrojtura Tiranë, në Administratën e Zonave të Mbrojtura AdZM Kukës, AdZM Berat dhe AdZM Vlorë | 15 |
| 19 | Agjencia Shtetërore për Shpronësim Tiranë | 37 |
| 20 | Aksesueshmëria për Personat me Aftësi të Kufizuar | 19 |
| 21 | AlbaFilm SHA | 6 |
| 22 | Auditim tematik në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve mbi çështjet e trajtuara në ankesën e federatës shqiptare "Kick Boxing" | 3 |
| 23 | Autoriteti i Aviacionit Civil | 18 |



| | | |
|----|-------------------------------------------------------------------|----|
| 24 | Autoriteti Kombëtar i Ushqimit | 50 |
| 25 | Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit | 29 |
| 26 | Autoriteti Portual Durrës | 45 |
| 27 | Avokati i Popullit | 23 |
| 28 | Avokatura e Shtetit | 19 |
| 29 | Bashkia Belsh | 29 |
| 30 | Bashkia Berat | 22 |
| 31 | Pasqyrat financiare, Bashkia Berat | 20 |
| 32 | Bashkia Bulqizë | 12 |
| 33 | Bashkia Cërrik | 14 |
| 34 | Bashkia Delvinë | 8 |
| 35 | Bashkia Devoll | 13 |
| 36 | Bashkia Dibër | 44 |
| 37 | Bashkia Dimal | 20 |
| 38 | Pasqyrat financiare, Bashkia Dimal | 18 |
| 39 | Bashkia Divjakë | 17 |
| 40 | Bashkia Dropull | 15 |
| 41 | Bashkia Durrës | 38 |
| 42 | Bashkia Elbasan | 23 |
| 43 | Pasqyrat financiare, Bashkia Elbasan | 19 |
| 44 | Bashkia Fier | 52 |
| 45 | Pasqyrat financiare, Bashkia Fier | 12 |
| 46 | Bashkia Finiq | 16 |
| 47 | Bashkia Fushë Arrëz | 10 |
| 48 | Bashkia Gjirokastër | 18 |
| 49 | Bashkia Gramsh | 34 |
| 50 | Bashkia Has | 10 |
| 51 | Bashkia Kamëz | 6 |
| 52 | Bashkia Kavajë | 23 |
| 53 | Bashkia Këlcyrë | 29 |
| 54 | Bashkia Klos | 11 |
| 55 | Bashkia Kolonjë | 34 |
| 56 | Bashkia Konispol | 45 |
| 57 | Bashkia Korçë | 22 |
| 58 | Pasqyrat financiare, Bashkia Korçë | 12 |
| 59 | Bashkia Krujë | 14 |
| 60 | Bashkia Kuçovë | 36 |
| 61 | Bashkia Kukës | 10 |
| 62 | Bashkia Kurbin | 10 |
| 63 | Bashkia Lezhë | 13 |
| 64 | Bashkia Libohovë | 17 |
| 65 | Bashkia Librazhd | 25 |
| 66 | Bashkia Lushnje | 34 |
| 67 | Pasqyrat financiare, Bashkia Lushnje | 14 |
| 68 | Bashkia Malësi e Madhe | 15 |
| 69 | Bashkia Maliq | 25 |
| 70 | Pasqyrat financiare, Bashkia Maliq | 9 |
| 71 | Bashkia Mallakastër | 21 |
| 72 | Bashkia Mat | 10 |
| 73 | Bashkia Memaliaj | 23 |
| 74 | Bashkia Mirditë | 11 |
| 75 | Bashkia Patos | 10 |
| 76 | Bashkia Përmet | 24 |
| 77 | Bashkia Pogradec | 16 |



| | | |
|-----|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 78 | Bashkia Poliçan | 14 |
| 79 | Bashkia Prrenjas | 11 |
| 80 | Bashkia Pukë | 10 |
| 81 | Bashkia Pustec | 7 |
| 82 | Bashkia Roskovec | 21 |
| 83 | Bashkia Rrogozhinë | 18 |
| 84 | Bashkia Sarandë | 48 |
| 85 | Pasqyrat financiare, Bashkia Sarandë | 5 |
| 86 | Bashkia Selenicë | 16 |
| 87 | Pasqyrat financiare, Bashkia Selenicë | 10 |
| 88 | Bashkia Shijak | 11 |
| 89 | Bashkia Shkodër | 9 |
| 90 | Bashkia Skrapar | 19 |
| 91 | Pasqyrat financiare, Bashkia Skrapar | 21 |
| 92 | Bashkia Tepelenë | 16 |
| 93 | Pasqyrat financiare, Bashkia Tropojë | 16 |
| 94 | Bashkia Tropojë | 17 |
| 95 | Bashkia Vau i Dejës | 23 |
| 96 | Bashkia Vlorë | 40 |
| 97 | Bashkia Vorë | 7 |
| 98 | Blerjet online në Shqipëri, taksat dhe shërbimi ndaj qytetarit | 15 |
| 99 | Cilësia dhe certifikimi i ujit të pijshëm që hidhet në treg për qytetarin | 26 |
| 100 | Cilësia e ujërave në plazhe | 24 |
| 101 | Cirku i Tiranës | 18 |
| 102 | Dega Doganore Durrës | 25 |
| 103 | Dega Doganore Rinas | 8 |
| 104 | Disponibiliteti i barnave në trajtimin e sëmundjeve tumorale | 32 |
| 105 | Drejtoria e Përgjithshëm e Doganave (Auditim përputhshmërie) | 4 |
| 106 | Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës | 6 |
| 107 | Drejtoria e Përgjithshme e Doganave | 26 |
| 108 | Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Publike | 26 |
| 109 | Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve | 37 |
| 110 | Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier | 17 |
| 111 | Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Korçë | 16 |
| 112 | Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë | 17 |
| 113 | Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Lezhë | 9 |
| 114 | Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës | 19 |
| 115 | Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan | 18 |
| 116 | Drejtoria Vendore të Policisë Shkodër | 32 |
| 117 | Enti Kombëtar i Banesave | 10 |
| 118 | Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor | 72 |
| 119 | Fuqia energjetike dhe siguria e digës në kaskadën e Drinit”, në KESH | 7 |
| 120 | Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër | 15 |
| 121 | Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë | 4 |
| 122 | Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm | 10 |
| 123 | Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave | 11 |
| 124 | Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit | 30 |
| 125 | Instituti i Sigurimeve Shoqërore | 26 |
| 126 | Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë | 18 |
| 127 | Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë | 10 |
| 128 | Kolegji i Posaçëm i Apelit | 3 |
| 129 | Korporata e Investimeve Shqiptare | 22 |
| 130 | Masat e ndërmarra nga institucionet përgjegjëse për eliminimin e derdhjes së ujërave të përdorura në Lumin e Lanës në Tiranë | 14 |



| | | |
|-----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
| 131 | Mbi ecurinë, performancën dhe efektivitetin e masave të marra në lidhje me borxhin doganor | 28 |
| 132 | Mbi ofrimin e shërbimit të ushqimit në Spitalin Rajonal Korçë | 15 |
| 133 | Mbi Përputhshmërinë e monitorimit të HEC "Sasaj" Sarandë | 10 |
| 134 | Mbi përputhshmërinë në ofrimin e shërbimit rezidencial dhe procedurat për birësimin e të miturve | 20 |
| 135 | Mbi vlerësimin e ecurisë, performancës dhe efektivitetit të masave të marra në lidhje me borxhin tatimor | 14 |
| 136 | Mbrojtja dhe Siguria e Digave | 20 |
| 137 | Ministria e Arsimit dhe Sportit | 19 |
| 138 | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural | 44 |
| 139 | Ministria e Financave (Aparati) | 24 |
| 140 | Ministria e Financave mbi Zbatimin e Buxhetit | 74 |
| 141 | Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale | 24 |
| 142 | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit | 11 |
| 143 | Ndikimi në mjedis dhe shëndet i aktivitetit të shfrytëzimit të naftës dhe gazit në zonën Patos - Marinëz | 18 |
| 144 | Ndotja e Liqenit Artificial të Tiranës | 8 |
| 145 | Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike | 45 |
| 146 | Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Drejtoria Rajonale Durrës | 18 |
| 147 | Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Drejtoria Rajonale Shkodër | 23 |
| 148 | Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Drejtoria Rajonale Tiranë | 15 |
| 149 | Projekti: "Infrastruktura Bashkiake V" | 8 |
| 150 | Qendra e Arsimit Bashkia Lushnje | 10 |
| 151 | Qendra Kombëtare e Kinematografisë | 13 |
| 152 | Qendrën Burimore "Ramazan Kabashi" | 17 |
| 153 | Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët | 7 |
| 154 | Rektorati (Universiteti i Tiranës) | 11 |
| 155 | Rezidenca Studentore Universitare Nr. 2, SHA | 20 |
| 156 | Roli dhe efektiviteti i oficerëve të sigurisë në shkolla | 16 |
| 157 | Shkolla e Magjistraturës | 17 |
| 158 | Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Lezhë SHA | 20 |
| 159 | Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime, Elbasan SHA | 18 |
| 160 | Siguria kibernetike në infrastrukturën kritike e - Taxation | 9 |
| 161 | Spitali Rajonal Shkodër | 23 |
| 162 | Spitali Rajonal Vlorë | 28 |
| 163 | Termocentrali i Vlorës SHA | 24 |
| 164 | Trajtimi i Studentëve Elbasan SHA | 13 |
| 165 | Trajtimi i Studentëve Gjirokastër SHA | 12 |
| 166 | Trajtimi i Studentëve Korçë SHA | 10 |
| 167 | Trajtimi i Studentëve Shkodër SHA | 11 |
| 168 | Trajtimi i Studentëve Vlorë SHA | 7 |
| 169 | Trajtimi, rehabilitimi dhe ri-integrimi i personave të dënuar | 30 |
| 170 | Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër | 32 |
| 171 | Universiteti i Sporteve të Tiranës | 16 |
| 172 | Universiteti i Tiranës: Fakulteti i Gjuhëve të Huaja | 7 |
| 173 | Universiteti i Tiranës: Fakulteti i Ekonomisë | 12 |
| 174 | Verifikimi i ankesës së banorëve të fshatit Piskovë në lidhje me vend depozitimin e mbetjeve urbane | 9 |
| 175 | Zyra Rajonale Statistike Fier | 6 |
| | Total | 3268 |



ANEKSI 4: Evidenca përmblledhëse e masave të rekomanduara për dëmin ekonomik të konstatuar

Në 000 lekë

| Nr. | Subjekti/Tema | Në Shpenzime | Të Ardhura | Total |
|-----|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------|------------|---------|
| 1 | Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve | 24,337 | | 24,337 |
| 2 | Agjencia Kombëtare të Bregdetit | 19,319 | | 19,319 |
| 3 | Agjencia Kombëtare të Zonave të Mbrojtura Tiranë, në Administratën e Zonave të Mbrojtura AdZM Kukës, AdZM Berat dhe AdZM Vlorë | 3,501 | 1,472 | 4,973 |
| 4 | Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit | 2,264 | | 2,264 |
| 5 | Autoriteti Portual Durrës | 76,061 | | 76,061 |
| 6 | Avokatura e Shtetit | 83 | | 83 |
| 7 | Bashkia Belsh | 16,497 | | 16,497 |
| 8 | Bashkia Berat | 3,895 | | 3,895 |
| 9 | Bashkia Dibër | 13,148 | | 13,148 |
| 10 | Bashkia Dimal | 3,803 | | 3,803 |
| 11 | Bashkia Dropull | 785 | | 785 |
| 12 | Bashkia Elbasan | 990 | | 990 |
| 13 | Bashkia Fier | 10,796 | | 10,796 |
| 14 | Bashkia Gjirokastrë | 594 | | 594 |
| 15 | Bashkia Gramsh | 8,816 | | 8,816 |
| 16 | Bashkia Konispol | 1,326 | | 1,326 |
| 17 | Bashkia Korçë | 5,198 | | 5,198 |
| 18 | Bashkia Kuçovë | 1,463 | | 1,463 |
| 19 | Bashkia Librazhd | 1,164 | | 1,164 |
| 20 | Bashkia Lushnje | 6,871 | | 6,871 |
| 21 | Bashkia Mallakastër | 2,521 | | 2,521 |
| 22 | Bashkia Përmet | 2,640 | | 2,640 |
| 23 | Bashkia Sarandë | 9,928 | | 9,928 |
| 24 | Bashkia Selenicë | 2,341 | 314 | 2,655 |
| 25 | Bashkia Skrapar | 1,112 | | 1,112 |
| 26 | Bashkia Tropojë | 5,584 | | 5,584 |
| 27 | Bashkia Vlorë | 6,002 | 742 | 6,744 |
| 28 | Dega Doganore Durrës | | 831,181 | 831,181 |
| 29 | Dega Doganore Rinas | | 46,746 | 46,746 |
| 30 | Drejtoria e Përgjithshëm e Doganave (pjesa II) | | 363,801 | 363,801 |
| 31 | Drejtoria e Përgjithshme e Doganave | | 1,884 | 1,884 |
| 32 | Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier | 1,161 | | 1,161 |
| 33 | Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Korçë | 1,975 | | 1,975 |
| 34 | Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë | 1,546 | | 1,546 |
| 35 | Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor | | 48,166 | 48,166 |
| 36 | Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë | 7,465 | | 7,465 |
| 37 | Mbi ofrimin e shërbimit të ushqimit në Spitalin Rajonal Korçë | 118 | | 118 |
| 38 | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural | 19,053 | | 19,053 |
| 39 | Ministria e Financave (aparati) | 8,924 | | 8,924 |
| 40 | Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale | 5,019 | | 5,019 |
| 41 | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit | 1,852 | | 1,852 |
| 42 | Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike | 7,200 | | 7,200 |
| 43 | Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Drejtoria Rajonale Durrës | 704 | | 704 |
| 44 | Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Drejtoria Rajonale Shkodër | 2,173 | | 2,173 |



| | | | | |
|----|-----------------------------------------------------------------|----------------|------------------|------------------|
| 45 | Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Drejtoria Rajonale Tiranë | 3,519 | | 3,519 |
| 46 | Shoqëria Rajonale e Ujësllës Kanalizime Lezhë SHA | 335 | | 335 |
| 47 | Shoqëria Rajonale Ujësllës Kanalizime, Elbasan SHA | 756 | | 756 |
| 48 | Spitali Rajonal Shkodër | 1,093 | | 1,093 |
| 49 | Termocentrali i Vlorës SHA | 409 | | 409 |
| 50 | Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër | 4,451 | | 4,451 |
| | Total | 298,788 | 1,294,305 | 1,593,093 |

ANEKSI 5: Evidenca e pasqyrimt të parregullsive të dispozitave ligjore në fuqi, për të ardhura të munguara ose shpenzime jo në përputhje me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit, të cila kanë sjell efekt negativ financiar në të ardhurat e subjekteve dhe buxhetin e shtetit

Në 000 lekë

| Nr. | Subjekti/Tema | Në Shpenzime | Të Ardhura | Total |
|-----|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------|------------|-----------|
| 1 | "Përmirësimi i sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit", në KESH | 31,077 | | 31,077 |
| 2 | Agjencia e Mbikëqyrjes Policore | 14,001 | | 14,001 |
| 3 | Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive | 8,167 | | 8,167 |
| 4 | Agjencia Kombëtare e Ujësllës Kanalizimeve | 231,813 | | 231,813 |
| 5 | Agjencia Kombëtare të Bregdetit | 9,037 | 4,960 | 13,997 |
| 6 | Agjencia Kombëtare të Zonave të Mbrojtura Tiranë, në Administratën e Zonave të Mbrojtura AdZM Kukës, AdZM Berat dhe AdZM Vlorë | | 990,397 | 990,397 |
| 7 | Agjencia Shtetërore për Shpronësim Tiranë | 560,230 | | 560,230 |
| 8 | AlbaFilm SHA | 2,988 | | 2,988 |
| 9 | Autoriteti i Aviacionit Civil | 21,998 | | 21,998 |
| 10 | Autoriteti Kombëtar i Ushqimit | 25,264 | 113,502 | 138,766 |
| 11 | Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit | 2,880 | | 2,880 |
| 12 | Autoriteti Portual Durrës | 273,815 | 160,204 | 434,020 |
| 13 | Avokatura e Shtetit | 41,691 | 1,038,622 | 1,080,313 |
| 14 | Bashkia Belsh | 0 | 33,979 | 33,979 |
| 15 | Bashkia Berat | 9,193 | 26,878 | 36,071 |
| 16 | Pasqyrat financiare, Bashkia Berat | 14,207 | 170,215 | 184,422 |
| 17 | Bashkia Bulqizë | | 48,912 | 48,912 |
| 18 | Bashkia Cërrik | 1,893 | 97,795 | 99,688 |
| 19 | Bashkia Delvinë | | 13,119 | 13,119 |
| 20 | Bashkia Dibër | 2,351 | 25,451 | 27,802 |
| 21 | Bashkia Dimal | | 37,630 | 37,630 |
| 22 | Bashkia Dropull | | 6,325 | 6,325 |
| 23 | Bashkia Elbasan | 29,714 | 21,348 | 51,062 |
| 24 | Pasqyrat financiare, Bashkia Elbasan | | 82,740 | 82,740 |
| 25 | Bashkia Fier | 13,000 | 221,752 | 234,752 |
| 26 | Pasqyrat financiare, Bashkia Fier | | 551,025 | 551,025 |
| 27 | Bashkia Fushë Arrëz | | 51,885 | 51,885 |
| 28 | Bashkia Gjirokastrë | | 37,125 | 37,125 |
| 29 | Bashkia Gramsh | 11,371 | 51,153 | 62,524 |
| 30 | Bashkia Has | 108 | 19,322 | 19,430 |
| 31 | Bashkia Këlcyrë | | 72,033 | 72,033 |
| 32 | Bashkia Klos | 9,202 | 31,526 | 40,728 |
| 33 | Bashkia Kolonjë | | 31,085 | 31,085 |
| 34 | Bashkia Konispol | 2,416 | 30,958 | 33,374 |
| 35 | Bashkia Korçë | | 118,842 | 118,842 |



| | | | | |
|----|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------|-----------|-----------|
| 36 | Bashkia Krujë | | 74,599 | 74,599 |
| 37 | Bashkia Kuçovë | 7,020 | 26,716 | 33,736 |
| 38 | Bashkia Kurbin | | 49,790 | 49,790 |
| 39 | Bashkia Lezhë | | 24,508 | 24,508 |
| 40 | Bashkia Libohovë | | 936 | 936 |
| 41 | Bashkia Librazhd | 133 | 26,875 | 27,008 |
| 42 | Bashkia Lushnje | | 80,772 | 80,772 |
| 43 | Bashkia Malësi e Madhe | | 14,556 | 14,556 |
| 44 | Bashkia Maliq | 0 | 79,246 | 79,246 |
| 45 | Pasqyrat financiare, Bashkia Maliq | 911 | | 911 |
| 46 | Bashkia Mallakastër | 59,951 | 30,763 | 90,714 |
| 47 | Bashkia Mat | | 59,734 | 59,734 |
| 48 | Bashkia Mirditë | | 2,450 | 2,450 |
| 49 | Bashkia Përmet | 697 | 16,455 | 17,152 |
| 50 | Bashkia Prrenjas | | 23,924 | 23,924 |
| 51 | Bashkia Pukë | 14,249 | 2,516 | 16,765 |
| 52 | Bashkia Sarandë | 22,142 | 59,971 | 82,113 |
| 53 | Bashkia Selenicë | 2,153 | 52,873 | 55,026 |
| 54 | Bashkia Shkodër | | 232,455 | 232,455 |
| 55 | Bashkia Skrapar | 4,157 | 16,755 | 20,911 |
| 56 | Pasqyrat financiare, Bashkia Skrapar | 2,696 | 2,837 | 5,533 |
| 57 | Pasqyrat financiare, Bashkia Tropojë | 14,575 | 19,784 | 34,359 |
| 58 | Bashkia Tropojë | 2,106 | 34,866 | 36,972 |
| 59 | Bashkia Vau i Dejës | | 291,674 | 291,674 |
| 60 | Bashkia Vlorë | 25,678 | 413,861 | 439,539 |
| 61 | Cirku i Tiranës | 19,814 | 797 | 20,611 |
| 62 | Dega Doganore Durrës | | 966,153 | 966,153 |
| 63 | Disponibiliteti i barnave në trajtimin e sëmundjeve tumorale | | 49,000 | 49,000 |
| 64 | Drejtoria e Përgjithshëm e Doganave (pjesa II) | | 5,359,927 | 5,359,927 |
| 65 | Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Publike | | 148,241 | 148,241 |
| 66 | Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve | 407,141 | | 407,141 |
| 67 | Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Korçë | 2,092 | | 2,092 |
| 68 | Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë | 1,365 | | 1,365 |
| 69 | Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës | | 496,134 | 496,134 |
| 70 | Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan | | 48,330 | 48,330 |
| 71 | Drejtoria Vendore të Policisë Shkodër | 9,139 | 39,580 | 48,719 |
| 72 | Fakulteti i Ekonomisë | | 85,834 | 85,834 |
| 73 | Fakulteti i Gjuhëve të Huaja | | 2,638 | 2,638 |
| 74 | Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor | 39,730 | | 39,730 |
| 75 | Fuqia energjetike dhe siguria e digës në kaskadën e Drinit, në KESH | 42,263 | | 42,263 |
| 76 | Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm | 1,223 | | 1,223 |
| 77 | Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit | 568,851 | | 568,851 |
| 78 | Instituti i Sigurimeve Shoqërore | 47,929 | | 47,929 |
| 79 | Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë | 11,076 | 32,577 | 43,652 |
| 80 | Korporata e Investimeve Shqiptare | 2,342 | 1,630 | 3,972 |
| 81 | Masat e ndërmarra nga institucionet përgjegjëse për eliminimin e derdhjes së ujërave të përdorura në Lumin e Lanës në Tiranë | 1,027 | | 1,027 |
| 82 | Ministria e Arsimit dhe Sportit | 26,118 | | 26,118 |
| 83 | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural | 187,758 | 19,207 | 206,964 |
| 84 | Ministria e Financave (aparati) | 29,340 | | 29,340 |
| 85 | Ministria e Financave mbi Zbatimin e Buxhetit | | 5,100,769 | 5,100,769 |



| | | | | |
|-----|------------------------------------------------------------------|------------------|-------------------|-------------------|
| 86 | Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale | 49,566 | | 49,566 |
| 87 | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit | 29,124 | | 29,124 |
| 88 | Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike | 881,192 | 1,399,977 | 2,281,168 |
| 89 | Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Drejtoria Rajonale Durrës | 58,622 | | 58,622 |
| 90 | Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Drejtoria Rajonale Shkodër | 13,783 | 96,757 | 110,539 |
| 91 | Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Drejtoria Rajonale Tiranë | 945,803 | 67,584 | 1,013,387 |
| 92 | Projekti: "Infrastruktura Bashkiake" | 44,543 | | 44,543 |
| 93 | Qendra Kombëtare e Kinematografisë | 1,407 | | 1,407 |
| 94 | Qendrën Burimore "Ramazan Kabashi" | 516 | | 516 |
| 95 | Rektorati (Universiteti i Tiranës) | | 4,322 | 4,322 |
| 96 | Rezidenca Studentore Universitare Nr. 2, SHA | 115 | | 115 |
| 97 | Shkolla e Magjistraturës | 1,343 | | 1,343 |
| 98 | Shoqëria Rajonale e Ujësllës Kanalizime, Lezhë Sha | 6,958 | | 6,958 |
| 99 | Shoqëria Rajonale Ujësllës Kanalizime, Elbasan | 2,346 | | 2,346 |
| 100 | Spitali Rajonal Shkodër | 2,101 | | 2,101 |
| 101 | Spitali Rajonal Vlorë | 1,097 | | 1,097 |
| 102 | Termocentrali i Vlorës SHA | 32,447 | | 32,447 |
| 103 | Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër | 9,444 | 20,057 | 29,501 |
| | Total | 4,950,494 | 19,667,208 | 24,617,703 |

ANEKSI 6: Evidenca e Masave Administrative dhe Disiplinore të rekomanduara

| Nr. | Subjekti/Tema | Masa Administrative | Masa Disiplinore | Total |
|-----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------|------------------|-------|
| 1 | "Mbi auditimin e procedurave të dhënies së lejeve, licencave dhe monitorimin e aktivitetit minerar me vendndodhje në Rasek, Shkodër". | | 1 | 1 |
| 2 | "Përmirësimi i sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit", në KESH | | 2 | 2 |
| 3 | "Roli dhe përgjegjësitë për monitorimin e mirëqenies së fëmijëve të birësuar" | | 1 | 1 |
| 4 | "Verifikimin e shkaqeve, pasojave dhe reagimit të institucioneve, lidhur me situatën e krijuar nga përmbytjet masive në qytetin e Vlorës" | | 17 | 17 |
| 5 | Agjencia Kombëtare e Bregdetit | | 28 | 28 |
| 6 | Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive | | 1 | 1 |
| 7 | Agjencia Kombëtare e Ujësllës Kanalizime | | 1 | 1 |
| 8 | Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura Tiranë, në Administratën e Zonave të Mbrojtura AdZM Kukës, AdZM Berat dhe AdZM Vlorë | | 1 | 1 |
| 9 | Agjencia Shtetërore për Shpronësim Tiranë | | 1 | 1 |
| 10 | Autoriteti i Aviacionit Civil | | 1 | 1 |
| 11 | Autoriteti Kombëtar i Ushqimit | | 1 | 1 |
| 12 | Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit | | 1 | 1 |
| 13 | Autoriteti Portual Durrës | | 61 | 61 |
| 14 | Avokati i Popullit | | 1 | 1 |
| 15 | Bashkia Belsh | | 16 | 16 |
| 16 | Bashkia Berat | 2 | 16 | 18 |
| 17 | Pasqyrat financiare, Bashkia Berat | | 4 | 4 |
| 18 | Bashkia Bulqizë | | 2 | 2 |
| 19 | Bashkia Dibër | | 19 | 19 |



| | | | | |
|----|--------------------------------------------------------------|----|----|----|
| 20 | Bashkia Dimal | | 8 | 8 |
| 21 | Pasqyrat financiare, Bashkia Dimal | | 1 | 1 |
| 22 | Bashkia Dropull | | 1 | 1 |
| 23 | Bashkia Durrës | | 2 | 2 |
| 24 | Bashkia Elbasan | | 13 | 13 |
| 25 | Pasqyrat financiare, Bashkia Elbasan | | 3 | 3 |
| 26 | Bashkia Fier | | 22 | 22 |
| 27 | Pasqyrat financiare, Bashkia Fier | | 1 | 1 |
| 28 | Bashkia Fushë Arrëz | | 1 | 1 |
| 29 | Bashkia Gjirokastrë | | 1 | 1 |
| 30 | Bashkia Gramsh | | 18 | 18 |
| 31 | Bashkia Has | | 1 | 1 |
| 32 | Bashkia Kamëz | | 1 | 1 |
| 33 | Bashkia Kavajë | | 1 | 1 |
| 34 | Bashkia Këlcyrë | | 11 | 11 |
| 35 | Bashkia Klos | | 15 | 15 |
| 36 | Bashkia Kolonjë | | 11 | 11 |
| 37 | Bashkia Konispol | | 13 | 13 |
| 38 | Bashkia Korçë | | 17 | 17 |
| 39 | Bashkia Krujë | | 3 | 3 |
| 40 | Bashkia Kuçovë | | 19 | 19 |
| 41 | Bashkia Kurbin | | 2 | 2 |
| 42 | Bashkia Librazhd | | 9 | 9 |
| 43 | Bashkia Lushnje | | 6 | 6 |
| 44 | Pasqyrat financiare, Bashkia Lushnje | | 1 | 1 |
| 45 | Bashkia Malësi e Madhe | | 2 | 2 |
| 46 | Bashkia Maliq | | 8 | 8 |
| 47 | Bashkia Mallakastër | | 9 | 9 |
| 48 | Bashkia Mat | | 2 | 2 |
| 49 | Bashkia Poliçan | | 1 | 1 |
| 50 | Bashkia Prrenjas | | 4 | 4 |
| 51 | Bashkia Pukë | | 1 | 1 |
| 52 | Bashkia Roskovec | | 1 | 1 |
| 53 | Bashkia Sarandë | | 25 | 25 |
| 54 | Bashkia Selenicë | 2 | 10 | 12 |
| 55 | Bashkia Shkodër | | 20 | 20 |
| 56 | Pasqyrat financiare, Bashkia Skrapar | | 2 | 2 |
| 57 | Pasqyrat financiare, Bashkia Tropojë | | 7 | 7 |
| 58 | Bashkia Tropojë | | 1 | 1 |
| 59 | Bashkia Vau i Dejës | | 3 | 3 |
| 60 | Bashkia Vlorë | 34 | 57 | 91 |
| 61 | Bashkia Vorë | | 1 | 1 |
| 62 | Dega Doganore Durrës | | 42 | 42 |
| 63 | Dega Doganore Rinas | | 8 | 8 |
| 64 | Disponibiliteti i barnave në trajtimin e sëmundjeve tumorale | | 29 | 29 |
| 65 | Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (Auditim përputhshmërie) | | 57 | 57 |
| 66 | Drejtoria e Përgjithshme e Doganave | | 18 | 18 |
| 67 | Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Publike | | 18 | 18 |
| 68 | Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve | | 3 | 3 |
| 69 | Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier | | 6 | 6 |
| 70 | Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Korçë | | 4 | 4 |
| 71 | Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë | | 5 | 5 |
| 72 | Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan | | 10 | 10 |



| | | | | |
|-----|----------------------------------------------------------------------------------------------------|---|-----------|------------|
| 73 | Drejtoria Vendore të Policisë Shkodër | | 1 | 1 |
| 74 | Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor | | 4 | 4 |
| 75 | Fuqia energjetike dhe siguria e digës në kaskadën e Drinit”, në KESH | | 1 | 1 |
| 76 | Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit | | 18 | 18 |
| 77 | Instituti i Sigurimeve Shoqërore | | 1 | 1 |
| 78 | Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë | | 41 | 41 |
| 79 | Korporata e Investimeve Shqiptare | | 1 | 1 |
| 80 | Mbi ofrimin e shërbimit të ushqimit në Spitalin Rajonal Korçë | | 1 | 1 |
| 81 | Mbi Përputhshmërinë e monitorimit të HEC “Sasaj” Sarandë | | 8 | 8 |
| 82 | Mbi përputhshmërinë në ofrimin e shërbimit rezidencial dhe procedurat për birësimin e të miturve | | 2 | 2 |
| 83 | Ministria e Arsimit dhe Sportit | | 7 | 7 |
| 84 | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural | | 5 | 5 |
| 85 | Ministria e Financave (Aparati) | | 3 | 3 |
| 86 | Ministria e Financave mbi Zbatimin e Buxhetit | 1 | 1 | 2 |
| 87 | Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale | 7 | 10 | 17 |
| 88 | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit | 2 | 1 | 3 |
| 89 | Ndotja e Liqenit Artificial të Tiranës | | 1 | 1 |
| 90 | Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike | | 1 | 1 |
| 91 | Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Drejtoria Rajonale Durrës | | 15 | 15 |
| 92 | Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Drejtoria Rajonale Shkodër | | 1 | 1 |
| 93 | Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Drejtoria Rajonale Tiranë | | 1 | 1 |
| 94 | Qendra Kombëtare e Kinematografisë | | 1 | 1 |
| 95 | Qendrën Burimore “Ramazan Kabashi” | 8 | 15 | 23 |
| 96 | Rektorati (Universiteti i Tiranës) | | 1 | 1 |
| 97 | Rezidenca Studentore Universitare Nr. 2, SHA | | 1 | 1 |
| 98 | Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime, Lezhë SHA | | 1 | 1 |
| 99 | Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime, Elbasan SHA | | 1 | 1 |
| 100 | Spitali Rajonal Shkodër | | 22 | 22 |
| 101 | Spitali Rajonal Vlorë | | 1 | 1 |
| 102 | Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër | 3 | 18 | 21 |
| 103 | Verifikim i ankesës së banorëve të fshatit Piskovë në lidhje me vend depozitimin e mbetjeve urbane | | 21 | 21 |
| | Total | | 59 | 916 |
| | | | | 975 |

ANEKSI 7: Evidenca e Masave Disiplinore të rekomanduara

| Nr. | Subjekti/Tema | Ligji nr. 152/2013 dt.30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil” Neni 58, shkronjat (a,b,c,ç) | Me Kodin e Punës dhe Kontratën Kolektive apo Individuale të Punës | Sipas kuadrit ligjor te institucionit përkatës | Total |
|-----|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------|-------|
| 1 | “Mbi auditimin e procedurave të dhënies së lejeve, licencave dhe monitorimin e aktivitetit minerar me vendndodhje në Rasek, Shkodër”. | | | 1 | 1 |



| | | | | | |
|----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|----|--|----|
| 2 | “Përmirësimi i sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit”, në KESH | | 2 | | 2 |
| 3 | “Roli dhe përgjegjësitë për monitorimin e mirëqenies së fëmijëve të birësuar” | | 1 | | 1 |
| 4 | “Verifikimin e shkaqeve, pasojave dhe reagimit të institucioneve, lidhur me situatën e krijuar nga përmbytjet masive në qytetin e Vlorës” | 8 | 9 | | 17 |
| 5 | Agjencia Kombëtare e Bregdetit | 28 | | | 28 |
| 6 | Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive | 1 | | | 1 |
| 7 | Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizime | | 1 | | 1 |
| 8 | Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura Tiranë, në Administratën e Zonave të Mbrojtura AdZM Kukës, AdZM Berat dhe AdZM Vlorë | 1 | | | 1 |
| 9 | Agjencia Shtetërore për Shpronësim Tiranë | | 1 | | 1 |
| 10 | Autoriteti i Aviacionit Civil | | 1 | | 1 |
| 11 | Autoriteti Kombëtar i Ushqimit | | 1 | | 1 |
| 12 | Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit | 1 | | | 1 |
| 13 | Autoriteti Portual Durrës | | 61 | | 61 |
| 14 | Avokati i Popullit | 1 | | | 1 |
| 15 | Bashkia Belsh | 16 | | | 16 |
| 16 | Bashkia Berat | 16 | | | 16 |
| 17 | Pasqyrat financiare, Bashkia Berat | 4 | | | 4 |
| 18 | Bashkia Bulqizë | 2 | | | 2 |
| 19 | Bashkia Dibër | 13 | 6 | | 19 |
| 20 | Bashkia Dimal | 8 | | | 8 |
| 21 | Pasqyrat financiare, Bashkia Dimal | 1 | | | 1 |
| 22 | Bashkia Dropull | 1 | | | 1 |
| 23 | Bashkia Durrës | 2 | | | 2 |
| 24 | Bashkia Elbasan | 13 | | | 13 |
| 25 | Pasqyrat financiare, Bashkia Elbasan | 3 | | | 3 |
| 26 | Bashkia Fier | 22 | | | 22 |
| 27 | Pasqyrat financiare, Bashkia Fier | 1 | | | 1 |
| 28 | Bashkia Fushë Arrëz | 1 | | | 1 |
| 29 | Bashkia Gjirokastrë | 1 | | | 1 |
| 30 | Bashkia Gramsh | 14 | 4 | | 18 |
| 31 | Bashkia Has | 1 | | | 1 |
| 32 | Bashkia Kamëz | 1 | | | 1 |
| 33 | Bashkia Kavajë | 1 | | | 1 |
| 34 | Bashkia Këlcyrë | 11 | | | 11 |
| 35 | Bashkia Klos | 4 | 11 | | 15 |
| 36 | Bashkia Kolonjë | 11 | | | 11 |
| 37 | Bashkia Konispol | 13 | | | 13 |
| 38 | Bashkia Korçë | 17 | | | 17 |
| 39 | Bashkia Krujë | 3 | | | 3 |
| 40 | Bashkia Kuçovë | 19 | | | 19 |
| 41 | Bashkia Kurbin | 2 | | | 2 |
| 42 | Bashkia Librazhd | 9 | | | 9 |
| 43 | Bashkia Lushnje | 6 | | | 6 |
| 44 | Pasqyrat financiare, Bashkia Lushnje | 1 | | | 1 |



| | | | | | |
|----|--------------------------------------------------------------------------------------------------|----|----|---|----|
| 45 | Bashkia Malësi e Madhe | 2 | | | 2 |
| 46 | Bashkia Maliq | 8 | | | 8 |
| 47 | Bashkia Mallakastër | 9 | | | 9 |
| 48 | Bashkia Mat | 2 | | | 2 |
| 49 | Bashkia Poliçan | 1 | | | 1 |
| 50 | Bashkia Përrenjas | 4 | | | 4 |
| 51 | Bashkia Pukë | 1 | | | 1 |
| 52 | Bashkia Roskovec | 1 | | | 1 |
| 53 | Bashkia Sarandë | 25 | | | 25 |
| 54 | Bashkia Selenicë | 10 | | | 10 |
| 55 | Bashkia Shkodër | 20 | | | 20 |
| 56 | Pasqyrat financiare, Bashkia Skrapar | 2 | | | 2 |
| 57 | Pasqyrat financiare, Bashkia Tropojë | 3 | 4 | | 7 |
| 58 | Bashkia Tropojë | 1 | | | 1 |
| 59 | Bashkia Vau i Dejës | 3 | | | 3 |
| 60 | Bashkia Vlorë | 57 | | | 57 |
| 61 | Bashkia Vorë | 1 | | | 1 |
| 62 | Dega Doganore Durrës | 33 | 9 | | 42 |
| 63 | Dega Doganore Rinas | 8 | | | 8 |
| 64 | Disponibiliteti i barnave në trajtimin e sëmundjeve tumorale | 29 | | | 29 |
| 65 | Drejtoria e Përgjithshëm e Doganave (Auditim përputhshmërie) | 57 | | | 57 |
| 66 | Drejtoria e Përgjithshme e Doganave | 18 | | | 18 |
| 67 | Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Publike | 18 | | | 18 |
| 68 | Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve | 1 | 1 | 1 | 3 |
| 69 | Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier | | 6 | | 6 |
| 70 | Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Korçë | | 4 | | 4 |
| 71 | Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë | | 5 | | 5 |
| 72 | Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan | 10 | | | 10 |
| 73 | Drejtoria Vendore të Policisë Shkodër | | 1 | | 1 |
| 74 | Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor | | 4 | | 4 |
| 75 | Fuqia energjetike dhe siguria e digës në kaskadën e Drinit”, në KESH | | 1 | | 1 |
| 76 | Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit | | 18 | | 18 |
| 77 | Instituti i Sigurimeve Shoqërore | | 1 | | 1 |
| 78 | Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë | 40 | 1 | | 41 |
| 79 | Korporata e Investimeve Shqiptare | | 1 | | 1 |
| 80 | Mbi ofrimin e shërbimit të ushqimit në Spitalin Rajonal Korçë | | 1 | | 1 |
| 81 | Mbi Përputhshmërinë e monitorimit të HEC “Sasaj” Sarandë | 1 | 7 | | 8 |
| 82 | Mbi përputhshmërinë në ofrimin e shërbimit rezidencial dhe procedurat për birësimin e të miturve | | 2 | | 2 |
| 83 | Ministria e Arsimit dhe Sportit | 7 | | | 7 |
| 84 | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural | 5 | | | 5 |
| 85 | Ministria e Financave (Aparati) | 3 | | | 3 |
| 86 | Ministria e Financave mbi Zbatimin e Buxhetit | 1 | | | 1 |



| | | | | | |
|-----|----------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|------------|----------|------------|
| 87 | Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale | 10 | | | 10 |
| 88 | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit | 1 | | | 1 |
| 89 | Ndotja e Liqenit Artificial të Tiranës | 1 | | | 1 |
| 90 | Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike | | 1 | | 1 |
| 91 | Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Drejtoria Rajonale Durrës | | 15 | | 15 |
| 92 | Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Drejtoria Rajonale Shkodër | | 1 | | 1 |
| 93 | Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Drejtoria Rajonale Tiranë | | 1 | | 1 |
| 94 | Qendra Kombëtare e Kinematografisë | | 1 | | 1 |
| 95 | Qendrën Burimore "Ramazan Kabashi" | | 15 | | 15 |
| 96 | Rektorati (Universiteti i Tiranës) | | 1 | | 1 |
| 97 | Rezidenca Studentore Universitare Nr. 2, SHA | | 1 | | 1 |
| 98 | Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Lezhë Sha | | 1 | | 1 |
| 99 | Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime, Elbasan | | 1 | | 1 |
| 100 | Spitali Rajonal Shkodër | | 22 | | 22 |
| 101 | Spitali Rajonal Vlorë | | 1 | | 1 |
| 102 | Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër | | 18 | | 18 |
| 103 | Verifikim i ankesës së banorëve të fshatit Piskovë në lidhje me vend depozitimin e mbetjeve urbane | 21 | | | 21 |
| | Total | 671 | 244 | 1 | 916 |

ANEKSI 8: Evidenca e Masave Administrative të rekomanduara

| Nr. | Subjekti/Tema | Masa administrative |
|-----|-------------------------------------------------|---------------------|
| 1 | Bashkia Berat | 2 |
| 2 | Bashkia Selenicë | 2 |
| 3 | Bashkia Vlorë | 34 |
| 4 | Ministria e Financave mbi Zbatimin e Buxhetit | 1 |
| 5 | Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale | 7 |
| 6 | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit | 2 |
| 7 | Qendrën Burimore "Ramazan Kabashi" | 8 |
| 8 | Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër | 3 |
| | Total | 59 |

Ky raport paraqet informacion mbi veprimtarinë e ushtruar nga KLSH përgjatë vitit 2025, duke përfshirë edhe çështje të finalizuara deri në momentin e paraqitjes së tij në Kuvend, të lidhura me këtë periudhë raportuese.



Pasqyrat financiare viti 2025


Në Lekë

| Nr. | Llogaria | EMËRTIMI | Viti 2025 | Viti 2024 |
|-----|----------|--------------------------------------------------------|--------------------|--------------------|
| 1 | A | AKTIVET | 635,582,169 | 667,305,811 |
| 2 | | I. Aktivët Afat shkurtër | 62,253,572 | 58,396,292 |
| 3 | | 1. Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre | 802,333 | 510,044 |
| 4 | 531 | Mjete monetare në Arke | | |
| 5 | 512,56 | Mjete monetare në Banke | | 15,200 |
| 6 | 520 | Disponibilitete në Thesar | 627,733 | 494,844 |
| 7 | 50 | Letra me vlerë | | |
| 8 | 532 | Vlera të tjera | 174,600 | |
| 9 | 54 | Akreditiva dhe paradhënie | | |
| 10 | 59 | Provigjone zhvlerësimi letra me vlerë (-) | | |
| 11 | | 2. Gjendje Inventari qarkullues | 10,742,502 | 10,576,247 |
| 12 | 31 | Materiale | 10,742,502 | 10,576,247 |
| 13 | 32 | Inventar i imët | | |
| 14 | 33 | Prodhim në proces | | |
| 15 | 34 | Produkte | | |
| 16 | 35 | Mallra | | |
| 17 | 36 | Kafshë në rritje e majmëri | | |
| 18 | 37 | Gjendje të pambërritura ose pranë të tretëve | | |
| 19 | 38 | Diferenca nga çmimet e magazinimit | | |
| 20 | 39 | Provigjone për zhvlerësimin e inventarit (-) | | |
| 21 | | 3. Llogari të Arkëtueshme | 50,708,737 | 47,310,001 |
| 22 | 411 | Klientë e llogari të ngjashme | | |
| 23 | 423,429 | Personeli, paradhënie, deficite, gjoba | | |
| 24 | 431 | Tatim e Taksa | | |
| 25 | 432 | Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal | | |
| 26 | 433 | Fatkeqësi natyrore që mbulohen nga shteti | | |
| 27 | 435 | Sigurime Shoqërore | | |
| 28 | 436 | Sigurime Shëndetësore | | |
| 29 | 437,438, | Organizma të tjerë shtetërorë | | |
| 30 | 44 | Institucione të tjera publike | | |
| 31 | 465 | Efekte për tu arkëtuar nga shitja e letrave me vlerë | | |
| 32 | 468 | Debitorë të ndryshëm | 2,972,409 | 2,972,409 |
| 33 | 4342 | Operacione me shtetin (Të drejta) | 47,736,328 | 44,337,592 |
| | 486 | Shpenzime të periudhave të ardhshme | | |
| 34 | 45 | Marrëdhënie midis institucioneve apo njësive ekonomike | | |
| 35 | 49 | Shuma të parashikuara për zhvlerësim(-) | | |
| 36 | | 4. Të tjera aktive afatshkurtra | 0 | 0 |
| 37 | 409 | Parapagime | | |
| 38 | 473 | Llogari e pritjes të marrëdhënieve me thesarin | | |
| 39 | 477 | Diferenca konvertimi aktive | | |
| 40 | 481 | Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime | | |
| 41 | 486 | Shpenzime të periudhave të ardhshme | | |
| 42 | | II. Aktivët Afat gjatë | 573,328,597 | 608,909,519 |
| 43 | 20 | 1. Aktive Afatgjatë jo materiale | 95,466,323 | 112,057,087 |
| 44 | 201 | Prime të emisionit dhe rimbursimit të huave | | |
| 45 | 202 | Studime dhe kërkime | 95,466,323 | 112,057,087 |
| 46 | 203 | Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme | | |
| 47 | 21 | 2. Aktive Afatgjatë materiale | 477,862,274 | 496,852,432 |
| 48 | 210 | Toka, Troje, Terrene | | |
| 49 | 211 | Pyje, Plantacione | | |
| 50 | 212 | Ndërtesa e Konstruksione | 420,462,780 | 439,794,729 |
| 51 | 213 | Rruge, rrjete, vepra ujore | | |
| 52 | 214 | Instalime teknike, makineri e pajisje | 25,457,595 | 26,802,968 |
| 53 | 215 | Mjete Transporti | 10,800,143 | 9,225,179 |
| 54 | 216 | Rezerva Shtetërore | | |
| 55 | 217 | Kafshë pune e prodhimi | | |
| 56 | 218 | Inventar ekonomik | 21,141,756 | 21,029,556 |
| 57 | 24 | Aktive afatgjatë të dëmtuara | | |
| 58 | 28 | Caktime të Aktiveve Afatgjatë | | |
| 59 | 25-26 | 3. Aktive Afatgjatë Financiare | 0 | 0 |



| | | | | |
|-----|----------|---------------------------------------------------------|--------------------|--------------------|
| 60 | 25 | Huadhënie e Nën huadhënie | | |
| 61 | 26 | Pjesëmarrje në kapitalin e vet | | |
| 62 | | 4. Investime | | |
| 63 | 230 | Për Aktive Afatgjata jo materiale | | |
| 64 | 231 | Për Aktive Afatgjata materiale | | |
| 65 | B | PASIVET (DETYRIMET) | 51,063,168 | 52,073,283 |
| 66 | | I. Pasivet Afat shkurtra | 51,063,168 | 52,073,283 |
| 67 | | 1. Llogari të Pagueshme | 51,063,168 | 52,073,283 |
| 68 | 401-408 | Furnitorë e llogari të lidhura me to | 0 | 4,541,750 |
| 69 | 42 | Detyrime ndaj personelit | 31,107,473 | 28,811,008 |
| 70 | 16,17,18 | Hua Afatshkurtra | | |
| 71 | 460 | Huadhënës | | |
| 72 | 431 | Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa | 4,834,462 | 4,278,990 |
| 73 | 432 | Tatime, mbledhur për llogari të pushtetit lokal | | |
| 74 | 433 | Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore | | |
| 75 | 435 | Sigurime Shoqërore | 11,774,403 | 11,247,594 |
| 76 | 436 | Sigurime Shëndetësore | | |
| 77 | 437,438, | Organizma të tjerë shtetërorë | | |
| 78 | 44 | Institucione të tjera publike | | |
| 79 | 45 | Marrëdhënie midis institucioneve apo njësjive ekonomike | | |
| 80 | 464 | Det. për tu paguar për bl. letrave me vlerë | | |
| 81 | 466 | Kreditorë për mjete në ruajtje | 354,421 | 221,532 |
| 82 | 467 | Kreditorë të ndryshëm | 20,000 | |
| 83 | 4341 | Operacione me shtetin (detyrime) | 2,972,409 | 2,972,409 |
| 84 | 49 | Shuma të parashikuara për zhvlerësim(-) | | |
| 85 | | 2. Të tjera pasive afatshkurtra | 0 | 0 |
| 86 | 419 | Kreditorë, Parapagime | | |
| 87 | 475 | Të ardhura për t'u regjistruar në vitet pasardhëse | | |
| 88 | 478 | Diferenca konvertimi pasive | | |
| 89 | 480 | Të ardhura për tu klasifikuar ose rregulluar | | |
| 90 | 487 | Të ardhura të arkëtuara para nxjerrjes së titullit | | |
| 91 | | II. Pasivet Afat Gjata | | |
| 92 | Klase 4 | Llogari të pagueshme | | |
| 93 | 16.17,18 | Hua Afatgjata | | |
| 94 | | Provigjone afatgjata | | |
| 95 | Klasa 4 | Të tjera | | |
| 96 | C | AKTIVET NETO/ FONDET (A-B) | 584,519,001 | 615,232,528 |
| 97 | D | FONDI I KONSOLIDUAR | 584,519,001 | 615,232,528 |
| 98 | 101 | Teprica (Fondi i akumuluar)/ Deficiti i akumuluar | 548,954,780 | 595,041,862 |
| 99 | 12 | Rezultatet e mbartura | | |
| 100 | 85 | Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore | 166,255 | |
| 101 | 111 | Rezerva | | |
| 102 | 115 | Nga Fondet e veta të investimeve | 10,349,187 | |
| | 15 | Shuma të parashikuara për rreziqe e Zhvlerësime | | |
| 103 | 105 | Teprica e Granteve kapitale të Brendshme | | |
| 104 | 106 | Teprica e Granteve kapitale të Huaja | 25,048,779 | 20,190,666 |
| 105 | 107 | Vlera e mjeteve të caktuara në perdorim | | |
| 106 | 109 | Rezerva nga Rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata | | |
| 107 | | Të Tjera | | |
| 108 | E | TOTALI I PASIVEVE (B+C) | 635,582,169 | 667,305,811 |





Telefon

+355 4 2247294



Email

klsh@klsh.org.al



website

www.klsh.org.al



Adresa

“Abdi Toptani”, Tiranë, Shqipëri

WWW.KLSH.ORG.AL